RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
MBI
"Auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë"

Bashkia Roskovec

Tiranë, tetor 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**1-4**
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	**4-5**
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	**5-6**
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	**6-8**
II.	**HYRJA**	**9**
1.	Objektivat dhe qëllimi	**9-10**
2.	Identifikimi i çështjes	**10**
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	**10**
4.	Përgjegjësitë e audituesve	**10-11**
5.	Kriteret e vlerësimit	**11-12**
5.	Standardet e auditimit	**12-13**
7.	Metodat e auditimit	**13-13**
8.	Dokumentimi i auditimit	**13-14**
III	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	**14-15**
	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	**15**
1.1	Auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	**15-29**
2.1	Auditimi mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	**30-36**
2.2	Vlerësimi dhe mbledhjes së të ardhurave	**36-61**
3	Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike	**61-75**
4	Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik	**75-106**
4.1	Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve	**106-124**
5	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit	**124-145**
6	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore	**146-153**
7	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike	**153-159**
8	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	**159-167**
IV	**REKOMANDIME**	**168-187**

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Bashkia Roskovec, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe Ligji nr. 68/2017, datë 24.07.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të Bashkisë Roskovec për periudhën e aktivitetit financiar për vitet 2024-2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në Fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Buxheti i Bashkisë Roskovec si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave kombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" nenit 50 "Auditi i jashtëm" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjorë".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Roskovec si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimet e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt. Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2024, deri në datën 31.12.2025. Objektivat e auditimit sipas drejtimeve të auditimit janë si vijon:

* Auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik për vitin 2025;
* Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit për vitin 2025;
* Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025;
* Auditim i prokurimeve;
* Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
* Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore;

* Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (aseteve dhe pyje kullotave) të transferuara sipas VKM;
* Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.
Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 60% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. **Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nénauditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 26 gjetje dhe ka dhënë 29 rekomandime, nga ku masa organizative me 19 gjetje dhe 20 rekomandime, 5 gjetje dhe 6 rekomandime në masën shpërblim dëmi në vlerën 37,484,657 lekë pa TVSh si dhe 2 gjetje dhe 2 rekomandime në fushën e të ardhurave për arkëtimin e detyrimeve debitore në shumën 230,413,548 lekë nga subjektet e biznesit dhe taksapaguesit familjarë.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:
-Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave.
-Mos nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjekë të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitore në shumën 230,413,548 lekë nga subjektet e biznesit dhe taksapaguesit familjarë, si dhe të bashkëpunojë me Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e debitorëve në mbyllje të vitit 2025;
-Të ardhura të munguara nga taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në vlerën 24,972,624 lekë në fund të vitit 2025, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec
-Bashkia Roskovec ka të dhëna vetëm për vlerën e arkëtuar nga këta agjentë, sipas vlerës së depozituar në thesar. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Roskovec ka kryer rakordimet mujore me Agjencisë Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Fier për vlerën e taksës së kalimit të pasurisë së paluajtshme (shitjes) për vlerën e taksës që i takon Bashkisë Roskovec. Arkëtimet për këtë taksë kalohen çdo muaj nga ASHKDVK referuar akt-rakordimeve mujore të taksës së shitjes së pasurisë së paluajtshme. Gjithashtu konstatojmë se Bashkia Roskovec, mos arkëtimet nga ana e D.R.V. ASHK Fier, janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Roskovec është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektesh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse.

- **Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve**

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Roskovec dhe Njësit Administrative të kaluara me VKM-të përkatëse, Sektori i Lejeve, Licencave dhe Administrimit të Pronave Publike nuk ka bërë regjistrimin e tyre në ASHK, nuk janë inventarizuar, nuk janë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet e të gjitha pronave si dhe mbledhjen e detyrimeve nga kontrata për dhënien me qira te ndërtesave/objekteve, në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe

të Ligjit nr. 20/2020,datë 05.03.2020, *"Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"*, neni 37,pika 1.

-Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Roskovec rezulton se për 8 raste, vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm është ekzekutuar nga IMTV në zbatim të nenit 41 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a), inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të proceseve të punës, në këtë rast të procesit të prishjes së objektit të kundërligjshëm, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Kryetari i Bashkisë Roskovec të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.
Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 594,444 lekë pa TVSh.
Titullari i Bashkisë Roskovec të gjitha masat e menjëhershme duke i kërkuar ASHK-së Roskovec- Fier, caktimin e një personi ekspert të fushës, që merret me Menaxhimin e Aseteve, me qëllim ngritjen e grupit të përbashkët për verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka Bashkia dhe NJA të transferuara në favor të tyre me VKM.
Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave në Bashkinë Roskovec, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2024 në vlerën 161,996,949 lekë.
Kryetari i Bashkisë Roskovec në cilësinë e Titullarit të AK të marrë masa që në komisionet e ngritura për hartimin e fondit limit të vendosen specialistë të fushës të pajisur me liçensat përkatëse.

1.1 Opinioni i Auditimit

Opinioni për auditimin e pasqyrave financiare[1]:

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të Bashkisë Roskovec, për vitin ushtrimor 2025, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdoruara dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Roskovec nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI.
Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare.
Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për

[1] - Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".

auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.
Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura duke marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 14,467 mijë lekë.
Për këto arsye kemi dhënë **Opinion të Kualifikuar**, sipas përshkrimit të çështjeve të mëposhtme:
-Nga auditimi i pasqyrës së flukseve të mjeteve monetare rezultoi se shumat në llogaritë sintetikë dhe analitike nuk janë të sakta, pasi janë keq klasifikuar, pavarësisht se llogaria "Teprica e likuiditeteve" si në çelje dhe në fund të vitit ushtrimor 2025 është sipas akt akordimit me thesarin.
-Në pasqyrën e performancës në të ardhurat e vitit ushtrimor 2025 është përfshirë gjendja e llogarisë 787 "Tërheqje nga seksioni i investimeve" në shumën 75,604,004 lekë, që përfaqëson të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës, dhe nuk mund të jenë pjesë e rezultatit të vitit ushtrimor, duke ndikuar në rezultat.
-Në pasqyrën e performancës gjendja e llogarisë 600 *'Paga, shpërblime e të tjera personeli"* për vitin 2025 paraqitet në shumën 184,246,609 lekë, ndërsa nga përllogaritja rezultoi në shumën 183,263,978 lekë, duke u mbivlerësuar me 982,631 lekë, duke ndikuar në rezultat.
-Në pasqyrën e performancës gjendja e llogarisë 601 *'Kontribute për sigurime"* për vitin 2025 paraqitet në shumën 30,123,300 lekë, ndërsa nga përllogaritja rezultoi në shumën 30,638,615 lekë, duke u nënvlerësuar me 515,315 lekë, duke ndikuar në rezultat.
-Në pasqyrën e performancës seksioni *"Shpenzime të tjera"* në mbyllje të vitit ushtrimor paraqitet në shumën 131,744,356 lekë, e cila sipas informacionit të dhënë përbëhet nga shuma prej 127,077,504 lekë investime nga të ardhurat + grant viti 2024 dhe detyrime të prapambetura nga të ardhurat për investime në fund të vitit 2025 në shumën 4,666,852 lekë, shumë kjo e fundit që nuk korrespondon me detyrimet për investime nga të ardhurat në fund të vitit 2025, që në fakt janë në shumën 41,984,399 lekë, pra me një diferencë në vlerën prej 37,317,547 lekë. Duhet theksuar se në seksionin *"Shpenzime të tjera"* janë kryer veprime të gabuara, pasi në këtë seksion evidentohen veprimet e korrigjimit të rezultatit, dhe llogaritë duhet të rakordojnë me llogaritë analoge në pasqyrat e tjera.
-Nga auditimi i llogarive të aktiveve afatgjata u konstatua se në gjendjet e llogarive (kosto historike) janë përfshirë vlera të grup aktivesh të pa analizuara të cilat janë të trashëguara nga bilanci i ish-komunave Roskovec të pa analizuara dhe që ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

II. <u>Opinioni mbi përputhshmërinë.</u>

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Roskovec për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2025, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky Raport realizon qëllimin e tij, në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Roskovec.
"Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Roskovec janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar, e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për Opinionin të Kualifikuar:

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Roskovec, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ISSAI 4000 dhe ISSAI 100. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në

përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 217, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Bashkia Roskovec dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e opinionit të kualifikuar .

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

Nga auditimi i 13 (trembëdhjetë) procedurave të prokurimit, për periudhën nga 01.01.2024 deri më 31.12.2025, me fond limit total prej 692,334,278 lekësh pa TVSH dhe vlerë totale kontratash prej 532,903,404 lekësh pa TVSH, auditimi evidentoi se:

- Në 7 raste janë përcaktuar kritere kualifikimi të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim apo të lidhura ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës.
- Në 5 raste, operatorët ekonomikë të shpallur fitues nuk rezultojnë në kushtet e plotësimit të kritereve të përcaktuara në DST.
- Në 2 raste, preventivi i punimeve është mbështetur në një manual çmimesh të shfuqizuar.
- Në 4 raste, procedurat nuk janë pajisur me leje ndërtimi/infrastrukture, në kundërshtim me kërkesat e nenit 39 të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar.
- Në 4 raste, nuk rezultoi të ishte kryer ose përfshirë oponencë teknike, megjithëse objektet e kontratave përbënin ndërtime publike ose me akses publik.

-Nga auditimi i zbatimit të kontratave në 4 objekte, rezultoi dëm ekonomik në vlerën **34,632,223 pa TVSh**, si rezultat i diferencave në volume pune.

-Nga auditimi i veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme përgjatë periudhës 01.01.2024-31.12.2025 u konstatua se:

-Nga IMTV nuk janë ushtruar kontrolle periodike për një periudhë të gjatë, si dhe nga Kryeinspektori nuk është përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga DTTV në Bashkinë Roskovec, rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë për taksat dhe tarifat vendore, ku në fund të vitit 2025 debitorët janë në shumën progresive prej 230,413,548 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH"*, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr.293/1 prot., datë 17.03.2026 i ndryshuar "Auditim Financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Roskovec", të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 24.03.2026 – 22.05.2026, në subjektin Bashkia Roskovec për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më datën 31.12.2025, u krye "Auditim Financiar dhe Përputhshmërie" nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Objektivat dhe qëllimi: Auditimi i Përputhshmërisë në Bashkinë Roskovec kishte si objektiva kryesore:

-Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

-Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315);

-Dhënien e opinionit dhe hartimin e Projekt Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Roskovec është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

2. Identifikimi i çështjes:Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi baze risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.
Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Roskovec, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.
Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Roskovec.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Kryetari i Bashkisë Roskovec(Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare., në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Roskovec, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.
NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.
Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.

KNJQV me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.
Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

4. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Roskovec në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispoizcion të auditimit.
Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.
Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.
Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Roskovec është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH-së kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.
Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit:
Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Roskovec është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Roskovec. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*";
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*";
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar;

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar;
- Ligji nr. 84/2022, datë 24.11.2022, "*Për buxhetin e vitit 2023*" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007, "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*" i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*";
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010, "*Për kundërvajtjet administrative*";
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015, "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore*";
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, "*Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 5, datë 27.12.2014, "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*" i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016, "*Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve*";
- Udhëzimi nr. 23, datë 30.07.2018, "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*";
- Udhëzimi nr. 10, datë 28.02.2020, "P*ër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023*";
- Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018, "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*";
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar;
- Etj.,.

6. Standardet e auditimit

-ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
-ISSAI 2000-2899 "Udhëzues të Auditimit Financiar";
-ISSAI 2300 "Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare";
-INTOSAI GOV 9100 "Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik"
-INTOSAI GOV 9110 "Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm";
-INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit,
-ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë" etj.;
-Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
-Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;

-Manuali i Auditimit të Brendshëm.
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
-Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.;
-Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

7. Metodat e auditimit

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales",* që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Roskovec me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale[2].

[2] ISSAI 1315

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.
Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon[3].
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur*; dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

8. Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit", i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rregullore e brendshme mbi organizimin dhe fonksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit miratuar me vendim të kryetarit të KLSH-së nr. 197 prot., datë 12.10.2022. Rregullore e procedurave të auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit miratuar me vendim nr. 07, datë 17.01.2024.
Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.
-Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u hartuan dhe u mbajtën 13 akt-konstatime dhe 1 Akt-verifikim.

[3] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Roskovec.

Bashkia Roskovec kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Lushnjë, në jug me Bashkinë Mallakastër, në lindje me Bashkinë Dimal, ndërsa në perëndim me Bashkinë Patos. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Roskovecit. Bashkia ka një sipërfaqe prej 118.01 km 2 . Në bazë të popullsisë së numëruar nga censusi, densiteti i popullsisë së bashkisë është 184 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrit civil densiteti rezulton 263.33 banorë/ km 2. Pjesë e bashkisë janë Njësitë Administrative Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan, e cila përfshin edhe fshatin Marinzë, që njihet veçanërisht si zonë naftëmbajtëse. Të ardhurat kryesore të banorëve vijnë nga ky sektori i naftës, në të cilin janë punësuar shumë prej banorëve të zonës. Gjithashtu, njësitë e tregtimit dhe shërbimeve janë një tjetër sektor ku janë punësuar shumë prej banorëve të qytetit të Roskovecit. Sa i takon zonave rurale, të ardhurat fitohen kryesisht nga prodhimet bujqësore dhe agrumet. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Auditimi në subjektin "Bashkia Roskovec", u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t'u audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës *(materiale por jo të përhapura)*, si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve, lejeve të ndërtimit etj.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga NJAB., fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

1. AUDITIM MBI KONTROLLIN E BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK PËR VITIN 2025.

1.1.Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-SË.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Roskovec si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e

konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

1.**Komponenti "Mjedisi i kontrollit":**

Në lidhje me parimin 1 "A*ngazhimin për integritet dhe vlerat etike"*

- Bashkia Roskovec ka Kod të Etikës të miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec nr.55. datë 22.02.2024 "për miratimin e kodit etik dhe të sjelljes të Bashkisë Roskovec", por edhe në nenin 17 të Rregullores së Brendshme, është përfshirë baza ligjore për etikën.
- Bashkia Roskovec ka miratuar Rregulloren e Brendshme të saj të funksionimit me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec nr.92. datë 11.04.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme të administratës së bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative në varësi Kurjan, Kuman dhe Strum ".
- Gjithashtu, Bashkia Roskovec ka miratuar dhe Rregulloren e Brendshme për parandalimin e Konfliktit të interesit të miratuar me Vendim të Titullarit nr.prot. 7323 datë 17.12.2019 të hartuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, por nuk ka trajnime për këto raste.

- Për procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, nuk ka një rregullore. Nga testimi rezultoi se nuk ka patur raste të raportuara të shkeljeve të kodit etik. Nuk ka programe të trajnimit nga ana e Bashkisë Roskovec për integritetin dhe sjelljen,
- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit(zyrën e marrëdhënieve me publikun), duke iu adresuar Kryetarit të Bashkisë dhe përgjigja kthehet nga zyrat përkatëse. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 34 të Rregullores së Brendshme.
-Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në 6 muaj.

Në lidhje me parimin 2 "Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje"

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse, që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë tij.

-Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme, në detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha niveleve janë përcaktuar mënyra e raportimit dhe realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike drejtuar Nënkryetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë. Për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

- Titullari merr opinione për përformancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit,

nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.
-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.
Në lidhje me parimin 3 "Titullari /NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë"
- Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Roskovec, e cila është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec nr.92 datë 11.04.2025.
- Është hartuar dhe miratuar dokumenti i PBA 2025-2027 me VKB nr.61, datë 30.09.2024, dhe është përfshirë në rregulloren e brendshme, neni 38, pika 5 "Detyrat dhe përgjegjësit e Drejtorisë Ekonomike". Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimet e menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.
- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e PBA-së, konfirmohet se kane marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat janë mbajtur procesverbale të takimeve të tyre, apo procesverbale të takimeve me grupet e interesit, si dhe për degjesat me publikun.
- Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike, dhe ka trajnime për këto raste nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit.
- Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike, pasi për ndonjë funksion të ndryshuar apo të shtuar pranë Drejtorive.
- Është hartuar plan i veprimit për menaxhimin financiar për periudhën e auditimit 2026 për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilin përfshihen, aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.
- Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë. Organograma e Bashkisë Roskovec është e ndërtuar në mënyrë të tillë që, 2 nën/Kryetarët dhe 10 drejtuesit e Drejtorive kryesore bashkë me 3 Administratorët e NJA e 1 Titullarin e institucionit të varësisë varen direkt nga Kryetari, ku dhe llogaridhënia është direkt tek Kryetari i Bashkisë në linjë horizontale, ndërsa nga niveli më i ulët specialist, përgjegjës sektori e specialistët llogaridhënia është në linjë vertikale. Strukturat organike sipas viteve janë:
Për vitin 2025 struktura organizative e Bashkisë Roskovec përbëhet nga Kabineti, 10 Drejtori, 3 Sektorë dhe 3 NJA me 188 punonjës gjithsej, e cila është miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 01, datë 06.01.2025 "Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum për vitin 2025" dhe Vendim të Kryetarit të Bashkisë Roskovec Nr. 152,datë 29.09.2025 "Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe NJA Kuman, Kurjan dhe Strum për vitin 2025".
- Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë saj. Për çdo Drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Po kështu edhe në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, kurse objektivat për secilin punonjës janë të pasqyruara në vlerësimet e punës.
- Bashkia Roskovec ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

- Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 "Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave"

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.
- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit në përputhje me ligjin për Shërbimin Civil, por nuk ka plan vjetor të rekrutimit.. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale, e cila përmbante dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: çertifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; çertifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

-Nga Bashkia Roskovec ka dërguar një shkresë me nr.prot. 1170/97, datë 17.10.2024 "Mbi vlerësimin e nevojave për trajnim për vitin 2025", bashkëlidhur me një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve për fusha të ndryshme, e cila ti dërgohej ASPA apo në institucione të tjera jashtë bashkisë (Organizata, Agjenci sipas fushave të ndryshme) për trajnimin e stafit me qëllim ngritjen profesionale sipas nevojave. (të dhënat për trajnime jashtë institucionit bashkëngjitur këtij materiali tabela)

-Për Bashkinë nëpunësi autorizues (NA) është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit. Është miratuar buxheti vjetor 2025 me VKB nr. 77, datë 23.12.2024 "Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarrjeve vartëse të bashkisë për vitin 2025", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. nr.1353/1 prot., datë 31.12.2024 dhe Programi Buxhetor Afatmesëm 2025-2027.

-Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

Në lidhje me parimin 5 "NjP vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale"

Në Rregulloren e Brendshme është parashikuar "funksionet/detyrat që delegohen" në zbatim të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokolli i institucionit rezulton se për periudhën objekt auditimi ka patur Urdhëresa për delegime detyrash.

-Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2019 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe udhëzimit të MFE nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore" Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Për vitin 2025 për hartimin e PBA 2025-2027 është ngritur GMS me 13 anëtarë dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve për 14 programe buxhetore me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.2613, datë 06.03.2024.

Në rregulloren e Brendshme neni 48, pika 6 është përcaktuar procedura për komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë, duke përfshirë dhe GMS, për të cilin përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e tij:

Nga verifikimi rezulton se GSM nuk ka kryer detyrat si:
-Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar
-Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

I. Komponenti "Menaxhimi i Riskut"

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.
Bashkia Roskovec në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva ashtu dhe në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë të përcaktuara në Planin e përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Roskovec. Këto objektiva bëhen të njohura, si në stafin e bashkisë nëpërmjet shkresave drejtuara Drejtorive dhe duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe në dëgjesat me publikun.
-Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të përformancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.
Në lidhje me parimin 7: "Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave"
Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.
Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, përcaktohet se '*Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësive të tij, nëpunësi autorizues mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës*.' Nuk ka Urdhër të Titullarit për përcaktimin e koordinatorit të riskut, si dhe mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut.
Në Bashkinë Roskovec mungon strategjia e menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Nuk është hartuar regjistri i riskut, ku të bëhej identifikimi dhe vlerësimi i risqeve për Drejtoritë përkatëse. Duke mos u përcaktuar koordinatori i riskut dhe grupi i menaxhimit të riskut si pasojë dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut.
Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.
Në lidhje me parimin 8: "Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime"
Krahas vlerësimit të riskut ,ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.
-Në Rregulloren e brendshme në nenin 13 janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.
Në lidhje me parimin 9: "Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm"

Bashkia Roskovec në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.
Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 21, pika 2; me Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 3 "Përgjegjësitë dhe detyrat e KR", pika 3.2.1 "Titullari i njësisë publike" pika 4 "Hapat për ngritjen e sistemit të MR" dhe - "Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.2, Kapitulli V, Anekset

II. <u>Komponenti: " Aktivitetet e Kontrollit"</u>

Në lidhje me parimin 10: " Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli"
-Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarte te zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj).
-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
-Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga NZ dhe autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA). Struktura e Drejtorisë Ekonomike përbëhet nga 3 punonjës, 1 drejtor, 1 përgjegjës Sektori.
-Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit. Detyrat dhe përgjegjësit e NjHDT dhe KVO janë parashikuar edhe kapitullin V të Rregullores së Brendshme.
-Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh dhe objekte prokurimesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurma e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga dega e Thesarit, e cila konfirmohet me regjistrimin në SIFQ dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.
-Në Rregulloren e Brendshme neni 25 " Punonjësi i arshivës," përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, <u>ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë</u>, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.
-Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve.

Në lidhje me parimin 11: "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë"

-Bashkia Roskovec nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë shkresore dhe elektronike.

Faqja Zyrtare e bashkisë Roskovec në internet ka një sistem back-up.

Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Në lidhje me parimin 12: "Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave"

-Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, ku përgjegjësitë janë të identifikuara në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, nuk ka plan-veprime të ndryshme operative për menaxhimin e riskut, pavarësisht pasi nuk është bërë identifikimi dhe vlerësimi i riskut sipas aktiviteteve.

-Në nenet 38 të rregullores së brendshme janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Ekonomike për të gjitha nivelet në të gjitha aktivitet e përfshira, duke eliminuar riskun që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar si hartim, miratim, zbatim, monitorim.

-Për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi merret Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës. Këto funksione janë përfshirë në detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre drejtorive neni 40 të rregullores së Brendshme.

-Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrolle dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. Pasqyrat Financiare konfirmohen nga NA dhe NZ.

Nga AB ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare kryhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 "Për hartimin e PF"). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar përcaktohet se '*Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi'*. Për sa më sipër, rezulton se Titullari i Bashkisë Roskovec për vitin 2025 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 5.2.7 "Monitorimi dhe Raportimi", me "Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

III. Komponenti: "Informimi dhe komunikimi"

Në lidhje me parimin 13: "Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor".

Drejtuesit në Bashkinë Roskovec kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacionale, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.
-Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe dërgohen në MFE. Ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analiza faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.
-Raportet për detyrimet e konstatuara, por të papaguara hartohen çdo muaj dhe paraqiten në degën e thesarit dhe çdo katër muaj në MFE. Stoku i detyrimeve të prapambetura për vitin 2025 është në vlerën 51,255 mijë lekë. Detyrimet dhe të drejtat janë paraqitur në llogaritë e klasës 4 në aktiv dhe pasiv të bilancit të PF.
-Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Roskovec për mbajtjen e kontabilitetit operon me program excel, pa e dubluar programin SIFQ. Regjistrimet apo evidentimi në SIFQ i transaksioneve financiare së bashku me dokumentet shoqërues kryhet nga Përgjegjësi i Drejtorisë Ekonomike. Në bazë të këtij programi kontabiliteti me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria Ekonomike dhe hartimi i pasqyrave financiare. Ndërsa monitorimi i të ardhurave kryhet me program Excel që e menaxhon DTT. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet. Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankës. Për lëvizjet AAGJM mbahen dokumente financiarë dhe për çdo vit kryhet inventarizimi i tyre. Për aktivet e amortizuara dhe pa vlerë përdorimi kryhen procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimi në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.
N**ë lidhje me parimin 14:** Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor.
Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm. Ka faqen e saj zyrtare. Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenet 14 "Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të administratës së Bashkisë", neni 15 "Marrëdhëniet me Këshillin bashkiak", neni 22 "Marrëdhëniet me publikun" neni 21 "Marrëdhëniet me Median". Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit herë pas here, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar.
Komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale. Për mbledhjet e ndryshme të stafit drejtues dhe të menaxherëve me këshillin Bashkiak janë mbajtur procesverbale. Në faqen e Bashkisë Roskovec janë të publikuar dokumentet kryesore, broshura, planet strategjike, raportet periodike, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e Bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet, që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.
-Ka raporte periodike dhe publikime vjetore për përformancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.
-Nga Bashkia Roskovec kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të evidentuara në dokumentin e konsultimit publik.
Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Roskovec ka një faqe zyrtare web në të cilën paraqiten informacione për publikun.

IV. <u>Komponenti: "Monitorimi"</u>

Në lidhje me parimin 16: "Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme"
-Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e

bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.
-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efiçencës e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.
-Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të MFK, pranë MF.
-Për **vitin 2025** me shkresën nr.prot.1590, datë 25.02.2026, të cilat janë dërguar Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave "Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Roskovec dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm".
Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë në këto drejtime kryesore:

1. Vlerësimi i përformancës së Aparatit të Bashkisë nëpërmjet monitorimit.
2. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas përshkrimit në pyetësorin e vetëvlerësimit. Veprimtaria e sektorit të Auditit të Brendshëm në investigimin e drejtorive të Aparatit të Bashkisë dhe njësive vartëse.
3. Rekomandimet të metat dhe mangësitë e gjetura.
4. Hartimi i plan-veprimeve për zbatimin e rekomandimeve dhe sidomos për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që përshkruhen në aktivitete e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe në përshkrimin e komponentëve të MFK.

Pjesë e Deklaratës është edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës**.**
Kjo realizohet nëpërmjet:
Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efiçencës e të efektivitetit.
Realizimit të "gjurmës së auditimit" që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.
Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.
-Në Bashkinë Roskovec mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, por është hartuar plani i veprimit për ecurinë e sistemit të MFK.
-Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH, gjithashtu ka rekomandime edhe nga Auditi i brendshëm.

-Në Bashkinë Roskovec aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

-Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Për vitin 2025 nga Auditi i Brendshëm janë realizuar 9 angazhime auditimi në drejtoritë: DTT, DE, DPKZHT, DZHRSH, SMAPÇ, IMT dhe disa kontrolle me tematika të ndryshme.

Në lidhje me parimin 17: "Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë"

-Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo të në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

-Titullari i këtij institucioni si për rekomandimet e lëna nga KLSH edhe për ato të lëna nga Auditi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Konkluzion: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë Roskovec është konstatuar se nuk është bërë mjaftueshëm në lidhje me:

"Mjedisin e kontrollit"

-Nga Bashkia Roskovec nuk është hartuar plan i veprimit për menaxhimin financiar për periudhën e auditimit 2025 për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilin përfshihen, aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Për periudhën 2025 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, i cili nuk ka kryer detyrat për vendosjen e rregullave të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.

-Mungon një rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit e mbrojtjen e konfidencialitetit.

"Menaxhimin e Riskut"

Bashkia Roskovec nuk ka hartuar një strategji risku; nuk është hartuar regjistri i riskut; nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe nuk është ngritur grupi i punës së riskut. Mungojnë planet e veprimit për menaxhimin e riskut dhe nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të përformancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

"Aktivitetet e Kontrollit"

-Titullari i Bashkisë Roskovec për vitin 2025 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK. Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up)apo për ruajtjen e tij.

"Informimin dhe komunikimin"

-Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

-Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e SMFK. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.
Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 dhe ngarkon me përgjegjësi strukturat drejtuese dhe pjesë e GMS zj. M.B. në funksionin e Kryetarit të Bashkisë, z.M.G. me detyrë nën/Kryetar i Bashkisë dhe zj. H. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm e (në cilësinë e koordinatores së MFK).

1.2. Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

- **Organizimi dhe Funksionimi:** Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve për ngritjen e NJAB në sektorin publik" Bashkia Roskovec ka ngritur NJAB. Për **vitin 2025** NJAB ka funksionuar me 3 audites sipas strukturës organizative të përcaktuar nga Titullari i Bashkisë me vendim nr. 01 datë 06.01.2025.

Konkluzion: Për vitin 2025 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 3 (audites), pasi në strukturën e miratuar nr.01 datë 06.01.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec për vitin 2025" në të cilën është përcaktuar 3 punonjës 1 Përgjegjës i Sektorit të Auditit, dhe dy specialist. Struktura e NJAB, niveli i arsimit, çertifikimi, përvoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten sipas tabelës se mëposhtme:

Nr.	Periudha 2025	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime te vijueshme
1	E.C	**Pergjegjes**	**Finance**	**6**	**6**	**2023**	**PO**
2	F.G	**Auditues**	**Finance**	**4**	**1**	**Ne proces**	**JO**
3	H.S	**Auditues**	**Finance**	**2**	**1**	**2025**	**JO**

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes të punonjësit të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se 2 punonjës janë të certifikuar si audites të brendshëm dhe një punonjës është në proces certifikimi dhe kanë ndjekur në mënyrë të vazhdueshme trajnime për kualifikimin profesional në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" nenet 11, "Punësimi i Auditit të Brendshëm" neni 19 "Certifikimi i audituesve të brendshëm" dhe neni 20 "Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm". Ndërsa 2 punonjësit e rekrutuar në vitin 2025, 1 është në proces certifikimi dhe 1 është i pa certifikuar, kanë eksperiencë në fushën e Auditimit vetëm rreth 1 vit dhe nuk ka ndjekur trajnime.

- **Komiteti i Auditit të Brendshëm:** Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"neni 13 "Komitetit të Auditimit të Brendshëm" i cili përcakton se: *:"Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:*
a) duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;
b) duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;
c) duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
ç) duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;
d) duke monitoruar zbatimin e rekoman-dimeve të dhëna;
dh) duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.
2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.

3. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

- **Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik**

NJAB në mbështetje te Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" ka hartuar "Kartën e Auditimit të Brendshëm ne sektorin publik" në Bashkinë Roskovec, e cila është miratuar nga titullari me urdhrin nr. 108/1 ,datë 10.01.2025, si dhe Rregullore e Brendshëm për Sektorin e Auditimit të Brendshëm , e cila është miratuar nga titullari me urdhrin nr. 108, datë 10.01.2025, dhe Kodi Etik për Sektorin e Auditimit të Brendshëm , e cila është miratuar nga titullari me urdhrin nr. 108/2, datë 10.01.2025. Krahas këtij dokumenti janë hartuar dhe dokumentet në funksion të punës audituese si:
- Është krijuar dhe përditësuar Regjistri i Riskut për Sektorin e AB me nr. 132 prot, datë 18.02.2025 si dhe nr. 43 prot., datë 07.01.2026.
- Gjurma e Auditimit të Brendshëm për Sektorin e AB me nr. 133 prot, datë 18.02.2025 si dhe nr. 42 prot., datë 07.01.2026.
- Programi i Sigurimit të Cilësisë për Sektorin e AB me nr. 134/1 prot, datë 18.02.2025 si dhe nr. 29 prot., datë 07.01.2026.
- Aneksi nr. 7/5 vlerësimi për menaxhimin financiar dhe kontrollin për vitin 2025,
- Aneksi nr. 7/6 vlerësimin e performancës së Sektorit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2025
- Aneksi nr. 7/3 Lista e kontrollit për të vlerësuar cilësinë e kritereve gjatë vetëvlerësimit periodik të cilësisë së brendshme të strukturës së AB për vitin 2025.

- **Planet Strategjike dhe Vjetore:**

Ne mbështetje te Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:
Për vitin 2025 me shkresën nr.7743/1, datë 16.10.2024 është miratuar plani strategjik i auditimit për vitet 2025-2027 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2025, i ndryshuar me nr. 329 prot., datë 16.01.2025. Këto plane janë dërguar zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", si dhe urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", me shkresën nr. 7743/1/1 prot, datë 16.10.2025.
Njësia e AB në Bashkinë Roskovec mbulon me auditim: Bashkia Roskovec, 3 Njësitë Administrative dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike. NjAB në hartimin e këtyre planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuara, dhe ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve.

- **Realizimi i Planeve Vjetore:**

- **Për vitin 2025** janë parashikuar gjithsej 9 auditime në Bashki dhe Ndërmarrja, ku sipas llojit janë të përputhshmërisë dhe kombinuar. Plani i angazhimeve në fillim të vitit përputhet me realizimin e auditimeve në fakt si për nga numri, objekti dhe lloji, duke u realizuar në masën 100%. Nuk ka patur ndryshime. Realizimi e auditimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financë	Kombinuar	Performancë	Tjera
4	Viti 2025	9	11	10		1		

Raportimi : Për veprimtarinë e NJAB Në Bashkinë Roskovec për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB te Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht: Me shkresën nr.1067 prot, datë 10.02.2025, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së NJAB, Bashkia Roskovec për vitin 2025. Të dhënat për realizimet e angazhimeve nga AB për auditimet e kryera paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Nr.	Subjektet e Audituara	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimit	
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshilimi	Angazhime me kërkesë të titullarit	Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces
			A. të përputhshmërisë	A. të performancë	A. financiare	A. tek. Informacionit	A. të kombinuara				
1	Dr. Ekonomi (Sektori i Prokurimeve)		**1**								
2	Detyrimet e prapambetura		**1**								
3	Drejt Ekonomike (Sektori Financës						**1**				
4	Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës.										
5	Verifikimi i Zbatimit të Rekomandime të dhëna në auditimet e mëparëshme		1								
6	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik		1								
7	Ndërmarrja e Pyjeve, Ujitjes e Kullimit Mirëmbajtje Rruge e Varreza		1								
8	Qendra Ekonomike Arsimore		1								
9	Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit		1								

- **Gjetje-Rekomandimet:**

Një aspekt mjaft i rëndësishëm i aktivitetit audites është dhënia e rekomandimeve në përfundim të auditimeve, ku:
Për vitin 2025 Nga auditimet janë dhënë 29 rekomandime, nga të cilat 24 janë rekomandime të karakterit organizativ dhe 5 rekomandim për arkëtim të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
4	Viti 2025	29	15	14	-	5		5	
TOTALI		**29**	**15**	**14**	**-**				

Ndjekja e zbatimi i rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve te manualit te A.B. NJAB u ka dërguar shkresa njësive të audituara për informim mbi nivelin e zbatimit te tyre dhe ne auditimin e radhës është çështja e zbatimit te rekomandimeve trajtohet si çështje kryesore. Rekomandimet sipas llojit dhe statusit të realizimit në subjektet e audituara, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2025	STATUSI I REKOMANDIMEVE			
			Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi
1.	Dr. Ekonomike (Sektori i Prokurimeve)	5			4	1
2.	Detyrimet e prapambetura	4				4

3	Drejtoria Ekonomike (Sektori Financës	5			2	3
4	Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës.	2				2
5	Verifiki i Zbatimi të Rekomand të dhëna në auditimet e mëparëshme	1				1
6	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	3			1	2
7	Ndërmar e Pyjeve, Ujitjes e Kullimie Mirëmbajtje Rruge e Varreza	4			4	
8	Qendra Ekonomike Arsimore	2			1	1
9	Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit	3			3	
		29			15	14

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se nga 29 masa të rekomanduara, janë pranuar 29 rekomandime, nga këto 15 rekomandime janë zbatuar, 14 rekomandime janë proces zbatimi, ndërsa rekomandime të pa zbatuara nuk ka.

- **Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm.**

Nga auditimi i detajuar i 6 dosjeve të auditimeve të kryera në vitin 2025 në subjektet: DZHE; Detyrimet e prapambetura; Qendra Ekonomike Arsimore; DPZHTMP; DE (Sektori i Prokurimeve) Në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit për:

a- Letrat e punës së auditimit në fazën përgatitore të programit ;

b- Letrat e punës në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit, hartimit të Projekt Raportit dhe Raportit Final nga audituesit ;

c- Bazueshmërinë ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standartet e auditimit, rezultoi se nuk janë respektuar me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 11, neni 12, shkronja "d", neni 19 dhe neni 20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "Për miratimin e MAB në sektorin publik" i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në MAB miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016", Kapitulli II 2.4.1 "Auditimi i përputhshmërisë" dhe 2.4.2 "Auditimi financiar"; Kapitulli III, pika 3.5; Kapitulli IV pika 4.1.1 "planifikimi i një angazhimi auditimi", pikës 4.1.11 dhe 4.1.12; Kapitulli VI "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese" pika 6.1 "Niveli i dokumentimit"; Kapitulli VII "Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm" pika 7.1.1 "Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë NjAB", kështu:

Në dosjet e auditimit mungon Memo e planifikimit, pra projektdrafti i programit te auditimit në fazën përgatitore të hartimit të programit të angazhimit, në të cilën duhet të përfshihet:

- Madhësia dhe kompleksiteti i njësisë, pra të kuptuarit dhe përshkrimi i mjedisit (universit) të auditimit, duke plotësuar edhe ;
- Kompleksitetin dhe riskun e sistemit/fushës që auditohet, duke plotësuar edhe Formatin e përgjithshëm të riskut;
- Plotësimi i Formatit të vlerësimit të riskut për sistemin/fushën që auditohet, përllogaritja e koeficientit të riskut për sistemin që auditohet. Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit, duke plotësuar edhe Formatet 4 e 5.
- Përcaktimi i objektivave në bazë të rezultateve të vlerësimit të riskut.
- Eksperienca dhe numri i audituesve;
- Përgjegjësitë individuale të çdo audituesi;
- Kohëzgjatja(ose afatet kohore);
- Buxheti dhe afati kohor për angazhimin e auditimit;
- Masat për sigurimin e cilësisë;

- Raportet në përmbajtjen e tyre ka rubrika dhe përshkrime jo korrekte, të pa qarta, nuk përcaktohet kampioni i testimit, trajtimi çështjeve nuk është bërë konkret, i plotë dhe i detajuar, duke mos mbështetur dhënien e ndonjë opinioni apo vlerësim përfundimtar.
- NJAB në drejtimet e auditimi ka përfshirë në të gjitha angazhimet e auditimit menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit

të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara

- Në shumicën e rasteve rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirëpërcaktuara, i referohen bazës ligjore, pra "në zbatim të akteve ligjore"', duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem. Për rekomandimet e adresuara nuk është përcaktuar afati i zbatimit të tyre dhe për disa raste nuk është përcaktuar nivelin i rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët);
- Në formulimin e gjetjeve ka mangësi, pasi në të shumtën e rasteve situata e përshkruar është i karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë, hallka që nuk ka funksionuar dhe mosveprimet konkrete, nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kujt viti i referohet, si dhe nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i detajuar i mospërputhshmërisë apo raportimit financiar për problematikën e konstatuar nga auditimi në kundërshtim me pikën 2.4.1 "Auditimi i përputhshmërisë" dhe 2.4.2 "Auditimi financiar"
- Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera në fakt nga Sektori i Auditimit të Brendshëm nuk janë realizuar në formë të thelluar sistemet objekt auditimi, ku shfaqen problematika më me prioritet të lartë risku si: i planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit, në sistemin e prokurimeve, sistemin e raportimit të pasqyrave financiare, në sistemin e shërbimeve publike, në sistemin e të ardhurave etj. Mungojnë auditimet në sistemin e administrimit dhe menaxhimit e aseteve etj.

Konkluzion: Nga audititmi i funksionimit të NjAB rezulton se në dosjet e auditimit mungojnë: projektdrafti i programit te auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit me të gjitha elementët e tij; Në programet e auditimit pavarësisht se është përfshirë si drejtim "vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm", vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht; Raportet në përmbajtjen e tyre ka rubrika dhe përshkrime jo korrekte, të paqarta, nuk përcaktohet kampioni i testimit, trajtimi çështjeve nuk është bërë konkret, i plotë dhe i detajuar, duke mos mbështetur dhënien e ndonjë opinioni apo vlerësimi përfundimtar; Në formulimin e gjetjeve ka mangësi, pasi në të shumtën e rasteve situata e përshkruar është i karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë, hallka që nuk ka funksionuar dhe mosveprimet konkrete, nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kujt viti i referohet, si dhe nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i detajuar i mospërputhshmërisë apo raportimit financiar për problematikën e konstatuar nga auditimi; Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirëpërcaktuara, i referohen bazës ligjore, pra "në zbatim të akteve ligjore", duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve, të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem, nuk është përcaktuar afati i zbatimit të tyre dhe në disa raste nuk është përcaktuar niveli i rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët); Në auditimet e kryera për zbatim të rekomandimeve nuk është dhënë asnjë opinion apo analizë mbi arsyet e mos realizimit, dhe nuk përcaktohen masat që duhet të marrë menaxhimi i subjektit të audituar për realizimin e tyre. Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera në fakt për periudhën objekt auditim nuk janë realizuar në formë të thelluar sistemet objekt auditimi, ku shfaqen problematika me prioritet të lartë risku si i planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit, në sistemin e prokurimeve, sistemin e raportimit të pasqyrave financiare, në sistemin e shërbimeve publike, në sistemin e të ardhurave etj. Mungojnë auditimet në sistemin e administrimit dhe menaxhimit e aseteve etj.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 11, neni 12, shkronja "d", neni 19 dhe neni 20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të

MFE nr.4 datë 10.01.2020 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në MAB miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016", Kapitulli II 2.4.1 "Auditimi i përputhshmërisë" dhe 2.4.2 "Auditimi financiar"; Kapitulli III, pika 3.5; Kapitulli IV pika 4.1.1 "Planifikimi i një angazhimi auditimi", pikës 4.1.11 dhe 4.1.12

Përsa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi: zj. E.Ç. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Auditit të Brendshëm.

Për sa është trajtuar në aktet e konstatimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 5077/prot datë 03.07.2026, ardhur në Klsh me nr nr293/6, datë 06.07.2026 nga Z/Znj Eva Hati, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë

Pretendimi i subjektit të audituar

- Në lidhje me konstatimin se mungojnë trajnimet e audituesve të brendshëm, theksojmë duke saktësuar se janë ndjekur trajnime të organizuara nga institucionet kombëtare ose ndërkombëtare si dhe publikime në fusha që lidhen me auditimin e brendshëm, si dhe trajnimi i vijueshëm nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për te cilat ju dërgojmë materialet e mëposhtme.

- Në lidhje me konstatimin se në dosjet e auditimit të realizuara nga NJAB nuk është dokumentuar letrat e punës së auditimit në fazën përgatitore të programit si dhe në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit, hartimin e projekt Raportit nga audituesit, pretendojmë se në çdo dosje është dokumentuar procesi ndarjes së detyrave për secilin anëtar të grupit të punës për të cilat ju dërgojmë materialet e mëposhtme.

- Për pikat e tjera të konstatuara në akt konstatim janë marrë masa në bazë të manualit të ri për zbatimin e tyre.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH

- Në observacionin e bërë meqenëse janë sjellë dokumente si për çështjen e trajnimit të audituesve që vërtetojnë disa trajnime të kryera për secilin auditues, për çështjen e certifikimit të audituesit të dytë edhe pse certifikata është sjellë me vonesë, edhe për audituesin e tretë është deklaruar së është në proces certifikimi, observacioni merret në konsideratë.
- Po ashtu edhe për konstatimin se dosjeve të auditimit u mungon dokumenti i ndarjes së detyrave për secilin anëtar të grupit të auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur disa dokumente të ndarjes së detyrave për dosje të ndryshme auditimi, për këtë arsye observacioni merret në konsideratë.
- Ndërsa për çështjen se mungon dokumenti i projekt-draftit të programit të auditimit me gjithë elementët e tij sqarojmë se nuk ka të bëjë nëse janë dokumentuar letrat e punës gjatë auditimit, por ka të bëjë me një dokument që hartohet para hartimit të programit të angazhimit me të gjitha elementet e listuara më lart sipas MAB, kështu observacioni për këtë çështje nuk merret në konsideratë, pasi nuk ka argument ligjor.

2. **Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;

2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.

2.3.Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor (grande dhe të ardhura) dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

- ***Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin e PBA dhe programimit të buxhetit vjetor.***

- *Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2025-2027*

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2025-2027 dhe PBA 2026-2028 u konstatua se:

- Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA **është ngritur GMS** për PBA 2025-2027 me Urdhrin nr. 2613 datë 06.03.2024 dhe për PBA 2026-2028 me Urdhrin nr. 2715 datë 27.02.2025.
- Është përgatitur dhe miratuar **kalendari i menaxhimit buxhetor** për vitin 2025 me VKB nr.78 datë 23.12.2024 dhe për PBA 2025-2027 dhe buxhetin vjetor 2025 me VKB nr. 77 datë

31.12.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkesën nr.prot. 1353/1, datë 31.1.2024, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 33/1.

- Janë miratuar për PBA 2025-2027 me VKB nr. 11 datë 19.02.2024 "Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2025-2027.
- Janë miratuar në Këshillin Bashkiak **tavanet përgatitore** për PBA 2025-2027 me VKB nr.22, datë 25.03.2024, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 365/1 prot., datë 03.04.2024 në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 34/6.
- PBA 2025-2027 **faza e parë** është miratuar me VKB nr. 38, datë 28.06.2024 dhe është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 712/1 datë 10.07.2024, e cila është dërguar në MF me shkresën nr. 4084, datë 03.06.2024.
- **Tavanet përfundimtare** të PBA 2025-2027 janë miratuar me VKB nr. 45, datë 31.07.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 837/1 prot., datë 13.08.2024, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 34/6.
-**Faza e dytë** e PBA 2025-2027 është miratuar me VKB nr. 61, datë 30.09.2024, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 10361/1, datë 08.10.2024 dhe është ngarkuar ne SMBV me date 15.09.2024

PBA 2025-2027 është përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar shoqëruar me relacion shpjegues, i cili përmban: rolin dhe qëllimin e PBA-së, vështrim të përgjithshëm të njësisë dhe orientimin afatgjatë të saj, të ardhurat dhe shpenzimet, planin e shpenzimeve 2025-2027, sipas programeve buxhetore, detyrimet e prapambetura, treguesit financiarë dhe rreziqet financiare e fiskale.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetit vjetor janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "Buxhetimit me pjesëmarrje", ku për të cilat janë mbajtur relacionet dhe protokollet përkatëse sipas datave: 30.11.2024 dhe 05.12.2024.

-**Buxheti vjetor 2025** dhe **PBA 2025-2027** është miratuar me VKB nr. 77, datë 31.12.2024, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1353/1datë 31.12.2024.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2025-2027 dhe buxhetit vjetor, rezulton se **janë hartuar mbi bazën e kërkesave** shkresore nga Njësitë Administrative, nga njësitë vartëse dhe nga Drejtorët e Drejtorive të bashkisë Roskovec në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, nga kërkesat e sektorëve të ndryshëm, që mbulojnë këto programe si dhe nga kërkesat e mbledhura në dëgjesat publike.

-Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investimet dhe të ardhurat. Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2025-2027 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2025		Viti 2026		Viti 2027	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	298,385	42.94%	298,444	42.56%	299,064	42.27%
2	Sigurime (601)	48,784	7.02%	48,784	6.96%	48,784	6.89%
3	Shpenzime operative (602)	85,662	12.33%	80,361	11.46%	75,330	10.65%
4	Shpenzime (605)	0	0%	0	0%	3,500	0.49%
5	Shpenzime (604)	8,812	1,27%	10,000	1.43%	10,000	1.41%
6	Shpenzime (606)	2,660	0.38%	3,500	0.50%	2,000	0.28%
7	Shpenzime (609)	1,500	0.22%	2,000	0.29%	0	0%
8	Shpenzime për investime (230-231)	249,078	35.84%	258,191	36.82%	268,895	38%
	TOTALI	**694,881**	**100%**	**701,280**	**100%**	**707,573**	**100%**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, përpunuar nga grupi i auditimit*

- *Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2025.*

Buxheti **për vitin 2025** është miratuar me VKB nr. 77, datë 23.12.2024, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1353/1 datë 31.12.2024. Plani fillestar i miratuar për vitin 2025 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar i vitit 2025	
		Të ardhurat	Shpenzimet
1	Transferta e pakushtëzuar	181,783	
2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	74,078	
3	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore + Institucionet e varësisë	365,069	
4	Të ardhura të tjera	20,000	
1	Shpenzime për paga (600)		250,877
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601)		40,965
3	Shpenzime operative		84,510
4	Subvencione (603)		0
5	Transferta (604+606)		13,500
6	Fondi rezervë+Fondi I kontigjencës (609)		2,000
7	Shpenzimet kapitale (230+231)		249,078
8	Principali+Interesi I kredisë (166+651)		0
	Total	**640,930**	**640,930**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, përpunuar nga grupi i auditimit*

Me VKB nr. 21, datë 26.03.20225 është miratuar "Përdorimi e të ardhurave të trashëguara të vitit 2024 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2025", i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr.393/1, datë 04.04.2025, të detajuara si më poshtë:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani I vitit 2025	
	Të ardhurat	Të ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara nga transferta e pakushtëzuar	46,304	
2	Të ardhura të trashëguara nga transferta e pakushtëzuar sektoriale	0	
3	Të ardhura të trashëguara nga transferta e pakushtezuar per detyrimet e prapambetura	11,403	
4	Të ardhura të trashëg ë ardhurat nga taksat e tarifat vendore + Institucio e varësisë	17,891	
5	Te ardhura jasht limitit	6	
	Shpenzimet		
1	Shpenzime për paga (600)		0
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601)		0
3	Shpenzime operative		37,452
4	Transferta (604+606)		0
5	Shpenzimet kapitale (230+231)		38,152
	Total	**75,604**	**75,604**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, përpunuar nga grupi i auditimit*

Buxheti fillestar i vitit 2025 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite, ku të ardhurat dhe shpenzimet të miratuara janë në shumën 640,930 mijë lekë dhe trashëgimet e fondeve në vlerën 75,604 mijë lekë.

- *2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë, ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.*

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë alokuar fondet nga transfertat e pakushtezuara, fondet nga transfertat e kushtëzuara, sektoriale, specifike etj, të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- **Për vitin 2025** kanë ndodhur 7 ndryshime me VKB, nga të cilat 3 shtesa në buxhet me akte normative dhe 4 ndryshime me VKB për shtesa në buxhetin e Bashkisë nga buxheti i shtetit. Ndryshimet

buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2025 paraqiten në Aneks.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga Sektori i Buxhetit dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Roskovec. Plani përfundimtar i shpenzimeve dhe të ardhurave **për vitin 2025** paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Burimet e financimit	Buxheti fillestar 2025	Ndryshimet gjatë vitit 2025		Buxheti perfund imtar	Emërtimi i shpenzimeve	Buxheti fillestar 2025	Ndryshimet gjatë vitit 2025		Buxheti perfund imtar
		Pakesim	Shtesa				Pakesime	Shtesa	
Të ardhurat e trashëguara			75,604	75,604	Art. 600 Paga	298,385		611	298,385
Transferta e pakushtëzuar	200,627			200,627	Art. 601 Sig. shoq.e shëndetësore	48,784			48,784
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	90,185		-	90,185	Art.602 Shpenzime operative	85,662		40,951	123,114
Të ardhurat nga taksat e ndara Inst.vares	83,100		-	83,100	Art.603 Subvencione	0			0
Te ardhura nga burimete e veta	320,969		-	320,969	Art. 604 Transf korrente të brendshme	8,812		3,735	8,812
Sponsorizime			4,112	4,112	Art. 606 Transf të buxhet familja,individ	2,660			2,660
Transferte e kushtëzuar			15,138	15,138	Art. 230-231 Investime	249,078		49,555	287,230
					Art.166+651 Shpenz principali +interesi	0			0
					Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	1,5 00			1,500
Total	**694,881**	**-**	**94,854**	**789,735**	**Total**	**694,881**	**0**	**94,854**	**789,735**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, përpunuar nga grupi i Auditimit*

➢ *2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me akt akordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.*

- ***Auditim mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit***

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Fier, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Fier, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv buxhetor, të miratuar me Vendim të KB, apo nga ndryshimet e transfertave të pakushtëzuara sektoriale nga pushteti qendror, nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Fier, u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

- **Për vitin 2025** realizimi i treguesve të buxhetit në nivel bashkie, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Institucionet	600 (paga)		601(sigurime)		602(shp.operative)		604-609 (transf indivi)		230-31(investime)		Totali	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Bashkia	174,322	174,321	28,483	28,440	69,789	45,276	8,859	279	286,351	143,017	567,804	391,333
Ministri e Linjes	5,421	5,310	943	931	1,741	1,469	198,111	196,117	123,457	122,446	329,673	326,273
Shuma Bashkia	**179,743**	**179,631**	**29,426**	**29,371**	**71,530**	**46,745**	**206,970**	**196,396**	**409,808**	**265,463**	**897,477**	**717,606**
Nderm Sherb Publik	116,410	116,405	18,406	18,406	59,051	42,948	-	-	15,463	11,908	209,330	189,667
TOTALI	**296,153**	**296,036**	**47,832**	**47,777**	**130,581**	**89,693**	**206,970**	**196,396**	**425,271**	**277,371**	**1,106,807**	**907,273**
masa e realizimit		**100%**		**100%**		**69%**		**95%**		**65%**		**82%**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, përpunuar nga grupi i auditimit*

Realizimi i i buxhetit për vitin 2025 për shpenzimet në mënyrë të përmbledhur për aparatin e bashkisë dhe institucionet e varësisë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/ lekë

Shpenzimet sipas llogarive ekonomike	Plani vjetor fillestar 2025	Plani perfundimtar 2025	Plani i celur 2025	Realizimi I shpenzimeve 2025	% e realizimit/ planit vjetor
Shpenzime për paga (600)	**298,385**	**296,531**	**123,772**	**296,425**	100%
Shp. për sig shoq e shëndetësore (601)	**48,784**	**47,466**	**20,669**	**47,407**	100%
Shpenzime operative (602)	**85,662**	**130,577**	**20,512**	**89,688**	69%
Subvencione (603)	**0**	**0**		**0**	

Transferta tek organizatat (604)	**8,812**	**8,880**		**3,627**	41%
Transferta tek individët (606)	**2,660**	**196,590**		**193,446**	98%
Fondi rezervë+e kontigjencës (609)	**1,500**	**8,061**		**1561**	19%
Shpenzime per Investime (231+230)	**249,078**	**418,702**	**98,000**	**275,803**	66%
a.Nga te ardhurat e transf e pakushtez	57,866	95,190		57,232	
b.Nga Ministrite linjes		123,455		122,443	99%
c.Nga te ardhurat e bashkise	191,212	200,057		96,128	48%
Total Bashki + Institucione	**694,881**	**1,106,807**	**262,953**	**907,957**	**82%**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, përpunuar nga grupi i Auditimit*

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit për vitin 2025 rezulton se, fondet buxhetore janë realizuar 907,957 mijë lekë nga 1,106,807 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 82%. Në këtë masë realizimi ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:
- llog.602"Shpenzime operative" në masën 69%, llog.604 "Transferta tek organizatat" në masën 41%, të cilat tregojnë për planifikime me rezervë dhe jo sipas nevojave, si dhe mos kryerje në kohë të procedurave për realizimin e shpenzimeve.
- llog.230 "Shpenzimet për investime oponencë teknike" dhe llog.231 "Shpenzimet për investime" me financim nga buxheti i Bashkisë dhe transferta e kushtëzuar janë realizuar në masën 66% nga mosrealizmi i projekteve të investimeve dhe morealizimi i të ardhurave.

Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre

Për **vitin 2025** janë **planifikuar** fonde për investime në shumën 418,702 mijë ***lekë*** (të cilat janë nga grant i pakushtëzuar + transferta sektoriale + të ardhura + transferte e kushtëzuar) dhe janë ***realizuar në*** vlerën 275,803 mijë ***lekë, ose në masën 66%***.
Konkluzion: Nga analiza e investimeve theksojmë se një pjesë e investimeve janë prokuruar me vonesë në fund të vitit 2025. Fondet e planifikuara për shpronësime nuk janë realizuar, pasi ka mungesa ne dokumentacionin e dorëzuar prej tyre, investimet në infrastrukturën rrugore janë planifikuar me 2 vite buxhetore. Një pjesë e projekteve nuk kanë përfunduar akoma, nuk janë marrë në dorëzim dhe një pjesë tjetër janë planifikuar më shumë se vlera e kontratave.

- **Fondet për investime nga të ardhurat e Bashkisë**

Për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 200,057 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 96,128 mijë lekë ose realizuar në masën 48%.

- **Fondet për investime të financuara nga Ministritë e Linjës**

Për vitin 2025 janë planifikuar fonde në vlerën 123,455 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 122,443 mijë lekë ose në masën 99%.

- *Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe kontigjencës*

Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës.

Për vitin 2025 është në total në shumën 1,500 mijë lekë, i cili është miratuar në buxhetin fillestar me VKB nr.77, datë 23.12.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1353/1, datë 31.12.2024. Përdorimi i fondit të kontigjencës është miratuar për të përballuar rritje te papritura te kostove te një shërbimi ose projekti apo nevoja te reja te cilat nuk janë planifikuar gjate hartimit te buxhetit.

- *Raportet e Monitorimit.*

Për vitet 2025 përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 6 dhe me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" pikat 10, 12, 28, 29, 48.
Për vitin 2025 janë dërguar në MFE raportet e detajuara si më poshtë:
"Raport monitorimi Janar-Prill 2025" me shkresën nr. 4789 prot., datë 09.06.2025,
"Raport monitorimi Janar-Gusht 2025" miratuar online 04.11.2025 SMBV
"Raport monitorimi Janar-Dhjetor 2025"miratuar online 17.03.2026 SMBV

➢ ***2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve etj.***

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga viti paraardhës në buxhet respektivisht paraqitet si vijon:

- *Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të palikujduara palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve etj.*

Konkluzion: Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Nuk është hartuar plani i shlyerjes së detyrimeve të vitit 2024 mbetur për likuidim në vitin 2025 në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Kreu II.3. "Buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore. Rregulla dhe kritere për përdorimin e buxhetit vendor" pika 106 në të cilën përcaktohet se*: "Plani vjetor i buxhetit, i akorduar në nivel titulli, kapitulli dhe artikulli, përfaqëson limitin maksimal të lejuar për t'u shpenzuar nga njësitë shpenzuese. Gjatë detajimit të planit të buxhetit, njësitë e qeverisjes qendrore më parë detajojnë fonde për të paguar detyrimet e mbartura të viteve të kaluara për të gjitha llojet e shpenzimeve."*

Me fondet e vitit buxhetor 2025, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara Bashkia, nga Ministritë e linjës, sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë MFE, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës "*Detyrimet e prapambetura*", sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Detyrimet e prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2025: *Në lekë*

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31.12.2024	Detyrimi I krijuar në periudhën 01/01/2025 – 31.12.2025	Total detyrime	Shlyerja e detyrimeve 2025	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2025
a	**1**	**2**	**3=1+2**	**4**	**5=3-4**
a. Investime nga Ministritë e linjës e FZHSH	54,651,861	20,096,199	74,748,060	54,651,861	20,096,199
b. Investime nga Bashkia	38,030,098	37,849,358	75,879,456	57,937,614	17,941,842
c.Investime nga Ndermarrja			-		-
INVESTIME :			-		-
Mallra dhe shërbime	5,805,461	15,868,161	21,673,622	8,456,014	13,217,608
Mallra dhe sherbime ne ndermarrje	1,090,274	32,132,581	33,222,855	27,650,662	5,572,193
Vendime gjyqësore	-	-	-	-	-
Totali :	**99,577,694**	**105,946,299**	**205,523,993**	**148,696,151**	**56,827,842**

Detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2024 paraqiten në shumën 99,577,694 lekë, gjatë vitit 2025 janë krijuar 105,946,299 lekë, janë paguar detyrime në shumën 148,696,151 lekë, ndërsa në fund të vitit 2025 detyrimet e prapambetura paraqiten në shumën **56,827,842** lekë, pra kemi një ulje të detyrimeve të prapambetura në shumën 42,749,852 lekë.

Detyrimet e prapambetura të akumuluara dhe të raportuara në MF dhe sipas publikimit në faqen e saj në fund të vitit 2025 paraqiten në shumën **137,658,800** lekë, të cilat jepen në tabelën si më poshtë:

Në lekë

		Viti 2025		
NR	**Emërtimi**	**Stoku në vlerë**	**Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në**	**Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së**
I	**Borxhe (a+b)**	**0**		
a	**Hua afatgjatë**	**0**		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financ, overdraftt etj)	0		
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë			

b	**Hua afatshkurtër**	**0**		
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financ, overdraftt etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	**Detyrimet e prapambetura**	**137,658,800**		**18.45%**
Llogaria ekonomi	**Emërtimi**			
4864100	Vendime Gjyqesore			
4864200	Det.Prap. Sherbime	345,733		
4864201	D.P.EneriElektirke			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	99,578		
4864400	Det.Prap. Investime	121,371,395		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	15,842,094		
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	**Totali (I+II)**	**137,658,800**	**745,944,088**	**18.45%**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, përpunuar nga grupi i auditimit*

Referuar shkresës nr. 1693 prot., datë 27.02.2026 "Raport vjetor i vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare për periudhën janar-dhjetor 2025, Bashkia Roskovec" janë në shumën 137,658,800 lekë, e cila përbëhet nga: shuma prej 121,371,395 lekë e faturave të palikujduara për investime, shuma prej 15,842,094 lekë e faturave të palikujduara për mallra, shuma prej 343,733 lekë e faturave të palikujduara për shërbime, shuma prej 99,578 lekë e faturave të palikujduara për mirëmbajtje.
Sipas pasqyrave financiare detyrimet e prapambetura të akumuluara në llogarinë e klasës 4 në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar në fund të vitit 2025 janë në shumën **79,130,794** lekë. Pra rezulton një diferencë prej 58,528,006 lekë që përbëhet nga:
- shuma prej 54,651,861 lekë që i përket faturës së OE "F. ShPK" në fakt e likuiduar, por e raportuar si detyrim i prapambetur në mënyrë të gabuar për investimin e financuar nga ministritë e linjës me objekt: "Përmirësim i furnizimit me ujë të NJA Strum Rikonstruksion i Ujësjellësit Suk1, Suk 2, Strum dhe Velmish 2".Kjo shumë është sistemuar gjatë hartimit të pasqyrave financiare në mbyllje të vitit ushtrimor 2025.
- shuma prej 3,876,145 lekë është e paidentifikuar.

Për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025 nga analiza e këtyre detyrimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme rezultojnë që në fund të vitit 2025 janë të palikujduara gjithsej 97 fatura me vlerë **51,255,649** lekë për Bashkinë Roskovec (Aparati) dhe 10 fatura me vlere **5,572,193 lekë** për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike. Detyrimet e prapambetura të detajuara paraqiten në aneks:

Konkluzion: Nga analiza e detyrimeve gjendje në fund të vitit 2025 u konstatua se detyrimet prapambetura ndaj të tretëve të pa likuiduara të akumuluara në llogaritë e klasës 4 sipas pasqyrave financiare janë në shumën prej 79,130,794 lekë. Referuar shkresës nr. 1693 prot., datë 27.02.2026 "Raport vjetor i vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare për periudhën janar-dhjetor 2025, Bashkia Roskovec" dërguar në MF detyrimi i mbetur në fund të vitit ushtrimor është në shumën prej 137,658,800 lekë. Pra kemi një diferencë në raportim në MF në shumën prej 58,528,006 lekë, që i përket detyrimeve për investime të raportuara gabimisht si të palikujduara, ndërkohë që janë të likuiduara të sistemuara në kontabilitet. Mos shlyerja e detyrimeve ndaj të tretëve dhe mosraportimi i saktë i tyre është në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, nenet 5/c, 40/h, me Udhëzimin e MFE nr. 09, datë 20.07.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit*" i ndryshuar, pikat 48/i, 58,130, me Udhëzimin e MF nr.22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore*" shtojca 4

germa (c), me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 27.12.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", pikat 82-91.

Vështirësia Financiare

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (*të akumuluara*) në fakt në fund të vitit 2025 paraqiten në vlerën **79,130,794** lekë dhe pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 9 % kundrejt fondeve faktike 907,957,000 lekë. Kjo situatë tregon se, Bashkia Roskovec konsiderohet në situate normale e gjendjes financiare, pasi nuk e ka kaluar pragun 15% të shpenzimeve faktike në fund të vitit ushtrimor, duke mos u konsideruar institucion në vështirësi financiare sipas nenit 56 "Vështirësia financiare" të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe Udhëzimit e MF nr. 35, datë 29.12.2023 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore" pika 33.

- *Burimet e financimit të buxhetit vjetor*

Referuar realizimit të buxhetit të vitit 2025, duke u nisur nga burimi i financimit rezulton se shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 301,675 mijë lekë ose në masën 33 %, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale në shumën 279,335 mijë lekë ose në masën 31 %, transferta e kushtëzuar në shumën 326,947 mijë lekë ose në masën 36%.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: z.S.Ç. me detyrë ish-Drejtor Ekonomik (për periudhën 01.01.2025-18.10.2026), zj.O.G. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike (për periudhën 01.01.2025-e në vazhdim), dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues.

2.5. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor.

- *Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*

Nga shqyrtimi i dokumentacioneve u konstatua se, DTTV në Bashkinë Roskovec struktura organizative e DTTV për vitin 2025 është miratuar me urdhrat e Kryetarit të Bashkisë Roskovec, nr. 01, datë 06.01.2025 dhe është organizuar me 9 punonjës.

	Viti 2024	
Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore	**Struktura**	**Fakt**
Drejtor Drejtorie	**1**	**1**
Sektori i Tatim-Taksave familjare	**5**	**5**
Përgjegjës Sektori Familjar	1	1
Specialistë	4	4
Sektori i Biznesit	**3**	**3**
Përgjegjës Sektori Biznesit	1	1
Specialistë Sektori Biznesit	1	1
Specialistë Transporti	1	1
Punonjës gjithsej	**9**	**9**

Burimi: *Bashkia Roskovec, përpunuar nga grupi i auditimit*

- *Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:*

Administrimi i taksave vendore bëhet me Exel, ku janë të pasqyruara regjistrat e biznesit të madh dhe të vogël në kodin përkatës dhe me bazën e të dhënave përkatëse, me ngarkesat për detyrimet e taksave dhe tarifat vendore, pagesat dhe datat e pagesave, si dhe dosjet për secilin taksapagues me njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik, pronaret e pasurive të paluajtshme**.** Sipas të dhënave të DTTV, gjendja e subjekteve tatimpagues në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Roskovec paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrimet e reja (hyrje)	Pezullimipërkohshëmiaktivitetit/Pasiv	Mbyllur Aktiviteti	Gjendjanë fund tëvitit total
Biznesi i Vogël	2025	409	51	0	31	429
Biznesi i Madh	2025	74	3	0	3	74
Institucione	2025	5	0	0	0	5

Total		**488**	**54**	**0**	**34**	**508**

Burimi:*DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2025 janë aktiv 508 subjekte të biznesit. Gjatë vitit 2025 janë pezulluar/mbyllur 34 subjekte.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka bashkëpunuar me DRT Fier në lidhje me rakordimin e subjekteve sipas statusit të tyre aktiv, pezulluar, mbyllur, nëpërmjet emal-eve qe dërgohen çdo dite nga DRT Fier dhe me shkresa zyrtare për shkëmbim informacioni.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka bashkëpunuar me Qendrën Kombëtare të Biznesit për regjistrimet, çregjistrimet dhe ndryshimet e pësuar për bizneset pranë Bashkisë Roskovec dhe me pas janë bërë verifikime ne terren nga ana jonë.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore të dhënat në lidhje me faturimet e taksave dhe tarifave vendore i mban në sistem kompjuterik (Exel).

- *Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve*

Për vitin 2025, paketa fiskale e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Roskovec është miratuar me VKB nr. 71, datë 25.11.2024 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1269/1 prot., datë 06.12.2024.

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2025 është kryer nga drejtoritë përkatëse sipas përgjegjësive përkatëse për përllogaritjen e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2025 miratuar me VKB nr.70, datë 28.12.2023 “Për miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Roskovec dhe PBA 2025-2027.

Plani dhe realizimi sipas llojeve të të ardhurave referuar akt-rakordimit me Thesarin për vitin 2025 paraqiten në tabelën në Aneks.

Për vitin 2025 referuar të dhënave dhe dokumentacionit të DTTV, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Roskovec janë realizuar në shumën 294,978,927 lekë nga 385,569,450 lekë të parashikuara, ose në masën 76.7%. Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet:

a. Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim të ulët të planit si:

- ***Tarifa e pastrimit*** është realizuar 18,127,761 lekë nga 21,340,450 lekë e planifikuar ose në masën 85%,
- ***Tarifë ndriçimi*** është realizuar 3,007,931 lekë nga 4,186,000 lekë e planifikuar ose në masën 71.86%,
- ***Tarifë gjelbërimi*** është realizuar 2,812,031 lekë nga 4,186,000 lekë e planifikuar ose në masën 67.18%,
- ***Tarifë vendore për urbanistikën*** është realizuar 1,791,439 lekë nga 3,000,000 lekë e planifikuar ose në masën 59.7%
- ***Tarifë regjistrimi biznesi*** është realizuar 0 lekë nga 500,000 lekë e planifikuar ose në masën 0%
- ***Tarifa vendore e përkohshme*** është realizuar 2,914,841 lekë nga 10,480,000 lekë e planifikuar ose ne masën 27.81%,
- *Të* ***ardhurat e tjera jo tatimore*** është realizuar 7,808,156 lekë nga 60,000,000 lekë e planifikuar ose në masën 13%
- ***Tarifa e ujitjes së tokës*** është realizuar 3,476,930 lekë nga7,700,427 lekë e planifikuar ose në masën 45.15%
- ***Renta minerare*** është realizuar 25,472,312 lekë nga 65,000,000 lekë e planifikuar ose në masën 39.19%.
- ***Licenca për tregtim karburanti*** është realizuar 0 lekë nga 4,000,000 lekë e planifikuar ose në masën 0%.

b. Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim mbi planin si:
- ***Tarifë zënie hapësire publike*** janë realizuar 4,043,585.97 lekë nga 3,324,000 lekë e planifikuar ose në masën 121.65%.
-***Taksë ndikimi në infrastrukture nga legalizimet*** janë realizuar 38,868,656.25 lekë nga 5,500,000 lekë e planifikuar ose në masën 706.70%.
- ***Tarifë parkimi*** është realizuar 414,500 lekë nga 400,000 lekë e planifikuar ose në masën 103%.
- ***Të ardhura të tjera nga vërtetime, certifikatat e etj.*** janë realizuar 1,519,773 lekë nga 1,000,000 lekë e planifikuar ose në masën 151.98%.
- ***Te ardhura nga kopshti*** është realizuar 1,935,617 lekë nga 1,700,000 lekë e planifikuar ose në masën 113.86%.
- ***Qira objekti, qira trualli, qira tokës bujqësore*** është realizuar 4,557,092 lekë nga 2,902,000 lekë e planifikuar ose në masën 157% etj.

Konkluzion: Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet më shumë mbi planin, fakt që tregon se planifikimi i të ardhurave në disa zëra të ardhurash nuk është mbi baza reale dhe realizimi i viteve të mëparshme nuk është marrë në konsideratë në planifikim. Gjithashtu për një pjesë të ardhurash nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e tyre, gjë që ka sjellë ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore**.** Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ‘‘Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 5, germa (a), me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 51, neni 9, pika 1.3/ç.

- *Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;*

Në realizimin në nivel të ulët të të ardhurave kanë ndikuar **niveli i lartë e debitorëve**. Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore në Bashkinë Roskovec, rezultoi se ka nivel të lartë **debitorësh** në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, individët, familjarët, **(**për taksën e ndërtesës, tabelës, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, etj), i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur.

- *Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për biznesin*

Në Bashkinë Roskovec subjektet tregtarë ngarkohen me detyrime vendore për taksën e regjistrimit, mbi truallin, pasuri, pastrim, ndriçim, tarifën e gjelbërimit, etj.,
Gjatë vitit 2025 ecuria e gjendje së debitorëve të biznesit të madh dhe të vogël sipas llojit të taksave paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr.	PËR SUBJEKTET FIZIK/JURIDIK/SHTETROR	Shuma progresive në fund të vitit 2024		Shtesa gjatë vitit 2025		Arkëtuar gjatë vitit 2025 edhe për vitet para 2025		Shuma progresive në fund të vitit 2025	
		Nr.Sub	Vlera	Nr.Sub	Vlera	Nr.Sub	Vlera	Nr.Sub	Vlera
1	Taksë mbi ndërtesën		4,351,920	119	1,026,694		506,806		4,871,808
2	Taksë mbi truallin	28	774,971	28	193,907		112,740		856,138
3	Tarifë Pastrimi	120	10,000,226	129	2,806,366		1,961,855		10,844,737
4	Tarifë Ndriçimi	120	698,824	129	106,556		108,030		697,350
5	Tarifë Gjelbërimi	120	658,053	129	106,556		92,830		671,779
6	Taksë Tabele	120	433,705	129	121,280		57,110		497,875
7	Tarifë Regjistrimi		412,000	15	184,000		120,000		476,000
8	Kamat vonesa		1,213,049		1209834		735,769		1,687,114
9	Tarife per permires, mbrojtja mjedis		2,320,000		2,035,839		1,080,000		3,275,839
10									
	SHUMA		**20,862,748**		**7,791,032**		**4,775,140**		**23,878,640**

Burimi:*DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Referuar të dhënave të vëna në dispozicion rezulton se debitorët nga taksapaguesit e kategorisë "biznes" në fund të vitit 2024 janë në shumën 20,862,748 lekë, gjate vitit 2025 janë krijuar debitorë në shumën 3,015,892 lekë dhe në fund të vitit 2025 debitorët nga taksapaguesit e kategorisë "biznes" janë në shumë progresive prej 23,878,640 lekë. Nga këto në fund të vitit 2025 u përket debitorëve të kategorisë "biznes" në 4 Njësitë Administrative në shumën 6,774,370 lekë.

- *Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për familjarët.*

Në Bashkinë Roskovec familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, taksën e truallit, tarifën e pastrimit, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, tarifën e mirëmbajtjes së varrezave publike dhe tarifën e mirëmbajtjes së rrugëve të parcelave dhe sistemit kullues.

Ecuria e detyrimet e familjeve për taksat dhe tarifat vendore sipas njësive administrative **gjatë vitit 2025** në mënyrë të përmbledhur është paraqitur në Aneks.

në lekë

Bashkia/N J.A	Taksa mbi tokën bujqësore		Taksë ndërtese		Tarifë pastrimi		Tarifë ndriçimi		Tarifa e mirëmbajtjes së parcelave dhe sistemit kullues		Taksë trualli		Tarifë gjelbërimi		Total
	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	
Roskovec	1584	5,532,799	1757	1981035	1757	3514000	1757	1405600	988	1,359,950	1757	39,690	1757	140600	13973674
Kuman	2206	6,761,822	1910	3025920	1910	2292000	1910	955000	1048	900,277	1910	44,520	1910	955000	14934539
Strum	2433	10,626,014	1865	2567235	1865	2238000	1865	932500	2032	2,149,171	1865	72,135	1865	932500	19517555
Kurjan	1406	6,749,996	766	122985	766	919200	766	383000			766	49,434	766	383000	8607615
TOTAL	**7629**	**29,670,631**	**6298**	**7697175**	**6298**	**8963200**	**6298**	**3676100**	**4068**	**4409398**	**6298**	**205,779**	**6298**	**2,411,100**	**57033383**

Burimi: *DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Në mënyrë të përmbledhur debitorët për vitin 2025 nga taksapaguesit subjektet tregtare dhe familjarë sipas llojeve të taksave/tarifave dhe viteve janë paraqitur në Aneks.

Në lekë

Nr.	Lloji i taksës	Subjekte biznes			Familjare (UKKO)			Total			Total 01.01.2026
		Prog 31.12.2024	Borxh vetem per 2025	Arktime 2025	Prog 31.12.2024	Borxh vetem per 2025	Arktime 2025	Prog 31.12.2024	Borxh 2025	Arktime 2025	Prog. 31.12.2025
1	Regjistrim	412,000	184,000	120,000				**412,000**	**476,000**	**120,000**	**476,000**
2	Pasuri	4,351,920	1,026,694	506,806	34,425,483	7,697,175	23,617,582	**38,777,403**	**8,723,869**	**24,124,388**	**23,376,884**
3	Truall	774,971	193,907	112,740	2,306,367	205,779	120,538	**3,081,338**	**399,686**	**233,278**	**3,247,746**
4	Pastrim	10,000,226	2,806,366	1,961,855	9,104,563	8,963,200	3,052,424	**19,104,789**	**11,769,566**	**5,014,279**	**25,860,076**
5	Ndriçim	698,824	106,556	108,030	8,656,358	3,676,100	1,433,370	**9,355,182**	**3,782,656**	**1,541,400**	**11,596,438**
6	Gjelbërim	658,053	106,556	92,830	6,847,789	2,411,100	952,640	**7,505,842**	**2,517,656**	**1,045,470**	**8,978,028**
7	Tabelë	433,705	121,280	57,110				**433,705**	**121,280**	**57,110**	**497,875**
8	Tarif permir mbroj mjedis	2,320,000	2,035,839	1,080,000				**2,320,000**	**2,035,839**	**1,080,000**	**3,275,839**
9	Kamatvonesa	1,213,049	1,209,834	735,769				**1,213,049**	**1,209,834**	**735,769**	**1,687,114**
10	Gjoba	2,808,500	2,903,111	358,000				**2,808,500**	**420,831**	**358,000**	**2,871,331**
11	Taks toke				92,539,160	29,670,631	13,579,612	**92,539,160**	**29,670,631**	**13,579,612**	**108,630,179**
12	Mirëmbajtje kanali				6,529,165	4,409,398	1,947,519	**6,529,165**	**4,409,398**	**1,947,519**	**8,991,044**
13	Taksa ndikimit infrastruk				25,916,869		944,245	**25,916,869**		**944,245**	**24,972,624**
14	Tarife ujitje		8		4,969,852	1,881,154	899,336	**4,969,852**	**1,881,854**	**899,336**	**5,952,370**
	SHUMA	**23,671,248**	**8,211,863**	**5,133,140**	**191,295,606**	**58,915,237**	**46,547,266**	**214,966,854**	**67,127,100**	**51,680,406**	**230,413,548**

Burimi: *DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Konkluzion: Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe informacionit të vënë në dispozicion nga DTTV në Bashkinë Bashkinë Roskovec, rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh **për taksat dhe tarifat** në numër dhe në vlerë, kështu:

Vlera e borxhit në fund të vitit 2024 është **214,966,854 lekë** i përbërë nga:

- Detyrime nga taksat dhe tarifat e bizneseve, në vlerën totale 23,671,248 lekë;
- Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në vlerën 184,766,441 lekë.

Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2025 është **67,127,100 lekë** i përbërë nga:

- Detyrime nga taksat dhe tarifat e bizneseve, në vlerën totale 8,211,863 lekë, nga ku 2,308,751 lekë janë detyrime për taksa e tarifa dhe 2,903,112 lekë janë gjoba nga IMTV dhe Policia.
- Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në vlerën 58,915,237 lekë.

Vlera e arkëtuar e detyrimeve gjatë vitit 2025 është 51,680,406 lekë.
- Detyrime nga taksat dhe tarifat e bizneseve, në vlerën totale 5,133,140 lekë;
- Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në vlerën 46,547,266 lekë.

Në fund të vitit 2025 gjendja e debitorëve progresiv për bizneset dhe familjarët është **230,413,548 lekë**, vlerë kjo që ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec, e cila përbëhet nga:
- Detyrime nga taksat dhe tarifat e bizneseve, në vlerën totale 26,749,971 lekë;
- Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në vlerën 203,663,577 lekë.

Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorët është në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"*Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 42, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, *neni 51,* neni 9 pika 1.3 nënpika (ç), VKB nr. 71, datë 25.11.2024 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025"

- Dinamika e Borxhit:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se struktura e borxhit për subjektet e biznesit të madh, biznesit të vogël dhe pronarë të bizneseve, sipas moshës së tij paraqitet si më poshtë:

Mosha e Borxhit ne fund te vitit 2024	Vlera/lekë	Nr. Subjekte
1-3 vit	11,011,917	134
3-5 vjet	2,654,913	20
Mbi 5 vjet	10,211,812	35
Totali	**23,878,642**	**189**

Referuar të dhënave të pasqyrës, konstatohet se vlerën më të lartë të borxhit e zënë debitorët e moshës 1-3 vjet në vlerën 11,011,917 lekë dhe debitorët e moshës mbi 5 vjet në vlerën 510,211,812 lekë.

- *Menaxhimi borxhit nga taksat e tarifat vendore. Auditimi i rasteve në lidhje me zbatimin e masave shtrëngese për arkëtimin e borxhit ndaj subjekteve debitorë***.**

Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore (DTTV), Bashkia Roskovec është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë dërguar dhe njoftuar me njoftim vlerësimi tatimor të gjithë bizneset brenda afateve të përcaktuara në paketën fiskale konkretisht brenda datës 12.03.2025 janë dërguar njoftim vlerësimet për subjektet tregtare në lidhje me tarifat lokale, brenda datës 16.05.2025 janë dërguar njoftim vlerësimet për pronarët e pasurive të paluajtshme dhe për subjektet e krijuara rishtazi janë dërguar brenda afatit të përcaktuar.
Për subjektet debitore dhe familjarët me detyrime të papaguara për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifat vendore janë dërguar njoftime dhe kërkesa për pagese.
Për vitin 2025 drejt debitorëve familjarë për detyrimet e akumuluara DTTV u bankave te nivelit te II kërkesë për urdhër bllokim të llogarive në vlerën **12,388,066 lekë** me numër total debitorësh prej **350 familjesh** për vlerën **12,388,066** l**ekë**, ku **254 familje** kanë arritur të paguajnë vlerën prej **6,452,574 lekë.** Është dërguar një shkresë e përgjithshme për bankat dhe secilës prej tyre u është dërguar lista me debitorët në mënyrë elektronike.

Njoftimi për bllokim të llogarive të subjekteve debitore:

Nr.	Nr. raste	Nr. protok	Datë	Vlerë në lekë
1	350	9541	13.11.2025	12,388,066

Njoftime për dhe kërkesë për pagesë për vitin 2025 për debitorët sipas Njësive Administrative

Nr.	Njësia Administrative	Nr.rastesh	Vlerë
1	Roskovec	17	488,221
2	Strum	200	7,942,870
3	Kuman	100	2,838,872
4	Kurjan	33	1,118,103
	TOTAL		**12,388,066**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se, për vitin 2025 drejt subjekteve tregtare janë dërguar 508 njoftime për çdo subjekt qoftë debitore dhe jo debitore. Gjithashtu DTTV ka komunikuar në mënyrë shkresore edhe me bankat e nivelit të II për bllokimin e llogarive bankare ku është dërguar shkresë e përgjithshme për të gjitha bankat dhe po ashtu në mënyrë elektronike u është dërguar lista e emrave të debitorëve.

Njoftim dhe kërkesë për pagesë për subjektet debitore,

Nr. protokolli	Datë	Nr. rastesh	Vlerë në lekë
9431	12.11.2025	129	16,910,450

Konkluzion: Drejtoria e Taksave Vendore në Bashkinë Roskovec për vjeljen e detyrimeve është mjaftuar me nxjerrjen e njoftim-vlerësimeve për detyrimin dhe një numri të kufizuar të masave shtrënguese dhe nuk janë aplikuar të gjitha masat administrative dhe ligjore, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara", nenet 89, 90, 91 dhe 93 dhe me VKB nr. 71, datë 25.11.2024 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025".

- *Planifikimi dhe arkëtimi i taksës së tokës bujqësore.*

Taksa mbi tokën bujqësore **për vitin 2025** taksa e tokës është realizuar në shumën 23,828 mijë lekë nga 25,852 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 92.17%. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për biznesin është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Roskovec sipas parashikimeve të paketës fiskale pika 1.2.2.
Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për familjarët është DTTV pranë Bashkisë Roskovec, si dhe specialistet e Njësive Administrative.
Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, gjithsej tokë bujqësore sipas Bashkisë Roskovec që mund të faturohen janë 23909.7 Ha. Fondi i tokës bujqësore sipas Drejtorisë së Mbrojtjes së Tokës deri me datë 31 dhjetor 2025 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Shuma	Arë	Pemtore	Vreshtë	Ullishte
	SIPËRFAQJA E TOKËS GJITHËSEJ	**Ha**	**9122.76**	**5800.8**	**66.96**	**148**	3107
1	Nga Kjo :						
2	**TOKË NË PRONËSI PRIVATE : Nga e cila:**	**Ha**	**9013.57**	**5702.61**	**66.96**	**148**	3096
2-Jan	Tokë në pronësi private me origjinë nga ish Kooperativat Bujqësore	Ha	7828.96	4560.01	65.96	147	70
2-Feb	Tokë në pronësi private me origjinë nga ish Ndërmarrjet Bujqësore	Ha	1184.61	1142.6	1	1	40
3	**TOKË NË PRONËSI SHTETËRORE : Nga e cila:**	**Ha**	**109.19**	**98.19**	**0**	**0**	11
3-Jan	Tokë e pandarë me origjinë nga ish Kooperativat Bujqësore	Ha	30	19	0	0	11
3-Feb	Tokë me origjinë nga ish-kooperativat kaluar Agjensisë së Trajtimit të Pronave	Ha	0	0	0	0	0
3-Mar	Tokë disponibël shtetërore me origjinë nga ish Ndërmarrjet Bujqësore	Ha	79.19	79.19	0	0	0
3-Apr	Tokë e ish-Ndërmarrjes bujqësore dhënë në përdorim familjeve bujqësore	Ha	0	0	0	0	0
3-May	Sipërfaqe toke në administrim të Institucioneve të tjera shtetërore.	Ha	0	0	0	0	0

Kjo sipërfaqe e ndarë sipas NJA dhe kategorive shumëzuar për tarifën e përcaktuar sipas kategorive në paketën fiskale, nga përllogaritja konstatohet se planifikimi i taksës së tokës bujqësore është në shumën 32,940,920 lekë, e cila pasqyrohet në tabelën si më poshtë vijon:

Planifikimi i taksës së tokës bujqësore Bashkia Roskovec për vitin 2025

Kategoria e tokës	Sip/ha Roskovec	Sip/ha Kuman	Sip/ha Strum	Sip/ha Kurjan	Shuma në/ ha	Vlera /ha	Plani

Kategoria I			6.5		6.5	5600	36,400
Kategoria II	593	138	932.2	0.4	1663.6	4900	8,151,640
Kategoria III	481	546	1622.6	137	2786.6	4200	11,703,720
Kategoria IV	115	459	586.4	673	1833.4	3600	6,600,240
Kategoria V		224	106.3	761	1091.3	3000	3,273,900
Kategoria VI		145	6	472	623	2400	1,495,800
Kategoria VII-X		470		462.9	932.9	1800	1,679,220
Shuma					8937.3		32,940,920

Diferenca midis planifikimit fillestar të taksës së tokës prej 32,940,920 lekë dhe planifikimit prej 25,852,000 lekë sipas aktrakordimit me Degën e Thesarin lidhet me VKB i cili aplikon ulje takse të tokës bujqësore me vlerë 30% për 6 mujorin e parë. Gjithashtu në ulje të planifikimit të të ardhurave nga taksa e tokës kanë ndikuar zbritja e sipërfaqeve të mbjella me pemëtari që përjashtohen nga taksa për 5 vjet, si dhe përjashtimi nga taksa edhe invalidët.

- *Ndjekja e procedurave për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore*.

Në **fund të vitit 2024** rezulton se vlera debitore për taksën e tokës bujqësore është në shumën **92,539,160 leke** dhe në **fund të vitit 2025** në shumën **81,467,439 lekë**, e cila në krahasim me vitin 2024 është ulur me vlerën me **11,071,721 lekë**.
Gjatë vitit 2025 janë gjithsej 4,143 familje debitore për vlerën 11,071,721 lekë.
Arkëtimi i kësaj takse pavarësisht punës që kryhet paraqitet me problem në Bashkinë Roskovec, për arsye se familjet të cilat taksohen për tokën bujqësore pavarësisht se njoftohen (referuar këtu njoftimeve të kryera nga zyra apo dhe në terren nga specialistët e njësive administrative) nuk kryejnë pagesat për shkak të lëvizjeve demografike, emigracionit etj.

Debitorë për taksën e tokës bujqësore viti 2025					
Njësia Administrative		**Debitorë të krijuar në vitin 2025 (Lekë)**			**Ne fund të vitit 2025**
	Debitorë të trashëguar deri ne fillim të vitit 2025	**Familje me tokë bujqësore**	**Familje debitore(Nr.)**	**Familje debitore (vlerë)**	**DEBIA PROGRESIVE**
Roskovec	12,673,218	1581	996	3,406,507	15734795
Strum	43,050,526	2433	1444	1,701,034	41556048
Kuman	21,254,767	2207	1232	3,880,510	20995754
Kurjan	15,560,649	1404	471	2,083,670	15148344
TOTAL	**92,539,160**				**81,467,439**

Burimi: DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga Sektori i Bujqësisë së Bashkisë Roskovec dhe nga Sektori i Mbledhjes dhe Kontrollit të të Ardhurave për Njësitë Administrative nuk është kryer punë e mjaftueshme për përditësimin e të dhënave si dhe për rritjen e arkëtimeve në NJA për uljen e borxhit për taksën e tokës.

Konkluzion: Nga DTTV nëpërmjet specialistëve të taksave në 4 NjA (Roskovec, Strum, Kuman, Kurjan) nuk është kryer punë e mjaftueshme për përditësimin e të dhënave si dhe për rritjen e arkëtimeve dhe uljen e borxhit për taksën e tokës, e cila në fund të vitit 2025 është në shumën 81,467,439 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Roskovec. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, neni 6, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë"**,** pika 1.3. nënpika(ç) dhe me VKB nr. 71, datë 25.11.2024 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025".

- *Mbi menaxhimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon DTTV, Bashkia Roskovec në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT, Fier janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK.
Kokluzion: Referuar listave të vëna në dispozicion nga Bashkia Roskovec në formatin exel mban pagesat e kryera nga personat që kanë patur detyrime për taksën e ndikimit në infrastrukturë, ku u konstatua se:

- **Në fund të vitit 2024** nga legalizimet kanë mbetur detyrime pa paguar në vlerën 25,916,863 lekë. Gjatë vitit 2025 nuk ka patur korrespondence me ASHK Fier, për këtë arsye nuk ka shtesa, ndërsa arkëtimet janë në shumën 944,245 lekë nga 25 individë. **Në fund të vitit 2025** detyrimet nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet janë në shumën **24,972,624 lekë**, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec. Këto veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006"*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, i ndryshuar me Ligjin nr. 95/2018, neni 9, pika 3/c, me ligjin nr. 98/2020 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 1, "në nenin 27, pika 3, shkronja "c", me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*" pika 5, me VKB nr. 71, datë 25.11.2024 *"Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025"*.

Në mënyrë të detajuar debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë paraqiten në aneks.

Në mënyrë të përmbledhur debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Lloji i takses	Gjendja e debitorëve në datë 31.12.2024		Shtesat gjatë vitit 2025		Arkëtimet gjatë vitit 2025		Gjendja e debitorëve në datë 31.12.2025	
Ndikimi ne Infrastrukture	Numri i individëve	Vlera	Numri i individëve	Vlera	Numri i individëve	Vlera	Numri i individëve	Vlera
	890	25,916,869	0	0	25	944,245	864	24,972,624

- *<u>Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:</u>*

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve dhe gazit për vitin 2025 ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Roskovec dhe në Njësitë Administrative **<u>11</u>** subjekte, të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, të cilat paraqiten në Aneks. Sipas të dhënave nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se, duke filluar nga viti kalendarik 2017 deri në vitin 2025 nga stacionet e karburantit janë mbledhur të ardhura për bashkinë Roskovec 5,000,000 lekë nga lëshimi i autorizimeve për lejimin e ushtrimit të aktivitetit në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre pasi subjektet e licencuara kanë paguar detyrimet e tyre në mënyrë të plotë për periudhën 5 vjeçare.

Gjatë vitit 2025 është licencuar 1 pikë karburanti që i kishte mbaruara afati i licencimit, i cili ka paguar tarifën e autorizimit për lejimin e aktivitetit të tregtimit me pakicë të hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Subjektet e licensuar janë:

SUBJEKTI	NUIS	AFATI I AUTORIZIMIT		Detyrimi	Pagesat	Diferenca
		FILLIMI	MBARIMI	autorizimin		
B.P	L..	18.12.2020	18.12.2025	1,000,000	1,000,000	0
Ç ShPK.	J..	19/12/2025	19/12/2030	1,000,000	1,000,000	0

Subjektet të cilët nuk janë licensuar janë:

	Subjekti	Administratori		Adresa	Aktiviteti
1	X.	A.I	L..	Roskovec	Karburante
2	B..	B.C	L..	Strum	Karburante
3	L.	A.T	L..	Velmish	Karburante
4	A.	V.B	K..	Kuman	Karburante
5	E SHPK	A.T	K..	Velmish	Karburante
6	"E" SHPK	M.T	K..	Suk 1	Karburante
7	"X" SHPK	B.A	K..	Suk 2	Karburante
8	S.G	G.I	K..	Strum	Pikë Gazi
9	H.A	H.A	L..	Suk 1	Pikë Gazi

Arsyeja mosdhënies së autorizimeve subjekteve të tregtimit të karburanteve dhe gazit që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Roskovec është pretendimi se këtyre subjekteve u mungon

autorizimi hyrje-dalje nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, shkak i cili nuk ka penguar që këto subjekte të jenë aktive në ushtrimin e aktivitetit.

Konkluzion: Referuar dosjeve të subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë Roskovec për shitje me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tij konstatohet se, për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 11 subjekte nga të cilat 2 subjekte janë të pajisura me autorizim me afat me 5 vjet për lejim ushtrim aktiviteti dhe kanë kryer pagesë për vlerën e plotë prej 1,000,000 lekë dhe 9 subjekte që nuk janë pajisur me autorizime, **duke sjellë të ardhura të munguara në shumën 9000,000 lekë** për buxhetin e Bashkisë Roskovec. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, nenet 4,15 dhe 20/2" dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kreu II, pika 3, pika 15.1.

- *Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:*

Të ardhurat nga agjentët tatimorë derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Roskovec dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Fier me të cilin mbahen akt-rakordimet mujore. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë gjatë periudhës së audituar janë:

në lekë

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	Vlera e realizuar Viti 2024	Vlera e realizuar Viti 2025
Drejtoria Rajonale Tatimore	Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin	0	0
Drejtoria e Përgjith e Shërbim të Transport Rrugor,DR Fier	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	11,617,477	12,039,431
SH.R.U.K.KO	Taksa & Tarifa Vendore Familjare	0	0
D. R. T Fier; D.R.T Tiranë Tatimpag e Mëdhenj e Dr Përgj Dogana	Renta Minerare	35,737,606	20,989,945
Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Roskovec	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë	0	0

- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me DPD, me Drejtorinë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, Fier. Janë kryer kërkesa për transferim të rentës minerare drejtuar, Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, Drejtorisë se Tatimpaguesve të Mëdhenj, Drejtorisë së Përgjithshme te Tatimeve dhe rakordimi i pjesës takuese te rentës minerare që i përket Bashkisë Roskovec. Realizimi i rentës minerare për vitin 2024 është në shumën 35,737,606 lekë nga 60,000,000 lekë të planifikuara ose masën 59.6%. Ndërsa për vitin 2025 realizimi i rentës minerare është në shumën 25,472,312 lekë nga planifikimi prej 65,000,000 lekësh, ose në masën 39.2%. Të ardhurat e arkëtuara nga renta minerare sipas akt-rakordimeve mujore për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

KALIMI NE EVIDENCE	TATIMET Fier	DOGANA	TATIMPAGUESIT E MEDHENJ	TOTALI VJETOR,
Janar 2025				
Shkurt 2025		2,526,707		2,526,707
Mars 2025				
Prill 2025		303,642		303,642
Maj 2025				
Qershor 2025				
Korrik 2025				
Gusht 2025		12,162,978		12,162,978
Shtator 2025				
Tetor 2025		6,048,790		6,048,790
Nentor 2025				
Dhjetor 2025		4,430,195		4,430,195
TOTALI		**25,472,312**		**25,472,312**

-DTTV e Bashkisë Roskovec ka kryer rakordimet mujore me ASHK Drejtoria Vendore Fier për vlerën e taksës së kalimit të pasurisë së paluajtshme (shitjes) për vlerën e taksës që i takon Bashkisë Roskovec. Arkëtimet për këtë taksë kalohen çdo muaj nga ASHKDVK referuar akt-rakordimeve mujore të taksës së shitjes së pasurisë së paluajtshme. Gjithashtu konstatojmë se

Bashkia Roskovec, mos arkëtimet nga ana e Drejtoria Rajonale Vendore ASHK Fier janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Roskovec është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektesh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse.
Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: zj.O.G. me detyrë ish-Drejtore e Drejtorisë të Ardhurave Vendore (për periudhën 01.01.2025- 18.10.2026), z. S.Ç. me detyrë Drejtor i Drejtorisë të Ardhurave Vendore (për periudhën 08.10.2026- e në vazhdim), zj.M.D. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Biznesit në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore.

- ***Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin e PBA dhe programimit të buxhetit vjetor.***

- *Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2025-2027*

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2025-2027 dhe PBA 2026-2028 u konstatua se:
-Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA **është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik** (GMS) për PBA 2025-2027 me Urdhrin nr. 2613 datë 06.03.2024 dhe për PBA 2026-2028 me Urdhrin nr. 2715 datë 27.02.2025.
-Është përgatitur dhe miratuar **kalendari i menaxhimit buxhetor** për vitin 2025 me VKB nr.78 datë 23.12.2024 dhe për PBA 2025-2027 dhe buxhetin vjetor 2025 me VKB nr. 77 datë 31.12.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkesën nr.prot. 1353/1, datë 31.1.2024, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 33/1.
-Janë miratuar për PBA 2025-2027 me VKB nr. 11 datë 19.02.2024 "Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2025-2027.
-Janë miratuar në Këshillin Bashkiak **tavanet përgatitore** për PBA 2025-2027 me VKB nr.22, datë 25.03.2024, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 365/1 prot., datë 03.04.2024 në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 34/6.
-PBA 2025-2027 **faza e parë** është miratuar me VKB nr. 38, datë 28.06.2024 dhe është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 712/1 datë 10.07.2024, e cila është dërguar në MF me shkresën nr. 4084, datë 03.06.2024.
-**Tavanet përfundimtare** të PBA 2025-2027 janë miratuar me VKB nr. 45, datë 31.07.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 837/1 prot., datë 13.08.2024, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 34/6.
-**Faza e dytë** e PBA 2025-2027 është miratuar me VKB nr. 61, datë 30.09.2024, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 10361/1, datë 08.10.2024 dhe është ngarkuar ne SMBV me date 15.09.2024.
PBA 2025-2027 është përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar shoqëruar me relacion shpjegues, i cili përmban: rolin dhe qëllimin e PBA-së, vështrim të përgjithshëm të njësisë dhe orientimin afatgjatë të saj, të ardhurat dhe shpenzimet, planin e shpenzimeve 2025-2027, sipas programeve buxhetore, detyrimet e prapambetura, treguesit financiarë dhe rreziqet financiare e fiskale.
Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetit vjetor janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore,

nëpërmjet procesit të "Buxhetimit me pjesëmarrje", ku për të cilat janë mbajtur relacionet dhe protokollet përkatëse sipas datave: 30.11.2024 dhe 05.12.2024.
- **Buxheti vjetor 2025** dhe **PBA 2025-2027** është miratuar me VKB nr. 77, datë 31.12.2024, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1353/1datë 31.12.2024.
-Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2025-2027 dhe buxhetit vjetor, rezulton se **janë hartuar mbi bazën e kërkesave** shkresore nga Njësitë Administrative, nga njësitë vartëse dhe nga Drejtorët e Drejtorive të bashkisë Roskovec në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, nga kërkesat e sektorëve të ndryshëm, që mbulojnë këto programe si dhe nga kërkesat e mbledhura në dëgjesat publike.
-Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investimet dhe të ardhurat. Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2025-2027 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2025		Viti 2026		Viti 2027	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	298,385	42.94%	298,444	42.56%	299,064	42.27%
2	Sigurime (601)	48,784	7.02%	48,784	6.96%	48,784	6.89%
3	Shpenzime operative (602)	85,662	12.33%	80,361	11.46%	75,330	10.65%
4	Shpenzime (605)	0	0%	0	0%	3,500	0.49%
5	Shpenzime (604)	8,812	1,27%	10,000	1.43%	10,000	1.41%
6	Shpenzime (606)	2,660	0.38%	3,500	0.50%	2,000	0.28%
7	Shpenzime (609)	1,500	0.22%	2,000	0.29%	0	0%
8	Shpenzime për investime (230-231)	249,078	35.84%	258,191	36.82%	268,895	38%
	TOTALI	**694,881**	**100%**	**701,280**	**100%**	**707,573**	**100%**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, përpunuar nga grupi i auditimit*

- *<u>Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2025.</u>*

Buxheti **për vitin 2025** është miratuar me VKB nr. 77, datë 23.12.2024, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1353/1 datë 31.12.2024. Plani fillestar i miratuar për vitin 2025 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar i vitit 2025	
		Të ardhurat	Shpenzimet
1	Transferta e pakushtëzuar	181,783	
2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	74,078	
3	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore + Institucionet e varësisë	365,069	
4	Të ardhura të tjera	20,000	
1	Shpenzime për paga (600)		250,877
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601)		40,965
3	Shpenzime operative		84,510
4	Subvencione (603)		0
5	Transferta (604+606)		13,500
6	Fondi rezervë+Fondi I kontigjencës (609)		2,000
7	Shpenzimet kapitale (230+231)		249,078
8	Principali+Interesi I kredisë (166+651)		0
	Total	**640,930**	**640,930**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, përpunuar nga grupi i auditimit*

Me VKB nr. 21, datë 26.03.20225 është miratuar "Përdorimi e të ardhurave të trashëguara të vitit 2024 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2025", i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr.393/1, datë 04.04.2025, të detajuara si më poshtë:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani I vitit 2025	
	Të ardhurat	Të ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara nga transferta e pakushtëzuar	46,304	

2	Të ardhura të trashëguara nga transferta e pakushtëzuar sektoriale	0	
3	Të ardhura të trashëguara nga transferta e pakushtezuar per detyrimet e prapambetura	11,403	
4	Të ardhura të trashëg ë ardhurat nga taksat e tarifat vendore + Institucio e varësisë	17,891	
5	Te ardhura jasht limitit	6	
	Shpenzimet		
1	Shpenzime për paga (600)		0
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601)		0
3	Shpenzime operative		37,452
4	Transferta (604+606)		0
5	Shpenzimet kapitale (230+231)		38,152
	Total	**75,604**	**75,604**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, përpunuar nga grupi i auditimit*

Buxheti fillestar i vitit 2025 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite, ku të ardhurat dhe shpenzimet të miratuara janë në shumën 640,930 mijë lekë dhe trashëgimet e fondeve në vlerën 75,604 mijë lekë.

- *2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë, ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.*

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.
Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë alokuar fondet nga transfertat e pakushtezuara, fondet nga transfertat e kushtëzuara, sektoriale, specifike etj, të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- **Për vitin 2025** kanë ndodhur 7 ndryshime me VKB, nga të cilat 3 shtesa në buxhet me akte normative dhe 4 ndryshime me VKB për shtesa në buxhetin e Bashkisë nga buxheti i shtetit. Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2025 paraqiten në Aneks.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga Sektori i Buxhetit dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Roskovec. Plani përfundimtar i shpenzimeve dhe të ardhurave **për vitin 2025** paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Burimet e financimit	**Buxheti fillestar 2025**	**Ndryshimet gjatë vitit 2025**		**Buxheti perfund imtar**	**Emërtimi i shpenzimeve**	**Buxheti fillestar 2025**	**Ndryshimet gjatë vitit 2025**		**Buxheti perfund imtar**
		Pakesim	**Shtesa**				**Pakesime**	**Shtesa**	
Të ardhurat e trashëguara			75,604	75,604	Art. 600 Paga	298,385		611	298,385
Transferta e pakushtëzuar	200,627			200,627	Art. 601 Sig. shoq.e shëndetësore	48,784			48,784
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	90,185		-	90,185	Art.602 Shpenzime operative	85,662		40,951	123,114
Të ardhurat nga taksat e ndara Inst.vares	83,100		-	83,100	Art.603 Subvencione	0			0
Te ardhura nga burimete e veta	320,969		-	320,969	Art. 604 Transf korrente të brendshme	8,812		3,735	8,812
Sponsorizime			4,112	4,112	Art. 606 Transf të buxhet familja,individ	2,660			2,660
Transferte e kushtëzuar			15,138	15,138	Art. 230-231 Investime	249,078		49,555	287,230
					Art.166+651 Shpenz principali +interesi	0			0
					Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	1,5 00			1,500
Total	**694,881**	**-**	**94,854**	**789,735**	**Total**	**694,881**	**0**	**94,854**	**789,735**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, përpunuar nga grupi i Auditimit*

➢ *2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me akt akordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.*

- ***Auditim mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit***

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Fier, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.
Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Fier, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv buxhetor, të miratuar me Vendim të KB, apo nga ndryshimet e transfertave të pakushtëzuara sektoriale nga pushteti qendror, nga auditimi i shkresave, evidencave të celjeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Fier, u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

- **Për vitin 2025** realizimi i treguesve të buxhetit në nivel bashkie, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Institucionet	600 (paga)		601(sigurime)		602(shp.operative)		604-609 (transf indivi)		230-31(investime)		Totali	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Bashkia	174,322	174,321	28,483	28,440	69,789	45,276	8,859	279	286,351	143,017	567,804	391,333
Ministri e Linjes	5,421	5,310	943	931	1,741	1,469	198,111	196,117	123,457	122,446	329,673	326,273
Shuma Bashkia	**179,743**	**179,631**	**29,426**	**29,371**	**71,530**	**46,745**	**206,970**	**196,396**	**409,808**	**265,463**	**897,477**	**717,606**
Nderm Sherb Publik	116,410	116,405	18,406	18,406	59,051	42,948	-	-	15,463	11,908	209,330	189,667
TOTALI	**296,153**	**296,036**	**47,832**	**47,777**	**130,581**	**89,693**	**206,970**	**196,396**	**425,271**	**277,371**	**1,106,807**	**907,273**
masa e realizimit		**100%**		**100%**		**69%**		**95%**		**65%**		**82%**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, përpunuar nga grupi i auditimit*

Realizimi i i buxhetit për vitin 2025 për shpenzimet në mënyrë të përmbledhur për aparatin e bashkisë dhe institucionet e varësisë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/ lekë

Shpenzimet sipas llogarive ekonomike	Plani vjetor fillestar 2025	Plani perfundimtar 2025	Plani i celur 2025	Realizimi I shpenzimeve 2025	% e realizimit/ planit vjetor
Shpenzime për paga (600)	**298,385**	**296,531**	**123,772**	**296,425**	100%
Shp. për sig shoq e shëndetësore (601)	**48,784**	**47,466**	**20,669**	**47,407**	100%
Shpenzime operative (602)	**85,662**	**130,577**	**20,512**	**89,688**	69%
Subvencione (603)	**0**	**0**		**0**	
Transferta tek organizatat (604)	**8,812**	**8,880**		**3,627**	41%
Transferta tek individët (606)	**2,660**	**196,590**		**193,446**	98%
Fondi rezervë+e kontigjencës (609)	**1,500**	**8,061**		**1561**	19%
Shpenzime per Investime (231+230)	**249,078**	**418,702**	**98,000**	**275,803**	66%
a.Nga te ardhurat e transf e pakushtez	57,866	95,190		57,232	
b.Nga Ministrite linjes		123,455		122,443	99%
c.Nga te ardhurat e bashkise	191,212	200,057		96,128	48%
Total Bashki + Institucione	**694,881**	**1,106,807**	**262,953**	**907,957**	**82%**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, përpunuar nga grupi i Auditimit*

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit për vitin 2025 rezulton se, fondet buxhetore janë realizuar 907,957 mijë lekë nga 1,106,807 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 82%. Në këtë masë realizimi ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:
- llog.602"Shpenzime operative" në masën 69%, llog.604 "Transferta tek organizatat" në masën 41%, të cilat tregojnë për planifikime me rezervë dhe jo sipas nevojave, si dhe mos kryerje në kohë të procedurave për realizimin e shpenzimeve.
- llog.230 "Shpenzimet për investime oponencë teknike" dhe llog.231 "Shpenzimet për investime" me financim nga buxheti i Bashkisë dhe transferta e kushtëzuar janë realizuar në masën 66% nga mosrealizmi i projekteve të investimeve dhe morealizimi i të ardhurave.

Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre

Për **vitin 2025** janë **planifikuar** fonde për investime në shumën 418,702 mijë ***lekë*** (të cilat janë nga grant i pakushtëzuar + transferta sektoriale + të ardhura + transferte e kushtezuar) dhe janë ***realizuar në*** vlerën 275,803 mijë ***lekë, ose në masën 66%***.
Konkluzion: Nga analiza e investimeve theksojmë se një pjesë e investimeve janë prokuruar me vonesë në fund të vitit 2025. Fondet e planifikuara për shpronësime nuk janë realizuar, pasi ka mungesa ne dokumentacionin e dorezuar prej tyre, investimet në infrastrukturën rrugore janë planifikuar me 2 vite buxhetore. Një pjesë e projekteve nuk kanë përfunduar akoma, nuk janë marrë në dorëzim dhe një pjesë tjetër janë planifikuar më shumë se vlera e kontratave.

- **Fondet për investime nga të ardhurat e Bashkisë**

Për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 200,057 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 96,128 mijë lekë ose realizuar në masën 48%.

- **Fondet për investime të financuara nga Ministritë e Linjës**

Për vitin 2025 janë planifikuar fonde në vlerën 123,455 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 122,443 mijë lekë ose në masën 99%.

- *Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe kontigjencës*

Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës.
Për vitin 2025 është në total në shumën 1,500 mijë lekë, i cili është miratuar në buxhetin fillestar me VKB nr.77, datë 23.12.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1353/1, datë 31.12.2024. Përdorimi i fondit të kontigjencës është miratuar për të përballuar rritje te papritura te kostove te nje sherbimi ose projekti apo nevoja te reja te cilat nuk jane planifikuar gjate hartimit te buxhetit.

- *Raportet e Monitorimit.*

Për vitet 2025 përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 6 dhe me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" pikat 10, 12, 28, 29, 48.
Për vitin 2025 janë dërguar në MFE raportet e detajuara si më poshtë:
"Raport monitorimi Janar-Prill 2025" me shkresën nr. 4789 prot., datë 09.06.2025,
"Raport monitorimi Janar-Gusht 2025" miratuar online 04.11.2025 SMBV
"Raport monitorimi Janar-Dhjetor 2025"miratuar online 17.03.2026 SMBV

➢ *2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve etj.*

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga viti paraardhës në buxhet respektivisht paraqitet si vijon:

- *Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likujdimi i faturave të palikujduara palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve etj***.**

Konkluzion: Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Nuk është hartuar plani i shlyerjes së detyrimeve të vitit 2024 mbetur për likujdim në vitin 2025 në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Kreu II.3.

"Buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore. Rregulla dhe kritere për përdorimin e buxhetit vendor" pika 106 në të cilën përcaktohet se*: "Plani vjetor i buxhetit, i akorduar në nivel titulli, kapitulli dhe artikulli, përfaqëson limitin maksimal të lejuar për t'u shpenzuar nga njësitë shpenzuese. Gjatë detajimit të planit të buxhetit, njësitë e qeverisjes qendrore më parë detajojnë fonde për të paguar detyrimet e mbartura të viteve të kaluara për të gjitha llojet e shpenzimeve."*

Me fondet e vitit buxhetor 2025, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara Bashkia, nga Ministritë e linjës, sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës "*Detyrimet e prapambetura*", sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Detyrimet e prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2025: *Në lekë*

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31.12.2024	Detyrimi I krijuar në periudhën 01/01/2025 – 31.12.2025	Total detyrime	Shlyerja e detyrimeve 2025	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2025
a	**1**	**2**	**3=1+2**	**4**	**5=3-4**
a. Investime nga Ministritë e linjës e FZHSH	54,651,861	20,096,199	74,748,060	54,651,861	20,096,199
b. Investime nga Bashkia	38,030,098	37,849,358	75,879,456	57,937,614	17,941,842
c.Investime nga Ndermarrja			-		-
INVESTIME :			-		-
Mallra dhe shërbime	5,805,461	15,868,161	21,673,622	8,456,014	13,217,608
Mallra dhe sherbime ne ndermarrje	1,090,274	32,132,581	33,222,855	27,650,662	5,572,193
Vendime gjyqësore	-	-	-	-	-
Totali :	**99,577,694**	**105,946,299**	**205,523,993**	**148,696,151**	**56,827,842**

Detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2024 paraqiten në shumën 99,577,694 lekë, gjatë vitit 2025 janë krijuar 105,946,299 lekë, janë paguar detyrime në shumën 148,696,151 lekë, ndërsa në fund të vitit 2025 detyrimet e prapambetura paraqiten në shumën **56,827,842** lekë, pra kemi një ulje të detyrimeve të prapambetura në shumën 42,749,852 lekë.

Detyrimet e prapambetura të akumuluara dhe të raportuara në MF dhe sipas publikimit në faqen e saj në fund të vitit 2025 paraqiten në shumën **137,658,800** lekë, të cilat jepen në tabelën si më poshtë:

Në lekë

		Viti 2025		
NR	**Emërtimi**	**Stoku në vlerë**	**Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në**	**Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së**
I	**Borxhe (a+b)**	**0**		
a	**Hua afatgjatë**	**0**		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financ, overdraftt etj)	0		
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë			
b	**Hua afatshkurtër**	**0**		
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financ, overdraftt etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	**Detyrimet e prapambetura**	**137,658,800**		**18.45%**
Llogaria ekonomi	**Emërtimi**			
4864100	Vendime Gjyqesore			
4864200	Det.Prap. Sherbime	345,733		
4864201	D.P.EneriElektirke			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	99,578		
4864400	Det.Prap. Investime	121,371,395		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			

4864600	Mallra	15,842,094		
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	**Totali (I+II)**	**137,658,800**	**745,944,088**	**18.45%**

Burimi: *Drejtoria Ekonomike, përpunuar nga grupi i auditimit*

Referuar shkresës nr. 1693 prot., datë 27.02.2026 "Raport vjetor i vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare për periudhën janar-dhjetor 2025, Bashkia Roskovec" janë në shumën 137,658,800 lekë, e cila përbëhet nga: shuma prej 121,371,395 lekë e faturave të palikujduara për investime, shuma prej 15,842,094 lekë e faturave të palikujduara për mallra, shuma prej 343,733 lekë e faturave të palikujduara për shërbime, shuma prej 99,578 lekë e faturave të palikujduara për mirëmbajtje.
Sipas pasqyrave financiare detyrimet e prapambetura të akumuluara në llogarinë e klasës 4 në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar në fund të vitit 2025 janë në shumën **79,130,794** lekë. Pra rezulton një diferencë prej 58,528,006 lekë që përbëhet nga:
- shuma prej 54,651,861 lekë që i përket faturës së OE "F". ShPK" në fakt e likuiduar, por e raportuar si detyrim i prapambetur në mënyrë të gabuar për investimin e financuar nga ministritë e linjës me objekt: "Përmirësim i furnizimit me ujë të NJA Strum Rikonstruksion i Ujësjellësit Suk1, Suk 2, Strum dhe Velmish 2".Kjo shumë është sistemuar gjatë hartimit të pasqyrave financiare në mbyllje të vitit ushtrimor 2025.
- shuma prej 3,876,145 lekë është e paidentifikuar.

Për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025 nga analiza e këtyre detyrimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme rezultojnë që në fund të vitit 2025 janë të palikujduara gjithsej 97 fatura me vlerë **51,255,649** lekë për Bashkinë Roskovec (Aparati) dhe 10 fatura me vlere **5,572,193 lekë** për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike. Detyrimet e prapambetura të detajuara paraqiten në aneks:

Konkluzion: Nga analiza e detyrimeve gjendje në fund të vitit 2025 u konstatua se detyrimet prapambetura ndaj të tretëve të pa likuiduara të akumuluara në llogaritë e klasës 4 sipas pasqyrave financiare janë në shumën prej 79,130,794 lekë. Referuar shkresës nr. 1693 prot., datë 27.02.2026 "Raport vjetor i vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare për periudhën janar-dhjetor 2025, Bashkia Roskovec" dërguar në MF detyrimi i mbetur në fund të vitit ushtrimor është në shumën prej 137,658,800 lekë. Pra kemi një diferencë në raportim në MF në shumën prej 58,528,006 lekë, që i përket detyrimeve për investime të raportuara gabimisht si të palikujduara, ndërkohë që janë të likuiduara të sistemuara në kontabilitet. Mos shlyerja e detyrimeve ndaj të tretëve dhe mosraportimi i saktë i tyre është në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, nenet 5/c, 40/h, me Udhëzimin e MFE nr. 09, datë 20.07.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit*" i ndryshuar, pikat 48/i, 58,130, me Udhëzimin e MF nr.22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore*" shtojca 4 germa (c), me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 27.12.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", pikat 82-91.

Vështirësia Financiare

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (*të akumuluara*) në fakt në fund të vitit 2025 paraqiten në vlerën **79,130,794** lekë dhe pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 9 % kundrejt fondeve faktike 907,957,000 lekë. Kjo situatë tregon se, Bashkia Roskovec konsiderohet në situate normale e gjendjes financiare, pasi nuk e ka kaluar pragun 15% të shpenzimeve faktike në fund të vitit ushtrimor, duke mos u konsideruar institucion në vështirësi financiare sipas nenit 56 "Vështirësia financiare" të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe

Udhëzimit e MF nr. 35, datë 29.12.2023 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore" pika 33.

- *Burimet e financimit të buxhetit vjetor*

Referuar realizimit të buxhetit të vitit 2025, duke u nisur nga burimi i financimit rezulton se shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 301,675 mijë lekë ose në masën 33 %, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale në shumën 279,335 mijë lekë ose në masën 31 %, transferta e kushtëzuar në shumën 326,947 mijë lekë ose në masën 36%.
Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: z.S.Ç. me detyrë ish-Drejtor Ekonomik (për periudhën 01.01.2025-18.10.2026), zj.O.G me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike (për periudhën 01.01.2025-e në vazhdim), dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues.

2.5. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor.

- *Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*

Nga shqyrtimi i dokumentacioneve u konstatua se, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Roskovec struktura organizative e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2025 është miratuar me urdhrat e Kryetarit të Bashkisë Roskovec, nr. 01, datë 06.01.2025 dhe është organizuar me 9 punonjës.

	Viti 2024	
Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore	**Struktura**	**Fakt**
Drejtor Drejtorie	**1**	**1**
Sektori i Tatim-Taksave familjare	**5**	**5**
Përgjegjës Sektori Familjar	1	1
Specialistë	4	4
Sektori i Biznesit	**3**	**3**
Përgjegjës Sektori Biznesit	1	1
Specialistë Sektori Biznesit	1	1
Specialistë Transporti	1	1
Punonjës gjithsej	**9**	**9**

Burimi: *Bashkia Roskovec, përpunuar nga grupi i auditimit*

- *Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:*

Administrimi i taksave vendore bëhet me Exel, ku janë të pasqyruara regjistrat e biznesit të madh dhe të vogël në kodin përkatës dhe me bazën e të dhënave përkatëse, me ngarkesat për detyrimet e taksave dhe tarifat vendore, pagesat dhe datat e pagesave, si dhe dosjet për secilin taksapagues me njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik, pronaret e pasurive të paluajtshme**.** Sipas të dhënave të DTTV, gjendja e subjekteve tatimpagues në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Roskovec paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrimet e reja (hyrje)	Pezullimipërkohshëmiaktivitetit/Pasiv	Mbyllur Aktiviteti	Gjendjanë fund tëvitit total
Biznesi i Vogël	2025	409	51	0	31	429
Biznesi i Madh	2025	74	3	0	3	74
Institucione	2025	5	0	0	0	5
Total		**488**	**54**	**0**	**34**	**508**

Burimi:*DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2025 janë aktiv 508 subjekte të biznesit. Gjatë vitit 2025 janë pezulluar/mbyllur 34 subjekte.
Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka bashkëpunuar me DRT Fier në lidhje me rakordimin e subjekteve sipas statusit të tyre aktiv, pezulluar, mbyllur, nëpërmjet emal-eve qe dërgohen çdo dite nga DRT Fier dhe me shkresa zyrtare për shkëmbim informacioni.

DTTV ka bashkëpunuar me QKB për regjistrimet, çregjistrimet dhe ndryshimet e pësuar për bizneset pranë Bashkisë Roskovec dhe me pas janë bërë verifikime ne terren nga ana jonë.
Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore të dhënat në lidhje me faturimet e taksave dhe tarifave vendore i mban në sistem kompjuterik (Exel).

- *Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve*

Për vitin 2025, paketa fiskale e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Roskovec është miratuar me VKB nr. 71, datë 25.11.2024 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1269/1 prot., datë 06.12.2024.
Planifikimi i të ardhurave për vitin 2025 është kryer nga drejtoritë përkatëse sipas përgjegjësive përkatëse për përllogaritjen e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2025 miratuar me VKB nr.70, datë 28.12.2023 "Për miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Roskovec dhe PBA 2025-2027.
Plani dhe realizimi sipas llojeve të të ardhurave referuar akt-rakordimit me Thesarin për vitin 2025 paraqiten në tabelën në Aneks.

Për vitin 2025 referuar të dhënave dhe dokumentacionit të DTTV, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Roskovec janë realizuar në shumën 294,978,927 lekë nga 385,569,450 lekë të parashikuara, ose në masën 76.7%. Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet:

a. Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim të ulët të planit si:
- ***Tarifa e pastrimit*** është realizuar 18,127,761 lekë nga 21,340,450 lekë e planifikuar ose në masën 85%,
- ***Tarifë ndriçimi*** është realizuar 3,007,931 lekë nga 4,186,000 lekë e planifikuar ose në masën 71.86%,
- ***Tarifë gjelbërimi*** është realizuar 2,812,031 lekë nga 4,186,000 lekë e planifikuar ose në masën 67.18%,
- ***Tarifë vendore për urbanistikën*** është realizuar 1,791,439 lekë nga 3,000,000 lekë e planifikuar ose në masën 59.7%
- ***Tarifë regjistrimi biznesi*** është realizuar 0 lekë nga 500,000 lekë e planifikuar ose në masën 0%
- *T**arifa vendore e përkohshme*** është realizuar 2,914,841 lekë nga 10,480,000 lekë e planifikuar ose ne masën 27.81%,
- *Të **ardhurat e tjera jo tatimore*** është realizuar 7,808,156 lekë nga 60,000,000 lekë e planifikuar ose në masën 13%
- ***Tarifa e ujitjes së tokës*** është realizuar 3,476,930 lekë nga7,700,427 lekë e planifikuar ose në masën 45.15%
- ***Renta minerare*** është realizuar 25,472,312 lekë nga 65,000,000 lekë e planifikuar ose në masën 39.19%.
- ***Licenca për tregtim karburanti*** është realizuar 0 lekë nga 4,000,000 lekë e planifikuar ose në masën 0%.

b. Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim mbi planin si:
- ***Tarifë zënie hapësire publike*** janë realizuar 4,043,585.97 lekë nga 3,324,000 lekë e planifikuar ose në masën 121.65%.
-***Taksë ndikimi në infrastrukture nga legalizimet*** janë realizuar 38,868,656.25 lekë nga 5,500,000 lekë e planifikuar ose në masën 706.70%.
- ***Tarifë parkimi*** është realizuar 414,500 lekë nga 400,000 lekë e planifikuar ose në masën 103%.

- ***Të ardhura të tjera nga vërtetime, certifikatat e etj.*** janë realizuar 1,519,773 lekë nga 1,000,000 lekë e planifikuar ose në masën 151.98%.
- ***Te ardhura nga kopshti*** është realizuar 1,935,617 lekë nga 1,700,000 lekë e planifikuar ose në masën 113.86%.
- ***Qira objekti, qira trualli, qira tokës bujqësore*** është realizuar 4,557,092 lekë nga 2,902,000 lekë e planifikuar ose në masën 157% etj.

Konkluzion: Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet më shumë mbi planin, fakt që tregon se planifikimi i të ardhurave në disa zëra të ardhurash nuk është mbi baza reale dhe realizimi i viteve të mëparshme nuk është marrë në konsideratë në planifikim. Gjithashtu për një pjesë të ardhurash nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e tyre, gjë që ka sjellë ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore**.** Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"*Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 5, germa (a), me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 51, neni 9, pika 1.3/ç.

- *Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;*

Në realizimin në nivel të ulët të të ardhurave kanë ndikuar **niveli i lartë e debitorëve**. Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore në Bashkinë Roskovec, rezultoi se ka nivel të lartë **debitorësh** në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, individët, familjarët, **(**për taksën e ndërtesës, tabelës, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, etj), i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur.

- *Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për biznesin*

Në Bashkinë Roskovec subjektet tregtarë ngarkohen me detyrime vendore për taksën e regjistrimit, mbi truallin, pasuri, pastrim, ndriçim, tarifën e gjelbërimit, etj.,

Gjatë vitit 2025 ecuria e gjendje së debitorëve të biznesit të madh dhe të vogël sipas llojit të taksave paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr.	PËR SUBJEKTET FIZIK/JURIDIK/SHTETROR	Shuma progresive në fund të vitit 2024		Shtesa gjatë vitit 2025		Arkëtuar gjatë vitit 2025 edhe për vitet para 2025		Shuma progresive në fund të vitit 2025	
		Nr.Sub	Vlera	Nr.Sub	Vlera	Nr.Sub	Vlera	Nr.Sub	Vlera
1	Taksë mbi ndërtesën		4,351,920	119	1,026,694		506,806		4,871,808
2	Taksë mbi truallin	28	774,971	28	193,907		112,740		856,138
3	Tarifë Pastrimi	120	10,000,226	129	2,806,366		1,961,855		10,844,737
4	Tarifë Ndriçimi	120	698,824	129	106,556		108,030		697,350
5	Tarifë Gjelbërimi	120	658,053	129	106,556		92,830		671,779
6	Taksë Tabele	120	433,705	129	121,280		57,110		497,875
7	Tarifë Regjistrimi		412,000	15	184,000		120,000		476,000
8	Kamat vonesa		1,213,049		1209834		735,769		1,687,114
9	Tarife per permires, mbrojtja mjedis		2,320,000		2,035,839		1,080,000		3,275,839
10									
	SHUMA		**20,862,748**		**7,791,032**		**4,775,140**		**23,878,640**

Burimi:*DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Referuar të dhënave të vëna në dispozicion rezulton se debitorët nga taksapaguesit e kategorisë "biznes" në fund të vitit 2024 janë në shumën 20,862,748 lekë, gjate vitit 2025 janë krijuar debitorë në shumën 3,015,892 lekë dhe në fund të vitit 2025 debitorët nga taksapaguesit e kategorisë "biznes" janë në shumë progresive prej 23,878,640 lekë. Nga këto në fund të vitit 2025 u përket debitorëve të kategorisë "biznes" në 4 Njësitë Administrative në shumën 6,774,370 lekë.

- *<u>Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për familjarët.</u>*

Në Bashkinë Roskovec familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, taksën e truallit, tarifën e pastrimit, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, tarifën e mirëmbajtjes së varrezave publike dhe tarifën e mirëmbajtjes së rrugëve të parcelave dhe sistemit kullues.

Ecuria e detyrimet e familjeve për taksat dhe tarifat vendore sipas njësive administrative **gjatë vitit 2025** në mënyrë të përmbledhur është paraqitur në Aneks.

në lekë

Bashkia/NJ.A	Taksa mbi tokën bujqësore		Taksë ndërtese		Tarifë pastrimi		Tarifë ndriçimi		Tarifa e mirëmbajtjes së parcelave dhe sistemit kullues		Taksë trualli		Tarifë gjelbërimi		Total
	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	
Roskovec	1584	5,532,799	1757	1981035	1757	3514000	1757	1405600	988	1,359,950	1757	39,690	1757	140600	13973674
Kuman	2206	6,761,822	1910	3025920	1910	2292000	1910	955000	1048	900,277	1910	44,520	1910	955000	14934539
Strum	2433	10,626,014	1865	2567235	1865	2238000	1865	932500	2032	2,149,171	1865	72,135	1865	932500	19517555
Kurjan	1406	6,749,996	766	122985	766	919200	766	383000			766	49,434	766	383000	8607615
TOTAL	**7629**	**29,670,631**	**6298**	**7697175**	**6298**	**8963200**	**6298**	**3676100**	**4068**	**4409398**	**6298**	**205,779**	**6298**	**2,411,100**	**57033383**

Burimi: *DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Në mënyrë të përmbledhur debitorët për vitin 2025 nga taksapaguesit subjektet tregtare dhe familjarë sipas llojeve të taksave/tarifave dhe viteve janë paraqitur në Aneks.

Në lekë

Nr.	Lloji i taksës	Subjekte biznes			Familjare (UKKO)			Total			Total 01.01.2026
		Prog 31.12.2024	Borxh vetem per 2025	Arktime 2025	Prog 31.12.2024	Borxh vetem per 2025	Arktime 2025	Prog 31.12.2024	Borxh 2025	Arktime 2025	Prog. 31.12.2025
1	Regjistrim	412,000	184,000	120,000				**412,000**	**476,000**	**120,000**	**476,000**
2	Pasuri	4,351,920	1,026,694	506,806	34,425,483	7,697,175	23,617,582	**38,777,403**	**8,723,869**	**24,124,388**	**23,376,884**
3	Truall	774,971	193,907	112,740	2,306,367	205,779	120,538	**3,081,338**	**399,686**	**233,278**	**3,247,746**
4	Pastrim	10,000,226	2,806,366	1,961,855	9,104,563	8,963,200	3,052,424	**19,104,789**	**11,769,566**	**5,014,279**	**25,860,076**
5	Ndriçim	698,824	106,556	108,030	8,656,358	3,676,100	1,433,370	**9,355,182**	**3,782,656**	**1,541,400**	**11,596,438**
6	Gjelbërim	658,053	106,556	92,830	6,847,789	2,411,100	952,640	**7,505,842**	**2,517,656**	**1,045,470**	**8,978,028**
7	Tabelë	433,705	121,280	57,110				**433,705**	**121,280**	**57,110**	**497,875**
8	Tarif permir mbroj mjedis	2,320,000	2,035,839	1,080,000				**2,320,000**	**2,035,839**	**1,080,000**	**3,275,839**
9	Kamatvonesa	1,213,049	1,209,834	735,769				**1,213,049**	**1,209,834**	**735,769**	**1,687,114**
10	Gjoba	2,808,500	2,903,111	358,000				**2,808,500**	**420,831**	**358,000**	**2,871,331**
11	Taks toke				92,539,160	29,670,631	13,579,612	**92,539,160**	**29,670,631**	**13,579,612**	**108,630,179**
12	Mirëmbajtje kanali				6,529,165	4,409,398	1,947,519	**6,529,165**	**4,409,398**	**1,947,519**	**8,991,044**
13	Taksa ndikimit infrastruk				25,916,869		944,245	**25,916,869**		**944,245**	**24,972,624**
14	Tarife ujitje		8		4,969,852	1,881,154	899,336	**4,969,852**	**1,881,854**	**899,336**	**5,952,370**
	SHUMA	**23,671,248**	**8,211,863**	**5,133,140**	**191,295,606**	**58,915,237**	**46,547,266**	**214,966,854**	**67,127,100**	**51,680,406**	**230,413,548**

Burimi: *DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Konkluzion: Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe informacionit të vënë në dispozicion nga DTTV në Bashkinë Bashkinë Roskovec, rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh **për taksat dhe tarifat** në numër dhe në vlerë, kështu:

Vlera e borxhit në fund të vitit 2024 është **214,966,854 lekë** i përbërë nga:

- Detyrime nga taksat dhe tarifat e bizneseve, në vlerën totale 23,671,248 lekë;
- Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në vlerën 184,766,441 lekë.

Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2025 është **67,127,100 lekë** i përbërë nga:

- Detyrime nga taksat dhe tarifat e bizneseve, në vlerën totale 8,211,863 lekë, nga ku 2,308,751 lekë janë detyrime për taksa e tarifa dhe 2,903,112 lekë janë gjoba nga IMTV dhe Policia.
- Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në vlerën 58,915,237 lekë.

Vlera e arkëtuar e detyrimeve gjatë vitit 2025 është 51,680,406 lekë.

- Detyrime nga taksat dhe tarifat e bizneseve, në vlerën totale 5,133,140 lekë;
- Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në vlerën 46,547,266 lekë.

Në fund të vitit 2025 gjendja e debitorëve progresiv për bizneset dhe familjarët është **230,413,548 lekë**, vlerë kjo që ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec, e cila përbëhet nga:

- Detyrime nga taksat dhe tarifat e bizneseve, në vlerën totale 26,749,971 lekë;

- Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në vlerën 203,663,577 lekë.

Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorët është në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"*Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 42, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, *neni 51,* neni 9 pika 1.3 nënpika (ç), VKB nr. 71, datë 25.11.2024 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025"

- Dinamika e Borxhit:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se struktura e borxhit për subjektet e biznesit të madh, biznesit të vogël dhe pronarë të bizneseve, sipas moshës së tij paraqitet si më poshtë:

Mosha e Borxhit ne fund te vitit 2024	Vlera/lekë	Nr. Subjekte
1-3 vit	11,011,917	134
3-5 vjet	2,654,913	20
Mbi 5 vjet	10,211,812	35
Totali	**23,878,642**	**189**

Referuar të dhënave të pasqyrës, konstatohet se vlerën më të lartë të borxhit e zënë debitorët e moshës 1-3 vjet në vlerën 11,011,917 lekë dhe debitorët e moshës mbi 5 vjet në vlerën 510,211,812 lekë.

- *Menaxhimi borxhit nga taksat e tarifat vendore. Auditimi i rasteve në lidhje me zbatimin e masave shtrëngese për arkëtimin e borxhit ndaj subjekteve debitorë***.**

Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore (DTTV), Bashkia Roskovec është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

5. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
6. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
7. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
8. Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë dërguar dhe njoftuar me njoftim vlerësimi tatimor të gjithë bizneset brenda afateve të përcaktuara në paketën fiskale konkretisht brenda datës 12.03.2025 janë dërguar njoftim vlerësimet për subjektet tregtare në lidhje me tarifat lokale, brenda datës 16.05.2025 janë dërguar njoftim vlerësimet për pronarët e pasurive të paluajtshme dhe për subjektet e krijuara rishtazi janë dërguar brenda afatit të përcaktuar.

Për subjektet debitore dhe familjarët me detyrime të papaguara për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifat vendore janë dërguar njoftime dhe kërkesa për pagese.

Për vitin 2025 drejt debitorëve familjarë për detyrimet e akumuluara DTTV u bankave te nivelit te II kërkesë për urdhër bllokim të llogarive në vlerën **12,388,066 lekë** me numër total debitorësh prej **350 familjesh** për vlerën **12,388,066** l**ekë**, ku **254 familje** kanë arritur të paguajnë vlerën prej **6,452,574 lekë.** Është dërguar një shkresë e përgjithshme për bankat dhe secilës prej tyre u është dërguar lista me debitorët në mënyrë elektronike.

Njoftimi për bllokim të llogarive të subjekteve debitore:

Nr.	Nr. raste	Nr. protok	Datë	Vlerë në lekë
1	350	9541	13.11.2025	12,388,066

Njoftime për dhe kërkesë për pagesë për vitin 2025 për debitorët sipas Njësive Administrative

Nr.	Njësia Administrative	Nr.rastesh	Vlerë
1	Roskovec	17	488,221
2	Strum	200	7,942,870

3	Kuman	100	2,838,872
4	Kurjan	33	1,118,103
	TOTAL		**12,388,066**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se, për vitin 2025 drejt subjekteve tregtare janë dërguar 508 njoftime për çdo subjekt qoftë debitore dhe jo debitore. Gjithashtu DTTV ka komunikuar në mënyrë shkresore edhe me bankat e nivelit të II për bllokimin e llogarive bankare ku është dërguar shkresë e përgjithshme për të gjitha bankat dhe po ashtu në mënyrë elektronike u është dërguar lista e emrave të debitorëve.

Njoftim dhe kërkesë për pagesë për subjektet debitore,

Nr. protokolli	Datë	Nr. rastesh	Vlerë në lekë
9431	12.11.2025	129	16,910,450

Konkluzion: Drejtoria e Taksave Vendore në Bashkinë Roskovec për vjeljen e detyrimeve është mjaftuar me nxjerrjen e njoftim-vlerësimeve për detyrimin dhe një numri të kufizuar të masave shtrënguese dhe nuk janë aplikuar të gjitha masat administrative dhe ligjore, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara", nenet 89, 90, 91 dhe 93 dhe me VKB nr. 71, datë 25.11.2024 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025".

- *Planifikimi dhe arkëtimi i taksës së tokës bujqësore.*

Taksa mbi tokën bujqësore **për vitin 2025** taksa e tokës është realizuar në shumën 23,828 mijë lekë nga 25,852 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 92.17%. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për biznesin është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Roskovec sipas parashikimeve të paketës fiskale pika 1.2.2.
Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për familjarët është DTTV pranë Bashkisë Roskovec, si dhe specialistet e Njësive Administrative.
Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, gjithsej tokë bujqësore sipas Bashkisë Roskovec që mund të faturohen janë 23909.7 Ha. Fondi i tokës bujqësore sipas Drejtorisë së Mbrojtjes së Tokës deri me datë 31 dhjetor 2025 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Shuma	Arë	Pemtore	Vreshtë	Ullishte
	SIPËRFAQJA E TOKËS GJITHËSEJ	**Ha**	**9122.76**	**5800.8**	**66.96**	**148**	3107
1	Nga Kjo :						
2	**TOKË NË PRONËSI PRIVATE : Nga e cila:**	**Ha**	**9013.57**	**5702.61**	**66.96**	**148**	3096
2-Jan	Tokë në pronësi private me origjinë nga ish Kooperativat Bujqësore	Ha	7828.96	4560.01	65.96	147	70
2-Feb	Tokë në pronësi private me origjinë nga ish	Ha	1184.61	1142.6	1	1	40
	Ndërmarrjet Bujqësore						
3	**TOKË NË PRONËSI SHTETËRORE : Nga e cila:**	**Ha**	**109.19**	**98.19**	**0**	**0**	11
3-Jan	Tokë e pandarë me origjinë nga ish Kooperativat Bujqësore	Ha	30	19	0	0	11
3-Feb	Tokë me origjinë nga ish-kooperativat kaluar Agjensisë së Trajtimit të Pronave	Ha	0	0	0	0	0
3-Mar	Tokë disponibël shtetërore me origjinë nga ish Ndërmarrjet Bujqësore	Ha	79.19	79.19	0	0	0
3-Apr	Tokë e ish-Ndërmarrjes bujqësore dhënë në përdorim familjeve bujqësore	Ha	0	0	0	0	0
3-May	Sipërfaqe toke në administrim të Institucioneve të tjera shtetërore.	Ha	0	0	0	0	0

Kjo sipërfaqe e ndarë sipas NJA dhe kategorive shumëzuar për tarifën e përcaktuar sipas kategorive në paketën fiskale, nga përllogaritja konstatohet se planifikimi i taksës së tokës bujqësore është në shumën 32,940,920 lekë, e cila pasqyrohet në tabelën si më poshtë vijon:

Planifikimi i taksës së tokës bujqësore Bashkia Roskovec për vitin 2025

Kategoria e tokës	Sip/ha Roskovec	Sip/ha Kuman	Sip/ha Strum	Sip/ha Kurjan	Shuma në/ ha	Vlera /ha	Plani
Kategoria I			6.5		6.5	5600	36,400
Kategoria II	593	138	932.2	0.4	1663.6	4900	8,151,640
Kategoria III	481	546	1622.6	137	2786.6	4200	11,703,720
Kategoria IV	115	459	586.4	673	1833.4	3600	6,600,240
Kategoria V		224	106.3	761	1091.3	3000	3,273,900
Kategoria VI		145	6	472	623	2400	1,495,800
Kategoria VII-X		470		462.9	932.9	1800	1,679,220
Shuma					8937.3		32,940,920

Diferenca midis planifikimit fillestar të taksës së tokës prej 32,940,920 lekë dhe planifikimit prej 25,852,000 lekë sipas aktrakordimit me Degën e Thesarin lidhet me vendimin e Këshillit Bashkiak i cili aplikon ulje takse të tokës bujqësore me vlerë 30% për 6 mujorin e parë. Gjithashtu në ulje të planifikimit të të ardhurave nga taksa e tokës kanë ndikuar zbritja e sipërfaqeve të mbjella me pemëtari që përjashtohen nga taksa për 5 vjet, si dhe përjashtimi nga taksa edhe invalidët.

- *Ndjekja e procedurave për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore*.

Në **fund të vitit 2024** rezulton se vlera debitore për taksën e tokës bujqësore është në shumën **92,539,160 leke** dhe në **fund të vitit 2025** në shumën **81,467,439 lekë**, e cila në krahasim me vitin 2024 është ulur me vlerën me **11,071,721 lekë**.
Gjatë vitit 2025 janë gjithsej 4,143 familje debitore për vlerën 11,071,721 lekë.
Arkëtimi i kësaj takse pavarësisht punës që kryhet paraqitet me problem në Bashkinë Roskovec, për arsye se familjet të cilat taksohen për tokën bujqësore pavarësisht se njoftohen (referuar këtu njoftimeve të kryera nga zyra apo dhe në terren nga specialistët e njësive administrative) nuk kryejnë pagesat për shkak të lëvizjeve demografike, emigracionit etj.

Debitorë për taksën e tokës bujqësore viti 2025					
Njësia Administrative		Debitorë të krijuar në vitin 2025 (Lekë)			Ne fund të vitit 2025
	Debitorë të trashëguar deri ne fillim të vitit 2025	Familje me tokë bujqësore	Familje debitore(Nr.)	Familje debitore (vlerë)	DEBIA PROGRESIVE
Roskovec	12,673,218	1581	996	3,406,507	15734795
Strum	43,050,526	2433	1444	1,701,034	41556048
Kuman	21,254,767	2207	1232	3,880,510	20995754
Kurjan	15,560,649	1404	471	2,083,670	15148344
TOTAL	**92,539,160**				**81,467,439**

Burimi: DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga Sektori i Bujqësisë së Bashkisë Roskovec dhe nga Sektori i Mbledhjes dhe Kontrollit të të Ardhurave për Njësitë Administrative nuk është kryer punë e mjaftueshme për përditësimin e të dhënave si dhe për rritjen e arkëtimeve në NJA për uljen e borxhit për taksën e tokës.

Konkluzion: Nga Drejtoria e Taksave Vendore nëpërmjet specialistëve të taksave në 4 NjA (Roskovec, Strum, Kuman, Kurjan) nuk është kryer punë e mjaftueshme për përditësimin e të dhënave si dhe për rritjen e arkëtimeve dhe uljen e borxhit për taksën e tokës, e cila në fund të vitit 2025 është në shumën 81,467,439 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Roskovec. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, neni 6, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë"**,** pika 1.3. nënpika(ç) dhe me VKB nr. 71, datë 25.11.2024 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025".

- *Mbi menaxhimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Roskovec në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT, Fier janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK.
Konkluzion: Referuar listave të vëna në dispozicion nga Bashkia Roskovec në formatin exel mban pagesat e kryera nga personat që kanë patur detyrime për taksën e ndikimit në infrastrukturë, ku u konstatua se:
- **Në fund të vitit 2024** nga legalizimet kanë mbetur detyrime pa paguar në vlerën 25,916,863 lekë. Gjatë vitit 2025 nuk ka patur korrespondence me ASHK Fier, për këtë arsye nuk ka shtesa, ndërsa arkëtimet janë në shumën 944,245 lekë nga 25 individë. **Në fund të vitit 2025** detyrimet nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet janë në shumën

24,972,624 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec. Këto veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006"*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, i ndryshuar me Ligjin nr. 95/2018, neni 9, pika 3/c, me ligjin nr. 98/2020 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 1, "në nenin 27, pika 3, shkronja "c", me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*" pika 5, me VKB nr. 71, datë 25.11.2024 *"Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025"*.
Në mënyrë të detajuar debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë paraqiten në aneks.
Në mënyrë të përmbledhur debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Lloji i takses	Gjendja e debitorëve në datë 31.12.2024		Shtesat gjatë vitit 2025		Arkëtimet gjatë vitit 2025		Gjendja e debitorëve në datë 31.12.2025	
Ndikimi ne Infrastrukture	Numri i individëve	Vlera	Numri i individëve	Vlera	Numri i individëve	Vlera	Numri i individëve	Vlera
	890	25,916,869	0	0	25	944,245	864	24,972,624

- *Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:*

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve dhe gazit për vitin 2025 ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Roskovec dhe në Njësitë Administrative **11** subjekte, të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, të cilat paraqiten në Aneks. Sipas të dhënave nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se, duke filluar nga viti kalendarik 2017 deri në vitin 2025 nga stacionet e karburantit janë mbledhur të ardhura për bashkinë Roskovec 5,000,000 lekë nga lëshimi i autorizimeve për lejimin e ushtrimit të aktivitetit në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre pasi subjektet e licencuara kanë paguar detyrimet e tyre në mënyrë të plotë për periudhën 5 vjeçare.

Gjatë vitit 2025 është licencuar 1 pikë karburanti që i kishte mbaruara afati i licencimit, i cili ka paguar tarifën e autorizimit për lejimin e aktivitetit të tregtimit me pakicë të hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.
Subjektet e licensuar janë:

SUBJEKTI	NUIS	AFATI I AUTORIZIMIT		Detyrimi	Pagesat	Diferenca
		FILLIMI	MBARIMI	autorizimin		
B.P	L..	18.12.2020	18.12.2025	1,000,000	1,000,000	0
Ç. ShPK	J..	19/12/2025	19/12/2030	1,000,000	1,000,000	0

Subjektet të cilët nuk janë licensuar janë:

	Subjekti	Administratori	NIPT	Adresa	Aktiviteti
1	X.H	A.I	L..	Roskovec	Karburante
2	B.O	B.C	L..	Strum	Karburante
3	L.	A.T	L..	Velmish	Karburante
4	A. O	V.B	K..	Kuman	Karburante
5	"E". SHPK	A.T	K..	Velmish	Karburante
6	"E" SHPK	M.T	K..	Suk 1	Karburante
7	"X" SHPK	B.A	K..	Suk 2	Karburante
8	S.G	G. I	K..	Strum	Pikë Gazi
9	H.A	H.A	L..	Suk 1	Pikë Gazi

Arsyeja mosdhënies së autorizimeve subjekteve të tregtimit të karburanteve dhe gazit që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Roskovec është pretendimi se këtyre subjekteve u mungon autorizimi hyrje-dalje nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, shkak i cili nuk ka penguar që këto subjekte të jenë aktive në ushtrimin e aktivitetit.
Konkluzion: Referuar dosjeve të subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë Roskovec për shitje me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tij konstatohet se, për periudhën

objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 11 subjekte nga të cilat 2 subjekte janë të pajisura me autorizim me afat me 5 vjet për lejim ushtrim aktiviteti dhe kanë kryer pagesë për vlerën e plotë prej 1,000,000 lekë dhe 9 subjekte që nuk janë pajisur me autorizime, **duke sjellë të ardhura të munguara në shumën 9000,000 lekë** për buxhetin e Bashkisë Roskovec. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, nenet 4,15 dhe 20/2" dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kreu II, pika 3, pika 15.1.

- *Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:*

Të ardhurat nga agjentët tatimorë derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Roskovec dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Fier me të cilin mbahen akt-rakordimet mujore. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë gjatë periudhës së audituar janë:

në lekë

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	Vlera e realizuar Viti 2024	Vlera e realizuar Viti 2025
Drejtoria Rajonale Tatimore	Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin	0	0
Drejtoria e Përgjith e Shërbim të Transport Rrugor,DR Fier	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	11,617,477	12,039,431
SH.R.U.K.KO	Taksa & Tarifa Vendore Familjare	0	0
D. R. T Fier; D.R.T Tiranë Tatimpag e Mëdhenj e Dr Përgj Dogana	Renta Minerare	35,737,606	20,989,945
Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Roskovec	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë	0	0

- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me DRT të Mëdhenj dhe me DRT Fier. Janë kryer kërkesa për transferim të rentës minerare drejtuar, Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, Drejtorisë se Tatimpaguesve të Mëdhenj, Drejtorisë së Përgjithshme te Tatimeve dhe rakordimi i pjesës takuese te rentës minerare që i përket Bashkisë Roskovec. Realizimi i rentës minerare për vitin 2024 është në shumën 35,737,606 lekë nga 60,000,000 lekë të planifikuara ose masën 59.6%. Ndërsa për vitin 2025 realizimi i rentës minerare është në shumën 25,472,312 lekë nga planifikimi prej 65,000,000 lekësh, ose në masën 39.2%. Të ardhurat e arkëtuara nga renta minerare sipas akt-rakordimeve mujore për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

KALIMI NE EVIDENCE	TATIMET Fier	DOGANA	TATIMPAGUESIT E MEDHENJ	TOTALI VJETOR,
Janar 2025				
Shkurt 2025		2,526,707		2,526,707
Mars 2025				
Prill 2025		303,642		303,642
Maj 2025				
Qershor 2025				
Korrik 2025				
Gusht 2025		12,162,978		12,162,978
Shtator 2025				
Tetor 2025		6,048,790		6,048,790
Nentor 2025				
Dhjetor 2025		4,430,195		4,430,195
TOTALI		**25,472,312**		**25,472,312**

- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Roskovec ka kryer rakordimet mujore me Agjencisë Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Fier për vlerën e taksës së kalimit të pasurisë së paluajtshme (shitjes) për vlerën e taksës që i takon Bashkisë Roskovec. Arkëtimet për këtë taksë kalohen çdo muaj nga ASHKDVK referuar akt-rakordimeve mujore të taksës së shitjes së pasurisë së paluajtshme. Gjithashtu konstatojmë se Bashkia Roskovec, mos arkëtimet nga ana e Drejtoria Rajonale Vendore ASHK Fier janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Roskovec është

kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektesh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse.
Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: zj.O.G. me detyrë ish-Drejtore e Drejtorisë të Ardhurave Vendore (për periudhën 01.01.2025- 18.10.2025), z. S.Ç. me detyrë Drejtor i Drejtorisë të Ardhurave Vendore (për periudhën 18.10.2025- e në vazhdim), zj.M.D. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Biznesit në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore.

3. Auditim mbi llogaritë vjetore për vitin 2025". Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare. Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar.

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2025 nga njësia shpenzuese "Bashkia Roskovec " për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022.

- ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Bashkia Roskovec për vitin 2025 ka hartuar Pasqyrat Financiare dhe Njësia e saj shpenzuese me nipt më vete si më poshtë:

1. Aparati i Bashkisë Roskovec

2. Agjensia e Shërbimeve Publike.

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Fier për vitin ushtrimor 2025 me shkresë përcjellëse nr.2476 prot, datë 31.03.2026.
Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Roskovec dhe në cilësinë e NZ është Drejtori Financës. Pra në këtë rast nuk kemi delegime të detyrave.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2025 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- *<u>Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit</u>*

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:
- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel"dhe nuk ka një program financiar, i cili do të shmangte pasaktësitë
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjke dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur libri i madh për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në librin e madh deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomiko - financiar për vitin 2025

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar,
Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme
Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël,
Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.
Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës
Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.
Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.
Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar, dhe detyrimet janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra janë të paraqitura të plota në bilanc..
Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese
Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, si dhe janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura.
Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.
Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria Ekonomike . Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2025 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2024.
Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;
Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë 520 "Disponibilitete në Thesar" dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin nr.5 "Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2025".

Nga testi kontrollit për vitet 2025 në lidhje me:
Rregullaritetin i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:
Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit për pagesat e taksave dhe tarifave .Gjendja e arkës nuk e kalon limit e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.
Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* dhe kreut III pika 34 dhe 35 germat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 *"Për limitin e arkës"*.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.
Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.
Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.
Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- *Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare***.**

Totali i Aktivit për vitin 2025 është në vlerën 3,353,490,845 lekë dhe i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari sintetike dhe analitike, paraqiten në kapitullin anekse.

A. AKTIVE AFATSHKURTRA

Në formatin nr. 1 **"Aktivet Afatshkurtra" në aktiv të bilancit** paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në vlerën **570,324,331 lekë** dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën **505,117,537** lekë.

Klasa 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën **173,926,101** lekë**,** të cilat rakordojnë me rubrikën VI "Teprica e likuiditeteve në fund te vitit ushtrimor" në Formatin nr.3 "Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOŴ) sipas metodës direkte" të paraqitur në Aneks.
Konkluzion: Referuar analizës së pasqyrës në formatin nr.5 "Pasqyra e lëvizjes në cash viti 2025" rezulton se shumat në llogaritë sintetikë dhe anilitikë nuk janë të sakta, pasi janë keqklasifikuar, pavarësisht se llogaria "Teprica e likuiditeteve" si në çelje dhe në fund të vitit ushtrimor 2025 është sipas aktrakordimit me thesarin, kështu:
a. Tek rubrika I "Veprimtaritë e shfrytëzimit"
✓ Seksioni "Akordim fonde buxhetore për shpenzime korente" paraqitet në shumën 206,217,351 lekë, kur duhet të ishte 203,827,000 lekë sipas aktrakordimit me thesarin. Po kështu kjo shumë nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 7201 "Grant korent i brendshëm nga buxheti për NJQP (vendore)" në pasqyrën e performancës që paraqitet në shumën 197,729,674 lekë.
✓ Seksioni "Arkëtime e të hyra (Cash), gjatë vitit ushtrimor" paraqitet në shumën 0 lekë, ndërkohë sipas shumës së llogarive analitike sipas pasqyrës së performancës duhet të ishte 295,227,277 lekë.
- Gjendja e llogarisë analitike "Të hyra nga tatimet" paraqitet në shumën 0 lekë, ndërkohë që kjo llogari analoge në pasqyrën e performancës paraqitet në shumën 226,543,534 lekë dhe sipas akt akordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë analitike "Të tjera arkëtuar' paraqitet në shumën 892,452,329 lekë, kur sipas llogarisë analoge 7204 "Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale" në pasqyrën e performancës është në shumën 49,843,533 lekë.

✓ Seksioni "Pagesa për detyrime e shpenzime korente" paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë sipas llogarive analitike duhet të ishte 463,929,055 lekë. Pagesat për detyrime për shpenzime korente të vitit ushtrimor dhe të viteve të kaluara paraqiten në shumën 452,823,480 lekë, ndërsa sipas aktrakordimit me thesarin janë në shumën 452,143,211 lekë, me një deviacion prej 680,269 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" kap. 3.5 i ndryshuar me UMF nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III, pika 24.

Në klasën 3 "Gjendja e inventarit qarkullues" të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën **59,024,757** lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 28,444,087 lekë, ku diferenca e tyre në ulje në vlerën prej **-30,580,670** lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" në formatin nr.2 "Pasqyra e performancës financiare". Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- Gjendja e llogarisë 31 "Materiale" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 23,992,479 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 19,090,830 lekë me një shtese për vitin ushtrimor prej 4,901,649 lekë, e cila përfaqëson rritje të gjendjes së mallrave në fund të vitit 2025.

- Gjendja e llogarisë 32 "Inventari i imët" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 35,032,278 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 9,353,257 lekë me një shtesë për vitin ushtrimor prej 25,679,021 lekë, e cila përfaqëson rritje të gjendjes së mallrave ne fund te vitit 2025.

Klasa 4 "Llogari të arkëtueshme" paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 337,373,473 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 337,615,098 lekë, ku kemi shtesë duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes se detyrimeve te debitorëve të ndryshëm.

- Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 239,641,604 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 224,676,704 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2025 në krahasim me vitin 2024 ka pësuar rritje prej 14,964,900 lekë, rritje e cila ka ardhur nga gjendja e debitorëve të krijuar në vitin 2025 për taksa dhe tarifa vendore. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar edhe teprica e debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të lëna nga Prefektura dhe KLSH në vite në vlerën 9,228,056 lekë, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërkimit. Analiza e gjendjes së llog.468 "Debitorë të ndryshëm" dhe lëvizjet e pësuara në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Analiza e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" Në lekë

Nr.	Emri i debitorit	Data ose viti i krijimit	Vlera e debisë ne 31.12.2024	Shtesat gjate periudhës 2025	Pagesat gjatë periudhës 2025	Vlera e debise mbyllëse 31 dhjetor 2025
1	Debitore nga Auditi i Prefektures (NJA Kurjan)		**388,243**			**388,243**
2	Debitore nga Auditi	2014	**2,617,422**			**2,617,422**
36	Debitore nga Auditi	2015	**461,987**			**461,987**
46	Keshilltaret nga KLSH	2017	**1,828,662**			**1,828,662**
47	Subjekte nga KLSH	2017	**2,705,657**			**2,705,657**
48	**Subjekte nga KLSH**	**2022**	**1,707,879**	**-**	**481,794**	**1,226,085**
-	"A."	2022	245,771		245,771	-
-	"B."	2022	1,226,085			1,226,085
-	"A.&D. & 2.K."	2022	236,023		236,023	-
	Debitor per taksa dhe tarifa vendore		**214,966,854**	**230,413,548**	**214,966,854**	**230,413,548**
42	Debitor per taksa dhe tarifa vendore NJA Roskovec	2025	69,792,119	75,183,699	69,792,119	75,183,699
43	Debitor per taksa dhe tarifa vendore NJA Kuman	2025	41,753,127	44,960,909	41,753,127	44,960,909
44	Debitor per taksa dhe tarifa vendore NJA Strum	2025	78,570,717	84,218,159	78,570,717	84,218,159
45	Debitor per taksa dhe tarifa vendore NJA Kurjan	2025	24,850,891	26,050,781	24,850,891	26,050,781
	Total		**224,676,704**	**230,413,548**	**215,448,648**	**239,641,604**

- ***Teprica e llogarisë 4342*** **"Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"** në aktiv të pasqyrës të pozicionit financiar paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në shumën 97,731,869 lekë, e cila përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara. Kjo gjendje rakordon me shumën e llogarive kundërparti në pasivin e bilancit: llog.401-404 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në vlerën 79,130,794 lekë, llog.42"Detyrime ndaj personelit" për vlerën 12,945,780, llog.431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" për vlerën 1,446,136 lekë, llog.435 "Sigurime shoqërore" për vlerën 3,694,131 lekë, llog.436 "Sigurime shëndetësore" për vlerën 515,028 lekë dhe vlerën pjesore prej 0 lekë të llog.467"Kreditorë të ndryshëm".

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Në formatin nr. 1 **"Aktivet Afatgjata" në aktiv të bilancit** paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën **2,783,166,514** lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 3,481,958,343 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur.Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)"paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 5,005,767,281lekë të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 "Aktive Afatgjata jo materiale" që përbëhet nga**:**

- Gjendja e llogarisë 202 ***"Studime dhe kërkime"*** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën 3,368,122 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën prej 806,518 lekë, të cilat rakordojnë me llogarinë anloge në Formatin 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlerë neto)". Në mënyrë të detajuar gjendja e kësaj llogarie paraqitet në Aneks:

Inventari i llogarise 202 "Studime dhe kërkime "

Nr.	Viti i krijimit	Emertimi I objektit	Celje 01.01.2025	Blerë gjatë vitit 2025	Pakesime gjatë vitit 2025	Gjendja në 31.12.2025
		Bashkia	0			**0**
23	2024	Hartimi I projekt-zbatimit per bllokun nr.3	806,518			**806,518**
	2025	Hartim projektesh per rruge dhe rrjete		2,561,604		**2,561,604**
		SHUMA	**806,518**	**2,561,604**	**0**	**3,368,122**

Konkluzion: Vlera e mbetur në fund të vitit 2025 prej 3,368,122 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e *llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime",* për 2 projekt-studime për investime të pakryera ose të kryera, të cilat duhet ishin shpërndarë sipas llojit të aktiveve material në rastin e investimeve të kryera. Gjithashtu për vlerën e mbetur të aktiveve prej 806,518 lekë nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% për vitin 2025, duke sjellë mbivlerësimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika16/b.d, Kreu III. pika 36, Aneksi 1 pika 2 Klasa 2.

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2025.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) "Aktivet afatgjata materiale" paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 në 2,600,181,456 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën totale prej 2,705,693,707 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 5,002,399,159 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- ***Gjendja e llog. 210 "Toka, Troje, Terrene"*** paraqitet me vlerë neto me vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 112,776,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 112,776,000 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" si në mbyllje të vitit 2025 është 112,776,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën

112,776,000 lekë dhe nuk ka asnjë ndryshim nga viti në vit. Për këto grupaktivesh nuk ka një inventar kontabël të plotë dhe mungon inventari fizik. Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë 210 "Toka, troje terrene" dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të dhe nuk janë përfshirë të gjithë aktivet ë këtij lloji për të gjitha njësitë administrative. Kjo gjendje paraqitet sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llogarisë *210 "Toka, Troje, Terrene"* me datë 31.12.2025

Nr.	Viti i krijimit	Emërtimi I objektit	Çelje 01.01.2025	Blerë gjatë vitit 2025	Pakesime gjatë vitit 2025	Gjendja në 31.12.2025
1	**para 2014**	Toka,troje,terene Njësia Kuman	**112,776,000**	**-**	**-**	**112,776,000**
		SHUMA	**112,776,000**	**0**	**0**	**112,776,000**

- Gjendja e llogarisë 211 "Pyje, Kullota e Plantacione" paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 ne shumen prej 271,161,300 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 271,161,300 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 ne vlerën 271,161,300 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në shumën prej 271,161,300 lekë.

Inventari kontabël i llogarisë *211 "Pyje, Kullota e Plantacione"* me datë 31.12.2025

Emërtimi I objektit	Çelje 31.12.2024	Blerë gjatë vitit 2025	Pakesime gjatë vitit 2025	Gjendja në 31.12.2025
Blerje pemë dekorative dhe shkurre	192,000			192,000
Pyllëzime	2,289,600			2,289,600
Blerje peme dekorative dhe shkurre	1,912,800			1,912,800
Pyje e kullota kaluar në pronësi me VKM nr. 433, datë 08.06.2016	260,262,500			260,262,500
Pyllëzime	952,800			952,800
Pyllëzime	4,056,400			4,056,400
Pyllëzime	1,495,200			1,495,200
SHUMA	**271,161,300**	**0**		**271,161,300**

- Gjendja e llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 917,403,407 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 899,422,808 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,159,135,047 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,222,086,786 lekë. Gjatë vitit 2025 janë pakësuar aktive për shkak te amortizimit ne vlerën 304,683,379 lekë dhe janë shtuar aktive ne vlerën 62,951,739 lekë. Në gjendjen e kësaj llogarie është përfshirë vlera 256,815,051 lekë e pa analizuar që është trashëguar nga ish-komunat. Për këto aktive mungon inventari fizik.

- Gjendja e Llogarisë 213"Rrugë, rrjete, vepra ujore" paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,253,741,211 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në 1,400,609,350 lekë. Gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 3,267,932,358 lekë. Gjatë vitit 2025 janë bërë shtesat në vlerën 133,415,035 lekë dhe pakësime nga amortizimi në vlerën 2,014,191,147 lekë. Në gjendjen e kësaj llogarie është përfshirë vlera 1,007,052,733 lekë e pa analizuar që është trashëguar nga ish-komunat. Për këto aktive mungon inventari fizik.

- Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 8,826,751 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 2,972,878 lekë. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2025 ne vlerën 12,061,321 lekë, ku është pakësuar gjatë vitit 2025 për shkak të amortizimit 3,234,570 leke dhe është shtuar në vlerën 6,002,516 lekë. Në gjendjen e kësaj llogarie është përfshirë vlera 4,211,717 lekë e pa analizuar që është trashëguar nga ish-komunat. Për këto aktive mungon inventari fizik.

- Gjendja e llogarisë 215 "Mjete Transporti" në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,687,048 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 2,108,810 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 26,376,014

ka shtesa në vlerën 0 leke dhe pakësime nga amortizimi në vlerën 24,688,966 lekë gjatë vitit 2025. Në gjendjen e kësaj llogarie është përfshirë vlera 17,259,600 lekë e pa analizuar që është trashëguar nga ish-komunat.

- ***Gjendja e llogarisë 218 "Inventar ekonomik"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën neto prej 34,585,739 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën neto 16,642,561 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 90,005,380 lekë. Në gjendjen e kësaj llogarie është përfshirë vlera 42,987,060 lekë e pa analizuar që është trashëguar nga ish-komunat.

Konkluzion: Nga auditimi i analizave të aktiveve afatgjata materiale rezultoi se në gjendjet e llogarive janë përfshirë vlera të grupaktivesh ta pa analizuara si: në llogarinë 210 *"Toka, troje, terrene"* në vlerën 112,776,000 lekë kosto historike është përfshirë vlera 112,776,000 lekë; 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* në vlerën 1,222,086,786 lekë kosto historike është përfshirë vlera 256,815,051 lekë; 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* në vlerën 3,267,932 lekë kosto historike është përfshirë vlera 1,007,052,733 lekë; 214 *"Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune"* në vlerën 12,061,321 lekë kosto historike është përfshirë vlera 4,211,717 lekë; 215 *"Mjete transporti"* në vlerën 26,376,014 lekë kosto historike është përfshirë vlera 17,259,600 lekë dhe 218 *"Inventar ekonomik"* në vlerën 90,005,380 lekë kosto historike është përfshirë vlera 42,987,060 lekë. Këto vlera janë të trashëguara nga bilanci i ish-komunave Roskovec të pa analizuara dhe që ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.
Referuar analizave të grupaktiveve ka paqartësi në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktivi, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve dhe pakësimet të secilit aktiv. Në këto inventarë kontabël janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo emërtese aktivi.
Regjistri historik i aktiveve nuk është sipas formatit të miratuar për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.
Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, kapitulli III pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 Pika 2. Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël).

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2025 paraqiten në Formatin nr.7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" të PF si më poshtë:

Nr. Ref Llog	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortiz	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	**I. AAGJ/JO MATERIALE**	**806,518**	**0**	**806,518**	**2,561,604**	**0**	**0**	**0**	**3,368,122**	**0**	**3,368,122**
201	Prime te emisionit e rimburs huave	0	0	0					0	0	0
202	Studime dhe kerkime	806,518	0	806,518	2,561,604			0	3,368,122	0	3,368,122
203	Konces, patent,licenc e tjera ngjash	0	0	0					0	0	0
21- 28	**II. AAGJ/ MATERIALE**	**4,752,642,714**	**2,046,949,007**	**2,705,693,707**	**250,119,776**	**355,632,027**	**363,331**	**363,331**	**5,002,399,159**	**2,402,217,702**	**2,600,181,456**
210	Toka,troje,Terene	112,776,000	0	112,776,000	0		0		112,776,000	0	112,776,000
211	Pyje,Kullota Plantacione	271,161,300	0	271,161,300	0		0		271,161,300	0	271,161,300
212	Ndertime e Konstruksione	1,159,135,047	259,712,238	899,422,809	62,951,739	44,971,140			1,222,086,786	304,683,379	917,403,407
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	3,134,517,323	1,733,907,973	1,400,609,350	133,415,035	280,283,174			3,267,932,358	2,014,191,147	1,253,741,211
214	Instal tekn,makin,paisje,vegla pune	6,058,805	3,085,927	2,972,878	6,002,516	148,644			12,061,321	3,234,570	8,826,751
215	Mjete transporti	26,376,014	24,267,204	2,108,810	0	421,762			26,376,014	24,688,966	1,687,048

216	Rezerva shtetrore	0	0	0	0		0		0		0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0	0	0	0		0	0	0
218	Inventar ekonomik	42,618,225	25,975,664	16,642,560	47,750,486	29,807,307	363,331	363,331	90,005,380	55,419,640	34,585,739
24	Aktive te Qend.te trupez te demtu	0		0	0		0		0	0	0
28	Caktime	0		0	0		0		0	0	0
	T O T A L I (I + II)	**4,753,449,232**	**2,046,949,007**	**2,706,500,225**	**252,681,380**	**355,632,027**	**363,331**	**363,331**	**5,005,767,281**	**2,402,217,702**	**2,603,549,578**

- ***Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale*** paraqitet në vlerën 2,402,217,702 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9. Nga auditimi rezultoi se përllogaritjet e amortizimit për aktivet afatgjata materiale janë respektuar normat e amortizimit në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III. pika 36.

Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)

			Shtesa gjatë vitit ushtrimor , kosto historike					Pakësime gjatë vitit ushtrimor			
				Shtesa pa pagesë							
		Gjendje në fillim të vitit	Blerje e krijuar me pagesë	Jashtë sistemit	Brenda sistemit	Lëvizje brend aktivee	Gjithsej	Nxjerrje jashtë perdorimi	Pakësime të tjera	Gjithsej	Gjendja në mbyllje të ushtrimit
b	**c**	**1**	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**	**10**
20	**I. AAGJ/JO MATERIALE**	**806,518**	**2,561,604**	**0**	**0**	**0**	**2,561,604**	**0**	**0**	**0**	**3,368,122**
201	Prime te emisionit e rimburs huave						0			0	0
202	Studime dhe kerkime	806,518	2,561,604			0	2,561,604			0	3,368,122
203	Konces, patent,licenc e tjera ngjash						0			0	0
21- 28	**II. AAGJ/ MATERIALE**	**4,752,642,714**	**201,427,258**	**0**	**48,692,518**	**0**	**250,119,776**	**363,331**	**0**	**363,331**	**5,002,399,159**
210	Toka,troje,Terene	112,776,000					0			0	112,776,000
211	Pyje,Kullota Plantacione	271,161,300					0		0	0	271,161,300
212	Ndertime e Konstruksione	1,159,135,047	62,951,739				62,951,739			0	1,222,086,786
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	3,134,517,323	133,415,035				133,415,035			0	3,267,932,358
214	Instal tekn,makin,paisje,vegla pune	6,058,805	4,416,000		1,586,516		6,002,516		0	0	12,061,321
215	Mjete transporti	26,376,014	0				0		0	0	26,376,014
216	Rezerva shtetrore	0					0			0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0					0			0	0
218	Inventar ekonomik	42,618,225	644,484		47,106,002		47,750,486	363,331		363,331	90,005,380
24	Aktive te Qend.te trupez te demtu	0					0			0	0
28	Caktime	0					0			0	0
	T O T A L I (I + II)	**4,753,449,232**	**203,988,862**	**0**	**48,692,518**	**0**	**252,681,380**	**363,331**	**0**	**363,331**	**5,005,767,281**

- ***Teprica e llogarisë 230- 231"Investime për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale"*** paraqitet në mbyllje të vit 2024 në vlerën 117,142,028 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 në vlerën 179,616,936 lekë, që i përket vlerave të plota ose pjesore të paguara të kontratave të investimeve që janë në vazhdim të pa kapitalizuar ose të pa marra në dorëzim. Teprica *e llogarisë 230- 231"Investime për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale" në aktiv* në shumën 179,616,936 lekë kuadron me tepricën e llogarisë kundërparti 115 "Nga fondet e veta të investimeve" në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar. Referuar analizës së kësaj llogarie rezulton se pakësimet në shumën 203,988,262 lekë rakordojnë me shumën e blerjeve me pagesë të aktiveve afatgjata në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata me kosto historike. Analiza e kësaj llogarie në nivel aktivi paraqitet në Aneks. Analiza e kësaj llogarie në nivel grupaktivesh paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	llogaria	Emërtimi I aktiveve	Çelje 01.01.2025	Blerë gjatë vitit 2025	Pakesime gjatë vitit 2025	Gjendja në 31.12.2025
1	**202**	Studime dhe kërkime	1,000,000	1,561,604	2,561,604	-
	2012	Shpenzime për ndertime e konstruksione	50,556,378	33,560,799	62,951,739	21,165,438
	2013	Shp. për rrugët, rrjetet dhe veprat ujore	66,585,650	225,280,883	133,415,035	158,451,498
	2014	Shp.instalime teknike,paisje	-	4,416,000	4,416,000	-
	2015	Mjete transporti	-	-	-	-
	2018	Inventar ekonomik	-	644,484	644,484	-
		SHUMA	**118,142,028**	**265,463,770**	**203,988,262**	**179,616,936**

<u>Pasivet afatshkurtra.</u> Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 3,353,490,845 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- ***Gjendja e llogarisë 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"*** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Gjendja e kësaj llogarije në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 79,130,794 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën

99,575,758 lekë ku rezulton një zbritje prej 20,444,964 lekë. Analiza e gjendjes së llog.401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"paraqite në Aneks.

Analiza e gjendjes së llog.401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"

	Gjendja në dt 31.12.2024			Gjendja në datë 31.12.2025
Objekti	**Shuma leke**	**shtesa**	**pakesime**	**Gj fund**
Shuma e llogarisë 401	**130,659,682.00**	**84,459,499.00**	**135,947,716.00**	**79,130,794.00**

- ***Teprica e llogarisë 42 "Detyrime ndaj personelit"*** paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën 12,945,780 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2025 për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2026.

- ***Teprica e llogarisë 431 "Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat*** paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën kontabël 1,446,136 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2025 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2026.

- ***Teprica e llogarisë 435 "Sigurime shoqërore*** paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën 3,694,131 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasaardhës.

- ***Teprica e llogarisë* 436** "*Sigurime shëndetësore*" në fund të vitit 2025 është në vlerën kontabël 515,028 lekë.

- ***Teprica e llogarisë* 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*"** përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 65,060,761 lekë. Për këtë gjendje të llog. 466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Fier. Analiza e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" paraqitet në Aneks.

Analiza e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"

FIRMA	Gjendja me 31.12.2024	Ngurtesim 2025	Clirim garancie 2025	Gjendja me 31.12.2025
Shuma e llogarisë 466	**63,454,347**	**12,711,989**	**11,105,575**	**65,060,761**

- ***Teprica e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 0 lekë.

- **Teprica e llogarisë 4341** ***"Operacione me shtetin (detyrime)"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 239,641,604 lekë, e cila kuadron me shumën e llogarive kundërparti në aktiv llog.468 "Debitorë të ndryshëm". Llogaria 4341"Operacione me shtetin (detyrime)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme.

- Rubrika D: Fondi i Konsoliduar

- T**e**prica e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 2,662,574,335 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 3,392,260,402 lekë, të cilat rakordojnë me tepricat e llogarisë analoge në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto të paraqitura në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor.
- Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/defiçiti i akumuluar"* kreditohet për shtesat e vitit sipas pasqyrës nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* në vlerën 252,682,380 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 30,580,670 lekë sipas llogarisë 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit".*
- Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/defiçiti i akumuluar"* debitohet për amortizimin shtesë të vitit 2024 në vlerën -355,632,027 lekë dhe për investimet kapitale të pakësuara në shumën -657,316,090 lekë.

Nga përllogaritjet rezulton se teprica e kësaj llogarie në mbyllje të vitit ushtrimor është në vlerën 2,662,574,335 lekë, e cila është llogaritur kështu: çelje (vitit paraardhës) e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* në vlerën 3,392,260,402 lekë duke shtuar tepricën e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" në vlerën 30,580,670 lekë dhe

shtesën e aktiveve për vitin 2025 në vlerën 252,681,380 lekë, duke zbritur vlerën e amortizimit të vitit të AAGJM prej 355,632,027 lekë dhe vlerën e investimeve kapitale të pakësuara prej 657,316,090 lekë. Pra kjo gjendja e kësaj llogarie e paraqitur në mbyllje të vitit ushtrimor është e saktë.

- **Teprica e llogarisë 105** ***"Teprica e granteve kapitale të brendshme"*** në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë.

- **Teprica e llogarisë 115** ***"Nga fondet e veta të investimeve"*** në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 179,616,936 lekë**.**

- Teprica e llogarisë 85 ***"Rezultati i veprimtarisë ushtrimore"*** në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 108,865,340 lekë, e cila rakordon me llogarinë analoge në pasqyrën e përformancës.

Pasqyra e Performancës financiare (F2)

Formati nr.2 "Pasqyra e performancës financiare" paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 667,903,213 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Fier paraqitet më poshtë:

Konkluzion: Teprica e llogarisë sintetike ***70 "Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"*** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 226,543,534 lekë, ndërsa sipas akrtrakordimit me Thesarin është në shumën 189,661,901 lekë, pra janë paraqitur 36,881,633 lekë më shumë se sa janë arkëtuar në fakt. Pasaktësia e gjendjes së kësaj llogarie tregon për pasaktësi të evidentimit të tepricave të llogarive analitike të të ardhurave tatimore.

-Gjendja e llogarisë analitike ***7002* "*Tatim mbi biznesin e vogël*"** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 0 lekë.

- Gjendja e llogarisë ***7020 "Tatim mbi pasurinë e paluajtshme"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 145,873,195 lekë që përfshin (*taksë toke në vlerën lekë 23,828,913, taksën mbi pasurinë në vlerën 122,044,282 lekë),*

- Gjendja e llogarisë ***7035 "Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 80,670,339 lekë që përfshin *(taksë tabele në vlerën* 485,690 *lekë, taksës vendore regjistrim biznesi në vlerën 463,000, tarifë për zënie hapësirë publike 4,043,585.97 leke, taksë e ndikimit në infrastrukture në vlerën 38,868,656.25 lekë, tarifë pastrimi në vlerën 18,127,761 lekë, tarifë gjelbërimi në vlerën 2,812,031 lekë, tarifë ndriçimi në vlerën 3,007,931 lekë, taksë për truallin 2,575,621 leke, tarifë për dhënie licencë 1,042,866 leke, tarifë e vendore për ujitjen e tokës 3,476,930 lekë, tarifë vendore për certifikatë përdorimi 13,407, tarifë vendore për urbanistikën në vlerën 1,791,439 lekë, tarifa për leje zhvillimi në vlerën 141,750 lekë, tarifë vendore për lëshim dokumenti në vlerën 500 lekë, tarifë vendore për leje ndërtimi në vlerën 25,000 lekë, tarifë vendore për varrim në vlerën 879,330 lekë, tarifë vendore e përkohshme në vlerën 2,914,841 lekë).*

Konkluzion: Teprica e llogarisë ***71 "Të ardhurat jo tatimore"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 18,840,210 lekë, ndërsa sipas akrtrakordimit me Thesarin është në shumën 55,721,843 lekë, pra janë paraqitur 36,881,633 lekë më pak se sa janë arkëtuar në fakt. Pasaktësia e gjendjes së kësaj llogarie tregon për pasaktësi të evidentimit të tepricave të llogarive analitike të të ardhurave jo tatimore.

- Gjendja e llogarisë ***7109*** "***Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 4,557,092 lekë, që përfshin *(të ardhura nga qira për troje në vlerën 2,402,980 lekë, të ardhura nga qira trualli në vlerën 17,960 lekë, të ardhura nga qira objekti në vlerën 2,136,152 lekë),*

- Gjendja e llogarisë ***7110*** "***Tarifë administrative dhe rregullatore"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 28,370 lekë që përfshin *(Tarifë leje transporti 28,370 lekë,)*

- Gjendja e llogarisë ***7111*** "***Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 2,357,117 lekë, që përfshin *(të ardhura nga kopshti në vlerën 1,935,617 lekë, të ardhura nga parkingu në vlerën 414,500 lekë, të ardhura sekondare në vlerën 7,000 leke),*
- Gjendja e llogarisë ***7113*** "***Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 77,000 lekë, që përfshin *(te ardhura nga shërbimi MNZ ne vlerën 35,000 lekë, të ardhura nga shitja e kartonit ne vlerën 42,000 leke).*
- Gjendja e llogarisë ***7115*** "***Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 4,019,475 lekë, që përfshin *(Të tjera gjoba policia bashkiake në vlerën 3,000 leke, të tjera gjoba në vlerën 458,992 lekë, kamatëvonesa në vlerën 1,698,744 leke, sekuestrime dhe zhdëmtime në vlerën 1,858,739 lekë).*
- Gjendja e llogarisë së fondeve ***72 "Grante Korente"*** është në vlerën prej 346,915,465 lekë, vlerë e cila përbëhet nga:

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 7201 "Grant korent i brendshëm nga buxheti për NJQP (vendore)" paraqitet në shumën 197,729,674 lekë, kur duhet të ishte 203,827,000 lekë sipas aktrakordimit me Thesarin.

- Gjendja e llogarisë *7204* "*Pjesëmarrja e institucioneve në tatime nacionale"* paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 49,843,533 lekë, që përfshin *(tarifë vendore e qarkullimit të mjeteve të përdorura në vlerën 12,907,030 lekë, TAP në vlerën 11,464,191 lekë, Renta minerare në vlerën 25,472,312 lekë),* e cila kuadron me akt akordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
- **llog.7206 "***Financim i pritshëm* në vlerën 97,731,869 lekë vlerë e cila rakordon me gjendjen e llogarisë analoge 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"*në formatin nr.1 "Pasqyra e pozicionit financiar", pasi kjo gjendje pasqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara **.**
- *Të ardhura të trashëguara* në vlerën 14,024,124.22 lekë.

Konkluzion: Nga auditimi në pasqyrën e performancës rezulton se në të ardhurat e vitit ushtrimor 2025 është përfshirë gjendja e llogarisë 787 "Tërheqje nga seksioni i investimeve" në shumën 75,604,004 lekë që përfaqëson të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës të pasqyruar një herë në atë vit dhe nuk mund të jenë pjesë e rezultatit të vitit ushtrimor.

Analiza e shpenzimeve në vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën **559,037,873** lekë paraqitet më poshtë:

Konkluzion: Teprica e llogarisë *600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"* për vitin 2025, paraqitet në vlerën 184,246,609 lekë, por nga përllogaritja rezulton se shpenzimet e konstatuara në fakt janë në vlerën 183,263,978 lekë, pra 982,631 lekë më shumë.

Konkluzion: Teprica e llogarisë *601 'Kontribute për sigurime"* për vitin 2025, paraqitet në vlerën 30,123,300 lekë. Nga përllogaritja rezulton se shpenzimet e konstatuara në fakt janë në vlerën 30,638,615 lekë, pra 515,315 lekë më pak, e cila ka rezultuar nga shpenzimet për kontribute e tatime të paguara sipas aktrakordimit me thesarin në shumën 29,371,150 lekë, duke zbritur detyrimet e dhjetorit të vitit 2024 në shumën 2,941,694 lekë të paguara në janar të vitit 2025 dhe duke shtuar detyrimet e dhjetorit të vitit 2025 për kontribute e tatime në shumën 4,209,159 lekë.

- Gjendja e llogarisë *602 "Blerje mallra e shërbime"* paraqitet për vitin 2025 në vlerën 46,430,068 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.
- Gjendja e llogarisë së fondeve *604 "Transferime korente te brendshme"* paraqitet për vitin 2025 në vlerën 3,627,480 lekë dhe sipas akt rakordimit me Thesarin.
- Gjendja e llogarisë së fondeve *606 "Transferime për buxhetet familjare e Individë"* paraqitet për vitin 2025 në vlerën 193,446,730 , e cila rakordon me akt akordimin me Thesarin.

- Gjendja e llogarisë *63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"* është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në pasqyrën e pozicionit financiar, ku për vitin 2025 është në vlerën -30,580,670 lekë.

Konkluzion: Në seksionin "Shpenzime të tjera" në mbyllje të vitit ushtrimor paraqitet në shumën 131,744,356 lekë, e cila sipas informacionit të dhënë përbëhet nga shuma prej 127,077,504 lekë investime nga të ardhurat+grant viti 2024 dhe detyrime të prapambetura nga të ardhurat për investime në fund të vitit 2025 në shumën 4,666,852 lekë, shumë kjo e fundit që nuk korrespondon me detyrimet për investime nga të ardhurat në fund të vitit 2025, që në fakt janë në shumën 41,984,399 lekë me një diferencë prej 37,317,547 lekë.

Duhet theksuar se në seksionin *"Shpenzime të tjera"* janë kryer veprime gabuara, pasi në këtë seksion evidentohen veprimet e korrigjimit të rezultatit, ku përfshihen veprimet kontabël me llogaritë 831 *"Caktim të ardhurash të funksionimit për investime",* llog.8420 *"Transferim i të ardhurave ne buxhet",* llog.8421*"Derdhje n buxhet te të ardhurave të papërdorura",* llog. 8422 *" Transferime të të ardhurave të krijuara brenda sistemit", llog. Transferimi i të ardhurave nga ndryshimi i gjendjeve* etj dhe duhet të korrespondojnë me formatet e tjera të pasqyrave financiare si pasqyra e flukseve të mjeteve monetare.

Për vitin 2025 totali i të ardhurave është 667,903,213 lekë dhe **totali shpenzimeve** është 559,037,873 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 108,865,340 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 "Rezultati i ushtrimit"

Si përfundim: Nga auditimi i pasqyrës së performancës u konstatua se ka pasaktësi në llogaritë:

- Gjendja e llogarisë 7201 "Grant korent i brendshëm nga buxheti për NJQP (vendore)" paraqitet në shumën 197,729,674 lekë, kur duhet të ishte 203,827,000 lekë sipas aktrakordimit me thesarin.
- Në të ardhurat e vitit ushtrimor 2025 është përfshirë gjendja e llogarisë 787 "Tërheqje nga seksioni i investimeve" në shumën 75,604,004 lekë, që përfaqëson të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës, dhe nuk mund të jenë pjesë e rezultatit të vitit ushtrimor.
- Gjendja e llogarisë 600 *'Paga, shpërblime e të tjera personeli"* për vitin 2025 paraqitet në shumën 184,246,609 lekë, ndërsa nga përllogaritja rezulton në shumën 183,263,978 lekë, duke u mbivlerësuar me 982,631 lekë.
- Gjendja e llogarisë 601 *'Kontribute për sigurime"* për vitin 2025 paraqitet në shumën 30,123,300 lekë, ndërsa nga përllogaritja rezulton në shumën 30,638,615 lekë, duke u nënvlerësuar me 515,315 lekë.
- Seksioni *"Shpenzime të tjera"* në mbyllje të vitit ushtrimor paraqitet në shumën 131,744,356 lekë, e cila sipas informacionit të dhënë përbëhet nga shuma prej 127,077,504 lekë investime nga të ardhurat + grant viti 2024 dhe detyrime të prapambetura nga të ardhurat për investime në fund të vitit 2025 në shumën 4,666,852 lekë, shumë kjo e fundit që nuk korrespondon me detyrimet për investime nga të ardhurat në fund të vitit 2025, që në fakt janë në shumën 41,984,399 lekë, pra me një diferencë prej 37,317,547 lekë. Duhet theksuar se në seksionin *"Shpenzime të tjera"* janë kryer veprime gabuara, pasi në këtë seksion evidentohen veprimet e korrigjimit të rezultatit, dhe llogaritë duhet të rakordojnë me llogaritë analoge në pasqyrat e tjera.

Pasaktësia e gjendjes së këtyre llogarive deformon rezultatin e veprimtarisë së vitit ushtrimor 2025, rrjedhimisht pozicionin financiar të subjektit në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, duke mos dhënë siguri edhe mbi tepricat e transaksioneve mbi të cilat është përgatitur pasqyra e flukseve apo pasqyra e pozicionit financiar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" Aneksi 1, pika 4, faqe 48-51.

Formati nr.6 "Investimet dhe burimet e financimit"

- Gjendjet e llogarive në Formatin nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit” rakordojnë më llogaritë analoge që paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar, Formatin nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” dhe në Formati nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOŴ).

- *Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar.*

Në bazë të UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese për vitin 2025 për Bashkinë Roskovec dhe NjA në varësi. Për kryerjen e procesit të inventarizimit për periudhën objekt auditimi ka dalë urdhri i titullarit me nr.prot.8739, datë 15.10.2025 “Për inventarizimin e aktiveve të njësisë për vitin 2025”. Në bazë të këtij urdhri janë përcaktuar komisionet e inventarizimit sipas objekteve ku do kryhet inventarizimi si në: Aparatin e Bashkisë, 3 NjA, 14 Shkolla, 1 çerdhe, 2 kopshte, Qendrën Social-Komunitare, Pallatin e Kulturës, Muzeun Vendor, Bibliotekën e qytetit, ndërtesa, automjete si edhe magazina. Procesi i inventarizimit është kryer për aktivet e llogarive: llog.312 “Materiale”, llog.327 “Inventar imet”, llog.218 “Inventar ekonomik”, llog.215 “Mjete transporti”, llog.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se, komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive**.** Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2025 dhe rezultojnë pa diferenca. Mungon relacioni përmbledhës për gjithë inventarin e AAGJM, ku të përshkruhet mënyra e ruajtjes së këtyre aktiveve dhe konfirmimi i rezultatit të inventarit. Komisionet gjatë procedurës së inventarizimit kanë bërë vlerësimin e aktiveve që kanë humbur vlerën e përdorimit, si dhe kanë hartuar listat me aktivet që do nxirren jashtë përdorimi. Komisioni i inventarizimit ka mbajtur raportet e vlerësimit të aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimi me nr.prot.10829-10833, datë 31.12.2025, në të cilat janë përshkruar aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi artikull për artikull si dhe shkaqet dhe arsyet e nxjerrjes së tyre jashtë përdorimi. Aktivet e vlerësuara jashtë përdorimi i përkasin llogarive: llog.327 “Inventar imët” në vlerën 1,726,468 lekë dhe llog.218 “Inventar ekonomik” në vlerën 6,193,625 lekë. Procesi i asgjesimit sapo ka filluar dhe është në vazhdim. Në vitin 2025 është proceduar me asgjesimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi nga procesi i inventarizimit i kryer në vitin 2024. Për këtë procedurë është mbajtur proces-verbali përmbledhës nr.prot.7377, datë 12.09.2025 nga komisioni i ngritur për këtë qëllim me urdhrin e titullarit nr.prot.194, datë 03.09.2025, i cili përshkruan procesin e asgjesimit të shoqëruar dhe me foto. Aktivet e nxjerra jashtë përdorimi dhe asgjesuar për vitin 2024 janë në llog.327 “Inventar imët” në vlerën 117,359 lekë dhe llog.218 “Inventar ekonomik” në vlerën 363,331 lekë, të cilat kanë gjetur evidentim në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2025.
Për aktivet afatgjata të llogarive: 210 *“Toka, troje, terrene”* në vlerë bruto 112,776,000 lekë; 212 *“Ndërtesa e konstruksione”* në vlerë bruto 1,222,086,786 lekë; 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”* në vlerë bruto 3,267,932 lekë; nuk është kryer inventar fizik në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: zj.O.G. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike (për periudhën 01.01.2025-e në vazhdim), në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe në cilësinë e hartueses të pasqyrave financiare dhe z. S.Ç. me detyrë ish-DE (për periudhën 01.01.2025-18.10.2026)

4. Auditimi i prokurimeve publike, periudha 01.01.2024 – 31.12.2025.

- Programi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.
- Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.

- Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

-Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitin ushtrimor.

-*Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.*

Për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, Bashkia Roskovec referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej 84 procedura prokurimi me vlerë kontrate 691,665,161 lekë pa TVSh, të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2024 – 31.12.2024	Nr.	Fond Limit pa TVSh	Vl. Kontrate pa TVSh	Diferenca	Ne %
GJITHESEJ, në të gjitha rastet	84	454 569 979.5	355 832 581	98 737 398.1	21.7%
-Të hapura	7	324 077 000.3	248,012,150	76 064 849.7	23.5%
-E hapur e thjeshtuar	33	114 367 497.2	94,416,695	19 950 801.57	17.4%
-Me vlerë të vogël	44	16 125 482	13,403,735	2 721 746.8	16.9%

Burimi: Bashkia Roskovec.

Për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025, Bashkia Roskovec referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej 63 procedura prokurimi me vlerë kontrate 354,141,646 lekë pa TVSh, të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2025– 31.12.2025	Nr.	Fond Limit (pa TVSh	Vl. Kontrate (pa TVSh)	Diferenca	Ne %
GJITHESEJ, në të gjitha rastet	63	24 0764 299	177 070 823.9	63 693 475.1	26.4%
-Të hapura	6	182 059 107	125 096 444	56 962 663	31.3%
-E hapur e thjeshtuar	13	41 071 493	37 952 564.4	3 118 928.6	7.6%
-Me vlerë të vogël	44	17 633 629	14 021 815.5	3 611 813.5	20.5%

Burimi: Bashkia Roskovec.

-Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjodhi për auditim:

-Për vitin 2024 janë realizuar 44 procedura prokurimi me vlerë të lartë me fond limit 454,409,731 lekë pa TVSh, nga grupi i auditimit janë përzgjedhur për auditim 7 procedura me fond limit 335,777,961 lekë pa TVSh ose 74 % të totalit të procedurave.

-Për vitin 2025 janë realizuar 19 procedura prokurimi me vlerë të lartë me fond limit 238,245,492 lekë pa TVSh, nga grupi i auditimit janë përzgjedhur për auditim 6 procedura me fond limit 196,837,582 lekë pa TVSh ose 83 % të totalit të procedurave

-U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1- Regjistri i realizimit të prokurimeve të periudhës 01/01/2024-31/12/2025;
2- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;
3- DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;
4- Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si Auditues;
5- Dosjet fizike të OE/BOE shpallur fitues;

Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të prokurimit, rezultoi si vijon:

1. Procedura e prokurimit me objekt : *"Rikonstruksion i rrugës "Kozma Prifti*", fshati Marinëz, (905 + 265 ml , b= 4 m+0.5 bankin).

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Rikonstruksion i rrugës "Kozma Prifti", fshati Marinëz, (905 + 265 ml , b= 4 m+0.5 bankin).			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF-08543-06-07-2024 **1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur "	**2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit** Nr.268Prot. Data 16.01.2025 A.H. E.T. S.K.	**3. Njësia e Prokurimit** Data 21.01.2025 6/445 E.P N.Y. S.C. E.K. A.D.	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Data 28.01.2025 Prot 661 M.G. E.H. O.G. D.H. D.S.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 59,111, 172 lekë	**6.Oferta fituese, vlera fituese:** Operatori Fitues: Rruga U E 41,383,400 lekë pa TVSh.		**7. Diferenca me fondin limit** 17 727 772 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data 10.02.2025	**9. Burimi Financimit** të ardhurat e veta.		**10. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender, 14 OE b) S'kualifikuar 1**,** c) Kualifikuar 13 **B/OE**
11. Ankimime **AK**-s'ka/ka**;** ka **APP**–s'ka/ka**;** **KPP**-s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK S'ka		**13.** P**ërgjigje** Ankesës nga APP apo **KKP:** S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës Data 04.03.2025 Nr.1781 Prot.	**15. Vlera e kontratës (me TVSH) 49 300 080**		**16. Likuiduar 33,526,368** lekë
17. Situacioni Përfundimtar	**18.Afati i kontratës në ditë 6 muaj**		**19. Zgjatja e kontratës me – ditë ska**

Burimi: Bashkia Roskovec.

I. Nga shqyrtimi i sipërcituar u konstatua se:

-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit në dosje rezultoi se preventivi i punimeve për procedurën me objekt "*Rikonstruksion i rrugës "Kozma Prifti", fshati Marinëz,(905+265 ml , b=4m+0.5 bankin*)" është hartuar nga subjekti A.Sh Engineering sh.p.k. me shkresën nr. 800/2 prot., datë 08.08.2024 është dërguar Oponenca Teknike. Është miratuar leja e ndërtimit me nr. 14 datë 09.09.2024.

- AK (NjP) në lidhje me "*Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve*".

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit" nr. 4176 port., datë 07.06.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), jo në të gjitha rastet, kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...". Grupi i auditimit vlerëson se, disa prej kritereve, të përcaktuar nga njësia e prokurimit, rezultojnë të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuar mbi bazën e parakushteve jo realiste. Në përgjithësi, për hartimin e kritereve dhe argumentimin e tyre njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke përcaktuar kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim apo të lidhura ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës. Në lidhje me këtë situatë neni 39 pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" përcakton se: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe

vlerën e kontratës…". Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:
-AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.5, ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues deponimin si vijon:
-Në pikën 2.3.6. është kërkuar nga Ak që Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatën e mëposhtme:
-Certifikatë ISO 50001:2018 mbi "*Sistemet e menaxhimit të energjisë*", (e vlefshme).
-Grupi i auditimit gjykon se ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.. Në përfundim, në lidhje me veprimet apo mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, ngarkohen me përgjegjësi, N. Y., S. K., E. K..
II-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO dhe lidhjen e kontratës**.**
Me shkresën 4178 datë 07.06.2024 është ngritur KVO me urdhër të titullarit të institucionit nënshkruar në mungesë nga zëvendës kryetari M. G.
Në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë 14 OE, për të cilin, referuar procesverbalit përkatës me nr. 4550 prot., datë 21.06.2024 si dhe SPE, KVO-ja ka kryer në datën 15.07.2024 vlerësimin paraprak dhe në datën 26.07.2024 vlerësimin përfundimtar duke pasqyruar klasifikimin si më poshtë:

OE/BOE	OFERTA LEKE PA TVSH
"U.A.E"	8,340,115
"G."	8,393,220
"R.C"	8,569,000
"A.C"	8,902,770
"V. E "	9,328,300
"S."	9,485,470
K.	9,627,900
"S"	9,638,300
"I. G"	9,818,000
"I".	9,837,400
"S."	9,944,100
"2.K."	10,235,900
"2.N."	11,009,800
"I."	7,904,970

Burimi: Bashkia Roskovec.
Me shkresën nr. 6180 prot., datë 05.08.2024 KVO ka paraqitur pranë titullarit të AK Raportin përmbledhës mbi hapjen dhe vlerësimin e ofertave. Me shkresën ne. 6778 prot., datë 28.08.2024 është realizuar nënshkrimi i kontratës.
Bazuar në procesverbalin e njoftimit përfundimtar rezultoi se janë kualifikuar 13 OE/BOE dhe është skualifikuar vetëm 1 (një) OE konkretisht OE "I." ShPK me ofertë 7,904,970 lekë pa TVSh. Është shpallur fitues OE "R.E", vlera më e ulët në raport me OE-të e kualifikuar. Sa i përket arsyeve të skualifikimit të OE Infiniy janë të renditura si më poshtë:
1.Oferta rezulton anomalisht e ulët.
Nga verifikimi i ofertave të vlefshme u konstatua se vlera totale e ofertuesve është 123,130,275/13 x 0.85= 8,050,825 lekë ku rezultoi se oferta anomalisht më e ulët është në këtë vlerë.

2.Ne lidhje me kriteret e veçanta te kualifikimit, pika 2.2 kapaciteti ekonomik dhe financiar konkretisht pika 2.2.2. Për të vërtetuar në aktivitet pozitiv të qëndrueshëm operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2022, 2023, të paraqitur në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet me nënshkrim dhe vule.
Bilancet të vitit 2022 dhe 2023 nuk janë të konfirmuara nga autoriteti përkatës (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve) me firmë dhe vule, pretendimi i KVO qëndron.
-Nga verifikimi ne SPE grupi i auditimit verifikoi Bilancet e OE I ku rezultoi se bilancet nuk janë të konfirmuara nga organi kompetent,
.Në lidhje me pikën 2.3 Kapaciteti teknik konkretisht pika 2.3.1 përvojë të suksesshme ne realizimin e te paktën një pune te ngjashme për një objekt te vetëm ne një vlere jo me te vogël se 30% e vlerës së përllogaritur te kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve te fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontratës. Punët e paraqitura kane kaluar afatin pesë vjet nga momenti i shpalljes se kontratës dhe zërat e përmendur në situacionin përfundimtare nuk përputhen me zërat e preventivit për objektin: Rikonstruksion i rrugës *"Kozma Prifti"*, fshati Marinëz, (905+265 ml,b=4m+0.5 bankin.
-Nga verifikimi në SPE lidhur me punët e ngjashme grupi auditimit verifikoi punët e ngjashme të paraqitura nga OE I ku rezultoi se ky OE ka paraqitur si punë të ngjashme "Sistemim Blloku tek ish Ferma Loti I", Ref-24356-05-29-2019. Sikurse shihet ky prokurim i përket një periudhe 6 vjeçare.
Nga auditimi i dokumentacion në sistemin SEP dhe dosjen e procedurës, rezultoi se shoqëria "R.E ." ShPK, nuk është në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve të DST, konkretisht:
-Në pikën 2.2.3 nga ak është kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2023. Nga auditimi rezultoi se OE fitues ka paraqitur si punë të ngjashme objekt kontrate *"Asfaltim i Fshatit Kotodesh"* me datë fillimi 09.02.2023 dhe datë mbarimi të kontratës me 09.05.2023 me një afat prej 5 maujsh. Nga auditimi u konstatua se, OE "*R .E* ." ShPK, nuk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e detyrimit për taksat dhe tarifat vendore pranë Bashkisë Përrenjas.
- Nga verifikimi i listëpagesave të paraqitura pranë Ak u konstatua se për punonjësin F.N paraqitur në formularin e vetëdklarimit si punëtor i thjeshtë ndërtimi, u konstatua se ky punonjës nuk figuron në listëpagesën e muajit maj. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", neni 92 "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 82 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2. Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga, *M.L, A.D, O.G.*

2. Procedura e prokurimit me objekt: "*Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjani*t".

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF-22747-10-04-2024 **1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur "	**2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit** Nr7516Prot.Data 20.09.2024 E.H. M.D. E.P.	**3. Njësia e Prokurimit** Data24.09.2024 129/7613 A.X. N.Y. A.D. S.C. E.K.	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Data 07.10.2024 NR.7960 Prot. M.G. D.H. O.G. E.H. D.S.

5. Fondi Limit (pa TVSh) 153, 009, 860 lekë	**6.Oferta fituese, vlera fituese:** Operatori Fitues: C.M – L. K.K - L78223801E 125, 436, 315 lekë pa TVSh.	**7. Diferenca me fondin limit** 27, 573, 545 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data 28.10.2024	**9. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit.	**10. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender, 8 OE b) S'kualifikuar 4**,** c) Kualifikuar 4 **B/OE**
11. Ankimime KPP- Data 26.11.2024 Prot 3442/2	**12. Përgjigje Ankesës** Data 05.12.2024 Nr. 9233/4	**13. Përgjigje** Ankesës Data 10.12.2024 Nr.3442/10 Prot
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Data 12.12.2024 Nr.9542 Prot	**15. Vlera e kontratës (me TVSH) 149 584 878**	**16. Likuiduar 62,432,908** leke
17. Situacioni Përfundimtar	**18.Afati i kontratës në ditë 6 muaj**	**19. Zgjatja e kontratës me – ditë ska**

Burimi: Bashkia Roskovec.

I. Nga shqyrtimi i sipërcituar u konstatua se:
-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.
Preventivi i punimeve është hartuar Shoqërisë S. Ltd në formë dhurimi dhe është marrë në dorëzim nga Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontraktr nr.7516 prot.,datë 20.09.2024. Me shkresën nr. 319/2 prot., datë 27.02.2024 është dërguar Oponenca Teknike. Është hartuar leja e ndërtimit nr. 22 datë 17.12.2024.
AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve".
-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit *"Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit"* nr. 7935 port., datë 04.10.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), jo në të gjitha rastet, kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...". Grupi i auditimit vlerëson se, disa prej kritereve, të përcaktuar nga njësia e prokurimit, rezultojnë të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuar mbi bazën e parakushteve jo realiste. Në përgjithësi, për hartimin e kritereve dhe argumentimin e tyre njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke përcaktuar kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim apo të lidhura ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës. Në lidhje me këtë situatë neni 39 pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" përcakton se: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës…". Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:
AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.3, pika c ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues dispononimin si vijon:
-Në pikën 2.3.6.nga Ak ka kërkuar që OE pjesëmarrës duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatën e mëposhtme:
-Certifikatë ISO 50001:2018 mbi *"Sistemet e menaxhimit të energjisë"*, (e vlefshme).

-AK ka kërkuar në pikën 2.3.3 b. Që OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës 1 (një) Inxhinier i Energjisë.
-Grupi i auditimit në lidhje me këtë kriter gjykon se është i pa argumentuar dhe nuk është në përpjesëtim me volumin dhe preventivin e objektit që prokurohet, inxhinieri i energjisë nuk ka titull. Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me *përgjegjësi A.X, N.Y, A.D,S.C, E.K.*

II- Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO dhe lidhjen e kontratës.

Në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë 8 OE, për të cilin, referuar procesverbalit përkatës si dhe SPE, KVO-ja ka kryer në datën 04.11.2024 njoftimi i klasifikimit dhe në datën 11.12.2024 vlerësimin përfundimtar duke pasqyruar klasifikimin si më poshtë:

OE/BOE	OFERTA LEKE PA TVSH
"Z."	139,931,276 kualifikuar
"B."	152,863,207 skualifikuar
"C.M. – L. K.K – L."	**125,436,315 Kualifikuar fitues**
"B.N."	152,957,166 skualifikuar
"S."	152,945,012 skualifikuar
"S."	153,009,852 kualifikuar
"B.B "	152,895,477 skualifikuar
"S."	153,009,850 kualifikuar

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm sipas AK:

Operatori ekonomik "B. N." Shpk skualifikohet pasi ka mungesë dokumentacioni si me poshtë:

1. Sipas kritereve të veçanta të kualifikimit duhet të dorëzonin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
2. Mungon pika 1,b sigurimi I ofertës
3. Mungon pika 2.3 kapaciteti teknik ,konkretisht pika 2.3.1 OE duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme
4. OE nuk ka të deklaruar asnjë punonjës dhe as makineritë, gjithashtu mungon katalogu/fragmenti i katalogut teknik të pompave për të krahasuar specifikimet teknike të ofertuara me ato të kërkuara në preventive.

Operatori ekonomik "B.B." SHPK skualifikohet pasi ka mungesë dokumentacioni si me poshtë:

1. Duhet të paraqesë licensën profesionale të shoqërisë të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, konkretisht duhet –N.P-10 B Ndërtim i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike ,ndërsa ju keni –N.P-10 A.
2. Numri total i punonjësve duhet 65 ju ku është deklaruar 49 punonjës, nga te cilët 52 duhen punonjës të thjeshtë ndërtimi të cilët nuk janë deklaruar.
3. Mungon inxhinieri i Energjisë dhe Inxhinier hidroteknik.
4.Mungojnë 2 specialistë për panelet fotovoltaike dhe specialist për hidroizolimin dhe makineri.
5. Mungon pika 1,b sigurimi i ofertës.
6. Mungon pika 2.3 kapaciteti teknik, konkretisht pika 2.3.1 OE duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme.
7. Mungon katalogu/fragmenti i katalogut teknik ti pompave për ti krahasuar specifikimet teknike të ofertuara me ato te kërkuara në preventive.

Operatori ekonomik "S."SHPK skualifikohet pasi ka mungesë dokumentacioni si me poshtë:

-Mungon pika 1,b sigurimi i ofertës.

duhet të paraqesë licensën profesionale të shoqërisë të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate ,konkretisht mungon –N.P-10 B Ndërtim i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.

-Numri total i punonjësve duhet 65 janë deklaruar 37 punonjës, nga të cilët 52 duhen punonjës të thjeshtë ndërtimi të cilët nuk janë deklaruar dhe makineritë.
-Mungon inxhinier mekanik , i Energjisë dhe inxhinier gjeodet.
-Mungojnë dy specialist për panelet fotovoltaike
-mungon katalogu/fragmenti i katalogut teknik të pompave për të krahasuar specifikimet teknike të ofertuara me ato të kërkuara në preventive.
Operatori ekonomik "B."SHPK skualifikohet pasi ka mungesë dokumentacioni si me poshtë:
-Mungojnë 2 specialistë për panelet fotovoltaike dhe specialist për hidroizolimin
-Mungon katalogu/fragmenti i katalogut teknik të pompave për të krahasuar specifikimet teknike të ofertuara me ato të kërkuara në preventive.
Ankesa: Në datën 26.11.2024 në SPE, OE "Z." ShPK ka paraqitur ankesë pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Roskovec dhe njëherazi pranë KPP, ku si objekt ankesa ka shfuqizimin e vendimit te KVO për kualifikimin e ofertës fitues BOE "C.M. & K.K." ShPK. OE "Z." Pretendon se BOE fitues nuk plotësojnë një pjesë të konsiderueshme të Kritereve të përgjithshme dhe kriteret e veçanta trajtuar në ankesë. Titullari i AK me shkresën nr. 9233 prot., datë 25.11.2024 ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për shqyrtimin e Ankesave (KSHA) ku është urdhëruar dhe pezullimi i procedurës. Ky komision pasi ka bërë verifikimet në lidhje me pretendimet e ankimuesit ka vlerësuar se pretendimi i OE ankimues nuk qëndrojnë dhe ka vendosur të rrëzojë e ankesën, ku një kopje të këtij vendimi i'u është dërguar për njoftim OE zdrava dhe Komisionit të Prokurimit Publik. KPP me shkresën 3442/10 prot., datë 10.12.2024 ka bër të njohur vendimin me nr.1755/2024 datë 10.12.2024 të KPP për dijeni AK, OE-së ankimues "Z." SHPK, OE "K.K." dhe APP-së. Me shkresën 3442 prot., datë 05.12.2024 KPP ka nga Ak dhënien e Dokumentacionit KPP-së lidhur me OE "Z.", me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së, i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i sipërcituar të dorëzohet pranë KPP-së brenda datës 06.12.2024. Me shkresën nr.9233/5 prot datë 06.12.2024 AK ka dërguar dokumentacionin nga BOE "K.K. & C.M." ShPK. KPP pasi ka vlerësuar ankesën dhe pretendimet e OE ankimues ka vendosur të mos pranojë ankesën e OE "Z." ShPK për procedurën me objekt "*Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit*", në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet që AK lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit. Me shkresën 95171 prot., datë 11.12.2024 është hartuar raporti përmbledhës.
Nga auditimi i dokumentacion në sistemin SEP dhe dosjen e procedurës, rezultoi se shoqëria "C.M & K.K." ShPK, nuk është në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve të DST, konkretisht:
1.-Në kriteret e veçanta, në pikën 2.3.3. a. është kërkuar nga AK që OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, Inxhinier Ndërtimi 1 (një) , Inxhinier Hidroteknik 1 (një Inxhinier Gjeodet 1 (një) Inxhinier Elektrik 1 (një). Nga auditimi u konstatua se, në shtojcën 8 formulari i vetëdeklarimit nga BOE fitues nuk është pasqyruar disponueshmëria e inxhinierit Gjeodet sikurse kërkohet në dokumetat e tenderit.
2.-Për punonjësin I.B Deklaruar në formularin e vetëdeklarimit me profesion hidraulik rezultoi se ndërmjet OE "C." dhe I.B është lidhur kontratë e cila fillon me datë 6.08.2019 dhe përfundon me datë 05.08.2022. Gjithashtu ekziston një tjetër kontratë e cila fillon me datë 05.01.2021 dhe përfundon me datë 02.01.2024, nga auditimi u konstatua se në të dyja rastet kontrata ka humbur vlefshmërinë e saj.
3.- Nga verifikimimi i listëpagesave të OE "C." u konstatua se 2 (dy) nga punonjësit e deklaruar nga OE "C." si punëtorë ndërtimi R.S. dhe L.P. nuk figurojnë për muajin shtator.
4.- Bazuar në vetëdeklarimin e paraqitur nga OE "K.K." më SPE, u konstatua se ka deklaruar punonjësen znj.V.M. si Inxhiniere Hidroteknike, nga verifikimi i dokumentacionit fizik në dosje si inxhinere Hidroteknike paraqitet znj. M.K., pra kemi një mos koherencë ndërmjet deklarimit dhe dokumetit fizik të paraqitur.

Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", neni 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 82 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2. Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga, *M.G, D.H, O.G, E.H, D.S.*

3. Procedura e prokurimit me objekt: "*Kompleksi i terreneve sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën 5 Dëshmorët*", Suk 1"

<table>
<tr><td colspan="4">a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Kompleksi i terreneve sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën 5 Dëshmorët", Suk 1"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
REF-08082-06-05-2024
1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur "</td><td colspan="2">2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit
Data 28.05.2024 Prot 3876
E.H.
E.T.
E.P.</td><td>3. Njësia e Prokurimit
Data 30.05.2024 Nr.62/3945
A.X.
N.Y.
R.K.
A.D.
S.C.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Data 11.06.2024 Prot 4258
M.L.
E.K.
O.G.
A.H.
M.P.</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh) 41, 539,346. lekë</td><td colspan="2">6.Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: 2 Z 41,539,346 lekë pa TVSh.</td><td>7. Diferenca me fondin limit 33,092,638 lekë pa TVSh</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit: 22.07.2024</td><td colspan="2">9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit+ të ardhurat e veta.</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a)Pjesëmarrës në tender, 8 OE
b) S'kualifikuar 5,
c) Kualifikuar 3 B/OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime
AK-s'ka/ka; ka
APP–s'ka/ka;
KPP-s'ka/ka</td><td colspan="2">12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:
S'ka</td></tr>
<tr><td colspan="4">b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td>14. Lidhja e kontratës Data Nr. prot 6511 Data 19.08.2024.</td><td colspan="2">15. Vlera e kontratës (me TVSH) 39,711,166</td><td>16. Likuiduar 33,754,491 leke</td></tr>
<tr><td>17. Situacioni Përfundimtar</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në ditë 8 muaj</td><td>19. Zgjatja e kontratës me – ditë ska</td></tr>
</table>

Burimi: Bashkia Roskovec.

I. Nga auditimi rezultoi se preventivi i hartuara nga "A.SH. E." ShPK për objektin: "*Kompleksi i terreneve sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën "5 Dëshmorët", Suk 1*".
Me shkresën nr. 2258/2 Prot., datë 02.02.2023 nga instituti i ndërtimit është dërguar Oponenca teknike. Me shkresën nr. nr.17, datë 13/09/2024 është hartuar leja e ndërtimit. Nga auditimi u konstatua se çmimet e preventivit të punimeve janë përllogaritur në bazë të manualit të çmimeve të vitit 2015. Në rastin konkret preventivi rezultoi të jetë mbështetur në një manual çmimesh të shfuqizuar. VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "*Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve*", në nenin 13, pika 1, përcakton se: "Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike nga buxheti i shtetit apo nga donatorë të huaj, në kontrollin e çmimeve për zërat e punës së ofertave të paraqitura në tender, u referohen çmimeve të zërave të punimeve të dhëna në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve". Gjithashtu në nenin 19, pika 1, të VKM-së së sipërcituar, përcaktohet se: "Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 15.07.2015, "*Për miratimin e manualeveteknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre*", të ndryshuar, dhe nr. 514, datë 15.8.2007, "*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit*", të ndryshuar, shfuqizohen". Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen

me përgjegjësi si persona të cilat kanë marrë në dorëzim preventivin e punimeve, *E.H, E.T, E.P.*

AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve".

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit" nr. 3945 port., datë 30.05.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) PV nr. 4575/1 datë 25.06.2024 për modifikimine kritereve të Kualifikimit, u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), jo në të gjitha rastet, kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...". Grupi i auditimit vlerëson se, disa prej kritereve, të përcaktuar nga njësia e prokurimit, rezultojnë të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuar mbi bazën e parakushteve jo realiste. Në përgjithësi, për hartimin e kritereve dhe argumentimin e tyre njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke përcaktuar kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim apo të lidhura ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës.

Në lidhje me këtë situatë neni 39 pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" përcakton se: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës…".

Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:

Në pikën 2.3.3. Ak ka kërkuar që Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

-1 (një) "Auditues Energjitik në Ndërtesa dhe Instalime Industriale".

Në nenin 16 pika 4 dhe 5 të ligjit nr.125/2015 "Për efincencën e energjisë" parashikohet se:" 4. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për: a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie; b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të financuar nga Fondi për Efiçencën e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e efiçencës së energjisë. 5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen: a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 4, të këtij neni; b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm."

Në pikën 2.3.3. a. Ak ka kërkuar që Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, Inxhinier Ndërtimi Profili Gjeoteknik, grupi auditimit gjykon se, bazuar në preventivin e punimeve nevojat për realizimin e këtij objekti mund të mbulohen nga inxhinieri i ndërtimit i Profilit Konstruktor/ Strukturist.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi *A.Xh, N.Y,R.K, A.D, S.C.*

<u>II- Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO dhe lidhjen e kontratës</u>**.**

Me shkresën nr. 4258 prot., datë 11.06.2024 është ngritur UB i titullarit të institucionit nr.62 datë 30.05.2024 për ngritjen e KVO. Me shkresën nr. 5013 prot., datë 05.07.2024 është ,mbajtur procesverbali nr.1 mbi hapjen e ofertave ku ë këtë procedurë kanë marrë pjesë 8 OE/BOE me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "Sh." SHPK me vlerë 29,293,992 lekë pa TVSh.
2. "Z.K." SHPK me vlerë 33 092 638 lekë pa TVSh.
3. "S." SHPK me vlerë 33,231,467.40 lekë pa TVSh.
4. BOE "N." SHPK & "I." SHPK me vlerë 33,600,748 lekë pa TVSh.
5. BOE"K.K." SHPK &"C.M." me vlerë 34,059,467 lekë pa TVSh.

6. “A.C.” me vlerë 36 518 142 lekë pa TVSh.
7. BOE “S.” SHPK + “L.V.” SHPK me vlerë 36,547,049 lekë pa TVSh.
8 “B.” SHPK me vlerë 39,046,766 lekë pa TVSh.
Me shkresën nr. 5668 prot., datë 22.07.2024 është, mbajtur procesverbali nr.2 mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave ku janë kualifikuar 4 OE-të si më poshtë:
1. “S.” SHPK me vlerë 29,293,992 lekë pa TVSh.
2. “Z.K.” SHPK me vlerë 33 092 638 lekë pa TVSh.
3. “S.” SHPK me vlerë 33,231,467.40 lekë pa TVSh.
4. BOE “N.” SHPK & “I.” SHPK me vlerë 33,600,748 lekë pa TVSh.
Sipas KVO njoftimi i KVO është bërë më datë 22.07.2024, bazuar në rënditjen përfundimtare dhe është nisur kërkesë OE S sh.p.k të bëjë dorëzimin e dokumentacionit deri në datë 24,07,2024 pranë zyrës së protokollit të Bashkisë Roskovec. Me shkresën nr. 5738 prot., datë 25.07.2024 është mbajtur PV nr. 3 ku sqaron se OE S nuk ka paraqitur dokumentacion në protokollin e Bashkisë brenda afatit të përcaktuar nga KVO dhe për këtë arsye skualifikohet. Me shkresën nr. 5744 prot datë 25.07.2024 është bërë rivlerësimi i ofertave ku në PV nr. 4 i ka dërguar kërkesë për dorëzimin e dokumentacionit fizik brenda datës 24.0.7.2024 Oe S ky i fundit nuk ka paraqitur dokumentacionin sikurse kërkohet. Me shkresën nr. 6019 datë 30.0.72024, me PV nr.5 sqarohet se në datën 25.07.2024 KVO mbylli rivlrësimine ofertave dhe po në këtë datë ju dërfua OE “Z.K.” ShPK kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit nga SPE. Në datën 29.0.72024 KVO ka marrë në dorëzim dokumentacionin dhe është shprehur se pasi verifikojë dokumentacionin kanë rezultuar të rregullta sipas deklarimeve të nenit 26 te vkm 285 datë 19.05.2021. Grupi i Auditimit Ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit, ku bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion u konstatua se nga data 01.07.2024-31.07.2024 nuk rezultoi të jenë regjistruara dokumentacione nga drejtuar bashkisë Roskovec nga OE S ShPK. Me shkresën nr. 6436 prot., datë 14.08.2024 është hartuar raporti përmbledhës miratuar nga titullari i AK.
<u>Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:</u>
1. BOE K.K.” SHPK & C.M.**”:** Nuk plotëson pikën 2, Kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht pika 2.3.3.a. Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë personelin kryesor Inxhinier Ndërtimi/Profili Gjeoteknik dhe të jetë drejtues teknik në licencën e shoqërisë.
2. “A.C.**”:** Nuk plotëson pikën 2, Kriteret e veçanta ë kualifikimit, konkretisht pika 2.3.3.a. Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë personelin kryesor Inxhinier Ndërtimi/Profili Gjeoteknik dhe të jetë drejtues teknik në licencën e shoqërisë.
3. BOE “S.” SHPK + “L.V.” SHPK **:** Nuk plotëson pikën 2, Kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht pika 2.3.3.a.Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë personelin kryesor Inxhinier Ndërtimi/Profili Gjeoteknik dhe të jetë drejtues teknik në licencën e shoqërisë.
4 “B.” SHPK **:**Nuk plotëson piken 2, Kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht pika 1,b Sigurimi i ofertës, sipas shtojcës 3 dhe 2.3.3.a. Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë personelin kryesor Inxhinier Ndërtimi/Profili Gjeoteknik dhe të jetë drejtues teknik në licencën e shoqërisë.
5. “S.” SHPK**:**Operatori ekonomik “S.”SHPK skualifikohet pasi nuk paraqiti dokumentacionin në protokollin e Bashkisë brenda afatit të përcaktuar nga KVO.
<u>Nga auditimi i dokumentacion në sistemin SEP dhe dosjen e procedurës, rezultoi se shoqëria “ Z .K.” ShPK, nuk është në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve të DST, konkretisht:</u>
1. Bazuar në të dhënat e përcaktuar në DT afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është Data:27.06.2024 Ora: 09:00. Në shkresën për njoftimin për ndryshimin e dokumenteve të tenderit është përcaktuar që nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet

afati i ri i përcaktuar data: 04.07.2024 ora: 09:00. Nga verifikimi në SPE rezultoi se OE fitues ka ngarkuar në sistem dokumentacionin në datën 02.07.2024 në orën 2:53 sipas sistemit. Nga auditimi u konstatua se licenca e paraqitur nga OE Z.K. paraqitet me një afat vlefshmërie deri në datën 25.06.2024, ku tregon që afati i vlefshmërisë për këtë licencë ka përfunduar.
2. Nga verifikimi i listëpagesave u konstatua se për punonjësin K.H. deklaruar si automakinist nuk figuron në listëpagesën e muajit maj. Këto veprime janë në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", neni 92 "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"*, pika 2. Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga, *z. M.L, z. E.K., Znj. O.G., Z. A.H., Z. M.P.*

4. Procedura e prokurimit me objekt: "*Mbrojtje nga lumi Seman në krahun e majtë, Zona Suk, Bashkia Roskovec*".

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Mbrojtje nga lumi Seman në krahun e majtë, Zona Suk, Bashkia Roskovec".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF-11556-06-28-2024 **1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur "	**2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit** Data 31.05.2024 Prot 4022, E.H. E.T. E.P.	**3. Njësia e Prokurimit** Data12.06.2024 Nr.68/4271 A.X. N.Y. R.K. A.D. S.C.	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Data02.07.2024 Prot,4918, M.l. E.K. O.G A.H. M.P.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 41,520 230 lekë	**6.Oferta fituese, vlera fituese:** Operatori Fitues: B 29 153 415 lekë pa TVSh.		**7. Diferenca me fondin limit** 12,366,815 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 22.08.2024	**9. Burimi Financimit -**të ardhurat e veta.		**10. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender, 7 OE b) S'kualifikuar 1**,** c) Kualifikuar 6 **B/OE**
11. Ankimime **AK**-s'ka/ka**;** ka **APP–**s'ka/ka**;** **KPP**-s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK S'ka		**13.** P**ërgjigje** Ankesës nga APP apo **KKP:** S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës Nr. prot 6894 data 02.09.2024	**15. Vlera e kontratës (me TVSH) 34 984 098 lekë**		**16. Likuiduar 34,452,098** leke
17. Situacioni Përfundimtar 34 984 098 leke (me TVSH)	**18.Afati i kontratës në ditë 4 muaj**		**19. Zgjatja e kontratës me – ditë ska**

Burimi: Bashkia Roskovec.

I. Nga auditimi rezultoi se preventivi punimeve është hartuar nga shoqëria S.LTd me inxhinier V.A. Me shkresën nr. 585/2 date25.07.2024 është dërguar nga Instituti i ndërtimit Oponenca Teknike. Nga auditimi u konstatua se çmimet e preventivit të punimeve janë përllogaritur në bazë të manualit të çmimeve të vitit 2015. Në rastin konkret preventivi rezultoi të jetë mbështetur në një manual çmimesh të shfuqizuar. VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "*Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve*", në nenin 13, pika 1, përcakton se: "Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike nga buxheti i shtetit apo nga donatorë të huaj, në kontrollin e çmimeve për zërat e punës së ofertave të paraqitura në tender, u referohen çmimeve të zërave të punimeve të dhëna në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve". Gjithashtu në nenin 19, pika 1, të VKM-së së sipërcituar,

përcaktohet se: "Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 15. 7.2015, "*Për miratimin e manualeveteknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre*", të ndryshuar, dhe nr. 514, datë 15.8.2007, "*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit*", të ndryshuar, shfuqizohen". Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi si persona të cilat kanë marrë në dorëzim preventivin e punimeve, *E.H., E.T., E.P.*

AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve".

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit" nr. 1394 port., datë 14.06.2024 ndryshuar me PV nr.5530/1 datë 17.07.2024 bazuar dhe në shkresën nr. 5530/4 prot datë 17.07.2024 Njoftim për ndryshimin dokumenteve të tenderit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), jo në të gjitha rastet, kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre..". Grupi i auditimit vlerëson se, disa prej kritereve, të përcaktuar nga njësia e prokurimit, rezultojnë të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuar mbi bazën e parakushteve jo realiste. Në përgjithësi, për hartimin e kritereve dhe argumentimin e tyre njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke përcaktuar kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim apo të lidhura ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës. Në lidhje me këtë situatë neni 39 pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" përcakton se: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës…". Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:

Në pikën 2.3.3.b. Ak ka kërkuar që operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës inxhinier ndërtimi gjeoteknik. Grupi i auditimimit lidhur më këtë kriter gjykon se është i pa nevojshëm ku bazuar dhe në preventivin e punimeve ky pozicion mbulohet dhe nga inxhinieri hidroteknik.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.5. ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues deponimin si vijon:

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi, A.X, N.Y., R.K., A.D., S.C.

<u>II-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO</u>.

Në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë 7 OE, për të cilin, referuar procesverbalit nr.6262 datë 30.07.2024 si dhe SPE, KVO-ja me shkresën nr.6179 datë., 05.08.2024 është bërë klasifikimi i ofertave si më poshtë:

OE Pjesëmarrës	Vlera
"B."	29,153,415 OE kualifikuar shpallur fitues
"B.9"	30,823,189 kualifikuar
"K.K"	31,733,411 kualifikuar
"A.A"	31,855,171 kualifikuar
"S."	34,733,459 kualifikuar
"N.S"	37,384,719 kualifikuar
"F."	0 skualifikuar

Burimi: Bashkia Roskovec.

Me shkresën nr.6766 prot., datë 27.08.2024 është hartuar raporti përmbledhës, i cili me shkresën nr. 6766/1 prot., datë 29.08.2024 është miratuar nga titullari i AK. Me shkresën

nr.6894 prot., datë 02.09.2024 është nënshkruar kontrata midis palëve të titullarit të AK dhe Administratorët e OE fitues. Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:
-"F." Sh.p.k me nipt: K.....C për arsye se nuk ka paraqitur dokumentacion.
Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Bashkia Roskovec rezultoi se është shpallur fitues vlera me e vogël gjithashtu nuk u konstatuan mangësi për ofertën fituese.

5. Procedura e prokurimit me objekt: "Rrugë parcele në fshatrat e NjA Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan"

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Rrugë parcele në fshatrat e NJA Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
REF-18006-09-04-2024
1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur "</td><td colspan="2">2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit
Nr.6697ProtDate 26.08.2024
E.H
B.H
X.D</td><td>3. Njësia e Prokurimit
Nr.6837 Prot Datë 30.08.2024
A.X
N.Y
S.C
E.K
A.H</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Nr.6992 Prot Datë 04.09.2024,
M.G
D.S
O.G
E.H
A.D</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh) 24, 314, 627 lekë</td><td colspan="3">6.Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: "R.M." SHPK 16,293,750lekë pa TVSh.</td><td>7. Diferenca me fondin limit 8,020,877lekë pa TVSh</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit: 26.09.2024</td><td colspan="3">9. Burimi Financimit -të ardhurat e veta.</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a)Pjesëmarrës në tender, 8 OE
b) S'kualifikuar 0,
c) Kualifikuar 8 B/OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime
AK-s'ka/ka; ka
APP–s'ka/ka;
KPP-s'ka/ka</td><td colspan="3">12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:
S'ka</td></tr>
<tr><td colspan="5">b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td>14. Lidhja e kontratës Nr.8811 Prot 13.11.2024</td><td colspan="3">15. Vlera e kontratës (me TVSH) 19 552 500 lekë</td><td>16. Likuiduar 17,465,671leke</td></tr>
<tr><td>17. Situacioni Përfundimtar</td><td colspan="3">18.Afati i kontratës në ditë 8muaj</td><td>19. Zgjatja e kontratës me – ditë ska</td></tr>
</table>

Burimi: Bashkia Roskovec.
Nga auditimi rezultoi se, komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike është ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontraktr nr. 6697 prot., datë 26.08.2024. Preventivi i punimeve është hartuar nga komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike, ku është dorëzuar dokumentacioni teknik me procesverbalin e komisionit nr. 6697/1 prot., datë 28.08.2024. Në lidhje me procedurën e sipërcituar, nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, nuk rezulton të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një oponencë teknike, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik. Mungesa e oponencës teknike, në rastin konkret, rezulton të jetë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, sipas të cilit: "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventivuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik". Si konkluzion, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponence teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit. Në përfundim, në lidhje me mosveprimin e konstatuar më sipër, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar si dhe VKM nr. 9, datë

11.01.2024 *"Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste*", ngarkohet me përgjegjësi: Titullari i AK Znj. M.B.

II-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me shkresën nr. 6992 prot., datë 04.09.2024 është ngritur KVO me urdhër të titullarit të institucionit M.B.

Në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë 8 OE, për të cilin, referuar procesverbalit përkatës me shkresën nr. 7667 datë 26.09.2024 si dhe SPE, KVO-ja ka kryer në datën 17.10.2024 vlerësimin paraprak dhe në datën 01.11.2024 vlerësimin përfundimtar duke pasqyruar klasifikimin si më poshtë:

NNr.	Operatorët Ekonomik	Vlera pa TVSh
1	"R.C." SHPK	**16 293 750 kualifikuar/shpallur fitues**
2	"A.I." SHPK	18 060 723 kualifikuar
3	"G.V." SHPK	18 077 925 kualifikuar
4	"S. " SHPK	18 115 155 kualifikuar
5	"M. "&"K.-D." SHPK	18 407 930 kualifikuar
6	"S. " SHPK	20 288 350 kualifikuar
7	"D.C." SHPK	21 233 190 kualifikuar
8	"C.M." SHPK	23 301 500 kualiikuar

Burimi: Bashkia Roskovec.

Me shkresën nr.6180 prot., datë 05.08.2024 KVO ka paraqitur pranë titullarit të AK raportin përmbledhës mbi hapjen dhe vlerësimin e ofertave. Me shkresën nr. 8811 prot., datë 13.11.2024 është nënshkruar kontrata ndërmjet palëve përfaqësues nga Ak është Titullari i institucionit dhe administratorit te OE R.M.

Nga auditimi i dokumentacion në sistemin SEP dhe dosjen e procedurës, rezultoi se shoqëria "R.C". ShPK, nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DST, konkretisht:

Nga auditimi rezultoi se, OE fitues ka paraqitur në shtojcën 2 listat e çmimeve sipas zërave të preventivit, ku nga verifikimi mbi përllogartijet e ofertuara nga OE "R.M. C" rezultuan të gabuara, pasi për NjA Strum janë dubluar 2 (dy) herë sasitë dhe vlerat në njëkohë, që në preventivin e hartuar nga AK Bashkia Roskovec janë kërkuar vetëm 1 (një) herë, për këtë NJA Nga auditimi u konstatua se, në këtë rast nuk kemi të bëjmë vetëm më një dublikim apo lapsuas nga ana e OE ofertues/fitues por me një llogaritje 2 (dy) herë të sasive dhe vlerave, në kundërshtim me dokumetat të tenderit (preventivit të punimeve), ku kjo përllogaritje ka ndikuar në çmimin e ofertuar. Vlera prej 843,000 lekë dhe sasia prej 900 m^3/2760 m^2 është më tepër krahasuar me sasitë e kërkuara nga AK në preventivin e punimeve. Në të dhënat e mëposhtme gjendet informacioni mbi preventivin e paraqitur nga OE. Grupi i auditimit bëri llogaritjen mbi ofertën anomalisht të ulët ku rezultoi sipas llogaritjeve 153,778,523 / 8 * 0.85 = 16,338,968 lekë pa TVSh. Nga auditimi u konstatua se *"R.M. C"* ShPK është kualifikuar dhe shpallur fitues me ofertën 16,293,750 lekë pa TVSh, sikurse evidentohet kemi të bëjmë me ofertë anomalisht të ulët. KVO me shkresën nr. 7667/1 prot., datë 30.09.2024 ka kërkuar shpjegime nga OE "R.S.M" Company dhe analizë të detajuar për ofertën e paraqitur, deri më datë 02.10.2024. Sqarojmë se në ligjin nr. 16/2024 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" në nenin 27 përcaktohet se: "*Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët*".

2. Nga auditimi u konstatua se, nuk plotësohet kriteri 2.3.3.a.dhe 2.3.4 ku nga OE "R.S.M" nuk janë paraqitur listëpagesat sipas përcaktimeve të kriterit më sipër. KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", neni 92 *"Shqyrtimi i ofertave"*, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e*

rregullave të prokurimit publik", neni 82 *"Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"*, pika 2. Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga, *M.G., E.H., O.G., D.H., D.S.*

6. Procedura e prokurimit me objekt: "Ndërtim i parkut te ri të qytetit"

.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:". Ndërtimi I parkut të ri të qytetit			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF-1.1. REF-15135-08-01-2024 Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur "	2. **Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit** Urdhrinr. Data 25.07.2024 Prot 5729, E.H. M.D. E.P.	**3. Njësia e Prokurimit** Urdhri nr. Data 29.07.2024 Nr96/5826 A.X. N.Y. R.E. K.C.	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** **Urdhri nr.** **Data 07.08.2024 Prot,4918,** M.L. D.S. B.H. E.H. M.P.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 25,770, 830	6.Oferta fituese, vlera fituese: 18,661, 795		7. Diferenca me fondin limit 7,109, 034
8. Data e hapjes së tenderit: 22.08.2024	9. Burimi Financimit Vetëfinancim		10. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender,4 OE b) S'kualifikuar 1 c) Kualifikuar 3 B/OE
11. Ankimime SKA AK- APP– KPP-	12. Përgjigje Ankesës SKA		13. Përgjigje Ankesës nga Ska APP apo KKP: SKA
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës Nr. prot 7688 data 27.09.2024	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 22 394 155		16. Likuiduar 22387768
17. Situacioni Përfundimtar 22, 387,769 leke (me TVSH)	18.Afati i kontratës Nga lidhja e kontratës 2 muaj		19. Zgjatja e kontratës me – ditë SKA

Burimi: Bashkia Roskovec.

I. Bazuar në të dhënave të vëna në dispozicion u konstatua se, preventivi i punimeve është hartuar nga studio Novach studio sh.p.k dorëzuar dokumentacioni teknik me procesverbalin e komisionit nr.5729/1prot,datë 25.07.2024. Me shkresën nr. 399/2 prot., datë 16.05.2024 është dërguar nga instituti ndërtimit Oponenca Teknike .

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit *"Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit*" nr. 6086 port., datë 31.07.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), jo në të gjitha rastet, kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...". Grupi i auditimit vlerëson se, disa prej kritereve, të përcaktuar nga njësia e prokurimit, rezultojnë të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuar mbi bazën e parakushteve jo realiste. Në përgjithësi, për hartimin e kritereve dhe argumentimin e tyre njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke përcaktuar kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim apo të lidhura ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës. Në lidhje me këtë situatë neni 39 pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" përcakton se: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe

vlerën e kontratës…". Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:
Në pikën 2.3.3. a**.** nga AK është kërkuar që operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë 1 (një) inxhinier mjedisi, lidhur me këtë kërkesë u konstatua se nga ana e NJP argumentohet nevoja se pse kërkohet inxhinieri i mjedisit.
Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi NJP, i përbërë nga, A.X, N.Y., R.K., E.K., S.C.
II-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.
Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion u konstatua se, me shkresën nr. 6235 prot., datë 07.08.2024 është ngritur KVO, me shkresën nr. 6576 prot., datë 21.08.2024 për ndryshimin e KVO. Me shkresën nr. 6610 prot., datë 22.08.2024 është mbajtur PV për hapjen e procedurës. Me shkresën nr. 6776 prot., datë 28.08.2024 është mbajtur PV mbi klasifikimin e Ofertave, ku janë kualifikuar 6 OE dhe është njoftuar me datë 28.08.2024 duke nisur kërkesë OE "B." ShPK ku i është kërkuar të dorëzojë dokumentacionin fizik pranë protokollit të Bashkisë deri më datë 30.08.2024 ora 16:00. Me shkresën nr. 6904 prot., datë 02.09.2024 është mbajtur PV ku sqarohet se OE B nuk ka paraqitur dokumentacionin pranë protokollit të Bashkisë brenda afatit të përcaktuar nga KVO. Me shkresën nr. 6924 prot., datë 02.09.2024 është mbajtur PV për rivlerësimin e ofertës ku KVO ka ka kaluar tëk OE i radhës në renditje dhe i ka dërguar kërkesë OE "N."ShPK ku i ka kërkuar që të dorëzojë dokumentacionin deri më datë 04.09.2024 pranë zyrës së protokollit të Bashkisë. Me shkresën nr. 7044 prot., datë 06.09.2024 është mbajtur PV nga KVO ku përcakton se në datën 04.09.2024 KVO mori në dorëzim dokumentacionin dhe e verifikojë ku rezultojnë të rregullt. Me shkresën nr.7535 prot., datë 20.09.2024 është hartuar raporti përmbledhës. me shkresën nr.7688 prot., datë 27.09.2024 është nënshkruar kontrata ndërmjët Titullarit të Ak dhe Administratorit të OE N shpk.
-Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:
1. "B." SHPK me vlerë 17,773,580.38 lekë pa TVSh.
2. "N." SHPK me vlerë 18,661,795.56 lekë pa TVSh.
3. "BOE: "N."&"G."SHPK me vlerë 18,899,959.44 lekë pa TVSh.
4. "BOE: "V.G. " SHPK & "I.C. G." SHPK me vlerë 19,340,135 lekë pa TVSh.
5. "F." SHPK me vlerë 20,230,741.24 lekë pa TVSh
6. BOE: "S." SHPK & "L.V." SHPK me vlerë 20,900,000 lekë pa TVSh.
-Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:
1."B." SHPK : Operatori ekonomik "B." SHPK nuk paraqiti dokumentacionin në protokollin e bashkisë brenda afatit të caktuar nga KVO.
Nga auditimi i dokumentacion në sistemin SEP dhe dosjen e procedurës, rezultoi se shoqëria "*N." SHPK"*. ShPK, nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DST, konkretisht:
1. Në pikën 2.3.3.c është kërkuar që Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesat e subjektit, punonjësit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:

EMERTIMI	
Teknik të mesëm ndërtimi	(2 persona)
Teknik të mesëm topograf	(1 person)
Elektricist	(1 person)
Pllakashtrues	(4 persona)
Hidraulik	(2 persona)
Saldator	(1 person)
Karpentier	(1 person)

Ndër të tjera Njësia e Prokurimit si argumentim për kriterin e sipërcituar i është referuar VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "*Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)*", të rishikuar. Po ti referohemi kësaj VKM-je konstatohet një mospërputhje ndërmjet profesioneve të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit nga OE dhe kodit të profesionit në listëpagesën e

paraqitur nga ky i fundit. Një rast i evidentuar ka të bëjë me punonjësen N.S deklaruar me profesion Elektriçiste ndërsa në listëpagesë paraqitet me kodin e profesionit 1211.09, në VKM ky kod i përket profesionit "*Manaxher i financave*". Një tjetër rast u konstatua se për punonjësen G.D. e deklaruar me profesion *"Punëtore e Thjeshtë Ndërtimi"* në një kohë që në listëpagesë paraqitet me kodin e profesionit 2631.04 kod i cili sipas VKM-së i përket profesionit "*Ekonomist për burimet njerëzore*". Pra konstatimi ka të bëjë me kriterin 2.3.3.c i cili është vendosur në zbatim të VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "*Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)*", dhe si i till ky kriter quhet i përmbushur kur është në përputhje gjitha dizpozitat ligjore të përcaktuara në këtë rast nga Njësia e Prokurimit, dhe që nuk është zbatuar nga KVO..KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", neni 92 "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 82 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2. *Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga, M.L, D.S, B.H, E.H, M.P.*

7. Procedura e prokurimit me objekt: "*Ndërtim i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të*".

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Ndërtim i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF-12425-07-08-2024 **1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur "	**2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit** Nr.4021ProtDatë 31.05.2024 E.H. M.D. E.P.	**3. Njësia e Prokurimit** Nr.4433 Prot, Datë 18.06.2024 A.X. N.Y. S.C. A.D. R.K.	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Nr.6238 Prot Datë 07.08.2024, M.L D.S O.G E.H M.P
5. Fondi Limit (pa TVSh) 36 731 666 lekë	**6.Oferta fituese, vlera fituese:** Operatori Fitues: B 24 766 467lekë pa TVSh.		**7. Diferenca me fondin limit** 11 965 199 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 07.08.2024	**9. Burimi Financimit -**të ardhurat e veta.		**10. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender,8 OE b) S'kualifikuar 0**,** c) Kualifikuar 8 **B/OE**
11. Ankimime **AK**-s'ka/ka**;** ka **APP**–s'ka/ka**;** **KPP**-s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK S'ka		**13.** P**ërgjigje** Ankesës nga APP apo **KKP:** S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës Nr.6891 Prot Datë 02.09.2024	**15. Vlera e kontratës (me TVSH) 29 719 760 lekë**		**16. Likuiduar 34,452,098** leke
17. Situacioni Përfundimtar 29 716 779 leke leke (me TVSH)	**18.Afati i kontratës në ditë 3 muaj**		**19. Zgjatja e kontratës me – ditë ska**

I. Nga auditimi rezultoi se, preventivi i punimeve është hartuar hartuara nga Shoqëria "*N.S"* sh.p.k, dorëzuar dokumentacioni teknik me procesverbalin e komisionit nr. nr. 4359 prot., datë 14.06.2024. Nga AK është bërë kërkesa për kryerjen e oponencës teknike me nr.1554 prot., datë 06.03.2024. me shkresën nr. 2071 prot., datë 20.03.2024 është lidhur marrëveshja ndërmjet institutit të ndërtimit dhe bashkisë Roskovec. Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit*" nr. 5205 port., datë 08.07.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), jo në të gjitha rastet, kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në zbatim të VKM-së

nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.". Grupi i auditimit vlerëson se, disa prej kritereve, të përcaktuar nga njësia e prokurimit, rezultojnë të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuar mbi bazën e parakushteve jo realiste. Në përgjithësi, për hartimin e kritereve dhe argumentimin e tyre njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke përcaktuar kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim apo të lidhura ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës. Në lidhje me këtë situatë neni 39 pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" përcakton se: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës…". Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:

Në pikën 2.3.3. a**.** nga AK është kërkuar që operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë 1 (një) inxhinier mjedisi, lidhur me këtë kërkesë u konstatua se nga ana e NJP nuk argumentohet nevoja se pse kërkohet inxhinieri i mjedisit.

. Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi NJP, i përbërë nga, A.X, N.Y, S.C., A.D., R.K.

II-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me shkresën nr. 5469 prot., datë 15.07.2024 është ngritur KVO, ky komision ka ndryshuar me shkresën nr. .6238 prot., datë 07.08.2024..me shkresën nr. 6238/1 datë 07.08.2024 është mbajtur PV për hapjen e procedurës ku kanë marrë pjesë ofertuesit si më poshtë vijon:

OE/BOE	VLERA PA TVSH
B	**24,766,467 kualifikuar/fitues**
"B.93 II"	25,297,020 kualifikuar
"V.K."	26,557,536 kualifikuar
"S."& "L."	26,800,602 kualifikuar
"F."	28,118,850 kualifikuar
"A-A .CO"	29,379,702.6 kualifikuar
"K.K."	29,609,580 kualifikuar
"S."	29,800,983 kualifikuar

Burimi: Bashkia Roskovec.

Me shkresën nr. 6350 prot., datë 09.08.2024 është mbajtur Pv mbi klasifikimin e ofertave ku nga KVO është skualifikuar BOE "S."& "L." me arsyen se nuk ka ngarkuar në sistem marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet OE-ve. Me shkresën nr. 6355 prot., datë 12.08.2024 KVO ka bërë rivlerësimin e ofertave ku ka sqaruar se BOE *"S*.' & "*L*." është skualifikuar si pasojë e një gabimi nga KVO pasi marrëveshja e bashkëpunimit ndodhej e ngarkuar në sistem, për këtë arsye është kërkuar rivlerësimi i ofertave. Me shkresën nr. 6357 prot., datë 12.08.2024 është mbajtur PV mbi klasifikim përfundimtar të ofertave ku nuk ka patur të skualifikuar, njoftimi i rikualifikimit është bërë më datën 12.08.2024 bazuar në renditjen përfundimtare është njoftuar OE Besta të dorëzojë dokumentacionin në protokollin e Bashkisë deri më datë 13.08.2024. Me shkresën nr. 6372 prot., datë 12.08.2024 është mbajtur PV ku KVO shprehet se në datën 12.08.2024 komisioni mori në dorëzim dokumentacionin, ku e verifikoj dhe rezultoi i rregullt. Me shkresën nr. 6768 prot., datë 27.08.2024 është hartuar Raporti Përmbledhës. Me shkresën nr. 6891 prot., datë 02.09.2024 është nënshkruar kontrata ndërmjet titullarit të Ak dhe Administratorit të OE.

Nga auditimi i dokumentacion në sistemin SEP dhe dosjen e procedurës, rezultoi se shoqëria "B". ShPK, nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DST, konkretisht:

1. Nga auditimi u konstatua se, për mjetin me targë A8J deklaruar si kamion me kapacitet mbi 20 ton në siguracionin e paraqitur nga OE fitues ka rezultuar se data e fillimit të siguracionit për këtë mjet ka filluar më datën 27.07.2024 ndërsa OE "B." ka ngarkuar dokumentacionin në sistem në datën 06.08.2024 që do të thotë se mjeti është deklaruar/paraqitur në mungesë të siguracionit në kundërshtim me kriterin 2.3.5. pika a).

2. Për mjetin e deklaruar tip greider frish me numër shasie: 28482 u konstatua se nuk është përmbushur kriteri 2.3.5.a ku përcaktohet se: a) Për **mjetet me rrota** që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme). Për këtë mjet nuk është paraqitur leja e qarkullimit , certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit.

Sa më sipër KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", neni 92 "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2. Autoriteti Kontraktor duhej të kishte proceduar me skualifikimin e tij dhe të vijonte vlerësimin me operatorin e renditur pas tij, nëse ky i fundit përmbushte kriteret e kërkuara.Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i *përbërë nga, M.L, D.S, O.G, E.H, M.P*.

8. Procedura e prokurimit me objekt: *"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Strum*"

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Strum".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
REF - 35850-01-23-2025
1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur "</td><td>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit
Nr.268Prot. Data 16.01.2025
A.H.
E.T.
S.K.</td><td>3. Njësia e Prokurimit
Data 21.01.2025
6/445
E.P.
N.Y.
S.C.
E.K.
A.D.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Data28.01.2025 Prot 661
M.G.
E.H.
O.G.
D.H.
D.S.</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh) 59, 111,172 lekë</td><td colspan="2">6.Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: C.M 41, 383,400 lekë pa TVSh.</td><td>7. Diferenca me fondin limit 17,727,772 lekë pa TVSh</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit: 10.02.2025</td><td colspan="2">9. Burimi Financimit -të ardhurat e veta.</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a)Pjesëmarrës në tender,11 OE
b) S'kualifikuar0,
c) Kualifikuar 11 B/OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime
AK-s'ka/ka; ka
APP–s'ka/ka;
KPP-s'ka/ka</td><td colspan="2">12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:
S'ka</td></tr>
<tr><td colspan="4">b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td>14. Lidhja e kontratës Data 04.03.2025 Nr.1781Prot.</td><td colspan="2">15. Vlera e kontratës (me TVSH) 49 300 080 lekë</td><td>16. Likuiduar 33,526,368 leke</td></tr>
<tr><td>17. Situacioni 49,00,080 leke me TVSH leke leke (me TVSH)</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në ditë 6 muaj</td><td>19. Zgjatja e kontratës me – ditë ska</td></tr>
</table>

Burimi: Bashkia Roskovec.

I. Nga auditimi rezultoi se, preventivi i punimeve është hartuar nga Studio "*A." & "G."* sh.p.k dhe është marrë në dorëzim nga "*Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike*" me procesverbalin nr. 268/1 prot., datë 17.1.2025. Është mbajtur procesverbalin nr.

268/2 prot., datë 17.01.2025 si dhe relacionin shpjegues nr. 268/3 prot., datë 17.01.2025. AK (NjP) në lidhje me "*Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve*":
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezultoi se, AK Bashkia Roskovec, nuk është pajisur me "*leje ndërtimi/infrastrukture*" dhe "oponenca teknike", në kundërshtim me nenin 39 të Ligjit nr. 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar; pikën 1 të nenit 6 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar me ligjin nr. 3/2020, datë 30.01.2020 dhe nr. 120/2020, datë 7.10.2020. Zbatimi i kontratës së sipërmarrjes në mungesë të lejes së ndërtimit, përbën një risk të shtuar, për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, si dhe për plotësimin e kushteve për kryerjen e punimeve, të përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, duke rënë ndesh me këtë të fundit. Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar,.

Në lidhje me procedurën e sipërcituar, nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, nuk rezulton të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një oponencë teknike, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik. Mungesa e oponencës teknike, në rastin konkret, rezulton të jetë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, sipas të cilit: "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventivuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik". Si konkluzion, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponence teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit. Në përfundim, në lidhje me mosveprimin e konstatuar më sipër, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar si dhe VKM nr. 9, datë 11.01.2024 "*Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste*", për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi Titullari i AK M B.

II-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO**.**

Me shkresën nr. 661 prot., datë 28.01.2025 është ngritur KVO. Me shkresën nr. 661/1 prot., datë 10.02.2025 është mbajtur PV për hapjen e procedurës së prokurimit ku kanë marrë pjesë BOE/OE si më poshtë:

OE/BOE	Vlera
C.M	**41,083,400 kualifikuar shpallur fitues**
"K."	41,742,160 kualifikuar
"N."	41,911,749 kualifikuar
"A.A. C.O "	42,297,500 kualifikuar
"L.C."	43,778,766 kualifikuar
"K.K."	45,728,400 kualifikuar
"E.C .C.O "	47,144,200 kualifikuar
"A."	49,631,100 kualifikuar
"L. K.O"	50,170,870 kualifikuar
"G."	51,180,720 kualifikuar
"B."	54,517,820 kualifikuar

Burimi: Bashkia Roskovec.

Me shkresën nr. 1225 prot., datë 13.02.2025 është mbajtur PV mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave ku nuk ka patur OE të skualifikuar është klasifikuar si Oferta e favorshme OE C.M, ku është shpallur fitues. Me shkresën nr. 540 prot., datë 25.02.2025 është hartuar Raporti Përmbledhës firmosur nga Titullari i AK. Me shkresën nr. 1781 prot., datë 04.03.2025 është nënshkruar kontrata ndërmjet Titullarit të Ak dhe administratorit të shoqërisë. Bazuar në të

dhënat e vëna në dizpozicion nga Bashkia Roskovec rezultoi se është shpallur vlera me e vogël në klasifikim për të cilën nuk u konstatuan mangësi.

9. Procedura e prokurimit me objekt: "*Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kuman*"

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kuman"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
REF- 35969-01-24-2025
1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur ”</td><td>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit
Nr.269 Prot 16.01.2025
A.H.
E.T.
S.K.</td><td>3. Njësia e Prokurimit
Data 24.01.2025
9/562
E.P.
S.C.
D.M.
E.K.
A.D.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Data 11.02.2025 Nr. 1089 Prot. M.G
E.H.
D.H.
D.S.
O.G.</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh) 36 222 194 lekë</td><td colspan="2">6.Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: “N.” SHPK 24 600 000 lekë pa tvsh.</td><td>7. Diferenca me fondin limit 11 622 194 lekë pa tvsh</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit: 25.02.2025</td><td colspan="2">9. Burimi Financimit -të ardhurat e veta.</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a)Pjesëmarrës në tender,9 OE
b) S’kualifikuar0,
c) Kualifikuar 9 B/OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime
AK-s’ka/ka; ka
APP–s’ka/ka;
KPP-s’ka/ka</td><td colspan="2">12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:
S’ka</td></tr>
<tr><td colspan="4">b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td>14. Lidhja e kontratës Data 01.04.2025 Nr. 2522Prot.</td><td colspan="2">15. Vlera e kontratës (me TVSH) 29 520 000 lekë</td><td>16. Likuiduar 6,144,854 leke</td></tr>
<tr><td>17. Situacioni 29.520.000 leke me TVSH leke</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në ditë 6 muaj</td><td>19. Zgjatja e kontratës me – ditë ska</td></tr>
</table>

Burimi: Bashkia Roskovec.

I. Nga auditimi rezultoi se, preventivi është hartuar nga Studio “A.” & “G.” sh.p.k dhe është marrë ne dorëzim nga Komisioni i Llogaritjes Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike, me procesverbalin nr. 269/1 prot., datë 17.01.2025. Specialistët e fushës konkretisht kanë mbajtur procesverbalin nr. 269/2 prot., datë 17.01.2025 si dhe relacionin shpjegues nr. 269/3 prot., datë 17.01.2025. Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezultoi se, AK Bashkia Roskovec, nuk është pajisur me “leje ndërtimi/infrastrukture” dhe, në kundërshtim me nenin 39 të Ligjit nr. 107/2014 “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar; pikën 1 të nenit 6 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar me ligjin nr. 3/2020, datë 30.01.2020 dhe nr. 120/2020, datë 7.10.2020. Zbatimi i kontratës së sipërmarrjes në mungesë të lejes së ndërtimit, përbën një risk të shtuar, për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, si dhe për plotësimin e kushteve për kryerjen e punimeve, të përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, duke rënë ndesh me këtë të fundit. Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 *“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”*, i ndryshuar. Gjithashtu nga auditimi u konstatua se pjesë e dosjes së prokurimit, nuk rezultoi të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një oponencë teknike, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik. Mungesa e oponencës teknike, në rastin konkret, rezultoi të jetë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventivuar

së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik". Si konkluzion, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponence teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit. Në përfundim, në lidhje me mosveprimin e konstatuar më sipër, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar si dhe VKM nr. 9, datë 11.01.2024 *"Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste"*, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Ak MB.

II-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me shkresën nr. 1089 prot., datë 11.02.2025 është ngritur KVO. Me shkresën nr. 1089/1 prot., datë 25.02.2025 është mbajtur PV mbi hapjen e procedurës. Me shkresën nr.1696 prot., datë 28.02.2025 është mbajtur PV mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si më poshtë vijon:

Nr	Operatorët Ekonomik	Vlera pa TVSh
1.	"N." SHPK	**24 600 000 kualifikuar fitues**
2.	"K." SHPK	24,950,221 kualifikuar
3.	"A.C." SHPK	27,419,509 kualifikuar
4.	"A." SHPK	28,363,961 kualifikuar
5.	"L.E. " SHPK	28,520,549 kualifikuar
6.	"K.K." SHPK	28,664,423 kualifikuar
7.	"B.B." SHPK	29,952,803 kualifikuar
8.	"B." SHPK	32,348,030 kualifikuar
9.	"Z. K."SHPK	32,525,939 kualifikuar

Burimi: Bashkia Roskovec.

Është skualifikuar OE "*E.*" SHPK me ofertë 23,094,829.20 lekë pa TVSh për arsye se, Operatori skualifikohet pasi oferta e paraqitur prej tij është anomalisht e ulët. Grupi i auditimit bëri llogaritjet për vlerën totale të ofertave të kualifikuara ku rezultoi se vlera anomalisht e ulët është 257,345,435 /9 * 0.85= 24,304,846 lekë pa TVSh, si rrjedhojë arsye e skualifikimit nga KVO qëndron.

Nga auditimi i dokumentacion në sistemin SEP dhe dosjen e procedurës, rezultoi se shoqëria "N". ShPK, nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DST, konkretisht:

Nga auditimi u konstatua se për mjetin Grejder, OE fitues ka paraqitur vetëm deklaratë doganore/faturë në kundërshtim me kriterin 2.4 pika a) ku përcaktohet se "*Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme).* KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për prokurimin publik"*, neni 92 *"Shqyrtimi i ofertave*", pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, neni 82 *"Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"*, pika 2. Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga, *M.G., E.H., D.H., D.S., O.G.*.

10. Procedura e prokurimit me objekt: *"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në qytetin Roskovec"*

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt ""Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në qytetin Roskovec"			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF- 35883-01-23-2025 **1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur "	**2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit** Nr. 267 Prot..,data 16.01.2025 A.H.	**3. Njësia e Prokurimit** Data 21.01.2025 5/444 E.P. N.Y.	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Data. 31.03.2025 Prot 804 M.G. E.H. O.G.

	E.T. S.K.	S.C. E.K. A.D.	D.H. D.S.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 30,864,728 lekë	**6.Oferta fituese, vlera fituese:** Operatori Fitues: "E.C 19,863,000 lekë pa TVSh.		**7. Diferenca me fondin limit** 11,001,728 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 25.02.2025	**9. Burimi Financimit -**të ardhurat e veta.		**10. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender,8 OE b) S'kualifikuar0**,** c) Kualifikuar 8 **B/OE**
11. Ankimime AK-s'ka/ka**;** ka **APP–**s'ka/ka**;** **KPP-**s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK S'ka		**13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo **KKP:** S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës Data 21.03.2025 Nr.6778 Prot	**15. Vlera e kontratës (me TVSH) 23,835, 600 lekë**		**16. Likuiduar 10,000,000** leke
17. Situacioni 23,828,400 leke me TVSH	**18.Afati i kontratës në ditë 6 muaj**		**19. Zgjatja e kontratës me – ditë ska**

Burimi: Bashkia Roskovec.

I. Nga auditimi rezultoi se, preventivi i punimeve është hartuar nga Studio "*A.*" & "*G.*" sh.p.k dhe marrë në dorëzim me procesverbalin nr. 267/1 prot., datë 17.01.2025. Nga Komisioni i Llogaritjes Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike dhe është mbajtur procesverbali nr. 267/2 prot., datë 17.01.2025 si dhe relacionin shpjegues nr. 267/3 prot., datë 17.01.2025.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezultoi se, AK Bashkia Roskovec, nuk është pajisur me "*leje ndërtimi/infrastrukture*" dhe, në kundërshtim me nenin 39 të Ligjit nr. 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar; pikën 1 të nenit 6 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar me ligjin nr. 3/2020, datë 30.01.2020 dhe nr. 120/2020, datë 7.10.2020. Zbatimi i kontratës së sipërmarrjes në mungesë të lejes së ndërtimit, përbën një risk të shtuar, për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, si dhe për plotësimin e kushteve për kryerjen e punimeve, të përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, duke rënë ndesh me këtë të fundit. Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar. Gjithashtu nga auditimi u konstatua se pjesë e dosjes së prokurimit, nuk rezultoi të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një oponencë teknike, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik. Mungesa e oponencës teknike, në rastin konkret, rezultoi të jetë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, sipas të cilit: "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventivuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik". Si konkluzion, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponence teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit. Në përfundim, në lidhje me mosveprimin e konstatuar më sipër, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar si dhe VKM nr. 9, datë 11.01.2024 *"Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe*

procedurat që ndiqen në këto raste", për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi, Titullar i Ak M.B.

II-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me shkresën nr. 804 prot., datë 31.01.2025 është ngritur KVO. Me shkresën nr. 1521/1 prot., datë 25.02.2025 është mbajtur PV mbi hapjen e procedurës. Me shkresën nr. 1627 prot., datë 27.02.2025 është mbajtur PV mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si më poshtë vijon:

OE/BOE	VLERA PA TVSH
"E.C."	**19,863,000 kualifikuar/fitues**
"K."	20,484,340 kualifikuar
"V.G."	21,115,350 kualifikuar
"N."	21,183,300 kualifikuar
"A."	23,769,594 kualifikuar
K.K.	25,081,900 kualifikuar
"B."	26,996,510 kualifikuar
"Z.K."	28,270,150 kualifikuar

Burimi: Bashkia Roskovec.

Me shkresën nr. 1862 prot., datë 05.03.2025 është mbajtur PV për sqarimin e një gabimi procedural në publikimin e njoftimit paraprak të fituesit, ku gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nga anëtarët e NJP është evidentuar se publikimi i njoftimit paraprak është bërë përpara se operatori i klasifikuar të dorëzonte dokumentacionin e kërkuar. Me shkresën nr. 1862 prot., datë 05.03.2025 është mbajtur relacioni shpjegues drejtuar titullarit të Ak "*Për sqarimin e një gabimi procedural*" sipas KVO ndodhur për shkak të ngarkesës dhe është rënë dakord për sqarimin e situatës dhe njohjen e këtij gabimi procedural pa pasoja ligjore për procedurën e prokurimit. Me shkresën nr. 1852/1 prot., datë 17.03.2025 është hartuar raporti përmbledhës. Nga vlersimi i KVO nuk ka OE të skualifikuar. Grupi i auditimit verifikoi nëse oferta është anaomalisht e ulët ku rezultoi se, totali i ofertave të kualifikuar është 186,764,144 lekë /8 OE të kualifikuar *0.85 ku vlera anomalisht e ulët rezultoi 19,843,690 lekë pa TVSh, që do të thotë OE fitues nuk ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët.

Nga auditimi i dokumentacion në sistemin SPE dhe dosjen e procedurës, rezultoi se OE "E. C." ShPK, nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DST, konkretisht:

-Për mjetin Grejder është paraqitur faturë tatimore blerje nr. 22 datë 30.11.2015, në kundërshtim me kriterin 2.4. pika a) ku thuhet se për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).

- Nuk plotësohet kriteri **2.3.3.b.**OE pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojë në listëpagesat e subjektit, punonjësit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:

EMERTIMI	
Teknik të mesëm ndërtimi	(1 person)

Në këtë kriter përcaktohet se, për punonjësin e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

-Kontratën individuale të punës; një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 "*Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar si dhe dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente.

Nga auditimi u konstatua se për punonjësin G.S. deklaruar me profesion teknik ndërtimi është paraqitur një certifikatë nga Qendra e Trajnimeve të Avancuara ku e klasifikon si specialist

ndërtimi kjo e cila nuk është e akredituar dhe e licencuar në Republikën e Shqipërisë për trajnimin e punonjësve/personelit.
-Për mjetin kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton me targë AA 163 VB në dokumentacionin e paraqitur fizikisht nuk rezultoi të jetë paraqitur foto, ku të provohet që kemi të bëjmë me të njëjtin mjet të deklaruar në shtojcën 8 në formularin e vetë deklarimit.
Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", neni 92 "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, neni 82 *"Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"*, pika 2. Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga, *M.G., E.H., O.G., D.H., D.S.*

11. Procedura e prokurimit me objekt: *"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kurjan*"

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kurjan"			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF - 36949-02-06-2025 **1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit** *"*E hapur "	**2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit** Nr.270Prot. 16.01.2025 A.H. E.T. B.H.	**3. Njësia e Prokurimit** Data 04.02.2025 21/893 E.P. S.C. D.M. E.K. A.D.	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Data 11.02.2025 Nr.1087 Prot. M.G. E.H. S.K. D.S. O.G.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 23, 920, 529 lekë	**6.Oferta fituese, vlera fituese:** Operatori Fitues: "E15,089,704 lekë pa TVSh.		**7. Diferenca me fondin limit** 8,830,825 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 03.03.2025	**9. Burimi Financimit -**të ardhurat e veta.		**10. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender,8 OE b) S'kualifikuar0**,** c) Kualifikuar 8 **B/OE**
11. Ankimime **AK**-s'ka/ka**;** ka **APP**–s'ka/ka**;** **KPP**-s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK S'ka		**13. P**ërgjigje Ankesës nga APP apo **KKP:** S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës Data 16.04.2025 Nr. Prot 2917	**15. Vlera e kontratës (me TVSH) 18 107 645lekë**		**16. Likuiduar** 7,000,000 leke
17. Situacioni 18,107,645 leke me TVSH	**18.Afati i kontratës në ditë 6 muaj**		**19. Zgjatja e kontratës me – ditë ska**

Burimi: Bashkia Roskovec.
I. Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike është ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 270 prot., datë 16.01.2025**.**
Preventivi i punimeve është hartuar nga Studio "A." & "G." sh.p.k dhe marre ne dorëzim nga specialistet e fushës konkretisht nga Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike me procesverbalin nr. 270/1 prot., datë 17.01.2025. Specialistët e fushës konkretisht Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike kanë mbajtur procesverbalin nr. 270/2 prot., datë 17.01.2025 si dhe relacionin shpjegues nr. 270/3 prot., datë 17.01.2025, ku shprehin kërkesat e Autoritetit Kontraktor për cilësinë e kryerjes së punimeve.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezultoi se, AK Bashkia Roskovec, nuk është pajisur me "leje ndërtimi/infrastrukture" dhe, në kundërshtim me nenin 39 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar; pikën 1 të nenit 6 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar me ligjin nr. 3/2020, datë 30.01.2020 dhe nr. 120/2020, datë 7.10.2020. Zbatimi i kontratës së sipërmarrjes në mungesë të lejes së ndërtimit, përbën një risk të shtuar,

për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, si dhe për plotësimin e kushteve për kryerjen e punimeve, të përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, duke rënë ndesh me këtë të fundit. Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se pjesë e dosjes së prokurimit, nuk rezultoi të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një oponencë teknike, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik. Mungesa e oponencës teknike, rezultoi të jetë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, sipas të cilit: "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventivuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik". Si konkluzion, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponence teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit. Në përfundim, në lidhje me mosveprimin e konstatuar më sipër, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar si dhe VKM nr. 9, datë 11.01.2024 "*Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste*",

II-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me shkresën nr. 1087 prot., datë 11.02.2025 është ngritur KVO. Me shkresën nr. 1771/1 prot., datë 03.03.2025 është mbajtur PV mbi hapjen e procedurës. Me shkresën nr.1894 prot., datë 06.03.2025 është mbajtur PV mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si më poshtë vijon:

Nr.	Operatorët Ekonomik	Vlera pa TVSh
1	"E' SHPK	**15,089,704 kualifikuar/ fitues**
2.	B.O.E: "V." & "G."SHPK	15,626,650 kualifikuar
3.	"N" SHPK	16,639,300 kualifikuar
4.	"K.K." SHPK	16,902,150 kualifikuar
5.	"Z." SHPK	18,202,600 kualifikuar
6.	"A." SHPK	18,429,770 kualifikuar
7.	"A." SHPK	18,799,290 kualifikuar
8.	"B.B." SHPK	19,559,340 kualifikuar

Burimi: Bashkia Roskovec.

-Me shkresën nr. 2580 prot., datë 03.04.2025 është hartuar raporti përmbledhës mbi hapjen, zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave të tenderit me objekt "*Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kurjan*".

- Grupi i auditimiti verifikoi nëse oferta është anaomalisht e ulët ku rezultoi se, totali i ofertave të kualifikuar është 139,248,804 lekë /8 OE të kualifikuar * 0.85 ku vlera anomalisht e ulët është 14,795,185 lekë pa TVSh, që do të thotë OE fitues nuk ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët.

Nga auditimi i dokumentacion në sistemin SPE dhe dosjen e procedurës, rezultoi se OE "E." ShPK, nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DST, konkretisht:

1. Nuk plotësohet kriteri 2.4. Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qira ku ndër të tjera është kërkuar:

Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Cope 2
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 15 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1

-Nga auditimi u konstatua se në formularin e vetëdeklarimit OE fitues nuk ka deklaruar në formularin e vetë deklarimit kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 15 ton.
me objekt *"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në qytetin Roskovec*". Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", neni 92 "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, neni 82 *"Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"*, pika 2. Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga, M.G., E. H., O.G., S.K., D.S.

12. Procedura e prokurimit me objekt: *"Blerje dhe instalimi i 3 pemëve "Smarfloëer"dhe ndërtim stacioni komercial të EV për makinat elektrike"*.

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Blerje dhe instalimi i 3 pemëve "Smarfloëer" dhe ndërtim stacioni komercial të EV për makinat elektrike"."</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
REF- 35531-01-20-2025
1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur "</td><td>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit
Nr.296Prot. Data 16.01.2025
E.H.
E.K.
S.K.</td><td>3. Njësia e Prokurimit
Data 17.01.2025 1/346
E.P.
E.S.
E.K.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Data,23.01.2025 Prot.548
M.G.
O.G.
A.D.</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh) 11 250 000lekë</td><td colspan="2">6.Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: "A 10,651,490 lekë pa TVSh.</td><td>7. Diferenca me fondin limit 598,510 lekë pa TVSh</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit: 06.02.2025</td><td colspan="2">9. Burimi Financimit - FSHZH</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a)Pjesëmarrës në tender,3 OE
b) S'kualifikuar2,
c) Kualifikuar 1 B/OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime
AK-s'ka/ka; ka
APP–s'ka/ka;
KPP-s'ka/ka</td><td colspan="2">12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:
S'ka</td></tr>
<tr><td colspan="4">b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td>14. Lidhja e kontratës Data 22.04.2025 nr. 1968 Prot.</td><td colspan="2">15. Vlera e kontratës (me TVSH) 12,781,788</td><td>16. Likuiduar -</td></tr>
<tr><td>17. Situacioni 12,768,502 leke me TVSh</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në ditë 3 muaj</td><td>19. Zgjatja e kontratës me – ditë ska</td></tr>
</table>

Burimi: Bashkia Roskovec.
I. Nga shqyrtimi i sipërcituar u konstatua se:
-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.
Ky projekt është realizuar bazuar në thirrjen *"*Mekanizmi i nxitjes së kapaciteteve të Bashkisë për zbatimin e projekteve konkretisht projekti *"iniciativa Bloom - fuqizimi i komuniteteve me smart flower dhe zjidhje të qëndrueshme të energjisë"*. Ky projekt konsiston në instalimin e sistemeve të prodhimit të energjisë së rinovueshme, konkretisht paneleve fotovoltaike dhe njësive inovative "smartfloëer" të lidhura me rrjetin elektrik, me qëllim sigurimin e një burimi të qëndrueshëm energjie për komunitetin, për ndriçimin e parkut të qytetit. kjo është faza e parë e projektit dhe është mbyllur si proces, kjo fazë ka qenë financim 100 % nga buxheti i shtetit (Fondi Shqiptar i zhvillimit) nga ky projekt është shpallur fitues Bashkia Roskovec pas aplikimit të bërë pas thirrjes për aplikim nga FSHZH. Preventivi i punimeve është hartuar nga Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike bazuar në procesverbalin e komisionit nr. 296/1 prot., datë 16.01.2025. Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit nr. 346/1 prot., datë 21.01.2025 "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi*", dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), rezultoi se në përgjithësi, edhe pse nuk konstatohen kërkesa apo kritere të ekzagjeruar,

njësia e prokurimit për hartimin dhe argumentimin e tyre është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos kryer asnjë argumentim teknik i cili do të justifikonte dhe ligjëronte vendosjen e secilit kriter apo licencë të kërkuar (kategoritë e licencave, certifikatat ISO, mjetet, stafin inxhinjerik, ejt), në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2.

II. Vlerësimi i ofertave .

Me shkresën nr. 548 prot., datë 03.01.2025 është ngritur KVO.

Me shkresën nr. 959 prot., datë 06.02.2025 është mbajtur PV mbi hapjen e ofertave. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE "A.F." & "E." vlera: 9,901,470 lekë pa TVSh.

2. OE "A." SHPK vlera: 10,651,490 lekë pa TVSh **(fitues)**

3. OE "I." vlera 0 (Zero**)** lekë pa TVSh.

Me shkresën nr.959/1 prot., datë 14.02.2025 është mbajtur PV mbi klasifikimin përfundimtar të Ofertave. Me shkresën nr.1608 prot., datë 27.02.2025 është hartuar Raporti Përmbledhës mbi hapjen, dhe zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave të tenderit.

Janë skualifikuar OE si më poshtë për arsyet e mëposhtme:

1.BOE *"*A.F.*"* & "E." ShPK në vendimin nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publike*", i ndryshuar, kreu XI *"Kushte Të Përgjithshme Për Zbatim*" konkretisht pika 2 e nenit 88 thuhet se:

Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë...

Në marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet "F." SH.P.K dhe "E" SH.P.K thuhet se palët bien dakord që shoqëria "E." sh.p.k, përfaqësuar nga administratori P.P merr përsipër kryesimin dhe përfaqësimin e shoqërive për tenderin, objekt i kësaj marrëveshje dhe shoqëria "F" e autorizon të kryejë të gjitha procedurat për përmbushjen e qëllimit .

Ndërkohë procedura në sistem është ngarkuar nga shoqëria *"*F.*"* SHPK dhe sigurimi i ofertës është bërë nga kjo shoqëri, ndërkohë në marrëveshje thuhet se duhet ti bëjë shoqëria "E." SH.P.K.

2. Në formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, nuk është plotësuar pika 2.3.3.b konkretisht elektricisti dhe pika 2.3.3.d duhet të deklaronte një punëtor të thjeshtë.

2. "I." ShPK nuk ka ngarkuar asnjë dokument në *sistemin* SPE**.**

-Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se për arsyet për të cilat shprehet KVO qëndrojnë.

Nga auditimi i dokumentacion në sistemin SPE dhe dosjen e procedurës, rezultoi se OE "A.". ShPK, nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DST, konkretisht:

1. Nuk plotësohet pika 2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet. Konkretisht nuk plotësohet pika a) ku nga NJP është kërkuar se për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme). Nga auditimi u konstatua se OE fitues nuk ka paraqitur dokumentacionin e sipër kërkuar për mjetin ekskavator. Gjithashtu nuk plotësohet pika e). Ku është kërkuar nga Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara ne procedura te shpallura fitues. Nga auditimi u konstatua se, për mjetin e deklaruar Autobot uji me targë A ... M nuk ishte pjesë e dokumentacionit të paraqitur foto e mjetit. Për mjetin e deklaruar si kamionçinë më targë A...R në foton e paraqitur nga OE nuk dallohej targë me qëllim identifikimin nëse kemi të bëjmë me të njëjtin mjet me atë të deklaruar.

2. Nga auditimi u konstatua se, për punonjësin E.Q. deklaruar si karpentier dhe punonjësin E.C. deklaruar si hidraulik dëshmia e kualifikimit është lëshuar nga QTA e cilat është akredituara në Republikën e Shqipërisë për trajnimin e punonjësve/personelit, në kundërshtim me kriterin 2.3.3.c ku përcaktohet se "*Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë*: -Kontratën individuale të punës;
-Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (certifikatë/dëshmi), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 "*Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë".* Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për prokurimin publik*", neni 92 "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 82 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2. *Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga, M.G., A.D., O.G.*

13. Procedura e prokurimit me objekt: "*Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregtare": Faza 1 "Punime për bazamentin e fushës së futbollit*".

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregtare": Faza 1 "Punime për bazamentin e fushës së futbollit"			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF-40758-03-11-2025 **1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur "	**2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit** Nr.1483Prot.Data 24.02.2025 V.Z. M.D. A.H.	**3. Njësia e Prokurimit** Data 26.02.2025 45/1572 Elsa Protoduari, S.C. B.H. E.K. B.T.	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Data 04.03.2025 Nr. 1785 Prot M.G. M.L. R.B. E.H. D.S.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 20,708, 484 lekë	**6.Oferta fituese, vlera fituese:** Operatori Fitues: "A" ShPK 13,808,849 lekë pa TVSh.		**7. Diferenca me fondin limit** 6,899,634 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 02.04.2025	**9. Burimi Financimit –** Të ardhurat e veta		**10. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender,9 OE b) S'kualifikuar0**,** c) Kualifikuar 9 **B/OE**
11. Ankimime **AK**-s'ka/ka**;** ka **APP**–s'ka/ka**;** **KPP**-s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK S'ka		**13.** P**ërgjigje** Ankesës nga APP apo **KKP:** S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës Data 05.05.2025	**15. Vlera e kontratës (me TVSH) 16 570 619**		**16. Likuiduar -6,034,680**
17. Situacioni -	**18.Afati i kontratës në ditë 4 muaj**		**19. Zgjatja e kontratës me – ditë ska**

Burimi: Bashkia Roskovec.
I. Nga auditimi rezultoi se preventivi i punimeve është hartuar nga Studio *"N.S."* sh.p.k dhe është marrë në dorëzim me procesverbalin nr. 328 prot., datë 07.05.2024. Komisioni i Llogaritjes Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike kanë mbajtur procesverbalin nr. 1483/1 prot., datë 25.02.2025 si dhe relacionin shpjegues nr. 1483/2 prot., datë 25.02.2025.
Në lidhje me argumentimin e kritereve u konstatua se në kriterin 2.3.2 Ak ka kërkuar që OE duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim te Këshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies se licencave profesionale te*

zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojnë veprimtari ndërtimi" e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP.1 A	Punime gërmimi në tokë
2	NP.2 A	Ndërtime civile dhe industriale
3	N.S – 14 A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Për kategorinë e licencës N.S – 14 A impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj, u konstatua se kjo kategori licence e cila është kërkuar nga NJP nuk është në përpjesëtim me preventivin e punimeve.

II-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me shkresën nr.1785 prot., datë 04.03.2025 është ngritur KVO, ky komision ka pësuar ndryshim bazuar në shkresën nr. 2513 prot., datë 01.04.2025 . Me shkresën nr. 2545 prot., datë 02.04.2025 është mbajtur PV mbi hapjen e ofertave. Me shkresën nr. 2545/1 prot., datë 10.04.2025 është mbajtur pv mbi klasifikimin e ofertave si më poshtë vijon:

Nr.	**Operatorët ekonomik**	**Vlera pa TVSh**
1	"A." SHPK	**13,808,849 kualifikuar / fitues**
2	"D." SHPK	13,824,866 kualifikuar
3	"V." SHPK	14,052,887 kualifikuar
4	"2N." SHPK	15,141,000 kualifikuar
5	"L.V." SHPK	15,324,861 kualifikuar
6	"A." SHPK & "K.K" SHPK	17,414,261 kualifikuar
7	"N." SHPK	17,431,617 kualifikuar
8	"S." SHPK	17,534,120 kualifikuar
9	"N." SHPK	17,601,979 kualifikuar

Burimi: Bashkia Roskovec.

Me shkresën nr. 3065 prot., datë 18,04,2025 është drejtuar OE "A." njoftimi i fituesit pas publikimit të cilit fillojnë afatet e ankimimit. Me shkresën nr. 3437 prot., datë 30.04.2025 formulari i njoftimit të fituesit , në përfundim të afateve të ankimit. Me shkresën nr. 3505 prot., datë 02.05.205 është hartuar Raporti përmbledhës.

Nga auditimi i dokumentacion në sistemin SPE dhe dosjen e procedurës, rezultoi se OE "A. C, nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DST, konkretisht:

1-Nuk plotësohet pika 2.2.2. ku nga AK është kërkuar që Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne përputhje me Ligjin nr.10091 date 05.03.2009 *"Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabël te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar"*, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Nga auditimi u konstatua se, për bilancet e paraqitura për vitet 2021 dhe 2022 nuk paraqitet dokumentacioni i cili vërteton se, këto bilance janë audituar nga audituesi ligjor sikurse kërkohet në kriterin e sipërcituar.

2-Nuk plotësohet 2.4. Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira, në dokumentacionin fizik pjesë e dosjes së OE fitues për mjetin kamioçinë me targë A...K foto e paraqitur e mjetit është pozicionuar në një mënyrë ku nuk dallohet targa me qëllim identifikimin nëse kemi të bëjmë me të njëjtin mjet si atë të deklaruar..

3- Për mjetet minieskavator dhe Grejder nuk paraqitet dokumentacioni sikurse kërkohet në pikën a) ku thuhet se: për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", neni 92 "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2. *Për veprimet/mosveprimet e mësipërme,*

ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga, M.G, M.L, R.B, E.H, D.S.

Mbi zbatimin e kontratave Publike

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin ***"Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kujanit"*** viti 2024, konstatohet se:

A. Të dhëna mbi objektin:

a. Zbatimi kontratës "*Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kujanit*", Bashkia Roskovec viti 2024		
14. Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatimi punimesh me nr. 9542 prot., datë 12.12.2024, midis Bashkisë Roskovec dhe Kontraktorit BOE "K.K" Shpk & "C.M.".	**15.Vlera e kontratës (me TVSh):** 149,584,878 lekë	**16. Leje ndërtimi-po** Nr. 22 datë 17.12.2024
17. Situacionet dhe likuidimet : Faturë Pune me volume 4 situacione progresive -Likuiduar vlera 63,396,161 lekë me TVSh -Palikuiduar vlera 38,400,000 lekë me TVSh = Vlera 101,796,161 lekë me Tvsh *e faturuar* Ngelet sit. përfundimtar; **47,788,717** lekë me TVSh.	**18. Afati i kontratës në muaj:** Parashikuar: 6 muaj nga data e nënshkrimit kontratës (12.12.2024). Fillimi i punimeve: Datë 18.12.2024 Përfundimi i punimeve sipas kontratës, duhej të ishte: **Datë 17.12.2025**	**19. Zgjatja e kontratës-po** Amendim kontrate 1 nr. 4915/1 prot., datë 17.06.2025 6 muaj dhe *punimet nuk kanë përfunduar, përcaktuar përfundimi i punimeve më 17.12.2025*
20. Mbikëqyrësi i punimeve: Kontratë mbikëqyrje nr. 9573 prot., datë 16.12.2024, midis AK Bashkisë Roskovec dhe OE "S." Shpk, përfaqësuar nga Ing. V.A. dhe N.P.	**Licensa** MK.....	**Vlera e kontratës me TVSh.** Vlera 2,052,174 lekë
21. Kolaudatori i punimeve: Pa lidhur kontrata	Licensa	
22. Akt Kolaudimi	Nuk janë përfunduar punimet	
23. Akt marrje në dorëzim-po	Nuk janë përfunduar punimet	

I. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 9542 prot., datë 12.12.2024, midis Bashkisë Roskovec përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë M.B dhe Kontraktorit BOE "K.K." Shpk & "C.M." Shpk, përfaqësuar nga Administratorët K.C. dhe M.C. Vlera e kontratës është 149,584,878 lekë me TVSh. Financimi i objektit sipas kontratës së miratuar edhe procedurë prokuruese me Ref-22747-10-04-2024 është i ndarë në vite si më poshtë:

- Për vitin 2024 – nga Buxheti i Shtetit 29,338,333 lekë pa TVSh ose 35,206,000 lekë me TVSh;
- Për vitin 2025 – nga Buxheti i Shtetit 44,008,323 lekë pa TVSh ose 52,810,000 lekë me TVSh;
- Për vitin 2026 – nga Buxheti i Shtetit 52,089,628 lekë pa TVSh ose 61,568,878 lekë me TVSh.

Hartimi i kontratës është hartuar mbështetur në Ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 "*Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar; Ligji nr. 162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; VKM nr. 285 datë 19.02.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar; Dokumentet Standarde Tenderit për procedurën e prokurimit; E hapur-punë. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 9 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata nr. 9573 prot., datë 16.12.2024, midis AK Bashkisë Roskovec dhe BOE "S." & "L-I" Shpk, përfaqësuar OE "S" Shpk me përfaqësues Ing. V.A., me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK 0944/10.

- Njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi BOE "S"& "L-I" Shpk, me nr. 9845 prot., datë 20.12.2024, është data **18.12.2024**. Njoftimi i fillimit të punimeve i përcaktuar nga Sipërmarrësi BOE "K.M.K."& "C.M."Shpk është data 18.12.2024. Procesverbali i fillimit të punimeve me shkresën nr. 9847 prot., datë 20.12.2024, ku përcaktojnë fillimin e punimeve datë 18.12.2024. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi me nr. 9846 prot., datë 20.12.2024 (*por jo i nënshkruar nga AK*), ku përcaktohet se sheshi i ndërtimit është dorëzuar më datë 18.12.2024. Akti i piketimit është realizuar më datë 18.12.2024.
- Me shkresën e sipërmarrësit nr. 4915 prot., datë 12.06.2025, kërkohet zgjatje të afatit të punimeve me 6 muaj shtesë për shkak të periudhës së vaditjes në Maj, kushtet atmosferike dhe reshjet e rënduara, vonesa në furnizimin me makineri dhe pajisje specifike jashtë vendit. Referuar paragrafeve të kontratës nr. 27.3 dhe 27.5, sipërmarrësi propozon përfundimin e punimeve më datë 17.12.2025. Pas kërkesës së sipërmarrësit nr. 4915prot., datë 12.06.2025, palët kanë rënë dakord të realizojnë Amendimin e kontratës nr. 1, Amendim nr. 4915/1 prot., datë 17.06.2025, në të cilën është përfshirë ndryshimi i afatit të ekzekutimit të më datë **17.12.2025**.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion kontatohet:
Sipërmarrësi i punimeve *ka dështuar në përfundimin e punimeve* dhe nuk ka arritur të përfundojë objektin më datë 17.12.2025, referuar kontratës së punimeve nr. 9542 prot., datë 12.12.2024 dhe amendimit nr. 1 nr. 4915 prot., datë 12.06.2025. Vonesat në punime referuar dokumentacionit të sjellë në observacion kanë ardhur si pasjojë e përmbytjeve në zonë dhe furnizimin me energji elektrike.

- Me shkresën e Kryetarit të Bashkisë **nr. 984 prot., datë 05.02.2026**, drejtuar sipërmarësit BOE "K.K." Shpk & "C.M." Shpk, për dijeni mbikëqyrësit "S." Shpk, njoftohen për ndreqjen e mospërmbushjes së marrëdhënieve kontratuale të objektit *"Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kujanit".* Në njoftimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec njoftohet sipërmarrësi që nuk ka zbatuar nenet 4, 9 dhe 10 të kontratës të cilat parashikojnë: Neni 4 "*Data e nënshkrimit të kontratës, fillimi i punimeve dhe afati për përfundimin e punimeve*" citon: *"...Afati për përfundimin e punimeve është 6 muaj nga data e fillimit të punimeve..." si dhe amendimi nr. nr. 4915prot., datë 12.06.2025 (+ 6 muaj) me afat 17.12.2025*.
Neni 9 i kontratës së punimeve "Realizimi i punimeve" citon se: "*Realizimi i të gjitha punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, terma reference apo detyre projektimi, nëse është rasti, si dhe shërbimet e lidhura me to, do të jenë në përputhje me kërkesat e spacifikuara në dokumentet e tenderit dhe me standardet teknike në fuqi*". Neni 10 i kontratës së punimeve "Përgjegjësitë e Kontraktorit" citon se: "*Kontraktori do të jetë përgjegjës për realizimin e të gjitha punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, terma reference apo detyrë projektimi, nëse është rasti si dhe shërbimet e lidhura me to të përfshira në objektin e kontratës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DT, si dhe standardet teknike në fuqi*". Në vijim, referuar nenit 32.1 të kontratës, AK Bashkia Roskovec njofton sipërmarrësin se ka afat 15 ditë që të ndreqin mospërmbushjen e kontratës. Neni 32 "Ndërprerja e kontratës" pika 1, citon "*Nëse kontraktori nuk përmbush ndonjë detyrim sipas kontratës, AK mund ti kërkojë me njoftim që të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve*. Neni 32.2 "Ndërpreja për mospërmbushje", citon "*AK pa cënuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e kontratës, mundet me anë të një njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet kontraktorit, ta përfundojë kontratën në tërësi ose pjesërisht*:
a) Kontraktori dështon në kryerjen e punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose

b) Kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
c) Nëse provohet se kontraktori është i angazhuar në praktika të ndaluara, sic përcaktohet në nenin 6, gjatë konkurimit për kontratën apo ekzekutimin e saj.
Të gjitha materialet, ngritja e kantierit dhe punët e përfunduara do të bëhen pronë e AK nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj. Në përfundim të shkresës së Kryetarit të Bashkisë nr. 984 prot., datë 05.02.2026, njoftohet se me kalimin e afatit 15 ditor në rastin e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, AK Bashkia Roskovec do të vijojë me penalitetet e përcaktuara në kontratë **neni 24 pika a**) "*Dëmet e likuiduara*".
Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore; *Për kontratat meperiudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës së koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës.*

- Me shkresën e Kryetarit të Bashkisë nr. 1465 prot., datë 19.02.2026, drejtuar mbikëqyrësit të punime "S." Shpk, kërkohet raport i detajuar lidhur me afatin e realizimit të punimeve. Me relacionin e mbikëqyrësit të punimeve datë 28.01.2026, sqarohet ecuria e punimeve po ecën me ritme të mira dhe deklaron se totali i investimit ka arritur në 95 % të vlerës. Nga relacioni i mbikëqyrësit nuk konstatohet se me raportin e datës 28.01.2026, *kontrata ka dalë jashtë afateve kontraktuale dhe masa që duhen marrë nga Investitori.*

- Me shkresën e Kryetarit të Bashkisë **nr. 1706 prot., datë 02.03.2026**, drejtuar sipërmarësit BOE "K.K." Shpk & "C.M." Shpk, për dijeni mbikëqyrësit "S." Shpk, njoftohen për zbatimin e penaliteteve për mospërmbushje kontraktuale, ku citohet;
"Me anë të shkresës nr. 984 prot., datë 05.02.2026, ju është bërë me dije njoftimi për ndreqjen e mospërmbushjes kontraktuale brenda 15 ditësh referuar nenit 32.1 të kontratës dhe me kalimin e afatit 15 ditor do të vijojë penalitetet e përcaktuara në kontratë neni 24 pika b)", "*për kontratat jo më shumë se 12 muaj tarifa ditore do të jetë 2/1000...*".
Nga auditimi i dokumentacioneve rezulton se, referuar shkresës 1706 prot., datë 02.03.2026, është përcaktuar ***përkufizim i gabuar*** i kontratës nga Kryetari i Bashkisë pasi me amendimin nr. 1 të gjitha klauzolat përvec afatit nuk janë ndryshuar dhe aplikimi i penalitetit i përket nenit 24 pika a) "*për kontratat jo më shumë se 6 muaj tarifa ditore do të jetë 4/1000...*".

- Refruar korrespondencave të palëve konstatohet se nuk është përmendur apo përdorur mekanizmi i Nenit 14 të kontratës "Sigurimi i kontratës" citon: 14.1 *Kontraktuesi, brenda afatit të caktuar nga AK në njoftimin e fituesit, paraqet sigurimin e kontratës në shumën e specifikuar në Kushtet e Vecanta të Kontratës (KVK).* Referuar nenit 2 të KVK "Sigurimi i kontratës" specifikon pika 2.1 se; "*Sigurimi i kontratës në shumën (10% e vlerës së ofertës) duhet të ofrohet nga kontraktori* ***për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës***".
Referuar formularit të sigurimit të kontratës nga shoqëria "A." Sh.a, me policë/seria nr.xxxxxxxx, është vendosur shuma **14,958,487 lekë** si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, ku citohet mënyrë eksplicide se; "*Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e Bashkisë Roskovec vlerën e siguruar brenda 15 ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos përmbushjen e kushteve të kontratës*".
- Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë **nr. 43 datë 25.02.2026**, ngrihet komisioni për llogaritjen e dëmit të shkaktuar nga mospërmbushja e detyrimeve kontraktuale referuar kontratës nr. 9542 prot., datë 12.12.2024 me objekt "*Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kujanit".* Komisioni përbëhet nga O.G. (Drejtor në Drejtorinë Ekonomike), V.Z. (Drejtor në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Juridik dhe Arkivit" dhe E.H. (Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Mjedisit dhe Pronës". Komisioni ngarkohet për llogaritjen e dëmit të shkaktuar brenda 5 ditëve nga data e urdhrit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, *nuk ekziston asnjë llogaritje e dëmit për kontraktorin.*
- Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 1581/1 prot., datë 02.03.2026, urdhërohet ndryshim i urdhërit nr. 43 datë 25.02.2026, i pikës 2 të urdhrit ku ndryshohet afati nga 5 ditë në 60 ditë për përcaktimin e vlerës së dëmit të kontraktorit. *Përsëri nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk ekziston asnjë llogaritje e dëmit për kontraktorin*.
- Kontrata përbëhet nga 4 situacione pjesore progresive, të cilat nuk janë shoqëruar me libreza masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005, *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"* Kreu II, pika 8.1; *"Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori"* dhe Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011, *"Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se: 3.3 *"Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me VKM"*.

Nr	Vlera Totale	Urdher shpenzimi	Data	Nr. Fature	Data	Likujdim	Situacioni
1		150	28.05.2025	4	25.24.2025	34,229,962	Nr.1
2		339	07.08.2025	17	04.08.2025	9,070,000	Nr.2
3		219	25.05.2026	17	04.08.2025	20,096,199	Nr.2 Pjesor Ne proces nga Dega e thesarit per miratin e fondit nga Ministria
4				7	10.04.2026	-	Vlera e fatures 9,600,000 leke, pa konfirmim situacioni nr. 3
5				12	30.04.2026	-	Vlera e fatures 28,800,000 leke, pa konfirmim situacioni nr. 4
	149,584,878	**Totali**				**63,396,161**	**38,400,000**

Referuar faturave të punëve me volume, nga Drejtoria e financës së Bashkisë Roskovec janë realizuar 4 situacione progresive, si më poshtë;
- Likuiduar vlera 63,396,161 lekë me TVSh
- Palikuiduar vlera 38,400,000 lekë me TVSh
= Vlera 101,796,161 lekë me Tvsh e faturuar
Vlera e ngelur e pazbatuar në kohë (*koresponduese)* është **47,788,717 lekë me TVSh** > 25 % e vlerës së kontratës.

Sa më sipër nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet:
Referuar kushteve kontraktuale dhe neglizhencës së kontraktorit për të përfunduar punimet në kohë, nga AK duhet të merren masa të për aplikuar penaliteteve të kontratës sipas ***nenit 24, pika a*** citon "*Për cdo ditë vonesë tej afatit të punimeve, kontraktori është detyruar t'i paguajë Investitorit, **masën 4/1000** të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës*".

Referuar datës që duhej të përfundonin punimet 17.12.2025, rezulton se kontraktori nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale dhe ato që rrjedhim nga Ligji nr. 7850 datë 29.07.1994 "*Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, duke vonuar punimet më shumë se 6 muaj vonesë (*llogaritur deri më 1 Qershor 2026*) plot **165 ditë vonesë**.
Referuar kontratës nenit 24 pika a), detyrimet e kontraktorit janë:

165 ditë x **47,788,717** lekë x 4/1000 ditë = **31,540,553 lekë, e cila konsiderohet dëm ekonomik** shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe Bashkisë Roskovec, për shkak të vonesave në përfundimin e punimeve.

a- Si përfundim sipërmarrësi BOE "K.K." Shpk & "C.M." Shpk, i kanë shkaktuar Bashkisë Roskovec dëm ekonomik në vlerën **31,540,553 lekë,** për vonesa në realizimin e punimeve në kundërshtim pikën 5.1 të Udhëzimit të KM Nr.3 datë15.2.2001 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve*", Ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar dhe kontratën e punimeve nr. 9542 prot., datë 12.12.2024, ku ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve V.A, përfaqësues i OE "S" sh.p.k, për mos llogaritje të vonesave. b- Referuar Ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar, nga AK duhet të mbahet në konsideratë përcaktimi i nenit 78 "Përjashtimi për një periudhë të caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik" pika 1 gërma b) ku citohet; Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për b) *mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, që kanë ndodhur për faj të operatorit ekonomik*;

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
- Mbikqyrësi i punimeve Ing. V.A. nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore dhe detyrimet kontraktuale të kontratës së shërbimit nr. 9573/3 prot., datë 16.12.2024, dhe Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: *Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat me kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.*

Në lidhje me observacionet e dërguara nga sipërmarrësi i punimeve OE "K.K." sh.p.k., me shkresën të protokolluara në KLSH me nr. 293/12 prot., datë 02.09.2026; shprehen pretendimet e tyre për projekt raportin e auditimit për objektin e mësipërm.
Pretendimi i subjektit përmbledhurazi: *Në lidhje me vonesën në zbatimin e kontratës "Rritja e sigurisë së digë dhe përmirësimi i aftësive ujëmbledhëse së rezervuarit të Kurjanit, ju paraqesim observacionin tonë në vijim të diskutimeve dhe dakortësimeve me mbikëqyrësin e punimeve lidhur me ecurinë e punimeve, pengesat e krijuara gjatë zbatimit të kontratës dhe nivelin e realizimit.*
I. Mbi dokumentacionin zyrtar lidhur me përmbytjet, ku në dosjen e kontratës ekziston dokumentacion i krijuar gjatë periudhës së zbatimit, më përpara përfundimit të auditimit i cili evidenton pengesat e krijuara nga përmbytjet dhe kushtet atmosferike, si më poshtë:
- Shkresa nga AKMC nr. 5449 prot., datë 16.07.2026 drejtuar Bashkisë Roskovec, ku evidentohet situata e përmbytjeve nga data 20.11.2025 deri më 20.02.2026 dhe gjendja emergjente ka vijuar,
- Foto datës 20.11.2025 mbi përmbytjet nga dalja e lumit Semanit nga shtrati,
- Në informacionet e mbikëqyrësit të muajit Nëntor 2025, Janar – Maj 2026, evidentohen pengesat nga reshjet dhe çmontimi i elektromotorëve,
- Grafikun e rishikuar të punimeve nga përmbytjet e Mars 2026,
Këto janë fakte të periudhës së zbatimit të kontratës, ku kërkojmë që dokumentet që ndodhen në dosje të provojnë pengesat objektive të vlerësohen në përcaktimin e përgjegjësive.
II. Mbi procesverbalin e Bashkisë për llogaritjen e dëmit
Në vijim të projektraportit të auditimit datë 04.08.2026, paraqitet për shqyrtim procesverbali i Bashkisë Roskovec datë 13.08.2026 për llogaritjen e dëmit të likuiduar si dhe përgjigjen e mbikëqyrësit datë 19.08.2026. Pas Projekt Raportit, Bashkia Roskovec ka vijuar procedurën për përcaktimin e dëmit, duke ua vënë në dispozicion procesverbalin e komisionit për përllogaritjen e dëmit datë 13.08.2026. Në procesverbal është pranuar se për periudhën 20.11.2025-17.12.2025, për shkak të përmbytjeve nga lumi Seman, Kontraktori e kishte të pamundur të vazhdonte normalisht punimet. Gjithashtu procesverbali merr në konsideratë informacionin e supervizorit dhe faktin se pas përmbytjeve kontraktori ishte i detyruar të çmontonte makineritë dhe pajisjet. Pra, vetë AK ka evidentuar ekzistencën e rrethanave

objektive që kanë ndikuar në ecurinë e punimeve dhe kërkohet të vlerësohet dokumenti në lidhje me gjetjen e KLSH-së.
III. Në vijim të procesverbalit datë 19.08.2026, supervizori ka paraqitur komente lidhur me mënyrën e llogaritjes së dëmit. Nëse merret në konsideratë periudha 21.03.2026-10.07.2026, duhet analizohet mënyra e llogaritjes së dëmit. Vlera e punimeve ndërtim-montim është 120,742,815 lekë pa TVSh, ku makineritë dhe pajisjet janë furnizuar.
IV. Në materialin e KLSH-së është kërkuar aplikimi i nenit 24, pika "a" me tarifë 4/1000 ndërsa komisioni i bashkisë në procesverbalin e përllogaritjes së dëmit ka konsideruar nenin 24, pika "b", me tarifë 2/1000. KLSH ka evidentuar dëm ekonomik prej ***31,540,553 lekë****, ndërsa komisioni i bashkisë ka përllogaritur dëmin prej* ***8,301,961 lekë****, mbi bazën e 111 ditë duke marrë në konsideratë përmbytjet dhe bazën ligjore 2/1000.*
Ndryshimi i dëmit nuk është thjesht matematikor, por lidhet me interpretimin dhe zbatimin e drejtëpërdrejtë të kushteve të kontratës. Kontrata fillestare kishte afat 6 muaj ndërsa me amendimin nr. 4915/1 prot., datë 17.06.2026, afati u ndryshua deri më 17.12.2025 dhe për rrjedhojë kërkohet të rivlerësohet baza ligjore me amendimin e realizuar nga bashkia, ku edhe vetë bashkia e ka marre në konsideratë.
V. Mbi vlerën mbi të cilën llogaritet penaliteti punimet e realizuara/faturuara në vlerën 84,160,967 lekë pa TVSh, ku grupi i auditimit nuk ka përfshirë vlerën e sit. 1 në shumën 15,944,121 lekë datë 30.12.2024 dhe totali i punimeve rezulton në vlerën 100,107,589 lekë pa TVSh. Për rrjedhojë duhet mare vlera reale e kontratës.
VI. Mbi vonesat e lidhura me furnizimin me energji elektrike, i cili ka qën faktormbi ecurinë e punimeve të cilat kanë sjellë vonesa në punime.
VII. Mbi grafikun e rishikuar të punimeve, ku sipas njoftimit të supervizorit dhe sipërmarrësit punimet kanë përfunduar më 10.07.2026. Në dosjen e punimeve ndodhet grafiku i rishikuar i punimeve, i cili pasqyron periudhën e pengesës së krijuar nga situata e përmbytjeve. Zbatimi i punimeve më 25.11.2025 rezulton 90%. Më datë 28.01.2026 rezultonin 95% dhe më datë 15.06.2026 rezulton 97%, ndërsa makineritë dhe pajisjet 100%, të cilat janë të dhëna të cilat duhet të merren në konsideratë në përcaktimin e shkakut real të vonesës, ku kontrata ka qenë në fazë të avancuar të përfundimit të punimeve.
VIII. Kërkesa për rishqyrtim nga observacioni
- Të merren në konsideratë dokumentacionin dhe faktet
- Të rivlerësohet dëmi ekonomik prej 31,540,553 lekë, duke marrë në konsideratë edhe përllogaritjen e mëvonshme të berë nga Bashkia Roskovec.
- Të rivlerësojë zbatimin e nenit 24 të kontratës midis pikës "a" dhe "b" dhe faktin e zgjatjes së kontratës deri më 17.12.2025 dhe të rivlerësohet periudha e pretenduar e vonesës.
- Të merret në konsideratë relacionet dhe informacionet periodike e supervizorit dhe sygjerimi i tij i datës 19.08.2026.
- Të rivlerësohet baza financiare e penatitetit, përfshirë trajtimin e TVSH-së dhe zërin e makineri/pajisje të realizuara në masën 100%.
- Të merret në konsideratë dokumentacioni lidhur me furnizimin me energji elektrike.
IX. Dokumentacioni bashkëlidhur observacionit
- Shkresa e Bashkisë Roskovec nr. 5449 prot., datë 16.07.2026 lidhur me përmbytjet;
- Njoftimi për zbatimin e penalitetit nr. 1706 prot., datë 02.03.2026;
- Kthim përgjigje Bashkisë datë 10.03.2026 me email;
-Urdhër për lidhjen e energjisë datë 10.07.2026;
- Njoftim përfundimi punime datë 10.07.2026;
- Njoftimi i Bashkisë nr. 6215 prot., datë 13.08.2026, mbi procesverbalin për përllogaritjen e dëmit;
- Përgjigja e mbikëqyrësit datë 19.08.2026;
- Informacionet mujore të mbikëqyrësit;

- Fotografi të datës 20.11.2025
- Grafiku i rishikuar i punimeve
- Dokumentacioni dhe korrespondenca lidhur me furnizimin me energji elektrike.
Me procesverbalit e komisionit për përllogaritjen e dëmit nr. 5121/1 datë 21.07.2026, i përbërë nga O.G., V.Z. dhe E.K. i miratuar edhe nga Kryetari i Bashkisë citohet:
Duke qenë se kontrata ka afat 12 muaj, atëherë aplikohet dispozita e nenit 24/b i kontratës nr. 9542 prot., datë 18.06.2025 ku parashikon 2/1000 të vlerë korresponduese por minimalisht 25% e vlerës së kontratës.
Vlera Totale e kontratës është 149,584,878 lekë me TVSh. Sipas informacioneve nga bashkia të ing. A.D., më datë 20.11.2025 lumi Seman ka dalë nga shtrati dhe ka vazhduar deri më 20.02.2026 (Bashkëlidhur Informacionin) dhe ditë vonesë nga 21.03.2026 deri në përfundim të punimeve 10.07.2026 janë gjithsej ***111 ditë****.*
Përllogaritja e dëmit është 149,584,878 lekë me TVSh, punime pa përfunduara në masën 5% e cila është më e vogël se 25 %, atëherë 0.25 x 149,584,878 = 37,396,219 lekë x 2/1000 x 111 ditë = ***8,301,961 lekë****.*
- Në përgjigje të procesverbalit e komisionit për përllogaritjen e dëmit nr. 5121/1 datë 21.07.2026, nëpërmjet shkresës nr. 6215 prot., datë 13.08.2026, realizohen disa komente nga mbikëqyrësi i punimeve datë 19.08.2026 si më poshtë:
Së pari; Në përcaktimin e vlerës së plotë të kontratës, kërkon që të zbritet vlera e TVSH, pasi nuk përbën detyrim që punëmarrësi duhet të furnizojë blerësin.
- Vlera e makinerive-pajisjeve është zë i vecantë që nuk përfshihet në vlerën e ndërtim-montimit, ku furnizimi i makinerive dhe pajisjeve është realizuar që në vitin 2025 dhe vlera e plotë e punimeve është ***120,742,815 lekë****.*
Së dyti; Në vlerësimin e ditë-vonesve për mosplotësimin e kontratës janë marrë 111 ditë, ku nuk janë marrë në konsideratë ditët e pushimit, të shtuna të djela dhe festat zyrtare.
- Për periudhën e specifikuar (21 Mars 2026 deri më 10 korrik 2026), rezultojnë sipas muajve 32 ditë shtuna, diela dhe 8 ditë festa zyrtare. Pra duhen marrë në konsideratë 111 ditë – 40 ditë = ***71 ditë vonesë****.*
- Në lidhje me nenin 24-a, b, interpretohet se kontrata ka zgjatur mbi 1 vit dhe në fund përllogaritja sipas mbikëqyrësit është 120,742,815 lekë x 0.25 x 0.002 x 71 ditë = ***4,286,369 lekë.***

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar argumentimeve dhe komenteve të bëra nga Sipërmarrësi i punimeve, *Mbikëqyrësi dhe AK, në observacionin e akt-konstatimit nr. 10 dhe projekt raportiti të auditimit të kryer, sqarojmë se:*
- Grupit të auditimit gjatë kohës së auditimit në terren dhe në fazën e aktkonstatimeve nuk iu është vënë në dispozicion asnjë dokument shtesë të sjellë në observacion në lidhje me përmbytjet dhe lidhjen me energjinë elektrike. Gjatë kohës së auditimit në terren dhe dorëzimit të akteve datë 25.06.2026, nuk ka qenë realizuar përfundimi i punimeve sic deklarohet 10.07.2026, shkresa e Bashkisë Roskovec nr. 5449 prot., datë 16.07.2026, njoftimi i bashkisë nr. 6215 prot., datë 13.08.2026 për përllogaritjen e dëmit në vonesa të punimeve dhe mbi llogaritjet e mbikëqyrësit.
Në lidhje me aktin e konstatimit nr. 10 datë 25.06.2026 dhe projekt raportin e auditimit, grupi i auditimit është shprehur vetëm në lidhje me dokumentacionin e vënë në dispozicion. Mbi bazën e dokumentacionit të vënë në dispozicion ka shprehur konkluzionet paraprake të gjetjeve në lidhje me objektin e kontratës.
Referuar dokumentacioneve shtesë të sjella në observacion, mbi përfundimin e kontratës, plotësimin e dosjes së punimeve dhe përllogaritjen ekonomike të vlerës së dëmit të realizuar nga Bashkia dhe mbikëqyrësi i punimeve, sqarojmë se nuk mund të gjykojmë mbi saktësinë, vërtetësinë dhe analizat e tyre, pasi:

- Informacioni i situatës së përmbytjeve me nr. 5449 prot., datë 16.07.2026 (pas auditimit në terren), tregon situatën në Nëntor të 2025, shkresa e AKMC datë 19.11.2025, nuk është bashkëlidhur në observacion dhe përllogaritjet e vonesave ndryshojnë nga AK dhe mbikëqyrësi. Përgjegjësia e dokumentacionit, analizat e dëmit, vlerësimi i punimeve nga ana sasiore dhe cilësore ngelet plotësisht përgjegjësi e mbikëqyrësit të punimeve si i kontraktuar nga Bashkia Roskovec me nr. 9573 prot., datë 16.12.2024 dhe rekomandimet mbi gjetjet kontratës do të ngelen në vlerësimin e mbikëqyrësit, Investitorit dhe përgjegjësinë e saj.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar argumentimeve dhe komenteve të bëra nga Sipërmarrësi i punimeve, *Mbikëqyrësi dhe Autoriteti kontraktor, në observacionin e akt-konstatimit nr. 10 dhe projekt raportiti të auditimit të kryer, sqarojmë se:*
- Grupit të auditimit gjatë kohës së auditimit në terren nuk është vënë në dispozicion asnjë dokument shtesë të sjellë në observacion në lidhje me përmbytjet dhe lidhjen me energjinë elektrike. Gjatë kohës së auditimit në terren dhe dorëzimit të akteve datë 25.06.2026, nuk ka qenë realizuar përfundimi i punimeve sic deklarohet 10.07.2026, shkresa e Bashkisë Roskovec nr. 5449 prot., datë 16.07.2026, njoftimi i bashkisë nr. 6215 prot., datë 13.08.2026 për përllogaritjen e dëmit në vonesa të punimeve.
Në lidhje me aktin e konstatimit nr. 10 datë 25.06.2026 dhe projekt raportin e auditimit, grupi i auditimit është shprehur vetëm në lidhje me dokumentacionin e vënë në dispozicion gjatë auditimit në fazën e terrenit. Mbi bazën e dokumentacionit të vënë në dispozicion ka shprehur konkluzionet paraprake të gjetjeve në lidhje me objektin e kontratës. Referuar dokumentacioneve shtesë të sjella në observacion, mbi përfundimin e kontratës, plotësimin e dosjes së punimeve dhe përllogaritjen ekonomike të vlerës së dëmit të realizuar nga Bashkia, sqarojmë se nuk mund të gjykojmë mbi saktësinë, vërtetësinë e tyre dhe analizat e tyre, pasi informacioni i situatës së përmbytjeve me nr. 5449 prot., datë 16.07.2026 (pas auditimit në terren), e cila tregon situatën në Nëntor të 2025 dhe shkresa e AKMC datë 19.11.2025, nuk është bashkëlidhur në observacion. Përgjegjësia e dokumentacionit, analizat e dëmit, vlerësimi i punimeve nga ana sasiore dhe cilësore ngelet plotësisht përgjegjësi e Bashkisë Roskovec dhe rekomandimet mbi gjetjet kontratës do të ngelen në vlerësimin e Bashkisë dhe përgjegjësinë e saj.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin ***"Ndërtimi i parkut të ri të qytetit"*** viti 2024, konstatohet se:

A. Të dhëna mbi objektin:

<table>
<tr><td colspan="3">a. Zbatimi kontratës "Ndërtimi i parkut të ri të qytetit", Bashkia Roskovec viti 2024</td></tr>
<tr><td>1. Lidhja e kontratës bazë:
Kontratë zbatimi punimesh me nr. 7688 prot., datë 27.09.2024, midis Bashkisë Roskovec dhe Kontraktorit OE "N." Shpk</td><td>2.Vlera e kontratës (me TVSh):
22,394,155 lekë</td><td>3. Leje Infrastrukture-po
Nr. 17 datë 04.10.2024</td></tr>
<tr><td>4. Situacionet dhe likuidimet :
Faturë Pune me volume
22,387,769 lekë

4.1 Garancia e punimeve
12 Muaj</td><td>5. Afati i kontratës në muaj:
Parashikuar: 2 muaj nga data e nënshkrimit kontratës (22.10.2024).
Fillimi i punimeve:
Datë 22.10.2024
Përfundimi i punimeve sipas kontratës dhe amendimit, Datë 25.04.2025</td><td>6. Zgjatja e kontratës-po
Amendim kontrate 1
nr. 2354 prot., datë 21.03.2025
4 muaj përfundimi i punimeve më 26.04.2025.

Punimet ndërprerë 21.11.2024
Punimet rifilluar 27.02.2025</td></tr>
<tr><td>7. Mbikëqyrësi i punimeve:
Kontratë mbikëqyrje nr. 6682 prot., datë 23.08.2024, midis AK Bashkisë Roskovec dhe BOE "A." & "L.I" Shpk, përfaqësuar nga Ing. B.H. dhe N.P.</td><td>8. Licensa
MK.....</td><td>9. Vlera e kontratës me TVSh.
Vlera 3,429,335 lekë për 5 objekte ndërtimore</td></tr>
<tr><td>10. Kolaudatori i punimeve:</td><td>11. Licensa</td><td>12. Procedurë "Blerje e vogël"</td></tr>
</table>

Kontratë shërbimi kolaudimi, midis AK Bashkisë Roskovec dhe OE "S." Shpk, përfaqësuar nga Ing. V.A.	MK.....	
13. Akt Kolaudimi	07.07.2025	
14. Akt marrje në dorëzim-po	15.07.2025	

I. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 7688 prot., datë 27.09.2024, midis AK Bashkisë Roskovec dhe Kontraktorit OE "N." Shpk. Vlera e kontratës është 22,394,155 lekë me TVSh. Financimi i projektit është realizuar nga fondet e Bashkisë Roskovec. Financimi i objektit sipas kontratës së miratuar është i ndarë në vite si më poshtë:
- Për vitin 2024 – nga Buxheti i Shtetit 6,666,667 lekë pa TVSh ose 8,000,000 lekë me TVSh;
- Për vitin 2025 – nga Buxheti i Shtetit 11,995,129 lekë pa TVSh ose 14,394,155 lekë me TVSh.
Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 9 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku Kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Kontrata e sipërpërmendur ka pasur Amendimin nr. 1, me nr. 2354 prot., datë 21.03.2025, në të cilën është përfshirë ndryshimi i afatit të punimeve deri më 26.04.2025, referuar kërkesës për shtyrje të afatit të punimeve nr. 378 prot., datë 18.03.2025. Punimet janë pezulluar ose ndërprerë më datë 21.11.2024, për shkak të zënies së sheshit nga banor i zonës dhe kanë rifilluar më datë 27.02.2025. Leja e infrastrukturës është miratuar me Vendimin 17 datë 04.10.2024, të Bashkisë Roskovec. Projekti parashikon ndërhyrjen në qytetin e Roskovecit, me shatërvane, hapsira të gjelbërta, trotuare, punime për amfiteatrin, sistemin e ujitjes, mobilimin urban dhe punime në fushën e sportit.
-Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata nr. 6682 prot., datë 23.08.2024, midis AK Bashkisë Roskovec dhe Kontraktorit BOE "A." & "L.-I." Shpk, përfaqësuar nga Ing. B.H dhe N.P., përfaqësuar nga OE "A."Shpk, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh 1997/4.
-Për kolaudimin e punimeve të është nënshkruar kontrata e shërbimit, midis AK dhe Kontraktorit "S." Shpk, përfaqësuar nga Ing. V.A., me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.
-Njoftimi i fillimit të punimeve nga kontraktori dhe mbikëqyrësi është realizuar me shkresën nr. 293 prot., datë 21.10.2024, ku përcaktohet se fillimi i punimeve është realizuar më datë 22.10.2024. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, miratohet nga palët datë 22.10.2024. Procesverbali i fillimit të punimeve është mbajtur nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi datë 22.10.2024. Punimet në objekt janë ndërprerë më datë 21.11.2024 dhe kanë rifilluar më datë 27.02.2025. Njoftimi i përfundimit u realizua me nr. 3334/1 prot., datë 25.04.2025 dhe procesverbali i përfundimit të punimeve nga mbikëqyrësi është me shkresën datë 25.04.2025, *brenda afateve kontraktuale*. Akti i kolaudimit është realizuar më datë 07.07.2025, dhe çertifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është realizuar me datë 15.07.2025.

-Kontrata përbëhet nga 3 situacione pjesore progresive, të cilat nuk janë shoqëruar me libreza masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005, *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"* Kreu II, pika 8.1; *"Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori"* dhe Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011, *"Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, të KM "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se: 3.3 *"Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave"*. Në dosjen teknike administrohet vetëm libreza e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar.

-Me kërkesën e mbikëqyrësit nr. 8639 prot., datë 04.11.2024, dhe të sipërmarrësit, njoftohet AK për disa ndryshime referuar situatës faktike në objekt. Përdorimi i fondit rezervë prej 5 % bazuar në azhornimin faktik dhe miratuar nga AK në tabelën e lëvizjeve të volumeve dhe me procesverbalin e ndryshimeve datë 23.04.2025.

II. Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i dosjes së objektit, situacionit përfundimtar, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave dhe nga verifikimi në terren datë 10.06.2026, u konstatuan disa parregullsi në deklarime të punime të realizuara me faktin, si më poshtë vijon:

1. Në kapitullin e punimeve për parkun, kap. I zëri nr. 1, nr. Anal. 3.89/a *"Gërmim dheu eskavator goma 0.25 m^3, në kanale gjerësi deri 2m, tokë zak, kat III, me shk në mjet"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 2,970 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 2,970 m^3. Llogaritja në librezën e masave pasqyrohet duke lloagritur sipërfaqet e të gjithë sheshit 3,241 m^2 + 910 m^2 + 802 m^2 = 4,953 m^2, me thellësi 50 cm. Ndërkohë në librezën e masave janë llogaritur shtese edhe sipërfaqe shtresës me pllaka betoni, nën njollën e amfiteatrit dhe podiumit të tij, njollën e shatërvanit, të cilat përfshihen në thellësitë e sipërfaqeve kryesore në të gjithë sheshin, si në tabelan e mëposhtme:

A	Germim dheu me eskavator 0.25 m3 shkakim mjet	Njesia	Gjatesi	Gjeresi	Lartesi	Sipf/Mes	Volumi L.M	Volumi Real	Diferenc
1		m3							
2	Njolla e siperfaqes se skarifikuar me h=50 cm eshte 3241 m2				0.5	3,241	1,621	1,621	-
3	Njolla e siperfaqes se skarifikuar me h=40 cm eshte 910 m2				0.4	910	364	364	-
4	Njolla e siperfaqes se skarifikuar me h=40 cm eshte 802 m2				0.4	802	321	321	-
5	Germim nen paketen e shtreses me pllaka betoni h=36cm				0.36	1,400	504		504.0
	Germim nen njollen e amfiteatrit				0.4	83	33		33.2
6	Germim nen njollen e podiumit te amfiteatrit				0.4	31	12		12.4
7	Germim nen njollen e shatervanit				0.4	95	38		38.0
8	Germim nen themelin e murit rrethues se shtepia		96.4	1.0	0.8		77	77	-
	Totali						**2,970**	**2,382**	**588**

Pra, njollat e sipërfaqeve të shtresës së pllakave, amfiteatrit dhe shatervanit me thellësi 0.36 m dhe 0.4 m, janë të përfshira në sipërfaqet e territorit. Gjithashtu në punimet e shatërvanit është llogaritur volum gërmimi 87.2 m^3 (0.8m x 109m). Rrjedhimisht konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht më tepër volumin prej **588 m^3** të nr. 1, nr. Anal. 3.89/a *"Gërmim dheu eskavator goma 0.25 m^3, në kanale gjerësi deri 2m, tokë zak, kat III, me shk në mjet"*, dhe me çmimin 150 lekë/ m^3, *rezulton vlera 88,200 lekë pa TVSh.*

2. Në kapitullin e punimeve për parkun, kap. I zëri zëri nr. 3 nr. anal 3.158/5a "*Transport materiale ndërtimi, dheu me audto deri 5 km*", në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 3,038 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas volumeve të gërmimit 3,038 m^3. Referuar zërit nr. 1 "*Gërmim dheu eskavator goma 0.25 m3, me shk në mjet*", ku është llogaritur sasi më tepër e gërmimit në volumin prej 588 m^3, rrjedhimisht transporti i këtij volumi është përfituar më tepër. Me çmimin përkatës prej 310 lekë/m^3, *rezulton se sipërmarrësi ka përfituar më tepër vlerën prej 182,280 lekë pa TVSH.*

3. Në kapitullin e punimeve për fushën e sportit, punime shtresa, zëri nr. 6 "Shtresë gome ***1.2 cm*** + primer" në sasinë 558 m^2 me çmimin 1,000 lekë/m^2 dhe vlerën 558,000 lekë, u konstatua se nuk ishte realizuar në fushën sportive por ishte realizuar vetëm shtresa e taratanit, pasi të dyja shtresat rezultonin të ngjitura me njëra-tjetrën. Pra direkt pas betonit të fushës ishte ngjitur vetëm shtresa e taratanit dhe nuk ishte realizuar shtresa e gomës. Rrjedhimisht *rezulton se sipërmarrësi ka përfituar më tepër vlerën prej 558,000 lekë pa TVSH.*

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet vlera e likuiduar më tepër tepër **828,480 lekë pa Tvsh** (*558,000 + 182,280 + 88,200)* **e përfituar më tepër nga sipërmarrësi,** për mos llogaritje të sakta të volumeve dhe për punime të pa realizuara.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
- Mbikqyrësi i punimeve Ing.B.H. nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore dhe detyrimet kontraktuale të kontratës së shërbimit nr. 6682 prot., datë 23.08.2024, dhe Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: *Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat me kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.*

Në lidhje me observacionet e dërguara nga Mbikëqyrësi i punimeve OE "A." sh.p.k., me shkresën të protokolluara në KLSH me nr. 293/10 prot., datë 17.08.2026; shprehen pretendimet e tyre për projekt raportin e auditimit për objektin e mësipërm.
Pretendimi i subjektit përmbledhurazi: *Në lidhje Projekt Raportin e auditimit ju paraqesim observacionin tonë në vijim:*
- Në lidhje me volumet e gërmimeve sqarohet se ato janë realizuar për të krijuar arritjen e kuotave sipas projektit dhe uniformitetit të kuotave me ato të rrugës kryesore. Më pas mbi sipërfaqet e gërmimit është vendosur shtresa e pllakave të betonit për shkak se kuotat e kësaj sipërfaqe është më e lartë se ajo e pllakave të trotuarit. Pra sipërfaqa nën gjurmën e pllakave është gërmuar 50 cm + 36 cm =85 cm në zonën 1, në zonën 2 dhe 3 është 40+36 cm.
- Në lidhje shtresën e gomës, sipërmarrësi ka realizuar vendosjen e shtresës së gominës dhe të tartanit sipas të gjithë kushteve teknike dhe specifikimeve teknike. Nqs shtresa e gominës nuk do të ishte vendosur, atëherë edhe shtresa e tartanit nuk vendosej dot teknikisht pasi nuk sigurohej dot lidhja me shtresën e betonit. Bashkëlidhur ndodhen foto të punimeve ku tragohet procesi i vendosjes së gominës ngjyrë e zerë dhe primerit ngjyrë jeshile.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar argumentimeve dhe komenteve të bëra nga *Mbikëqyrësi OE "A." sh.p.k., në projekt raportin e auditimit, sqarojmë se observacioni është i njëjtë me observacionet e akt-konstatimit nr. 11 dhe trajtimi i tyre është njësoj si në projekt raport ku sqarojmë se:*
- Në lidhje me volumet e gërmimeve dhe kuotat e terrenit për të arritur thellësitë e nevojshme bashkëlidhur observacionit nuk është paraqitur rilevim topografik fillestar dhe azhurnuar ku të përcaktoheshin kuotat e tokës në mënyrë që të përllogaritej saktë volumi i gërmimit dhe nuk mund të merret në konsideratë.
- Në lidhje me shtresën e gomës dhe shtresën e tartarit, pavarësisht se pretendohet se janë realizuar sipas specifikimeve teknike, grupi i auditimit vlerëson se duhet një analizë në terren për saktësimin përfundimtar të këtij konstatimi në përputhje me specifikimet teknike të fushës së sportit.

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin ***"Kompleksi i Terreneve Sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën "5 Dëshmorët", Suk 1"*** viti 2024, konstatohet se:

A. Të dhëna mbi objektin:

a. Zbatimi kontratës "*Kompleksi i Terreneve Sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën "5 Dëshmorët", Suk 1",* Bashkia Roskovec viti 2024		
1. Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatimi punimesh me nr. 6510 prot., datë 19.08.2024, midis Bashkisë Roskovec dhe Kontraktorit OE "Z K" Shpk	**2.Vlera e kontratës (me TVSh):** 39,711,166 lekë	**3. Leje Infrastrukture-po** Nr. 17 datë 13.09.2024

4. Situacionet dhe likuidimet : Faturë Pune me volume 39,706,548 lekë	**5. Afati i kontratës në muaj:** Parashikuar: 8 muaj nga fillimi i punimeve Fillimi i punimeve: Datë 17.09.2024 Përfundimi i punimeve sipas kontratës dhe amendimit, Datë 16.06.2025	**6. Zgjatja e kontratës-po** Amendim kontrate 1 nr. 3791 prot., datë 14.05.2025 30 ditë shtyrje të afatit përfundimi i punimeve më 16.06.2025.
4.1 Garancia e punimeve **12 Muaj**		
7. Mbikëqyrësi i punimeve: Kontratë mbikëqyrje nr. 6682 prot., datë 23.08.2024, midis AK Bashkisë Roskovec dhe BOE "A." & "L-I" Shpk, përfaqësuar nga Ing. B.H dhe N.P.	**8. Licensa** MK.....	**9. Vlera e kontratës me TVSh.** Vlera 3,429,335 lekë për 5 objekte ndërtimore
10. Kolaudatori i punimeve: Kontratë shërbimi kolaudimi, midis AK Bashkisë Roskovec dhe OE "S." Shpk, përfaqësuar nga Ing. V.A.	**11.** Licensa MK.....	**12.** Procedurë "Blerje e vogël"
13. Akt Kolaudimi	30.07.2025	
14. Akt marrje në dorëzim-po	07.08.2025	

I. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 6510 prot., datë 19.08.2024, midis AK Bashkisë Roskovec dhe Kontraktorit OE "Z. K." Shpk. Vlera e kontratës është 39,711,166 lekë me TVSh. Financimi i projektit është realizuar nga fondet e deleguara nga Ministria e Arsimit.

Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 11 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku Kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Kontrata ka pasur Amendimin nr. 1, me nr. 3791 prot., datë 14.05.2025, në të cilën është përfshirë ndryshimi i afatit të punimeve prej 30 ditësh deri më 16.06.2025. Leja e infrastrukturës është miratuar me Vendimin 17 datë 13.09.2024, të Bashkisë Roskovec. Projekti parashikon sistemimin e kompleksëve sportive në fshatin Suk1, ku përfshihen punime në fushën e jashtme, në minifushën e shkollës, në palestrën e shkollës dhe ndërtimi i një godine një katshe. Në dokumentet e tenderit, formularin e ofertës dhe ofertën e paraqitur nga OE është parashikuar zë punimi/shërbimi i vecantë "*Mirëmbajtje e punimeve për 2 vite 2 %*" në vlerën 648,800 lekë pa TVSh, e cila është e paargumentuar apo e specifikuar se cfarë do të përfshihet në mirëmbajtje e objektit etj. Vetë garancia e punimeve sipas kontratës është për 12 muaj në masën 5% dhe vlerën 1,985,327 lekë sipas kontratës likuidohet pas peridhuës së garancisë.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata nr. 6682 prot., datë 23.08.2024, midis AK Bashkisë Roskovec dhe Kontraktorit BOE "A." & "L.-I." Shpk, përfaqësuar nga Ing. B.H dhe N.P., përfaqësuar nga OE "A."Shpk, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh 1997/4.
- Për kolaudimin e punimeve të është nënshkruar kontrata e shërbimit, midis AK dhe Kontraktorit "S." Shpk, përfaqësuar nga Ing. V.A., me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.

- Njoftimi i fillimit të punimeve nga kontraktori dhe mbikëqyrësi është realizuar me shkresën nr. 741 prot., datë 17.09.2024, ku përcaktohet se fillimi i punimeve është realizuar më datë 17.09.2024. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, miratohet nga palët datë 17.09.2024. Procesverbali i fillimit të punimeve është mbajtur nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi datë 17.09.2024. Njoftimi i përfundimit u realizua më datë 16.06.2025 dhe procesverbali i përfundimit të punimeve nga mbikëqyrësi është me shkresën datë 16.06.2025, *brenda afateve kontraktuale*. Akti i kolaudimit është realizuar më datë 30.07.2025, dhe çertifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është realizuar me datë 07.08.2025.
- Kontrata përbëhet nga 3 situacione pjesore progresive, të cilat nuk janë shoqëruar me libreza masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005, *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"* Kreu II, pika 8.1; *"Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori"* dhe

Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011, *"Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, të KM"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se: 3.3 *"Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të KM"*. Në dosjen teknike administrohet vetëm libreza e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar. Me kërkesën e mbikëqyrësit nr. 7828 prot., datë 02.10.2024, dhe të sipërmarrësit, njoftohet AK për disa ndryshime referuar situatës faktike në objekt. Me procesverbalin datë 06.11.2024, miratohen nga palët ndryshimet e nevojshme të projekti bazuar në azhornimin faktik dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor në tabelën e lëvizjeve të volumeve.

II. Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i dosjes së objektit, situacionit përfundimtar, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave dhe nga verifikimi në terren datë 10.06.2026, u konstatuan disa parregullsi në deklarime të punime të realizuara me faktin, si më poshtë vijon:

1. Referuar kontratës së punimeve, dokumenteve të tenderit, formularin e ofertës të paraqitur nga OE është parashikuar zë shërbimi/pune i vecantë "*Mirëmbajtje e punimeve për 2 vite 2 %*" në vlerën 648,800 lekë pa TVSh, e cila është e paargumentuar apo e specifikuar se cfarë përfshihet në kontratën e punimeve si zë më vehte, kur vetë garancia e punimeve për 12 muaj në masën 5% dhe vlerën 1,985,327 lekë sipas kontratës likuidohet pas peridhuës së garancisë.
Në situacionin përfundimtar është llogaritur vlerat si më poshtë:
- Shuma për nënobjektet në vlerën = 32,439,990 lekë pa TVSh
- Mirëmbajtje e punimeve për 2 vite 2% = **648,800** lekë pa TVSh
- Shuma = 33,088,790 lekë pa TVSh
- TVSH 20% = 6,617,758 lekë
- Shuma Totale = 39,706,548 lekë me TVSH
- Zbritet garancia 5% = 1,985,327 lekë me TVSh

Vlera e likuiduar progresive e situacionit përfundimtar = 37,721,221 lekë me TVSH.
Pra, sa më sipër kontatohet se zëri "*Mirëmbajtje e punimeve për 2 vite 2%*", është në kundërshtim me termat e referencës së punëve, kontratën e punimeve nr. 6510 prot., datë 19.08.2024 dhe i paargumentuar përdorimi dhe likuidimi e këtij zëri punimi apo i quajtur si shërbim, ku pas përfundimit të punimeve investimi i kalon përfituesit ose investitorit Bashkisë Roskoves apo Shkollës.
Për veprimin e mësipërm, është shkelur koncepti i "*Begatimit pa shkak*", i ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të Dokumenteve të Tenderit, realizuar nga Bashkia Roskovec, me përfitues padrejtësisht operatorin ekonomik "Z. K." shpk, në vlerën ***648,800 lekë,*** referuar Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 655 "*Begatimit pa shkak*", ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: "*Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të begatimit". Për pasojë vlera* ***648,800 lekë pa TVSH, përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Bashkisë Roskovec*** *dhe duhet të dëmshpërblehet nga operatori ekonomik "2Z konstruksion". Dëmshpërblimi mbështet në Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 655 dhe neni 32.* Gjithahtu referuar edhe kushteve të kontratës nr. 6510 prot., datë 19.08.2024, neni 2 "*Sigurimi i kontratës*" të kushteve të vecanta të kontratës është përcaktuar se periudha e garancisë është **1 (një)** vit, rrjedhimisht mirëmbajtja për 2 vite sjellë përsëri konfuzion dhe paqartësi në likuidimin e zërit të punimit, si zë pune në përfitim të padrejtë të sipërmarrësit. Referuar kushteve të kontratës, neni 9 i kontratës së punimeve "Realizimi i punimeve" citon se: "*Realizimi i të gjitha punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, terma reference apo*

detyre projektimi, nëse është rasti, si dhe shërbimet e lidhura me to, do të jenë në përputhje me kërkesat e spacifikuara në dokumentet e tenderit dhe me standardet teknike në fuqi". Neni 10 i kontratës së punimeve "Përgjegjësitë e Kontraktorit" citon se: "*Kontraktori do të jetë përgjegjës për realizimin e të gjitha punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, terma reference apo detyrë projektimi, nëse është rasti si dhe shërbimet e lidhura me to të përfshira në objektin e kontratës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DT, si dhe standardet teknike në fuqi*".

2. Në kapitullin e punimeve të gërmimit dhe murature, zëri nr. 1, nr. Anal. 2.64/2 "*Mure me tulle plota në lartësi deri 3m*", në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 23 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 23 m^3 . Sipas llogaritjeve në librezën e masave janë llogaritur muret me tullë 20 cm (Muri perimetral L= 41.84 m, muret e brendshme dhe janë zbritur kollonat 9 copë, dyra hyrjes, dritaret). Nga verifikimi i librezës së masave për këtë zë punimi, konstatohet se nuk janë përllogaritur zbritjet e volumit të "*Trarëve e arkitrarëve b/a C20/25*" (zëri nr. 3, kap. Punime betoni). Llogaritja e brezave të betonit është në në trarët në kuotën +0.00, arkitratë dritaresh dhe dyersh me një volum total prej 9 m^3, *e cila duhej zbritur nga sasia 23 m^3*, e zëri nr. 1, nr. Anal. 2.64/2 "*Mure me tulle plota në lartësi deri 3m*". Rrjedhimisht sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht volumin prej **9 m^3** "*Ndërtim mure tulle*" dhe me çmimin përkatës 16,000 lekë/m^3, *rezulton vlera 144,000 lekëpa TVSH*.
3. Në kapitullin e punimeve të gërmimit dhe murature, zëri nr. 5, nr. Anal. 2.295 "*Tavan rrjet teli + suva*", në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 65 m^2 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 65 m^2. Nga verifikimi në objekt, u kontatua se "tavani me rrjete teli + suva", nuk është realizuar dhe është i mbivendosur zërit nr. 4, nr. anal 2.300 "*Suva solete h-4m me drejtues me krahë*", pasi soleta monolite b/a C 20/25 t=17 cm e objektit "Risport" është suvatuar nëpërmjet zërit nr. 4. Gjithashtu llogaritjet e volumit në librezën e masave të zërit nr. nr. 4, nr. anal 2.300 "*Suva solete h-4m me drejtues me krahë*" është përllogaritur e gjithë sipërfaqa e taracës 83.1 m^2, ndërkohë kur tavani me rrjetë teli është llogaritur në ambientet nga 1-7 në sipërfaqen 65 m^2. Rrjedhimisht sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht volumin prej **65 m^2** "*Tavan rrjet teli + suva*" dhe me çmimin përkatës 1,500 lekë/m^2, *rezulton vlera 97,500 lekëpa TVSH*.

4. Në kapitullin e nënobjektit 4 "Punimet për dhomat e zhveshjes" punime ndërtimore, zëri nr. 6, nr. Anal. 2.67/1 "*Mure tulle të plota bulme 12 cm, h=3 m*", në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 32.9 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 32.9 m^3 . Sipas llogaritjeve në librezën e masave janë llogaritur muret me tullë 29 cm – 46 cm (Muri i gjatë, muri kufizues i shkallëve dhe nuk janë zbritur kollonat dhe trarë e arkitrarë). Nga verifikimi i librezës së masave për këtë zë punimi, konstatohet se nuk janë përllogaritur zbritjet e volumit të "*Kollonave dhe Trarëve e arkitrarëve b/a C20/25*". Llogaritja e kollonave dhe brezave të betonit është me një volum total prej 5.5 m^3 (2.9 m^3 + 2.6 m^3), *e cila duhej zbritur nga sasia 32.9 m^3*, e zëri nr. 6, nr. Anal. 2.67/1 "*Mure tulle të plota bulme 12 cm, h=3 m*". Rrjedhimisht sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht volumin prej **5.5 m^3** "*Ndërtim mure tulle*" dhe me çmimin përkatës 16,000 lekë/m^3, *rezulton vlera 88,000 lekëpa TVSH*.
Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet vlera e likuiduar më tepër tepër **978,300 lekë pa Tvsh** (*88,000 + 97,500 + 144,000 + 648,800)* **e përfituar më tepër nga sipërmarrësi,** për mos llogaritje të sakta të volumeve dhe për punime të pa realizuara.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- Mbikqyrësi i punimeve Ing.B.H. nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore dhe detyrimet kontraktuale të kontratës së shërbimit nr. 6682 prot., datë 23.08.2024, dhe Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: *Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat me kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.*

Në lidhje me observacionet e dërguara nga Mbikëqyrësi i punimeve OE "A." sh.p.k., me shkresën të protokolluara në KLSH me nr. 293/11 prot., datë 17.08.2026; shprehen pretendimet e tyre për projekt raportin për objektin e mësipërm.

Pretendimi i subjektit përmbledhurazi: *Në lidhje me projekt raportin e auditimit ju paraqesim observacionin tonë në vijim:*
- Në lidhje zërin "Mirëmbajtje e punimeve për 2 vite 2%, sqarohet se është përfshirë në ofertën e tenderuar nga AK dhe nuk është në kushtet e VKM nr. 610 datë 22.09.2022, neni 23, për miratimin e fondit rezervë dhe nuk mund të zbritej nga formati i paraqitur në tender. Pas marrjes përfundimtare në dorëzim do të realizohet akt marrëveshje për mirëmbajtje objekti 2 vite të tjera dhe po mos të likuidohej ky zë punimi nga AK do të detyrohej që fondet e kërkuara për mirëmbajtje do të merreshin nga Buxheti i Bashkisë. Në lidhje me zërat e tjerë, pranohen pasaktësitë.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar argumentimeve dhe komenteve të bëra nga *Mbikëqyrësi OE "A." sh.p.k., në projekt raportin e auditimit, sqarojmë se observacioni është i njëjtë me observacionet e akt-konstatimit nr. 12 dhe trajtimi i tyre është njësoj si në projekt raport ku sqarojmë se:*
- Në lidhje zërin e mirëmbajtjes sqarojmë se argumentimi është i pamjaftueshm ligjërisht dhe teknikisht. Pra observacioni i sjella nuk është shoqëruar me fakte dhe argumente bindëse ato nuk kanë mbështetje teknike – ligjore, rrjedhimisht nuk do të merren në konsideratë.

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin ***"Mbrojtje nga lumi Seman në krahun e majtë zona Suk Bashkia Roskovec"*** viti 2024, konstatohet se:

A. Të dhëna mbi objektin:

a. Zbatimi kontratës "*Mbrojtje nga lumi Seman në krahun e majtë zona Suk" Bashkia Roskovec* viti 2024		
1. Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatimi punimesh me nr. 6894 prot., datë 02.09.2024, midis Bashkisë Roskovec dhe Kontraktorit BOE "B."& "Ll." Shpk, përfaqësuar nga "B."shpk	**2.Vlera e kontratës (me TVSh):** 34,984,098 lekë	**3. Leje Infrastrukture-po** Nr. 16 datë 12.09.2024
4. Situacionet dhe likuidimet : Faturë Pune me volume 34,984,098 lekë	**5. Afati i kontratës në muaj:** Parashikuar: 4 muaj nga nënshkrimi i kontratës Fillimi i punimeve: Datë 26.09.2024 Përfundimi i punimeve sipas kontratës, Datë 24.01.2025	**6. Zgjatja e kontratës-jo** Brenda afateve kontraktuale
4.1 Garancia e punimeve 12 Muaj		
7. Mbikëqyrësi i punimeve: Kontratë mbikëqyrje nr. 7616 prot., datë 24.09.2024, midis AK Bashkisë Roskovec dhe OE "M.P.", përfaqësuar nga Ing. M.A.	**8. Liçensa** MK.....	**9. Vlera e kontratës me TVSh.** Vlera 1,102,080 lekë
10. **Kolaudatori i punimeve:** Kontratë shërbimi kolaudimi, midis AK Bashkisë Roskovec dhe OE "A." Shpk, përfaqësuar nga Ing. B.H.	**11.** Liçensa MK.	**12.** Procedurë "Blerje e vogël"
13. Akt Kolaudimi	14.07.2025	
14. Akt marrje në dorëzim-po	02.09.2025	

I. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 6894 prot., datë 02.09.2024, midis AK Bashkisë Roskovec dhe Kontraktorit BOE "B."& "L." Shpk, përfaqësuar nga "B."shpk. Vlera e kontratës është 34,984,098 lekë me TVSh. Financimi i projektit është realizuar nga fondet e Bashkisë Roskovec, i ndarë në vite si më poshtë vijon;
- Për vitin 2024 – nga Buxheti i Shtetit 14,966,589 lekë pa TVSh ose 17,959,907 lekë me TVSh;
- Për vitin 2025 – nga Buxheti i Shtetit 14,186,826 lekë pa TVSh ose 17,024,191 lekë me TVSh.
Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 11 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Referuar dokumenteve tëdokumenteve të tenderit dhe nenit 9 të KVK "Lloji i kontratës" është përcaktuar se kontrata është me cmim njësie bazuar në cmimet e njësisë të shprehura në preventivin njësi, ku sipas DT citohet;
"*Preventiv per njesi*" *do të thotë volumet e punës të dhena në projekt shoqëruar me cmimet për njësi* ***<u>të pandryshuara</u>*** *që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje*. Bashkëlidhur kontratës së punimeve nr. 6894 prot., datë 02.09.2024, është bashkëlidhur edhe oferta fituese e BOE "B."& "L." Shpk, me njësitë dhe sasitë e përaktuara në dokumentet e tenderit. Referuar dokumentacionit të procedurës prokuruese me REF-11556-06-28-2024, AK ka hedhur në SPE, formularin e ofertës si më poshtë:

		A. Mbrojtje ne zonen Suk - Hoxhenj	Njesia	Sasia
1	3-160 a	Germim e transport dheu per skarifikim trupit te argjinatures ekzistuese ne zonat e dömtuara.	m3	162
2	3-47/1a	Mbushje e ngjeshje me dhè (me shtresa 30 cm te nje perzjerje 30% argjil e 70 % çakull e zhavor) per riparimin e argjinatures nö zonat e çara (ne forme rampash, shih detajin) perfshi dhe rakordimet me argjinaturen	m3	324.8
3	3-161/1	Rrafshim skarpate ne germim per trupin e rampave, pas mbushjes	m2	522
4	An 1	Ndertim peneli mbrojtes TIP me L = 33.5 ml , me blloqe betoni e rrjet gabioni special, mbi skoliere me gure kave masiv, pozicioni nr 2 dhe pozicioni 7 (analize)	**cope**	2
5	An 2	Idem, peneli mbrojtes TIP me L=35.5, ne pozicionin 3 (analize)	**cope**	1
6	An 3	Ndertim peneli mbrojtes TIP me L = 37.5 ml , me blloqe betoni e rrjet gabioni special, mbi skoliere me gure masiv, në pozicionin nr 8 - 8 (analize)	**cope**	1
7	3-102/b	Germime me eskavator per punime devijimi te pjeseshme	m3	806.6
		Shuma A		
		B. Mbrojtje ne zonen Suk - Agaçaj		
1	3-160 a	Germim e transport dheu per skarifikim trupit te argjinatures ekz.ne zonat e çara	m3	89
2	3-47/1a	Mbushje e ngjeshje me dhè (me shtresa 30 cm ngjeshje me tokmak elektrik) per riparimin e argjinatures nö zonat e çara (ne forme rampash, shih detajin) perfshi dhe rakordimet me argjinaturen	m3	123.8
3	3-161/	Rrafshim skarpate ne germim per trupin e rampave, pas mbushjes	m2	236
4	An 4	Ndertim peneli mbrojtes TIP me L =32.5; h=3.5m , me blloqe betoni e rrjet gabioni special, mbi skoliere me gure (shih analizen)	**cope**	1
5	An 5	Idem me L =38.5 m (shih analizen)	**cope**	1
6	An 6	Idem me L = 34.5m (shih analizen)	**cope**	1
7	3-102/b	Germime me eskavator per punime devijimi te pjeseshme	m3	723.02
		Shuma B		
		C Punime per permiresimin e pjeseshem te rrugëve në të dyja zonat e ndertimit		
1	3-160	Germim e transport dheu per skarifikim trupit te rrugeve qe do te trajtohen	m3	482
2	3-47/	Mbushje e ngjeshje me shtrersa per trasetë e rrugëve	m3	45.2
3	3-45/1	Germim dheu me krah per kanalet anesor	m3	24.4
		Germim dheu me makineri per kanalet anesor	m3	206.6
4	3-209	Ndertim shtrese cakelli me mbeturina kave me makineri t=10 cm,	m2	4920
5	3-212/	Shtrese stabilizanti t= 5 cm granil + 10 % argjil, perfshi edhe bankinen nga nje ane me b= =0.5m	m2	4920
6	An	Shtresë me rere bituminoze t = 10 cm	m2	4305
		SHUMA C		
		SHUMA A + B +C		
		Fondi Rezerve 1.5 %		
		Shuma		
		TVSH 20 %		
		Shuma Totale		

Gjithashtu nga BOE është dhënë lista e cmimeve sipas zërave të punimeve më datë 30.07.2024, si më poshtë:

NR	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA
		A. Mbrojtje ne zonen Suk - Hoxhenj				
1	3-160 a	Germim e transport dheu per skarifikim trupit te argjinatures ekzistuese ne zonat e dömtuara.	m3	162	250	40,500
2	3-47/1a	Mbushje e ngjeshje me dhè (me shtresa 30 cm te nje perzjerje 30% argjil e 70 % çakull e zhavor) per riparimin e argjinatures nö zonat e çara (ne forme rampash, shih detajin) perfshi dhe rakordimet me argjinaturen	m3	324.8	350	113,680
3	3-161/1	Rrafshim skarpate ne germim per trupin e rampave, pas mbushjes	m2	522	150	78,300
4	An 1	Ndertim peneli mbrojtes TIP me L = 33.5 ml , me blloqe betoni e rrjet gabioni special, mbi skoliere me gure kave masiv, pozicioni nr 2 dhe pozicioni 7 (analize)	cope	2	3500000	7,000,000
5	An 2	Idem, peneli mbrojtes TIP me L=35.5, ne pozicionin 3 (analize)	cope	1	3560000	3,560,000
6	An 3	Ndertim peneli mbrojtes TIP me L = 37.5 ml , me blloqe betoni e rrjet gabioni special, mbi skoliere me gure masiv, në pozicionin nr 8 - 8 (analize)	cope	1	3600000	3,600,000
7	3-102/b	Germime me eskavator per punime devijimi te pjeseshme	m3	806.6	300	241,980
		Shuma A				14,634,460

Pjesë e ofertës së sipërmarrësit fitues

		C Punime per permiresimin e pjeseshem te rrugëve në të dyja zonat e ndertimit				
1	3-160 a	Germim e transport dheu per skarifikim trupit te rrugeve qe do te trajtohen	m3	482	200	96,400
2	3-47/1a	Mbushje e ngjeshje me shtrersa per trasetë e rrugëve	m3	45.2	300	13,560
3	3-45/1	Germim dheu me krah per kanalet anesor	m3	24.4	300	7,320
		Germim dheu me makineri per kanalet anesor	m3	206.6	200	41,320
4	3-209	Ndertim shtrese cakelli me mbeturina kave me makineri t=10 cm,	m2	4920	260	1,279,200
5	3-212/b	Shtrese stabilizanti t= 5 cm granil + 10 % argjil, perfshi edhe bankinen nga nje ane me b= =0.5m	m2	4920	150	738,000
6	An	Shtresë me rere bituminoze t = 10 cm	m2	4305	600	2,583,000
		SHUMA C				**4,758,800**
		SHUMA A + B +C				**28,722,576**
		Fondi Rezerve 1.5%				**430,839**
		Shuma				**29,153,415**
		TVSH 20 %				**5,830,683**
		Shuma Totale				**34,984,098**

ënshkrimi i ofertuesit _____
ula
hënim:Çmimet duhet të shprehen në Monedhën (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Pjesë e ofertës së sipërmarrësit fitues

Leja e infrastrukturës është miratuar me Vendimin 16 datë 12.09.2024, të Bashkisë Roskovec. Projekti parashikon mbrojtjen nga lumi Seman, duke ndërtuar panele mbrojtëse.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata nr. 7616 prot., datë 24.09.2024, midis AK Bashkisë Roskovec dhe OE "M.P.", përfaqësuar nga Ing. M.A., me licensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.
- Për kolaudimin e punimeve të është nënshkruar kontrata e shërbimit, midis AK dhe Kontraktorit "A." Shpk, përfaqësuar nga Ing. B.H, me licensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.

- Njoftimi i fillimit të punimeve nga kontraktori dhe mbikëqyrësi është realizuar datë 26.09.2024, ku përcaktohet se fillimi i punimeve është realizuar më datë 26.09.2024. Procesverbali i fillimit të punimeve është mbajtur nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi datë 26.09.2024.

Njoftimi i përfundimit u realizua me nr. 625 prot., datë 27.01.2025 dhe procesverbali i përfundimit të punimeve nga mbikëqyrësi është me shkresën datë 24.01.2025, *brenda afateve kontraktuale*. Akti i kolaudimit është realizuar më datë 14.07.2025, dhe çertifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është realizuar me datë 02.09.2025.

- Kontrata përbëhet nga 2 situacione pjesore progresive, të cilat nuk janë shoqëruar me libreza masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005, *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"* Kreu II, pika 8.1; *"Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori"* dhe Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011, *"Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, 3.3 ku

përkatësisht përcaktohet se: 3.3 *"Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të KM"*. Në dosjen teknike administrohet vetëm libreza e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar.

- Me kërkesën e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit nr. 7827/2 prot., datë 01.11.2024, kërkohet përdorimi i fondit rezervë tek zëri nr.8 "*Shtresë asfaltobetoni me zall lavatrice, 5 cm, me makineri*", në sasinë shtesë prej 381 m2, me cmimin përkatës 1,130 lekë/m2 dhe vlerë 430,839 lekë pa TVSh, e cila është miratuar nga Bashkia Roskovec me procesverbalin e mbajtur nga palët datë 01.11.2024.

II. Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i dosjes së objektit, situacionit përfundimtar, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave, u konstatua parregullsi në deklarime të çmimeve të ofertuara, si më poshtë vijon:

1. Referuar kontratës së punimeve, dokumenteve të tenderit, formularin e ofertës dhe situacionin përfundimtar të paraqitur nga OE, konstatohet se janë ndryshuar çmimet e zërave të punimeve në mënyrë të paargumentuar në kundërshtim me kontratën nr. 6894 prot., datë 02.09.2024 dhe nr.162/2020 "*Për PP*", i ndryshuar nenet 1, 2 neni 2 pika d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; Neni 3 pika 1 të këtij ligji *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.* Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, ndaj dhe të gjithë ofertuesit duhet të paraqesin ofertën e tyre në përputhje me këto dokumenta.
Sasitë dhe njësia matëse, *është element i rëndësishëm i preventivit të ofertës ekonomik për procedurën objekt prokurimi, përvec faktit që është një elemet i detyrueshëm i përcaktuar në DST nga autoriteti kontraktor, modifikimi i tij përbën mospërgatitjen e ofertës sipas përcaktimeve të dhëna në dokumentat e tenderit, duke e kthyer ofertën ekonomike në një ofertë të pavlefshme*. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me dokumentat e tenderit duhet të refuzohen si të papranueshme. Ky gjykim bazohet dhe në vendimin e KPP i cili është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit publik, koncesioneve/partneritetit publik privat, ankandeve publike dhe procedurave konkurruese të dhënies së lejeve minerare, organ i krijuar me Ligjit Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar". K.P.P. 550/2020. Gjithashtu në kundërshtim edhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, ***ku ndryshimi i çmimit nuk miratuar në asnjë moment nga AK Bashkia Roskovec.*** Më poshtë paraqitet tabela e ndryshimit të çmimit nga oferta në situacionin përfundimtar.

			Preventivi Ofertues				**Situacioni Perfundimtar**			**Dif. Cmimi (2)-(1)**
N	Nr Anal	Zerat e Punes	Njesia	Sasia	Cmimi (1)	Vlera	Sasia	Cmimi (2)	Vlera	
		A. Mbrojtje ne zonen Suk - Hoxhenj								
4	An 1	Ndertim peneli mbrojtes TIP me L = 33.5 ml , me blloqe betoni e rrjet gabioni special, mbi skoliere me gure kave masiv, pozicioni nr 2 dhe pozicioni 7 (analize)	**cope**	2	3,500,000	7,000,000	1	3,603,880	3,603,880	103,880
5	An 2	Idem, peneli mbrojtes TIP me L=35.5, ne pozicionin 3 (analize)	**cope**	1	3,560,000	3,560,000	1	3,676,780	3,676,780	116,780
6	An 3	Ndertim peneli mbrojtes TIP me L = 37.5 ml , me blloqe betoni e rrjet gabioni special, mbi skoliere me gure masiv, në pozicionin nr 8 - 8 (analize)	**cope**	1	3,600,000	3,600,000	1	3,632,850	3,632,850	32,850

		B. Mbrojtje ne zonen Suk - Agaçaj								
4	An 4	Ndertim peneli mbrojtes TIP me L =32.5; h=3.5m , me blloqe betoni e rrjet gabioni special, mbi skoliere me gure (shih analizen)	**cope**	1	3,000,000	3,000,000	1	3,301,510	3,301,510	301,510
5	An 5	Idem me L =38.5 m (shih analizen)	**cope**	1	3,020,000	3,020,000	1	3,409,170	3,409,170	389,170
6	An 6	Idem me L = 34.5m (shih analizen)	**cope**	1	3,010,000	3,010,000	1	3,350,700	3,350,700	340,700
										1,284,890

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi, se vlera e likuiduar më tepër në kundërshtim me kontratën e punimeve, legjislacionin e prokurimit publik dhe K.C të Republikës së Shqipërisë, është në vlerën **1,284,890 lekë pa Tvsh e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi,** për ndryshime të kushteve kontraktuale.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- Mbikqyrësi i punimeve Ing. M.A. nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore dhe detyrimet kontraktuale të kontratës së shërbimit nr. 6682 prot., datë 23.08.2024, dhe Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: *Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat me kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.*

5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, periudha 01.01.2024 – 31.12.2025.

- Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.
- Auditimi mbi përllogaritjen dhe arkëtimin e taksave për pajisje me leje ndërtimi.

Bashkia Roskovec ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor me Vendimin e **KKT-së Nr.4, datë 10.06.2020**, i cili shërben si bazë për shqyrtimin e lejeve të ndërtimit së bashku me Rregulloren Vendore të miratuar, si dhe në referencë të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, për "*Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", të ndryshuar, të Ligjit nr. 107/ 2014, datë 31.07.2014, për "*Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", të ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, " *Për Sistemin e Taksave Vendore*", i ndryshuar.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. *Dhënia e lejes së zhvillimit dhe përputhshmëria me kondicionet urbane të përcaktura sipas Planit të Përgjithshme Vendore dhe Planeve të Detajuara Vendore;*
2. *Dhënia e lejes së ndërtimit, plotësimi i të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e lejes, përputhshmëria me kondicionet urbane të përcaktura dhe me lejen e zhvillimit;*
3. *Saktësia e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë;*
4. *Dhënia e çertifikatës së përdorimit;*

<u>-Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit të miratuara për përiudhën 2024 – 2025</u>

Referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nga DPZHT të Bashkisë Roskovec, dhe në bazë të sistemit e-leje, gjatë periudhës 01.01.2024 deri më 31.12.2025 janë miratuar **3 leje** ndërtimi (ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2), **1 leje** ndërtimi (shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2), **7 leje** ndërtimi (ndërtim të ri me siperfaqe deri në 250 m^2), **79 leje** infrastrukture, **32 deklarata** paraprake për kryerje punimesh dhe **6 çertifikata përdorimi**, të pasqyruara në tabelën nr. 1, si vijon.

Tabela nr. 1. *<u>Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2025 nga sistemi e-Leje</u>*

Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2025 nga sistemi e-Leje			
Viti 2024			
Nr.	**Përshkrimi i lejes**	**Numri i aplikimeve**	**Numri i miratimeve**
1	Certifikatë përdorimi	**4**	**3**
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	**20**	**18**
3	Leje infrastrukture	**14**	**14**
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me siperfaqe deri në 250 m^2	**8**	**5**
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	**-**	**-**
6	Leje për ndryshim funksioni	**1**	**0**
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	**-**	**-**
8	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	**-**	**-**
9	Leje përshtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	**-**	**-**
10	Leje rindërtimi,rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	**-**	**-**
11	Leje zhvillimi	**7**	**6**
12	Njoftim për fillim punimesh	**2**	**2**
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	**-**	**-**
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m^2	**-**	**-**
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me siperfaqe më të madhe se 250 m^2	**3**	**2**
16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	**-**	**-**
17	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	**-**	**-**
Viti 2025			
Nr.	**Përshkrimi i lejes**	**Numri i aplikimeve**	**Numri i miratimeve**
1	Certifikatë përdorimi	**6**	**3**
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	**18**	**14**
3	Leje infrastrukture	**66**	**65**
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me siperfaqe deri në 250 m^2	**2**	**2**
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	**-**	**-**
6	Leje për ndryshim funksioni	**1**	**1**
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	**-**	**-**
8	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	**-**	**-**
9	Leje përshtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	**-**	
10	Leje rindërtimi,rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	**-**	**-**
11	Leje zhvillimi	**9**	**5**
12	Njoftim për fillim punimesh	**1**	**1**
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	**-**	**-**
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m^2	**-**	**-**
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me siperfaqe më të madhe se 250 m^2	**1**	**1**
16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	**1**	**1**
17	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	**-**	**-**

***Burimi**:Të dhënat të vendosura në dispozicion nga drejtoria e urbanistikës e Bashkisë Roskovec.*

Në bazë të analizës së riskut, vlerës më të lartë të preventivit/ investimit, referuar sipërfaqes më të madhe të ndërtimit, si edhe tipologjisë së ndërtimit janë përzgjedhur 4 raste për leje ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2 /deri në 250 m^2 dhe 1 çertifikaë përdorimi, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Nr. Prot.i aplikimit	Zhvilluesi	Vendimi leje ndërtimi	Preventivi sipas subjektit
1	Magazinë Buqësore 1-Kat	3613	A.K.	Nr. 08, Datë 08.08.2024	8,676,703 lekë
2	"Stallë për mbarështimin e lopëve"	8758	O.M.	Nr.01, Datë 27/02/2025	35,990,096 lekë


Nr.	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Nr. Prot.i aplikimit	Zhvilluesi	Vendimi leje ndërtimi	Preventivi sipas subjektit
3	"Shtesë anësore 1 kat në objektin ekzistues magazinë shërbimi"	5763	D.H.	Nr. 03, Datë 04.09.2025	15,089,155 Lekë
4	Godinë 1 kat banimi	4499	A.T.	Nr.07, Datë 11/07/2024	3,382,645 Lekë
5	Ndërtim objekti 6 kate	8314	Enti Kombëtar i Banesave	Nr.03, Datë 31.12.2025	Çertifikatë përdorimi

<u>Nga auditimi i dokumentacionit në dosje dhe të dhënat e sistemit e-leje, rezultoi se</u>:

1.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin "*e-Leje*" të lejeve të ndërtimit në Bashkinë Roskovec, lidhur me auditimin e përputhshmërisë së miratimit të procedurës me objekt "***Magazinë Buqësore 1-Kat***", për të cilën është marrë **Vendimi Nr. 08, datë 08.08.2024**, referuar Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", të ndryshuar, Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr.4, datë 10.06.2020, të ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave Vendore*", të ndryshuar, etj., u konstatua si vijon:

Të dhëna të përgjithshme mbi lejen e ndërtimit:

Objekti i lejes së ndërtimit: *"Magazinë Buqësore 1-Kat"*





1. Njësia Strukturore: RO_B_B1_18/86 1.1.PDV: JO	2. Zhvilluesi: Z.K Subjekt ndërtues: Shoqëria "V. K." ShPK	3. Adresa e realizimit të punimeve: Fshati Kurjan , Bashkia Roskovec	4. Ndërtim i ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2: PO/JO-PO
5. Data e dorëzimit të kërkesës për leje ndërtimi: Data: 15.05.2024	6. Numri dhe data e Vendimit të miratimit të kërkesës për leje ndërtimi: Nr. 08, datë 08.08.2024		4/1. Lloji i objektit: Bujqësi
5/1. Kohëzgjatja e shqytimit të kërkesës: 61 ditë	7. Vlera e preventivit referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti: 8,676,703 lekë		8. Nga auditimi është konstatuar diferencë apo përllogaritje e gabuar e TNI-së: Po/Jo- JO

- <u>Në lidhje me zbatimin e afateve të përcaktuara për miratimin e lejes</u>:

Nga dokumentacioni i audituar dhe nga të dhënat e përgjithshme lidhur me detajet e aplikimit të pasqyruara në sistemin e-leje, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka shqyrtuar kërkesën për leje ndërtimi **60 ditë**, në respektim të afateve të përcaktuara, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 44, pika 2, të ligjit 107/2014 "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, sipas të cilit: "*Autoriteti përgjegjës vendos për lejen e ndërtimit brenda 60 ditëve pune nga dorëzimi i kërkesës për leje ndërtimi...*", dhe nenit 20 dhe nenit 21 të VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.


<u>-Në lidhje me zbatimin e kushteve të zhvillimit të përcaktuara për miratimin e lejes</u>:


Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr.3, datë 23.04.2024. Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në zonën në njësinë strukturore ***RO_B_B1_18/86***, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:
Të dhënat mbi kushtet bazë të zhvillimit, referuar Njësië Strukturore: RO_B_B1_18/86, në të cilën do të zhvillohet ndërtimi:

Kondicionet referuar dokumentit	***PPV/ VKM-në 283, datë 1.4.2015***	***Leje zhvillimi/ Leje ndërtimi***
Kategoria e përdorimit të tokës	B_ Bujqësor B. Tokë Bujqësore 100% B1-Kultura të Përhershme B2-Kultura Sezonale	Objekt për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore.
Parcela minimale për zhvillim	-	1870 m^2
Lartësia në kate	-	1
Lartësia në metra	-	5.5 metra
Intesiteti i ndërtimit	1 m^3/m^2	0.76 m^3 /m^2
KSHT	-	16.1 %

Për sa më sipër, grupi i auditimit ka konstatuar se leja e ndërtimit, në rastin konkret, është miratuar referuar kushteve të zhvillimit (kondicionet), si vijon:
Leja e ndërtimit bazohet në kondicionet e përcaktuara në VKM-në 283, datë 1.4.2015, "*Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore*", të ndryshuar. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, në kapitullin II.b, pika 10, përcaktohet që për objektet për grumbullimi, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
a) Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej **1 m^3/m^2;**
b) Të respektojnë distancat minimale **7 metër** nga kufijtë e pronës dhe **10 metër** nga ndërtesa të tjera.
- Nga verifikimi i planvendosjes së miratuar, evidentohet që distanca minimale nga kufiri i pronës është **5.9 metra**, nga 7 metra që duhet të ruante.
-Përsa i përket respektimit të distancës nga objektet e tjera, objekti kufizohet me disa objekte, por nuk pasqyrohen në planvendosje distacat ndërmjet tyre.
Për sa më sipër, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 10, kapitulli II.b, të VKM-në 283, date 1.4.2015, "*Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", të ndryshuar.*
Autoriteti përgjegjës nuk ka marrë asnjë masë për njoftimin e kërkuesit me qëllim plotësimin e mangësive të sipërcituara, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 20, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, e cila, ndër të tjera, citon se: "*Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, autoriteti përgjegjës njofton kërkuesin që, brenda 15 ditëve, të kryejë plotësimin e dokumentacionit:...*".
Si konkluzion, pranimi dhe miratimi i dokumentacionit shoqërues në lidhje me kërkesën për leje ndërtimi, në kushtet kur ky i fundit nuk është i plotë, përveç efektit "*miratim në heshtje*" (pika 5, neni 20, VKM nr. 408, datë 13.05.2015), mund të shkaktojnë problematika apo efekte negative gjatë fazës së zbatimit dhe zhvillimit të lejes së ndërtimit.
-Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi:

- Në planvendosjen e miratuar konstatohet që ka një ndryshim të pozicionimit të pasurisë në të cilin objekti zhvillohet të paraqitur mbi planin e rilevimit topografik, <u>në raport me pozicionimin e pasurisë në hartën treguese të paraqitur në dokumentacionin e pronësisë</u>. Në hartën treguese të pasurisë, ndërmjet pasurisë nr.153/21, në zonën kadastrale nr. 2336 dhe trupit të rrugës, pozicionohet **pasuria nr.153/23**.



Pasuria nr.153/21, në të cilën zhvillohet objekti, referuar planit të rilevimit topografik <u>zhvendoset/mbivendoset në pasurinë me nr.153/23, duke tejkaluar kufirin e pasusisë së tij dhe duke cënuar pasurinë kufizuese. Për pasurinë kufizuese me nr.153/23, nuk është paraqitur dokumentacioni i pronësisë dhe nuk është ngarkuar në sistem asnjë marrëveshje ndërmjet palëve, për zhvillimin e objektit të propozuar.</u> Për sa më sipër, në kundërshtim me pikën 1/b të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet që për tu pajisur me leje ndërtimi nevojiten dokumentacioni që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë dhe vërtetimet e pronësisë për zonat kadastrale të cilat nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar, si dhe marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta dhe në kundërshtim me pikën 1/ç, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, në të cilin përcaktohet që duhet të paraqitet <u>plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese.</u>

Autoriteti përgjegjës nuk ka marrë masë për njoftimin e kërkuesit me qëllim sqarimin dhe plotësimin e mangësive të sipërcituara, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 20, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, e cila, ndër të tjera, citon se: "*Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, autoriteti përgjegjës njofton kërkuesin që, brenda 15 ditëve, të kryejë plotësimin e dokumentacionit:...*".

-Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, nuk paraqitet projekti i instalimeve hidrosanitare, në kundërshtim me gërmën iii, të pikës 1/1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.

- Në projektin arkitektonik u kontatuan mangësi në paraqitje, pasi projekti nuk nuk pasqyrohen prerjet në të gjitha drejtimet e objektit, në kundërshtim me gërmën ç, të pikës 1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet që në dokumentacionin që duhet dorëzuar në kërkesën për leje ndërtimi është edhe projekti i plotë arkitektonik dhe relacioni shoqërues i tij, të nënshkruar elektronikisht nga projektuesi në format pdf dhe dëg-je.

Si konkluzion, pranimi dhe miratimi i dokumentacionit shoqërues në lidhje me kërkesën për leje ndërtimi, në kushtet kur ky i fundit nuk është i plotë, përveç efektit "miratim në heshtje" (pika 5, neni 20, VKM nr. 408, datë 13.05.2015), mund të shkaktojnë problematika apo efekte negative gjatë fazës së zbatimit dhe zhvillimit të lejes së ndërtimit.

*<u>-Në lidhje me paraqitjen nga aplikuesi të dokumentave që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta</u>**:***

Referuar pikës 1/ "b", të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar (pjesë e dokumentave që duhet të dorëzojë aplikuesi), si kusht për pajisjen e leje ndërtimi, ndër të tjera janë edhe "*dokumentet që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta*". Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri, nga kontrolli i kryer mbi dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, grupi i auditimit ka konstatuar paraqitjen e dokumentacionit shoqërues si vijon:

-Certifikatë pronësie për pasuritë që marrin pjesë në zhvillim:

Nr. rendor	***Nr. pasurie***	***ZK nr.***	***Lloji***	***Sipërfaqe totale/m2***	***Truall m2***	***Ndërtesë m2***	***Data e lëshimit të dokumentit***
1	153/21	2336	Arë	1870	-	-	09/12/2021

Nga verifikimi i dokumentave të pasurisë që merr pjesë në zhvillim, sipërfaqja totale e pasurisë që do të zhvillohen objektet është **1870 m^2**.

Në lidhje me sa më sipër trajtuar, grupi i auditimit ka konstatuar se hartat treguese dhe kartelat e pasurisë nuk janë të rifreskuara mbi statusin juridik të pronës *brenda 3 muajve të fundit*, referuar periudhës së paraqitjes së aplikimit për pajisjen me leje ndërtimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 111/2018, për "*Kadastrën*", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4, në të cilën përcaktohet se: "*Certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale. Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar*".

-Në lidhje me kërkesën apo mendimet e shprehura nga autoritetet publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, për miratimin e lejes:

Nga autoriteti përgjegjës janë marrë paraprakisht disa nga mendimet e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Në mënyrë të përmbledhur, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka kërkuar dhe marrë paraprakisht mendimin nga: *AZHT, Drejtoria Vendore ASHK Fier, IN, MBZHR.*

AZHT-ja në mendimin e institucionit shprehet se: "Në zbatim të Vendimit Nr. 12, datë 27.02.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit, *"Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin Sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N)*", Agjencia e Zhvillimit të Territorit pasi ka rishqyrtuar kërkesën Tuaj ka konstatuar se parcela e propozuar për zhvillim ndodhet në sistemin **Bujqësor (B).** Për sa më sipër, sipas vendimit të sipërcituar në pikë 1 të saj përcaktohet se: *a) Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sektorial.*

Në kërkesën për mendim drejtuar ASHK-së nga autoriteti përgjegjës, institucioni ka dërguar mendim, por nuk ka dërguar statusin e pronësië, kartelën dhe hartën treguese, në kundërshtim me nenin e sipërcituar, në të cilin përcaktohet që:"*Përjashtimisht, në kuptim të këtij neni, informacioni, që mundësojnë drejtoritë vendore të ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë* ***statusin e pronësisë*** *apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën*".

Nga autoriteti përgjegjës nuk është marrë mendim nga: OSHEE; UKT; PMNZSH; AKM; AEE,etj., në kundërshtim me përcaktimet e nenit 21, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.

- Në lidhje me Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI):


Lidhur me Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI), llogaritja e saj i referohet pikës 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", të ndryshuar, në të cilën përcaktohet se: "*Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet e reja që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet sipas legjislacionit për sistemin e taksave vendore*". Gjithashtu, neni 27 i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore*", i ndryshuar, përcakton se: "*1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit...; 3/a. Për ndërtime që*


destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë,... taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 (një) deri në 3 (tre) për qind e vlerës së investimit ", dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.101, datë 30.11.2023, "*Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2024 të Bashkisë Roskovec*", pika 1.3, taksa e ndikimit në infrastrukturë. Niveli i taksës për ndërtime që destinohen në sektorin e bujqësisë dhe blektorisë është 1% e vlerës së investimit referuar Paketës Fiskale të Bashkisë Roskovec, sipas llogaritjes së mëposhtme:
Vlera e preventivit sipas subjektit: 8,676,703 lekë është vlera e preventivit x 1% (niveli i taksës për destinacionin në sektorin e bujqësisë) = **86,767 lekë**
Konkretisht, vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e autoritetit përgjegjës është **86,767 lekë .**
Në vijim të lejes së ndërtimit të miratuar me Vendimin Nr. 08, datë 08.08.2024, objekti është pajisur edhe me çertifikatë përdorimi, të miratuar me Vendimin Nr.02, datë 31.12.2025, e zhvilluar në një parcelë për të cilën nuk disponon dokumentacionin e pronësisë.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:*1. Znj. M.B., *Kryetare e Bashkisë Roskovec*; 2. Znj. E.H., *me pozicion ish drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*; 3. Znj. S.P., *me pozicion përgjegjëse në Sektorin e Lejeve të ndërtimit;* 3.Znj. E.H., *me pozicion ish përgjegjëse në Sektorin e Lejeve të ndërtimit;* 4. Znj. R.B., *me pozicion specialiste për mbrojtjene mjedisit*; 5. Znj.O.G., *me pozicion drejtor i DAV;*

2.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin "*e-Leje*" të lejeve të ndërtimit në Bashkinë Roskovec, lidhur me auditimin e përputhshmërisë së miratimit të procedurës me objekt "***Stallë për mbarështimin e lopëve***", për të cilën është marrë Vendimi Nr.01, datë 27/02/2025, referuar Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", të ndryshuar, Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr.4, datë 10.06.2020, të ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave Vendore*", të ndryshuar, etj., u konstatua si vijon:

Të dhëna të përgjithshme mbi lejen e ndërtimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Objekti i lejes së ndërtimit: "Stallë për mbarështimin e lopëve"</td></tr>
<tr><td colspan="4">


</td></tr>
<tr><td>1.Njësia Strukturore:
RO_B_B2_19/33</td><td>2. Zhvilluesi:
O.M</td><td>3. Adresa e realizimit të punimeve: Fshati Suk-1, Bashkia Roskovec</td><td>4. Ndërtim i ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2:
PO/JO-PO</td></tr>
<tr><td>5. Data e dorëzimit të kërkesës për leje ndërtimi:
Data: 07/11/2024</td><td colspan="2">6. Numri dhe data e Vendimit të miratimit të kërkesës për leje ndërtimi:
Nr. 1, datë 27/02/2025</td><td>4/1. Lloji i objektit:
Objekt në funksion të blektorisë</td></tr>
<tr><td>5/1. Kohëzgjatja e shqytimit të kërkesës:
77 ditë</td><td colspan="2">7. Vlera e preventivit referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti: 35,990,096.92 lekë</td><td>10/1. Nga auditimi është konstatuar diferencë apo</td></tr>
</table>

		përllogaritje e gabuar e TNI-së: Po/Jo- JO

- *<u>Në lidhje me zbatimin e afateve të përcaktuara për miratimin e lejes</u>**:***
Nga dokumentacioni i audituar dhe nga të dhënat e përgjithshme lidhur me detajet e aplikimit të pasqyruara në sistemin e-leje, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka shqyrtuar kërkesën për leje ndërtimi për **77 ditë**, duke tejkaluar afatet e përcaktuara, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 44, pika 2, të ligjit 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, sipas të cilit: "*AP vendos për lejen e ndërtimit brenda 60 ditëve pune nga dorëzimi i kërkesës për leje ndërtimi...*", dhe nenit 20 dhe nenit 21 të VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.

*<u>-Në lidhje me zbatimin e kushteve të zhvillimit të përcaktuara për miratimin e lejes</u>**:***
Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr.05, date 06.11.2024.
Në zbatim të Vendimit Nr. 12, datë 27.02.2019 të KKT "*Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin Sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N)*", AZHT pasi ka rishqyrtuar kërkesën ka konstatuar se parcela e propozuar për zhvillim ndodhet në sistemin Bujqësor (B).
Për sa më sipër, sipas vendimit të sipërcituar në pikë 1 të saj përcaktohet se:
1.Në bashkitë të cilat kanë Plane të Përgjithshme Vendore te miratuara, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit lejohet të japin leje zhvillimi/ndërtimi, në njësitë që i përkasin sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N), për objektet e strukturat si më poshtë:
a) Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sektorial.
Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në zonën në njësinë strukturore ***RO_B_B2_19/33***, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:
Të dhënat mbi kushtet bazë të zhvillimit, referuar Njësië Strukturore: RO_B_B2_19/33, në të cilën do të zhvillohet ndërtimi:

Kondicionet referuar dokumentit	***PPV/ VKM-në 283, datë 1.4.2015***	***Leje zhvillimi/ Leje ndërtimi***
Kategoria e përdorimit të tokës	B_ Bujqësor B2-Kultura Sezonale	Blektori
Parcela minimale për zhvillim	-	**15000 m²**
Lartësia në kate	1	1
Lartësia në metra	6 metra	4.93
Intesiteti i ndërtimit	0.5 m³/m²	0.32 m³ /m²
KSHT	-	7 %

Për sa më sipër, grupi i auditimit ka konstatuar se leja e ndërtimit, në rastin konkret, është miratuar në kundërshtim me disa nga kushtet e zhvillimit (kondicionet), si vijon:
Leja e ndërtimit bazohet në kondicionet e përcaktuara në VKM-në 283, datë 1.4.2015, "*Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore*", të ndryshuar. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, në kapitullin II.b, pika 3, përcaktohet që për Stallat, që mbarështojnë mbi 50 njësi gjedhi mbi bazë ditore, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
a) Të respektojnë distancat minimale të mëposhtme:
- 20 metër nga kufijtë e pronës;
- 500 metër nga qendrat e banuara;
- 100 metër nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.
b) Të zhvillohen në një kat të vetëm, me lartësi të ndryshme në bazë të karakteristikave të veçanta teknike dhe lartësi maksimale 6 m;
c) Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej 0.5 m³/m².

- Nga verifikimi i planvendosjes së miratuar, evidentohet që distanca minimale nga kufiri i pronës është 20 metra - 60 metra, ndërsa me banesat e tjera më të afërta, të veçuara nga qëndrat urbane, objekti ruan distancën prej 129 metrash. Për sa më sipër, në përputhje me përcaktimet e pikës 3/a, nënpika 1, e kapitullit II.b, të VKM-në 283, datë 1.4.2015, "*Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", të ndryshuar*.
-Përsa i përket lartësisë së ndërtimit, lartësia maksimale e objektit është 5.18 metra nga kuota e sistemimit, brenda lartësisë maksimale të lejuar prej 6 metrash, referuar pikës 3/c, të kapitullit II.b, të VKM-në 283, datë 1.4.2015, të ndryshuar.
- Në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohet gjurma e objektit e pozicionuar mbi rilevimin topografik. Gjithashtu nuk paraqitet konfigurimi i objektit dhe përsat e tij, në kundërshtim me gërmën c, të pikës 1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.
Autoriteti përgjegjës nuk ka marrë asnjë masë për njoftimin e kërkuesit me qëllim plotësimin e mangësive të sipërcituara, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 20, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, e cila, ndër të tjera, citon se: "*Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, autoriteti përgjegjës njofton kërkuesin që, brenda 15 ditëve, të kryejë plotësimin e dokumentacionit:...*".
Si konkluzion, pranimi dhe miratimi i dokumentacionit shoqërues në lidhje me kërkesën për leje ndërtimi, në kushtet kur ky i fundit nuk është i plotë, përveç efektit "miratim në heshtje" (pika 5, neni 20, VKM nr. 408, datë 13.05.2015), mund të shkaktojnë problematika apo efekte negative gjatë fazës së zbatimit dhe zhvillimit të lejes së ndërtimit.
*-<u>Në lidhje me paraqitjen nga aplikuesi të dokumentave që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta</u>**:*
Referuar pikës 1/ "b", të nenit 15, të VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar (pjesë e dokumentave që duhet të dorëzojë aplikuesi), si kusht për pajisjen e leje ndërtimi, ndër të tjera janë edhe "*dokumentet që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta*". Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri, nga kontrolli i kryer mbi dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, grupi i auditimit ka konstatuar paraqitjen e dokumentacionit shoqërues si vijon:
-Certifikatë pronësie për pasurinë që merr pjesë në zhvillim:

Nr. rendor	***Nr. pasurie***	***ZK nr.***	***Lloji***	***Sipërfaqe totale/m2***	***Truall m2***	***Ndërtesë m2***	***Data e lëshimit të dokumentit***
1	49/11	3537	Arë	15000	-	-	06.09.2013

Nga verifikimi i dokumentave të pasurisë që merr pjesë në zhvillim, sipërfaqja totale e pasurisë që do të zhvillohen objektet është **<u>15000 m^2</u>**.
Në lidhje me sa më sipër trajtuar, grupi i auditimit ka konstatuar se hartat treguese dhe kartelat e pasurisë nuk janë të rifreskuara mbi statusin juridik të pronës *<u>brenda 3 muajve të fundit</u>*, referuar periudhës së paraqitjes së aplikimit për pajisjen me leje ndërtimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 111/2018, për "*Kadastrën*", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4, në të cilën përcaktohet se: "*Certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale. Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar*". Gjithashtu, certifikata e pasurisë është paraqitur në një kopje të vetme për të gjithë bashkëpronarët, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3, nenit 17, të Ligjit nr. 111/2018 "Për Kadastrën", sipas të cilit: "*Certifikata e pronësisë i lëshohet vetëm personit pronar ose bashkëpronarëve. Në rastin e bashkëpronësisë certifikata hartohet në aq kopje sa është numri i bashkëpronarëve*".

-Në lidhje me pasurinë e sipërcituar, nga dokumentacioni i shqyrtuar në sistemin e-leje, paraqitet një **kontratë huapërdorje** e pasurisë, me nr. Repertori: 2892, nr. Koleksioni: 1427, datë 25.10.2024, në të cilën pasuria me nr.49/11, jepet në huapërdorje, në bazë të nenit 901-903, të Kodit Civil. Në kushtet e kontratës për huapërdorje nuk përcaktohet në mënyrë të qartë e drejta për të zhvilluar pronën dhe nuk specifikohet në asnjë nga pikat e drejta për të aplikuar për lejen e ndërtimit.

Për sa më sipër, në kundërshtim me gëmën b, të pikës 1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet: "*Dokumentat që duhet të paraqisë aplikuesi për tu pajisur me leje ndërtimi...,* si dhe marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta;".

Si konkluzion, pranimi dhe miratimi i dokumentacionit që vërteton të drejtat pasurore, në kushtet kur ky i fundit nuk është i plotë dhe/ose nuk është paraqitur në formën e kërkuar, përveç riskut të veprimeve tjetërsuese që mund të ndodhin mbi pasurinë, mund të shkaktojë problematika apo efekte negative edhe gjatë fazës së zbatimit dhe zhvillimit të lejes së ndërtimit.

*-Në lidhje me kërkesën apo mendimet e shprehura nga autoritetet publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, për miratimin e lejes**:***

Nga autoriteti përgjegjës janë marrë paraprakisht mendimet e disa prej autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Në mënyrë të përmbledhur, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka kërkuar dhe marrë paraprakisht mendimin nga: AZHT; AKM; Drejtoria Vendore ASHK Fier; MBZHR.

Në kërkesën për mendim drejtuar ASHK-së nga autoriteti përgjegjës, institucioni është shprehur, por **nuk ka dërguar statusin e pronësisë**, kartelën e pasurisë, si dhe hartën kadastrale për pronën e aplikimit, në kundërshtim me nenin e sipërcituar, në të cilin përcaktohet që: "*Përjashtimisht, në kuptim të këtij neni, informacioni, që mundësojnë drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën.*".

-Në mendimin e dërguar të insitucioneve, AZHT shprehet se:

"Për sa më sipër, Bashkia Roskovec si autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit, mund të vijojë, sipas fushës së kompetencës, me vazhdimin e procedurave për shqyrtimin dhe vlerësimin e këtij projekt-propozimi për pajisjen me Leje Ndërtimi, në përputhje me kriteret dhe standardet e përcaktuara në Vendimit Nr. 12, datë 27.02.2019 të KK të Territorit, me kusht miratimin nga MBZHR, në zbatim të VKM-së Nr. 283, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", i ndryshuar, si dhe legjislacionin sektorial në fuqi.".

-Nga autoriteti përgjegjës nuk është marrë mendim nga; OST; PMNZSH Qendrore; UKT; etj., në kundërshtim me përcaktimet e nenit 21, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.

- Në lidhje me Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI):

Lidhur me Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI), llogaritja e saj i referohet pikës 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", të ndryshuar, në të cilën përcaktohet se: "*Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet e reja që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet sipas legjislacionit për sistemin e taksave vendore*". Gjithashtu, neni 27 i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore*", i ndryshuar, përcakton se: "1.*Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit...; 3/a. Për ndërtime që*


destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë,... taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 (një) deri në 3 (tre) për qind e vlerës së investimit", dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.71, datë 25.11.2024, "*Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025 të Bashkisë Roskovec*", pika 1.3, taksa e ndikimit në infrastrukturë. Niveli i taksës për ndërtime që destinohen në sektorin e bujqësisë dhe blektorisë është 1% e vlerës së investimit referuar Paketës Fiskale të Bashkisë Roskovec, sipas llogaritjes së mëposhtme:

Vlera e preventivit sipas subjektit: 35,990,096.92 lekë është vlera e preventivit x 1% (niveli i taksës për destinacionin në sektorin e blektorisë) = 359,990.97 lekë
Konkretisht, vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e autoritetit përgjegjës është **359,991 lekë.**

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1. Znj. M.B., *Kryetare e Bashkisë Roskovec;* 2. Znj. E.H., *me pozicion ish drejtoreshë në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;* 3. Znj. S.P., *me pozicion përgjegjëse në Sektorin e Lejeve të ndërtimit;* 4. Znj. R.B., *me pozicion specialiste për mbrojtjene mjedisit*; 5. Znj. O.G, *me pozicion drejtor i DAV.*

3.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin "*e-Leje*" të lejeve të ndërtimit në Bashkinë Roskovec, lidhur me auditimin e përputhshmërisë së miratimit të procedurës me objekt ***"Shtesë anësore 1 kat në objektin ekzistues magazinë shërbimi"***, për të cilën është marrë vendimi Nr. 03, datë 04.09.2025, referuar Ligjit 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr.4, datë 10.06.2020, të ndryshuar, si dhe Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave Vendore*", i ndryshuar, etj., u konstatua si vijon:

Të dhëna të përgjithshme mbi lejen e ndërtimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Objekti i lejes së ndërtimit: "Shtesë anësore 1 kat në objektin ekzistues magazinë shërbimi"</td></tr>
<tr><td colspan="4">
</td></tr>
<tr><td>1. Njësia Strukturore:
RO_UB_A2_70/21
1.1.PDV: PO
Nuk ka PDV të miratuar</td><td>2. Zhvilluesi: D.H
Subjekt ndërtues: Shoqëria "K." ShPK</td><td>3. Adresa e realizimit të punimeve: Bashkia Roskovec</td><td>4. Ndërtim i ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2:
PO/JO- PO</td></tr>
<tr><td>5. Data e dorëzimit të kërkesës për leje ndërtimi:
Data: 02/07/2025</td><td colspan="2">6. Numri dhe data e Vendimit të miratimit të kërkesës për leje ndërtimi:
Nr. 03, datë 04.09.2025</td><td>4/1. Lloji i objektit:
Shërbim</td></tr>
<tr><td>5/1. Kohëzgjatja e shqytimit të kërkesës:
47 ditë</td><td colspan="2">7. Vlera e preventivit referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti: 15,089,155 lekë</td><td>8. Nga auditimi është konstatuar diferencë apo përllogaritje e gabuar e TNI-së: Po/Jo- PO</td></tr>
</table>

-Në lidhje me zbatimin e afateve të përcaktuara për miratimin e lejes:

Nga dokumentacioni i audituar dhe nga të dhënat e përgjithshme lidhur me detajet e aplikimit të pasqyruara në sistemin e-leje, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka shqyrtuar kërkesën për leje ndërtimi për **47 ditë**, në respektim të afateve të përcaktuara nenin 44, pika 2, të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", dhe përcaktimet e nenit 20 dhe 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.

-Në lidhje me zbatimin e kushteve të zhvillimit të përcaktuara për miratimin e lejes:

Leja e zhvillimit është miratuar me Vendimin Nr.1, datë 02.04.2025. Parcelat në të cilën zhvillohet objektet bëjnë pjesë në njësinë strukturore *RO_UB_A2_70/21*, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Të dhënat mbi kushtet bazë të zhvillimit, referuar Njësië Strukturore: RO_UB_A2_70/21, në të cilën do të zhvillohet ndërtimi:

Kondicionet referuar dokumentit	***PPV***	***Leje ndërtimi***
Kategoria e përdorimit të tokës	UB_Urban A1.Banim 100%; A2-Banim dhe Shërbime	Shërbime
Parcela minimale për zhvillim	500 m^2	6284 m^2
Lartësia në kate	5 kate + tarracë	1 kat
Lartësia në metra	21.5 metra	9.06 metra
Intesiteti i ndërtimit	3	2.2
KSHT	45%	30.6 %

Grupi i auditimit ka konstatuar se leja e ndërtimit, është miratuar në kundërshtim me disa nga kushtet kryesore të zhvillimit (kondicionet), konkretisht si vijon:

- Referuar të dhënave të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr. 4, datë 10.06.2020, të ndryshuar, përcaktohet që në njësinë strukturore RO_UB_A2_70/21, është kusht hartimi i PDV përpara shqyrtimit të kërkesave për ndërtim. Nga verifikimi i dokumentacioneve u konstatua që nuk është hartuar PDV përpara shqyrtimit të kërkesës për leje ndërtimi. Për sa më sipër, në kundërshtim me nenin 33, të Rregullores Vendore.

-Në lidhje me lartësinë e objektit dhe numrit të kateve, nga shqyrtimi i projektit të ndërtimit, objekti zhvillohet në lartësinë e 2 kateve dhe jo në lartësinë e 1 kati, por nuk e tejkalon lartësinë maksimale të lejuar sipas PPV.

-Në lidhje me "***distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës***", objekti ruan distancën 5 deri në 50 metra nga kufiri i pronës, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

-Në lidhje me "***distancat minimale midis ndërtimeve***", në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohen të gjitha objektet me të cilat kufizohet, numrat e kateve dhe distancat ndërmjet tyre, në kundërshtim me nenin 34, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.

-Në lidhje me "***distancat e lejuara midis ndërtimit dhe trupit të rrugës***", objekti i propozuar ruan distancën nga 47.5 metra, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

-Në lidhje me parkimin, në të dhënat e treguesve të zhvillimit dhe në planvendosjen e pasqyruar nuk janë parashikuar hapësira parkimi për objektin e shërbimit, në kundërshtim me nenin 29, të Rregullores Vendore.

-Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi:

-Në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohet rilevimi topografik dhe plani i vendosje së objektit të propozuar mbi fragmentin e hartës ekzistuese. Në mungesë të paraqitjes së gjendjes ekzistuese të parcelës në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, nuk mund të merret në konsideratë saktësia e vendosjes së njollës së objektit mbi hartën e treguese të pasurisë dhe distancat e shënuara nga kufiri i pronës. Gjithashtu nuk paraqiten objektet me të cilat objekti kufizohet, lartësitë e tyre, si dhe distancat ndërmjet tyre. Në lidhje me respektimin e distancave nuk mund të përcaktohet nëse janë respektuar, pasi nuk paraqitet një plan i saktë mbi të cilën të verifikohen. Për sa më sipër, në mospërputhje me pikën 1/ç, të nenit 15; pikën 2, të nenit 34, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i

ndryshuar dhe me pikën 10, të kapitullit II.b, të VKM-në 283, datë 1.4.2015, "*Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", të ndryshuar*.

-Përsa i përket projektit teknik janë konstatuar pasaktësi dhe mospërputhje, pasi referuar planeve teknike, evidentohen që janë 2 kate, një kat në kuotën + 0.00 dhe një kat në kuotën +3.06. Objekti nuk është në lartësinë e 1 kati, por në lartësinë e dy kateve. Projekti i pasqyruar nuk është i plotë dhe mungojnë prerjet në të gjitha orjentimet. Gjithashtu, në projektin teknik nuk pasqyrohet gjendja ekzistuese e objektit në të cilin propozohet shtesa dhe nuk evidentohet qartë sesi realizohet lidhja me objektit ekzistues, detajet arkitektonike të lidhjes së dy objekteve, duke shfaqur objektin si një godinë të re, të ndërtuar në të njëjtën parcelë me objektin ekzistues.

Sa më sipër, në kundërshtim me pikën 1/1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, sipas të cilit "*...dokumentet që duhet të dorëzojë aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi janë: Projekti i ndërtimit hartohet konform kushteve të përcaktuara në lejen e zhvillimit/dokumentet e planifikimit dhe në bazë të tij lëshohet leja e ndërtimit.*".

Autoriteti përgjegjës nuk ka marrë asnjë masë për njoftimin e kërkuesit me qëllim plotësimin e mangësive të sipërcituara, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 20, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, e cila, ndër të tjera, citon se: "*Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, autoriteti përgjegjës njofton kërkuesin që, brenda 15 ditëve, të kryejë plotësimin e dokumentacionit:...*".

Si konkluzion, pranimi dhe miratimi i dokumentacionit shoqërues në lidhje me kërkesën për leje ndërtimi, në kushtet kur ky i fundit nuk është i plotë, përveç efektit "miratim në heshtje" (pika 5, neni 20, VKM nr. 408, datë 13.05.2015), mund të shkaktojnë problematika apo efekte negative gjatë fazës së zbatimit dhe zhvillimit të lejes së ndërtimit.

-Në lidhje me paraqitjen nga aplikuesi të dokumentave që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta:

Referuar pikës 1/ "b", të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, pjesë e dokumentave që duhet të dorëzojë aplikuesi, si kusht për pajisjen e leje ndërtimi, janë, ndër të tjera, edhe "*dokumentet që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta*".

Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri, nga kontrolli i kryer mbi dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, grupi i auditimit ka konstatuar paraqitjen e dokumentacionit shoqërues si vijon:

-Certifikatat e pronësisë për pasuritë që marrin pjesë në zhvillim:

Nr. rendor	*Nr. pasurie*	*ZK nr.*	*Lloji*	*Sipërfaqe totale/m2*	*Truall m2*	*Ndërtesë m2*	*Datë e aplikimit*
1	156/17	3196	Arë	2840	-	-	22.02.2025
2	156/20	3196	Arë	1012	-	-	22.02.2025
3	156/18	3196	Arë	1432	-	-	22.02.2025
4	156/56	3196	Arë	1000	-	-	17.10.2024
5	156/14-ND	3196	Ndërtesë	960	-	960	29.01.2025

Në kartelën e pasurive nr.156/17, nr.156/18 dhe nr.156/14-ND, në zonën kadastrale nr.3196, përkatësisht **në seksionin e kufizimeve të pronësisë**, në datën 27/12/2022 është regjistruar kontrata për vendosje e hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga Raiffeisen Bank, për 20 vite. Në dokumentacionin e paraqitur në sistemin e-leje, nuk është ngarkuar miratimi i bankës për të vijuar me aplikimin për leje ndërtimi.

Nga verifikimi i dokumentave të të gjitha pasurive që marrin pjesë në zhvillim, sipërfaqja totale e pasurisë që do të zhvillohet objekti është **6284 m^2**.

Në lidhje me pasurinë e sipërcituar, pronari ka shprehur vullnetin e tij me kontratën e sipërmarrjes të poshtëshënuar.

Nr. rendor	*Nr. Repertori*	*Nr. Koleksioni*	*Datë*
1	611	337	12.03.2025

Sa më sipër trajtuar, grupi i auditimit ka konstatuar se hartat treguese dhe kartelat e pasurisë nuk janë të rifreskuara mbi statusin juridik të pronës brenda *3 muajve të fundit*, referuar periudhës së paraqitjes së aplikimit për pajisjen me leje ndërtimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 111/2018, për "Kadastrën", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4.

*-Në lidhje me kërkesën apo mendimet e shprehura nga autoritetet publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, për miratimin e lejes**:***

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, konstatohet që autoriteti përgjegjës nuk ka kërkuar dhe nuk ka marrë paraprakisht mendimin nga asnjë institucion që duhet të shprehet për miratimin e lejes së ndërtimit, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 6, të nenit 21, të VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, sipas të cilit "*Në rast se në lidhje me kërkesën për leje duhet të shprehen, paraprakisht, edhe autoritete të tjera publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, autoriteti vendor përgjegjës ose KKT-ja, sipas fushës së kompetencës, u dërgon atyre kërkesë për mendim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve..."*

-Lidhur me ASHK, nuk është marrë mendim për statusin e pasurive që marrin pjesë në zhvillim, në kundërshtim me nenin e sipërcituar, në të cilin përcaktohet që: "*Përjashtimisht, në kuptim të këtij neni, informacioni, që mundësojnë drejtoritë vendore të ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën*".

-Në lidhje me Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI):

Konstatohet se në Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) evidentohen pasaktësi llogaritjen e saj referuar pikës 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, neni 27 i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore*", i ndryshuar dhe VKB nr.71, datë 25.11.2024, "*Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025 të Bashkisë Roskovec*", pika 1.3, taksa e ndikimit në infrastrukturë. Niveli i taksës për ndërtime që destinohen për njësi shërbimi është **4% e vlerës** së investimit referuar Paketës Fiskale të Bashkisë Roskovec, sipas llogaritjes së mëposhtme:

Konkretisht, vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e autoritetit përgjegjës është **603,566 lekë**, ndërkohë që, sipas përllogaritjes së kryer nga grupi i auditimit, vlera e TNI-së duhet të ishte **3,456,000 lekë**. Përllogaritja jo e saktë e taksës nga autoriteti përgjegjës ka ndodhur për shkak se është llogaritur në bazë të preventivit dhe jo në baza të vlerës në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit dhe për arsye të mosverifikimit të sipërfaqeve referuar projektit teknik të miratuar.

-Llogaritja e TNI-së sipas autoritëtit përgjegjës:

15,089,155.05 (Vlera e preventivit) x 4% = **603,566.20 lekë**

-Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin që është në funksion të shërbimit është:

Sipërfaqja e ndërtimit për objektin e ri të shërbimit është 1920 m^2

(*16 metra x 60 metra = 960 m^2/për secilin kat x 2 kate=1920 m^2*)



1920 m^2 (*Sipërfaqja e përgjithshme e objektit të shërbimeve*) x 30,000 lekë (*Referenca e çmimit të shitjes*) x 1.5 (*Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 here më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve*) x 4% (*Niveli i taksës për njësitë e shërbimit*)= **3,456,000 lekë**.

Për sa më sipër, grupi i auditimit arrin në përfundimin se **vlera prej 2,852,434 lekë**, si diferenca ndërmjet vlerës së paguar konkretisht nga subjekti dhe vlerës të cilës realisht ky i fundit duhet të paguante, **përbën të ardhura të munguara të Bashkisë Roskovec**.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:*1. Znj. M.B., *Kryetare e Bashkisë Roskovec;* 2. Znj. E.H., *me pozicion ish drejtoreshë në DPZHT;* 3. Znj. S.P., *me pozicion përgjegjëse në Sektorin e Lejeve të ndërtimit;* 4. Znj. Y.K., *me pozicion ish specialiste juriste*; 5. Znj. O.G., *me pozicion drejtor i DAV.*

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin "*e-Leje*" të lejeve të ndërtimit në Bashkinë Roskovec, lidhur me auditimin e përputhshmërisë së miratimit të procedurës me objekt ***"Godinë 1 kat banimi"***, për të cilën është marrë Vendimi Nr.07, datë 11.07.2024, referuar Ligjit 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin Nr.4, datë 10.06.2020, të ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, " *Për Sistemin e Taksave Vendore*", i ndryshuar, etj., u konstatua si vijon:

Të dhëna të përgjithshme mbi lejen e ndërtimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Objekti i lejes së ndërtimit: "Godinë 1 kat banimi"</td></tr>
<tr><td colspan="2">
</td><td colspan="2">
</td></tr>
<tr><td>1. Njësia Strukturore: RO_UB_A2_43/1
1.1.PDV: JO</td><td>2. Zhvilluesi: A.T</td><td>3. Adresa e realizimit të punimeve: Bashkia Roskovec</td><td>4. Ndërtim i ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2: PO/JO- JO</td></tr>
<tr><td>5. Data e dorëzimit të kërkesës për leje ndërtimi: Data: 23.05.2024</td><td colspan="2">6. Numri dhe data e Vendimit të miratimit të kërkesës për leje ndërtimi: Nr.07, Datë. 11.07.2024</td><td>4/1. Lloji i objektit: Banim</td></tr>
<tr><td>5/1. Kohëzgjatja e shqytimit të kërkesës: 35 ditë</td><td colspan="2">7. Vlera e preventivit referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti: 3,382,645 lekë</td><td>11. Nga auditimi është konstatuar diferencë apo përllogaritje e gabuar e TNI-së: Po/Jo- PO</td></tr>
</table>

*-Në lidhje me zbatimin e afateve të përcaktuara për miratimin e lejes**:***
Konstatohet se autoriteti përgjegjës ka shqyrtuar kërkesën për leje ndërtimi për **35 ditë**, në respektim të afateve të përcaktuara nenin 44, pika 2, të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", dhe përcaktimet e nenit 20 dhe 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.
*-Në lidhje me zbatimin e kushteve të zhvillimit të përcaktuara për miratimin e lejes**:***
Leja e zhvillimit është miratuar me Vendimin Nr.7, date 17.08.2023. Parcelat në të cilën zhvillohet objektet bëjnë pjesë në njësinë strukturore *RO_UB_A2_43/1*, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:
*Të dhënat mbi kushtet bazë të zhvillimit, referuar Njësië Strukturore: RO_UB_A2_43/1, në të cilën do të zhvillohet ndërtimi**:***

Kondicionet referuar dokumentit	***PPV/ Leja e zhvillimit***	***Leje ndërtimi***


Kategoria e përdorimit të tokës	A. Banim 100% A2-Banim dhe Shërbime	Banim
Parcela minimale për zhvillim	300 m^2	800 m^2
Lartësia në kate	3 kate	1 kat
Lartësia në metra	3 kate me tarracë ose çati të pashfrytëzuar/ Neni 20	5.73 metra
Intesiteti i ndërtimit	2	0.16
KSHT	45 %	16 %

Grupi i auditimit ka konstatuar se leja e ndërtimit, është miratuar në mospërputhje me disa nga kushtet e zhvillimit (kondicionet), si vijon:

-Në lejen e zhvillimit është përcaktuar kushti si më poshtë:
Bazur në VKM-ne Nr.410, datë 27.06.2012, i ndryshuar me VKM-në Nr.440, datë 03.06.2020, pika VII/1 "*Kalimi i tokave të resurseve të ndryshme në kategorinë e resursit tokë urbane, truall, sipas Planeve të Detajuara dhe Planeve të Përgjithshme Vendore",* zhvilluesi duhet të bëjë konvertimin e pasurisë nr.170/22 nga "*vresht*" në "truall" dhe më pas të bëjë aplikimin për tu pajisur me leje ndërtimi duke dorëzuar dokumentin e pronësisë të konvertuar. Kushti i përcaktuar në fazën e lejes së zhvillimit, nuk është respektuar në fazën e lejes së ndërtimit, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 9, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", të ndryshuar.

- Në planvendosjen e miratuar konstatohet që ka një ndryshim të pozicionimit të pasurisë në të cilin objekti zhvillohet të paraqitur mbi planin e rilevimit topografik, në raport me pozicionimin e pasurisë në hartën treguese të paraqitur në dokumentacionin e pronësisë. Në hartën treguese pasuria me nr.170/22, në zonën kadastrale nr. 3196, në veri kufizohet nga pasuria me nr. **nr.170/7**. Në planin e rilevimit topografik pasuria 170/22 nuk kufizohet më me pasurinë nr.170/7, por kufizohet në mënyrë direkte me rrugën. Për pasurinë kufizuese me nr.170/7, nuk është paraqitur dokumentacioni i pronësisë dhe nuk është ngarkuar në sistem asnjë marrëveshje ndërmjet palëve, për zhvillimin e objektit të propozuar. Për sa më sipër, në kundërshtim me pikën 1/b të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet që për tu pajisur me leje ndërtimi nevojiten dokumentacioni që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë dhe vërtetimet e pronësisë për zonat kadastrale të cilat nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar, si dhe marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta dhe në kundërshtim me pikën 1/ç, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, në të cilin përcaktohet që duhet të paraqitet plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese.





AP nuk ka marrë asnjë masë për njoftimin e kërkuesit me qëllim sqarimin saktësimin e mangësive të sipërcituara, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 20, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.
-Në lidhje me lartësinë maksimale të ndërtimit, nga verifikimi i projektit teknik lartësia e objektit nuk është përcaktuar saktë në të dhënat e tregueve të zhvillimi. Lartësia maksimale e objektit është **6.99 metra** dhe jo 5.73 metra, referuar përcaktimeve të nenit 17, pika 1/b, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet që:"*Lartësia e ndërtimit matet nga kuota mesatare e sistemimit të trotuarit rrethues të objektit në terren të sheshtë, deri në kulmin e mbulesës nga jashtë, për mbulesa të pjerrëta;".* Në bazë të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, të miratuar me Vendimin e KKT-së nr. 4, datë 10.06.2020, neni 20, pika 6, përcaktohet që lartësia maksimale e objektit në lartësinë e 1 kati duhet të jetë **7.5 metra** e matur në kulmin e çatisë. Lartësia e propozuar e objektit nuk e tejkalon lartësinë sipas PPV, ndonëse nuk është përcaktuar saktë tek treguesit e zhvillimit.
-Në lidhje me "***distancat minimale midis ndërtimit dhe kufirit të pronës***", është respektuar distanca minimale prej 2 metër nga kufiri i pronës, për objektin në lartësinë e 1 kati, në përputhje me përcaktimet e VKM-së 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, sipas nenit 35, pika 1.
Autoriteti përgjegjës nuk ka marrë asnjë masë për njoftimin e kërkuesit me qëllim plotësimin e mangësive të sipërcituara, në kundërshtim me pikën 4, të nenit 20, të VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, e cila, ndër të tjera, citon se: "*Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, autoriteti përgjegjës njofton kërkuesin që, brenda 15 ditëve, të kryejë plotësimin e dokumentacionit:...*".
*-Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi***:**
- Në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohet gjurma e saktë e objektit, njolla e objekti dhe konfigurimi i mbulesës, që paraqitet qartë konturin e objektit. Sa më sipër, në kundërshtim me gërmën c, të pikën 1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, sipas të cilit "*....dokumentet që duhet të dorëzojë aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi janë: Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese;*".
-Përsa i përket projektit teknik janë konstatuar mangësi, pasi projekti i pasqyruar nuk është i plotë dhe mungojnë prerjet në të gjitha orjentimet, dimensionimi i plotë i planeve dhe janë evidentuar pasaktësi në paraqitjen e kuotave në fasadat teknike dhe prerjen.
Sa më sipër, në kundërshtim me pikën 1/1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, sipas të cilit "*...dokumentet që duhet të dorëzojë aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi janë: Projekti i ndërtimit hartohet konform kushteve të përcaktuara në lejen e zhvillimit/dokumentet e planifikimit dhe në bazë të tij lëshohet leja e ndërtimit.*".
*-Në lidhje me paraqitjen nga aplikuesi të dokumentave që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta***:**
Referuar pikës 1/"b", të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, pjesë e dokumentave që duhet të dorëzojë aplikuesi, si kusht për pajisjen e leje ndërtimi, janë, ndër të tjera, edhe "*dokumentet që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta*". Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri, nga kontrolli i kryer mbi dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, grupi i auditimit ka konstatuar paraqitjen e dokumentacionit shoqërues si vijon:
-Certifikatë pronësie për pasuritë që marrin pjesë në zhvillim:

Nr. rendor	*Nr. pasurie*	*ZK nr.*	*Lloji*	*Sipërfaqe totale/m2*	*Truall m2*	*Ndërtesë m2*	*Datë e aplikimit*
1	170/22	3196	Vreshtë	800	-	-	11.07.2023

Sipërfaqja totale e pasurisë që do të zhvillohen objektet është **800 m²**.

Në lidhje me sa më sipër trajtuar, grupi i auditimit ka konstatuar se hartat treguese dhe kartelat e pasurisë nuk janë të rifreskuara mbi statusin juridik të pronës *brenda 3 muajve të fundit*, referuar periudhës së paraqitjes së aplikimit për pajisjen me leje ndërtimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 111/2018, për "*Kadastrën*", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4, në të cilën përcaktohet se: "*Certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale. Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar*". Gjithashtu, certifikata e pasurisë është paraqitur në një kopje të vetme për të gjithë bashkëpronarët, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3, nenit 17, të Ligjit nr. 111/2018 "Për Kadastrën", sipas të cilit: "*Certifikata e pronësisë i lëshohet vetëm personit pronar ose bashkëpronarëve. Në rastin e bashkëpronësisë certifikata hartohet në aq kopje sa është numri i bashkëpronarëve*".

Si konkluzion, pranimi dhe miratimi i dokumentacionit që vërteton të drejtat pasurore, në kushtet kur ky i fundit nuk është i plotë dhe/ose nuk është paraqitur në formën e kërkuar, përveç riskut të veprimeve tjetërsuese që mund të ndodhin mbi pasurinë, mund të shkaktojë problematika apo efekte negative edhe gjatë fazës së zbatimit dhe zhvillimit të lejes së ndërtimit.

-Në lidhje me kërkesën apo mendimet e shprehura nga autoritetet publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, për miratimin e lejes:

Nga dokumentacioni i audituar, në mënyrë të përmbledhur, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka kërkuar dhe marrë paraprakisht mendimin nga: AZHT; Drejtoria Vendore ASHK Fier.

Në këtë rastin e ASHK-së, nga autoriteti përgjegjës është marrë paraprakisht mendimi, por mendimi i dërguar nuk përkon me numrin e pasurisë për të cilin subjekti zhvillues paraqet kërkesën për leje ndërtimit. Sa më sipër cituar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 21, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar.

Nga autoriteti përgjegjës nuk është marrë mendim nga; OST; PMNZSH Qendrore; UKT; AEE, etj., në kundërshtim me përcaktimet e nenit 21, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.

-Në lidhje me Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI):

Lidhur me Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI), llogaritja e saj i referohet pikës 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", të ndryshuar, në të cilën përcaktohet se: "*Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet e reja që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet sipas legjislacionit për sistemin e taksave vendore*". Gjithashtu, neni 27 i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore*", i ndryshuar, përcakton se: "*1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit...; 3/a. Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë,... taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 (një) deri në 3 (tre) për qind e vlerës së investimit* ", dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.101, datë 30.11.2023, "*Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2024 të Bashkisë Roskovec*", pika 1.3, taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Niveli i taksës për ndërtime të ndryshme nga ato të përcaktuara në tabelë, përkatësisht objekt banimi është 2% e vlerës së investimit referuar Paketës Fiskale të Bashkisë Roskovec, sipas llogaritjes së mëposhtme:

Sipas preventivit:

3,382,645 lekë (*sipas vlerës së preventivit nga subjekti*) x 2 % (*niveli i taksës*) = **67,653 lekë**

Në bazë të vlerës së investimit:
128 m2 x 31,597 lekë (kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave) = 4,044,416 lekë (vlera e investimit në bazë të kostos mesatare të ndërtimit).
4,044,416 lekë (vlera e investimit) x 2 % (niveli i taksës për destinacionin) = **80, 888 lekë** (*Vlera e TNI-së që duhet të paguante*)

Vlera e TNI-së e llogaritur nga autoriteti përgjegjës është:
3,382,644.55 lekë është vlera e preventivit x 4% = **135, 305.78 lekë**.

Për sa më sipër, grupi i auditimit arrin në përfundimin se diferenca e **vlerës prej 54,417 lekë**, është taksuar më shumë nga autoriteti përgjegjës nga vlera e taksës që subjekti realisht duhet të paguante.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:*1.Znj. M.B., *Kryetare e Bashkisë Roskovec;* 2. Znj.E.H., *me pozicion ish drejtoreshë në DPZHT;* 3. Znj. E.H., *me pozicion ish përgjegjëse në Sektorin e Lejeve të ndërtimit;* 4. Znj. R.B., *me pozicion specialiste për mbrojtjen e mjedisit*; 5. Znj. O.G., *me pozicion drejtor i DAV-së.*

5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin "*e-Leje*" të çertifikatave të përdorimit në Bashkinë Roskovec, lidhur me auditimin e përputhshmërisë së miratimit të procedurës me objekt ***"Ndërtim objekti 6 kate"***, për të cilën është marrë vendimi nr.03, datë 31.12.2025, referuar Ligjit 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr.4, datë 10.06.2020, të ndryshuar, si dhe në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar., u konstatua si vijon:

Të dhëna të përgjithshme mbi certifikatën e përdorimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Objekti i çertifikatës së përdorimit: "Ndërtim objekti 6 kate"</td></tr>
<tr><td colspan="2">
</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>1. Leja e ndërtimit:
Nr.10, datë 11/07/2023</td><td>2. Zhvilluesi: Enti Kombëtar i Banesave

Subjekti zbatues:
"S." ShPK</td><td>3. Adresa e realizimit të punimeve: Roskovec, Bashkia Roskovec</td><td>4. Ndërtim i ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2:
PO/JO- PO</td></tr>
<tr><td colspan="2">1/2. Afati i lejes së ndërtimit:
Datë 16 muaj nga data e fillimit të punimeve</td><td colspan="2"></td></tr>
</table>

5. Data e dorëzimit të kërkesës për certifikatë përdorimi: 29/09/2025	6. Numri dhe data e Vendimit të miratimit të kërkesës për çertifikatë përdorimi: Nr.03, Datë 31.12.2025	7. Lloji i objektit: Banim
5/1. Kohëzgjatja e shqytimit të kërkesës: 68 ditë	8.Vlera e preventivit sipas situacionit përfundimtar: 87,760,120 lekë	

*-<u>Në lidhje me zbatimin e afateve të përcaktuara për miratimin e lejes</u>**:***

Nga dokumentacioni i audituar dhe nga të dhënat e përgjithshme lidhur me detajet e aplikimit të pasqyruara në sistemin e-leje, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka shqyrtuar kërkesën për certifikatë përdorimi për **68 ditë**, në tejkalim të afateve të përcaktuara në bazë të legjislacionit në fuqi, në mospërputhje me përcaktimet e pikës 5, të nenit 42, të ligjit 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*",i ndryshuar, sipas të cilit "*AP vendos për lëshimin e certifikatës së përdorimit brenda 55 ditëve pune nga dorëzimi i kërkesës për leje ndërtimi...*" dhe përcaktimet e pikës 6 dhe 7, të nenit 27, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.

*-<u>Në lidhje me zbatimin e kushteve të përcaktuara në miratimin e lejes së ndërtimit</u>**:***

Nga dokumentacioni i shqyrtuar për aplikimin e certifikatës së përdorimit, në raport me plotësimin e kushteve të përcaktuara në lejen e ndërtimit të miratuar, në mënyrë të përmbledhur pasqyrohen si vijon:

- Leja e ndërtimit është miratuar në datën 11.07.2023 dhe është e vlefshme **16 muaj** pas datës së fillimit të punimeve, referuar grafikut të punimeve. Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, data e fillimit të punimeve është data 25.07.2023. Referuar kushteve të lejes së ndërtimit, afati i lejes së ndërtimit duhet të përfundonte në datën **<u>25.11.2024</u>**. Objekti ka përfunduar punimet me datë **<u>15.04.2025</u>,** <u>rreth 5 muaj më vonë,</u> 141 ditë pas përfundimit të afatit të lejes së ndërtimit. Kërkesa për çertifikatë përdorimi është realizuar në datën 29.09.2025, 167 ditë pas përfundimit të punimeve dhe 308 ditë pas përfundimit të afatit të lejes së ndërtimit.


Nga shqyrtimi i dokumentacionit, nuk është realizuar shtyrje afati për përfundimin e punimeve, në kundërshtim me nenin 18, të VKM-së 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar dhe në kundërshtim me pikën 3, të nenit 40, të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet që: "Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve kryhet nga autoriteti që ka miratuar lejen, mbi bazën e një kërkese të arsyetuar të subjektit të pajisur me leje ndërtimi. Kërkesa shoqërohet nga kalendari i ri i punimeve dhe <u>vërtetimi i pagesës së gjobës për shkeljen e afatit</u>, sipas nenit 52 të këtij ligji.".

-Në raport me destinacionin e zhvillimit të strukturës së realizuar është në përputhje me lejen e ndërtimit.

*-<u>Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesi për t'u pajisur me certifikatë përdorimi</u>**:***

-Në shqyrtimin e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, u konstatua që planvendosja e pasqyruar në projektin teknik në fazën e kërkesës për çertifikatë përdorimi, si dhe në realizimi në terren i objektit, nuk është në përputhje të plotë me planvendosjen e miratuar në lejen e ndërtimit, kryesisht përsa i përket aksesimit të objektit dhe orjentimi i tij në raport me rrugën kryesore. Më poshtë pasqyrohen të dy planvendosjet, ajo e miratuara në lejen e ndërtimit dhe ajo e pasqyruar në fazën e çertifikimit të objektit.





-Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, u konstatua që projekti arkitektonik i miratuar me realizimin e objektit në terren, ka disa ndryshime të evidentuar në fotot e objektit të përfunduar. Në dokumencionin e ngarkuar në sistem nuk paraqitet projekti "*as build*" (i zbatuar), në të cilin të reflektohen ndryshimet përkatëse, në kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, referuar gërmës g, të pikës 1, të nenit 27/2.


-Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje në kërkesën për pajisjen e objektit me çertifikatë përdorimi, nuk është ngarkuar vërtetimi i pagesës së gjobës, sipas parashikimeve të pikës dh, të nenit 52, të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar.

-Në lidhje me miratimin e certifikatës së përdorimit:

- Nga verifikimi i realizimit të punimeve të ndërtimit në terren u konstatuan disa ndryshime nga planvendosja dhe projekti i miratuar në lejen e ndërtimit. Ndryshimet përkojnë me orjentimin e objektit, me ndryshimin e disa çarjeve në fasadë, me ndryshimin e lyerjes së fasadës (kryesisht në katin përdhe), me sistemimin e jashtëm dhe me mbulesën në planin e tarracës. Këto ndryshime pasqyrohen në imazhet e mëposhtme:







-Në bazë të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, Neni 42, në pikën 3, përcaktohet se certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor. Gjithashtu, bazuar në Neni 27/1, mbikëqyrja e punimeve, pika 3, të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, përcaktohet se: " Në çdo rast, verifikimi dhe konfirmimi i akteve të kontrollit , sipas shkronjave "ç" dhe "dh", të këtij neni, janë të detyrueshme. Autoriteti vendor nuk ka kryer të gjitha verifikimet e nevojshme përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, duke sjellë si pasojë disa ndryshimin në planvendosje të objektit, në trajtimin e fasadës dhe me mbulesën me kolona në planin e tarracës.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1. Znj. M.B., *Kryetare e Bashkisë Roskovec;* 2. Znj. E.H., *me pozicion ish drejtoreshë në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;* 3. Znj. S.P., *me pozicion përgjegjëse në Sektorin e Lejeve të ndërtimit;* 4. Znj. B.T., *me pozicion specialiste në Sektorin e Lejeve të ndërtimit.*.

6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV), periudha 01.01.2024 – 31.12.2025.

- Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi dhe mbi procedurat e ndjekura lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit.

1. Procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjes;
2. Vendimet e masave administrative (gjobave);
3. Vendimet e pezullimeve të punimeve;
4. Vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme;
5. Planet mujore, tremujore dhe/ose vjeçare të punës;
6. Dokumentacioni i IMTV-së në lidhje me gjobat e vendosura, arkëtimet, urdhrat ekzekutivë, vendimet e gjykatës etj;
7. Dokumentacioni financiar në lidhje me kontabilizimin dhe arkëtimet e gjobave;
8. Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga IMTV dhe Drejtoria e Financës.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) ushtron aktivitet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 *"Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 *"Për kundërvajtjet administrative"*;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore"*;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *"Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël".*

Për kryerjen e aktivitetit të tij, IMTV, Bashkia Roskovec disponon vetëm një automjet për nevoja të inspektimit ditor, ndërkohë që nuk disponon mjet për ekzekutimin e vendimeve të

prishjeve. Për ekzekutimin e këtyre vendimeve Bashkia ka bashkëpunuar me Ndërmarrjen e tjera të Shërbimeve Publike, si dhe me IKMT.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, dhe përputhshmërisë me dispozitat ligjore, konstatohet se:

6.1. Mbi strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor:

6.1.1. Auditim i periudhës 01.01.2024-31.12.2024.

Referuar strukturës organizative të Bashkisë Roskovec për vitin 2024 dhe informacionit të kërkuar DBNJSHM**,** në lidhje me organizimin e IMTV, rezulton se: është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar. Struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor është miratuar me Vendimin nr. 02, datë 05.01.2024, nr.76 Prot, datë. 05.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë Roskovec. IMTV ka në përbërjen e saj 3(tre) pozicione pune, nga të cilët 1 Kryeinspektor (kat. III-a/1), 2 specialistë (kat. IV-a). Për vitin 2024 struktura e punonjësve te saj paraqitet si në tabelën më poshtë (Tabela nr. 1):

Tabela nr. 1: *Struktura e IMTV, Bashkia Roskovec, 01.01.2024 – 31.12.2024*

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Lloji i arsimit/dega	Data e emërimit	Data e largimit
1	Z.C	Kryeinspektor	Master shkencor "Juridik"	01.02.2022	02.02.2024
2	S.M	Iinspektor	Bachelor "Drejtësi"	17.01.2024	27.01.2025
3	E.C	Kryeinspektor i komanduar	Bachelor "Ing Elektronike"	02.04.2024	15.01.2025

Burimi: Bashkia Roskovec *Përpunoi: Grupi i Auditimit*

Nga tabela e mësipërme rezulton se struktura e IMTV në Bashkinë Roskovec për periudhën 01.02.2022-02.02.2024, drejtohet nga Kryeinspektor Z.C., me profil arsimor "Jurist" dhe Inspektor S.M me profil arsimor "Bachelor "Drejtësi". Ne datën 02.04.2024 është komanduar Kryeinspektor E.C. post të cilin e ka ushtruar deri në datë 15.01.2025.
-Struktura e IMTV Roskovec nuk e ka të plotësuar tërësisht numrin e punonjësve përgjatë vitit 2024, sipas vendimit të Kryetares së Bashkisë Roskovec, me 1 (një) pozicion pune Kryeinspektor (kat. III-a), 2 (dy) Inspektorë (kat. IV-a).
Nga sa paraqitet në tabelën e mësipërme, konstatohet se:
- Për periudhën 02.02.2024 – 02.04.2024, struktura e IMTV nuk ka qenë e plotë, pasi ka pasur një pozicion *"Kryeinspektor"* vakant;
- Për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, struktura e IMTV nuk ka qenë e plotë, pasi ka pasur një pozicion *"Inspektor"* vakant;

Nga të dhënat e pasqyruara edhe në tabelën 1, konstatohet se:
- Janë reflektuar mangësi në plotësimin e strukturës së IMTV me personelin e nevojshëm, sipas organigramës së miratuar me Vendim nr. 02, datë 05.01.2024, me nr. 76 prot.
- Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arsimin e nevojshëm profesional rezulton se në IMTV Bashkia Roskovec, është punësuar staf që nuk plotëson kriteret arsimore të përcaktuara në nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, i cili përcakton se:

Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

Kryeinspekti i komanduar E.C i cili ka qenë pjesë e stafit të IMTV gjatë periudhës 02.04.2024-15.01.2025, ka pasur arsimim si ing-elektronike; profile këto të cilat nuk janë të parashikuara në dispozitat ligjore. Mungesa e stafit të kualifikuar sipas profilit përkatës, përbën element

risku për cilësin e kryerjes së punës të IMTV-së, për përcaktimin dhe përshkrimin teknik në aktet e kontrollit respektive të situatave të konstatuara gjatë inspektimit në terren.

6.1.2. Auditim i periudhës 01.01.2025 - 31.12.2025

Struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor është miratuar me Vendimin nr. 01, datë 06.01.2025, nr.20 Prot, datë. 06.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë Roskovec. IMTV ka në përbërjen e saj 3(tre) pozicione pune, nga të cilët 1 Kryeinspektor (kat. III-2), 2 specialistë (kat. IV-3). Për vitin 2025 struktura e punonjësve te saj paraqitet si në tabelën më poshtë (Tabela nr. 2):

Tabela nr. 2: *Struktura e IMTV, Bashkia Roskovec, viti 2025*

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Lloji i arsimit/dega	Data e emërimit	Data e largimit
1	D.S.	Kryeinspektor	Bachelor "Ing Naftë-Gaz"	16.01.2025	Vazhdon
2	S.M.	Inspektor	Bachelor "Drejtësi"	17.01.2024	27.01.2025
3	E.C.	Inspektor	Bachelor "Ing Elektronike"	02.04.2024	15.01.2025
4	E.C.	Inspektor	Bachelor "Ing Elektornike"	13.10.2025	17.12.2025
5	S.M.	Inspektor	Bachelor "Drejtësi"	12.05.2025	16.12.2025

Burimi: Bashkia Roskovec *Përpunoi: Grupi i Auditimit*

Nga tabela e mësipërme rezulton se struktura e IMTV në Bashkinë Roskovec, për periudhën 16.01.2025 - 31.12.2025 e në vazhdim drejtohet nga kryeinspektor D.S, me profil arsimor Bachelor "Ing Naftë-Gaz" dhe ka pësuar ndryshime të shumta përgjatë vitit 2025 ku më konkretisht; Inspektor E.C në periudhën 16.01.2025-27.01.2025 pastaj në periudhën 12.05.2025-21.05.2025 dhe në periudhën 13.10.2025-17.12.2025, si dhe Inspektor S.M për periudhën 12.05.2025-16.12.2025.

Nga sa paraqitet në tabelën e mësipërme, konstatohet se:
- Për periudhën 27.01.2025 – 12.05.2025, struktura e IMTV nuk ka qenë e plotë, pasi ka pasur dy pozicione *"Inspektor"* vakant, si dhe në periudhën 12.05.2025-13.10.2025 struktura e IMTV nuk ka qenë e plotë, pasi ka pasur një pozicion *"Inspektor"* vakant; vëren të theksohet se kjo strukturë nuk ka qenë e qëndrueshme përgjatë të gjithë vitit 2025.
- Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arsimin e nevojshëm profesional rezulton se në IMTV Bashkia Roskovec është punësuar staf që nuk plotëson kriteret arsimore të përcaktuara në nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar. Inspektori E.C i cili ka qenë pjesë e stafit të IMTV gjatë periudhave të ndryshme të vitit 2025, ka pasur arsimim si ing-elektronike; profile këto të cilat nuk janë të parashikuara në dispozitat ligjore. Mungesa e stafit të kualifikuar sipas profilit përkatës, përbën element risku për cilësin e kryerjes së punës të IMTV-së, për përcaktimin dhe përshkrimin teknik në aktet e kontrollit respektive të situatave të konstatuara gjatë inspektimit në terren.

Nga verifikimi i faqes zyrtare të Bashkisë Roskovec, si dhe informacioni i ardhur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, konstatohet se për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, janë bërë 8(tetë) shpallje për vende të lira pune:
1. Shkresa me nr. 745 prot., datë 05.02.2024, ku është shpallur një pozicion vakant për pozicionin *"Kryeinspektor"*. Kjo procedurë është mbyllur pa kandidat të regjistruar;
2. Shkresa me nr. 1135 prot., datë 22.02.2024, ku është shpallur një pozicion vakant për pozicionin *"Kryeinspektor"*. Kjo procedurë është mbyllur pa kandidat të regjistruar;
3. Shkresa me nr. 2926 prot., datë 22.04.2024, ku është shpallur një pozicion vakant për pozicionin *"Kryeinspektor"*. Kjo procedurë është mbyllur pa kandidat të regjistruar;

4. Shkresa me nr. 3786 prot., datë 24.05.2024, ku është shpallur një pozicion vakant për pozicionin *"Kryeinspektor"*. Kjo procedurë është mbyllur pa kandidat të regjistruar;
5. Shkresa me nr. 4851 prot., datë 01.07.2024, ku është shpallur një pozicion vakant për pozicionin *"Kryeinspektor"*. Kjo procedurë është mbyllur pa kandidat të regjistruar;
6. Shkresa me nr. 5662 prot., datë 22.07.2024, ku është shpallur një pozicion vakant për pozicionin *"Kryeinspektor"*. Kjo procedurë është mbyllur pa kandidat të regjistruar;
7. Shkresa me nr. 7466 prot., datë 19.09.2024, ku është shpallur një pozicion vakant për pozicionin *"Kryeinspektor"*. Kjo procedurë është mbyllur pa kandidat të regjistruar;
8. Shkresa me nr. 9400 prot., datë 05.12.2024, ku është shpallur një pozicion vakant për pozicionin *"Kryeinspektor"*. Kjo procedurë është mbyllur pa kandidat të regjistruar;

Si konstatohet, Bashkia Roskovec ***nuk ka bërë shpallje për pozicione të lira pune Inspektor në IMTV*** (përveç rasteve të sipërcituar), ç'ka do të thotë se nuk janë marrë masa për plotësimin e kësaj strukture dhe ushtrimin e funksionit të inspektimit në përputhje me përcaktimet në kuadrin rregullator të fushës.

Nga verifikimi i faqes zyrtare të Bashkisë Roskovec, si dhe informacioni i ardhur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, konstatohet se për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025 janë bërë 3(tre) shpallje për vende të lira pune:
1. Shkresa me nr. 5895 prot., datë 07.07.2025, ku është shpallur një pozicion vakant për pozicionin *"Inspektor"*. Kjo procedurë është mbyllur pa kandidat të regjistruar;
2. Shkresa me nr. 6675 prot., datë 06.08.2025, ku është shpallur një pozicion vakant për pozicionin *"Inspektor"*. Kjo procedurë është mbyllur pa kandidat të regjistruar;
3. Shkresa me nr. 6678 prot., datë 06.08.2025, ku është shpallur një pozicion vakant për pozicionin *"Inspektor"*. Kjo procedurë është mbyllur pa kandidat të regjistruar;

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
-Znj. V.Z., në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Njërëzore e Shërbimeve Mbështetëse.

6.2. Mbi planifikimin e inspektimeve dhe raportimin periodik:

6.2.1. Mbi planifikimin e inspektimeve:

Inspektorati i Mbrojtes së Territorit Vendor duhet t'i ushtrojë detyrat e tij funksionale në bazë të planeve mujore, tre-mujore dhe / ose vjeçare të punës, sipas planifikimit, i cili hartohet nga Kryeinspektori i IMTV-së, në zbatim të VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore".*
Nga grupi i auditimit është kërkuar dokumentacion dhe informacion mbi hartimin e tyre, në mënyrë periodike dhe përcjelljen tek strukturat e varësisë.

Për periudhën e auditimit 01.01.2024 – 31.12.2024
Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e IMTV për hartimin dhe miratimin e planeve të punës për vitin 2024, është konstatuar se:
- Plani vjetor i punës është hartuar me urdhërin e Kryetares së Bashkisë nr prot/222, datë 12.01.2024, dokumentet janë vendosur në dispozicion për të gjithë periudhën vjetore 01.01.2024-31.12.2024.
Po ashtu edhe për periudhën 01.01.2025-31.12.2025 ka hartim të planit vjetor i hartuar me urdhërin e Kryeters së Bashkisë nr prot/262, datë 10.01.2025.

1) . IMT nuk punon me zona të ndara për secilin inspektor si pasojë e mungesës së stafit.

2). Në dispozicioin të IMT është një makinë e tipit Toyota e cila përdoret gjithashtu dhe nga Policia Bashkiake, kurse përsa i përket mjeteve për prishje nuk disponojnë por kërkojnë bashkëpunimin e sektorve të tjerë të cilët bëjnë të mundur diponibilitetin e mjeteve të nevojshme. Për ekzekutimin e këtyre vendimeve Bashkia ka bashkëpunuar me Ndërmarrjen e tjera të Shërbimeve Publike, si dhe me IKMT.
3).Plane mujore dhe raportime 3 mujore me IKMT nuk kanë mbajtur.
4).IMT nuk ka patur raste të cilat kanë të bëjnë me heqje të licensave për subjekete të cilat kanë shkelur kushtet e lejeve të ndërdimit.

Për periudhën e auditimit 01.01.2024 – 31.12.2024
Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e IMTV për hartimin dhe miratimin e planeve mujore të punës për vitin 2024, është konstatuar se:
- Nuk janë hartuar planet mujore të punës.

Për periudhën e auditimit 01.01.2025 – 31.12.2025
Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e IMTV për hartimin dhe miratimin e planeve mujore të punës për vitin 2025, është konstatuar se:
- Nuk janë hartuar planet mujore të punës.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
-Z E.C., në cilësinë e ish-kryeinspektori të IMTV (02.04.2024-15.01.2025).
-Z D.S., në cilësinë e Kryeinspektori të IMTV (16.01.2025-vazhdim).

6.2.2. Mbi raportimin periodik:
Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet të përgatisë dhe t'i japë të dhëna statistikore c çdo tre muaj për masat e marra, si p.sh. vendimet e marra ndaj kundërvajtjeve të konstatuara (pezullim, gjobë, prishje të objektit të kundërligjshëm), kallëzimet penale, si dhe kërkesat për heqje të licensave profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, sipas përcaktimeve të nenit 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* pika f). Nga ana e IMTV nuk janë vendosur në dispozicion raportimet për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, si dhe për periudhën 01.01.2025-31.12.2025 pasi nga ana e IMTV Bashkia Roskovec nuk mbahet plane mujore, 3-mujore.

Për periudhën e auditimit 01.01.2024 – 31.12.2024
Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e IMTV, për raportimin periodik ndaj Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit të punës sipas ligjit në fuqi për vitin 2024, është konstatuar se:
-Në asnjë rast nuk janë kryer raportime dhe mbajtje korespodence me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

Për periudhën e auditimit 01.01.2025 – 31.12.2025
Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e IMTV, për raportimin periodik ndaj Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit të punës sipas ligjit në fuqi për vitin 2025, është konstatuar se:
-Në asnjë rast nuk janë kryer raportime dhe mbajtje korespodence me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
-Z E.C., në cilësinë e ish-kryeinspektori të IMTV (02.04.2024-15.01.2025).
-Z D.S., në cilësinë e Kryeinspektori të IMTV (16.01.2025-vazhdim).

6.3. Mbi dokumentimin e procesit të prishjes së objekteve të kundërligjshëm me evidenca fotografike:

Në zbatim të nenit 41 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a), inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të proceseve të punës, në këtë rast të procesit të prishjes së objektit të kundërligjshëm, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë.

Nga auditimi i procedurave të vendimeve të prishjes së objekteve të kundërligjshëm gjatë vitit 2024, është konstatuar se për vitin 2024 nuk ka pasur vendime prishje nga ana e IMTV Bashkia Roskovec.

Për vitin 2025 nga ana e Bashkisë Roskovec ka pasur 8(tetë) vendime për prishje të objekteve

Tabela nr. 3: *Vendimet e prishjeve, viti 2025*

Nr	Emër Mbiemër	Nr Vendnim-Prishje
1	M.M.	Nr41. Datë 29.07.2025
2	A.K.	Nr42. Datë. 22.08.2025
3	A.T.	Nr43. Datë. 22.08.2025
4	N.B.	Nr44. Datë. 22.08.2025
5	S.S.	Nr45. Datë. 22.08.2025
6	D.H.	Nr46. Datë. 22.08.2025
7	Z.F.	Nr47. Datë. 22.08.2025
8	K.K.	Nr48. Datë. 27.08.2025

6.4. Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të pezullimit të punimeve:

Vendimi për pezullimin e punimeve në ndërtim nxirret në rastin kur është i nevojshëm një afat kohor paraprak, për marrjen e vendimit, për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës, ose për marrjen e vendimit për prishjen e objektit. Pezullimi i punimeve në ndërtim ka afat deri në 60 ditë. Një vendim i tillë merret në rastet kur:

- subjekti i kontrolluar mungon në objekt ose nuk i paraqet grupit të inspektimit dokumentacionin teknik e/ose ligjor të punimit/ndërtimit;
- mungojnë masat e sigurimit teknik në objekt dhe mjetet mbrojtëse të jetës së punëtorëve;
- plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor kërkon proces miratimi nga autoriteti përgjegjës i planifikimit;
- vendimi i pezullimit të punimeve të ndërtimit për plotësimin e dokumentacionit teknik e/ose ligjor ka rezultuar i pamjaftueshëm dhe subjekti ndërtues kërkon zgjatjen e afatit, duke e argumentuar në mënyrë zyrtare.

Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se:

Për vitin 2024:

Nga ana e IMTV nuk ka pasur raste vendimi i pezullimit të punimeve.

Për vitin 2025:

- Nga ana e IMTV janë mbajtur 2(dy) procedura në total. Nga këto procedura është nxjerrë vendimi i pezullimit të punimeve.

-Për rastet kur nuk është nxjerrë vendimi i pezullimit të punimeve, nuk janë konstatuar problematika / devijime nga legjislacioni në fuqi;

Tabela nr. 4: *Rastet kur nxjerra e vendimit të pezullimit është në përputhje me legjislacionin, viti 2025*

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar
	Nr. serie	Data		
1	10	23.09.2025	"A.C."	Subjekti ndërtues "A. C." ka kryer punime ndërtimi në shkelje të rregullave të ndërtimit dhe rregullat e kantierit. c
2	11	12.11.2025	"F.' shpk	Subjekti ndërtues 'F."shpk ka kryer punime dhe ka prishur rrugën në disa segmente duke e bërë të pakalueshme dhe ka sjellë shqetësim te qytetarët. Parashikuar nga vendimi Nr 448, datë 31.07.2025

6.8 Mbi arkëtimin e masave administrative:

Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Roskovec:

-Për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, rezulton se janë vendosur ***4 gjoba*** në vlerën ***560,000 lekë***, dhe janë arkëtuar prej tyre ***dy gjoba*** në vlerë **260,000 l*ekë.***

-Është falur nje gjobë me vlerë 150,000 *lekë*.

-Për një gjobë me vlerë **150,000** ***lekë*** kundrejt shtetasit S.T, nga ana e Bashkisë Roskovec, nuk ka asnjë informacion lidhur me gjendjen e saj(as nuk është paguar masa administrative dhe as nuk është falur)**.**

-Për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025, rezulton se janë vendosur ***6 gjoba*** në vlerën ***2,573,780 lekë***, dhe janë arkëtuar prej tyre ***4 gjoba*** në vlerën ***210,000 lekë***.

- Është në proces gjyqësor me shtetasin M.M banor i Njësisë Suk-1, pasi me vendim Nr,41 datë 29.07.2025 ndaj keëtij shtetasi është vendosur masa e gjobës në vlerë 2,313,780, si dhe vendim prishje të objektit të ndërtuar pa lejen përkatëse.

Në total, për të gjithë periudhën nën auditim janë vendosur ***10 gjoba*** në vlerën ***3,133,780 lekë***, dhe janë arkëtuar prej tyre ***6 gjoba*** në vlerën ***470,000 lekë***.

Për periudhën e auditimit:

Në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja "e", të ligjit nr. 107/2014, "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë në masën e barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje. Në rastet kur ndërtimi realizohet për qëllime fitimi, masa e gjobës nuk mund të jetë më e vogël se 35,000 lekë për metër katror.

Nga verifikimi i masave administrative të vendosura gjatë periudhës objekt auditimi rezultoi se, përgjithësisht, vlerat e gjobave janë përllogaritur në përputhje me bazën ligjore përkatëse. Përjashtim përbën rasti i evidentuar me procesverbalin nr. 30, datë 19.04.2024, ndaj kundërvajtësit Perikli Gishti, për ndërtim pa leje, për të cilin është vendosur gjobë në vlerën 210,000 lekë. Për këtë rast, nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton i argumentuar dhe i dokumentuar përllogaritja e masës së gjobës në raport me sipërfaqen, destinacionin dhe vlerën e punimeve të kryera pa leje.

Tabela nr. 5: *Rastet e vendosjes së masave administrative janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:*

PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar	Vlera e gjobës, në lekë
Nr. serie	Datë			
30	19.04.2024	"P.G."	Objekt ndërtimi pa leje përkatëse	210,000
31	01.08.2024	"G.".shpk	Fillim punimesh pa deklaruar dhe mos vendosje tabele për zhvillim punimesh	50,000
32	24.06.2025	"M.C."	Tejkalim të autorizimit (vendimit) Nr, 14, datë 07.05.2025	50,000
33	27.06.2025	"E.H."	Mosdeklarim punimesh që përjashtohen nga pajisja me leje ndërtimi	50,000
34	11.07.2025	"E.V."	Mosdeklarim punimesh që përjashtohen nga pajisja me leje ndërtimi	50,000
36	15.12.2025	"F.R."	Objekt ndërtimi pa leje përkatëse	60,000

Për periudhën e auditimit:

- Në dy raste IMTV Bashkia Roskovec nuk ka vendosur asnjë informacion në lidhje me masat e marra për vjeljen e masave administrative;
- Në një rast nga informacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se statusi i vjeljes së gjobës është *"procesi është në shqyrtim nga gjykata pasi palët janë në gjyq.*

Tabela nr. 6: *Këto raste (rastet kur nuk është paguar masa administrative) janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:*

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar	
	Nr. serie	Datë			Vlera e gjobës
1	33	24.09.2024	"S.T."	Mosdeklarim punimesh që përjashtohen nga pajisja me leje ndërtimi	150,000 lekë
2	35	14.11.2025	"K.D."	Mosdeklarim punimesh që përjashtohen nga pajisja me leje ndërtimi	50,000 lekë

- Në një rast, IMTV Bashkia Roskovec nuk ka dhënë asnjë informacion në lidhje me masat e marra për vjeljen e masës administrative;
- Në një rast, nga informacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se statusi i vjeljes së gjobave është *"Në proces gjyqësor",* që do thotë se që nga dita e nxjerrjes së vendimit për dënim me masë administrative gjobë (gjatë vitit 2025) deri në ditën e mbajtjes së akt-konstatimit, nga IMTV nuk janë marrë të gjithë hapat ligjor për arkëtimin e këtyre vlerave monetare;
-Në një rast, nga informacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se statusi i vjeljes së gjobave është *"Përfiton"*, duke nënkuptuar se këta kundërvajtës janë subjekt i Ligjit nr. 127, datë 19.12.2024 *"Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 01 Janar 2015 deri më 30 Nëntor 2024 nga Inspektoratet vendore të mbrojtjes së territorit, Inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit, Autoriteti kombëtar i ushqimit, Inspektorati shtetëror shëndetësor, si dhe Policia e shtetit dhe ajo bashkiake"*. Edhe pse në këto kushte, për gjobat e vendosur nga data 01.01.2024 – 30.09.2024, nga IMTV nuk janë marrë të gjithë hapat ligjor për arkëtimin e këtyre vlerave monetare;

7. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM, periudha 01.01.2024 – 31.12.2025.

- Auditim mbi statusin e pronave të transferuara me VKM dhe rregjistrimin e tyre në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).
- Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likujdimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.
-Listat e inventarëve sipas VKM-ve përkatëse;
-Gjendjen e inventarit të pasurive të paluajtshme dhe regjistrimin e tyre në Drejtorinë Vendore të DVASHK-së, Roskovec;
-Listat e inventarit të regjistruar/pa regjistruar pranë DVASHK (Roskovec);

Bashkia Roskovec e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore, për secilën
fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuara në programin e auditimit. Kryetare e Bashkisë Roskovec është znj. M.B., dhe Këshilli Bashkiak i Roskovec përbëhet nga 21 anëtarë, të cilët janë mandatuar në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023 dhe konstituuar më 28 qershor 2023.
Bashkia Roskovec funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, referuar në Urdhrin me Nr. 92, datë 11.04.2025, nr. 2799 prot., "Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit, të Bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative". Grupi i punës, i ngarkuar për zbatimin e këtij vendimi është gjithë administrata e Bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative.
Bashkia Roskovec, me Urdhrin e Kryetarit të saj, znj. M.B. me nr. 1, datë 06.01.2025, e administruar me Nr. 20 prot., datë 06.01.2025, ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve dhe strukturën organizative sipas drejtorive/sektorëve. Struktura e cila merret me administrimin e pasurive (aseteve), është pjesë e Drejtorisë së Administrimit, Menaxhimit dhe

Mbrojtjes së Tokës. Sektorin e Bujqësisë Kullimit, Vaditje, Veterinarisë, Sektorin e Pyjeve dhe Sektorin e Kadastrës, që kanë përgjegjësi për dokumentimin dhe azhornimin e të dhënave për asetet e Bashkisë Roskovec. Strukturat sa më sipër, mbikëqyrin gjithë procesin e inventarizimit në bazë të urdhrit të titullarit dhe arshivojnë gjithë inventarët, sigurojnë dokumentimin, inventarizimin dhe ruajtjen e mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit përkatës financiar kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të inventarit kontabël të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese, përpilojnë fletët e inventarit të aktiveve të qëndrueshme sipas zyrave në Bashki, institucioneve të arsimit, çerdheve, gjendjes civile, ndriçimit rrugor dhe mbajnë kartelat për aktivet e qëndrueshme dhe inventarin e imët. Është krijuar sektori i cili përbehet si me poshtë:

E.K.- Përgjegjës i Sektorit, B.T. –Specialiste, L.T. –Specialiste.

Aktualisht ky sektor është me një punonjës ne vakancë si dhe punonjësja B.T. është me leje lindje. Deri ne vitin 2024, ky sektor është quajtur Sektori i Regjistrimit te pronave Publike dhe

përtej detyrave te ngarkuara nga titullari misioni i sektorit ka qenë ndjekja e proceduarave te inventarizimit dhe te regjistrimit te pronave publike te Bashkisë Roskovec dhe me pas me konfirmimet ne strukture është vendosur emërtimi "Sektori i Menaxhimit te Pronave" .

Njësitë Administrative dhe fshatrat në varësi administrimi të Bashkisë së Roskovec, janë si vijon:

Roskovec: Qyteti Roskovec,

Njësitë Administrative: Kurjan, Kuman dhe Strum.

Si çdo institucion publik, edhe Bashkia Roskovec, ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: Pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Roskovec i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve, si dhe një pjesë të tyre nga shkrirja e ish-komunave, aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Roskovec. Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Roskovec, duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj...

Mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të aseteve në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

a) Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative: Roskovec, Kurjan, Kuman dhe Strum, gjatë Vitit 2024-2025, nuk është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve, të cilat janë transferuar në Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative, si dhe nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të këtyre pronave, duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik, më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Veprime këto në kundërshtim me *Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", Neni 37, pika 1,* ku përcaktohet që, "Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara, apo të transferuara në favor të tyre brenda 18-muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji".

b) Sa më sipër, grupi i auditimit kërkoi regjistrin e pronave, tokave dhe pasurive natyrore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Roskovec. Gjithashtu, referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Roskovec, në mënyrë të përgjithshme përcaktohen detyrat për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve, për inventarizimin e pronave, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve dhe më pas regjistrimin në kadastër. Nga sa konstatohet edhe nga materiali i vënë në dispozicion grupit të auditimit, se: Bashkia Roskovec disponon një regjistër kontabël në formatin "Excel", jo sipas formatit të përcaktuar në *Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.* Konkretisht në të nuk evidentohet data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia. Gjithashtu nuk është përmbushur detyrimi ligjor për krijimin e një regjistri fizik në zbatim të *Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26-30,* si dhe pronat e transferuara me VKM-të, nuk janë të evidentuara saktësisht në regjistrat të cilat Bashkia Roskovec i mban në programin "Excel".
Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë inventarizuar, si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale.
Dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse në lidhje me asetet e Bashkisë, janë vënë në dispozicion me shkresa zyrtare nëpërmjet VKM-ve përkatëse, si më poshtë:

c. Me VKM-të përkatëse janë transferuar në total **458 pasuri** si: ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat **443 pasuri në pronësi** dhe **15 pasuri në përdorim,** si më poshtë:

Nr.	*Njesia Vendore*	*VKM ,(inventarzim)*		*VKM , (Shpronesim)*		*Prona ne total*	*Në përdorim Në numër*	*Në pronësi Në numër*	*Nga këto regjistruar*
		Numër	*Datë*	*Numer*	*Date*				
1	*Bashkia Roskovec*	*770*	*24.09.2010*			*161*	*7*	*154*	*15*
				455	*10.07.2024*	*5*		*5*	*5*
				269	*09.05.2025*	*2*		*2*	*2*
2	*Ish Komuna Kuman*	*1210*	*11.12.2009*			*82*	*7*	*75*	*13*
3	*Ish Komuna Kurjan*	*108*	*17.02.2010*			*47*	*0*	*47*	*4*
		27	27.01.2023			1		1	1
		453	10.07.2024			3		3	3
4	*Ish Komuna Strum*	*241*	*25.04.2007*			157	1	156	1
	Totali					*458*	*15*	*443*	44

- **<u>Bashkia Roskovec</u>**

<u>Bashkisë Roskovec</u>, me VKM nr. 770, datë 24.10.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi, ose në përdorim të Bashkisë Roskovec "i është miratuar lista inventarit me 34 flete, dhe përfundon me numrin rendor 161 (njëqind e gjashtëdhjetë e një)

<u>Ish Komuna Kurjan sot Njësia Administrative Kurjan e Bashkisë Roskovec</u>, me VKM nr. 108, datë 17.02.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish Komunës Kurjan ,Bashkia Roskovec ", i është miratuar lista inventarit me 31 flete dhe përfundon me numrin rendor 125 (njëqind e njëzetë e pesë)

Ish Komuna Kuman sot Njësia Administrative Kuman e Bashkisë Roskovec, me VKM nr. 1210, datë 11.12.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish Komunës Kuman ,Bashkia Roskovec ", i është miratuar lista inventarit me 29 flete dhe përfundon me numrin rendor 122 (njëqind e njëzetë e dy) .

Ish Komuna Strum sot Njësia Administrative Strum e Bashkisë Roskovec, me VKM nr. 241, datë 25.04.2007 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish Komunës Strum ,Bashkia Roskovec ", i është miratuar lista inventarit me 33 flete dhe përfundon me numrin rendor me nr. 157 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë).

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, nga subjekti i audituar, rezulton se: Asetet janë dorëzuar nëpërmjet shkresave me VKM-të përkatëse, nga Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht për Bashkinë Roskovec nëpërmjet shkresës nr. 4467/7 prot, datë 11.06.2009 dhe Njësive Administrative nëpërmjet shkresës nr. 5946 prot, datë 04.12.2015 dhe për Fondin Pyjor-Kullosor nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet shkresës me nr. 2367 prot., datë 17.03.2021.

Bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga subjekti, në tabelën e mëposhtme është pasqyruar numri i pronave sipas listës së inventarit, si dhe VKM-ve përkatëse të njësive Administrative dhe të Bashkisë Roskovec.

Tabela përmbledhëse e pronave sipas listës së inventarit

Nr	Emertimi i Pasurisë	Zona kadastral	Nr Pasurise	Indeksi I harte	Nr. rregjis	Siperfaqia sipas V.K.M.		Data e aplikimit Nr. Dt.	Vertetim ose certifikate Hipoteke	Siperfaqia sipas Faktit	
						Truall	Ndert			Truall	Ndert
1	Shkolla 9-Vjecare Suk1	3538	56/2+56/3	168-A	5	5689	406	18091 datë 04.07.2024		5689	406
2	Fushe sporti Suk1	3538	56/1	168-A	16	12900		9938 datë 13.05.2024		11840	
3	Kenete ,Kuman	2326	5	214-B	43	7300		19536 datë 01.10.2024		1200	
4	Kenet ,Kuman	2326	190	214-B	43	7300		19536 datë 01.10.2024		1400	
5	Kenet , Kuman	2326	191	214-B	43	7300		19536 datë 01.10.2024		1400	

Burimi: Bashkia Roskovec

Inventarët e pronave të paluajtshme të miratuara me VKM, përgjatë viteve dhe VKM-të për njësitë e tjera administrative, nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Roskovec, nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së, mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm që kanë pësuar këto pasuri, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit, apo vendimet gjyqësore.

Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26-30 konstatohet se nga strukturat përgjegjëse nuk janë ngritur grupet e punës, apo ndërmarrë masa konkrete për ndjekjen e procedurës së inventarit të pasurive të paluajtshme sipas VKM-ve respektive.

Konstatohet se, në Vitin 2025 janë marrë disa masa duke kryer disa aplikime nga ana e Bashkisë Roskovec, për regjistrim në ASHK Fier, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2025. kjo është kryer nga një grup pune i ngritur në bashki, që do të ndjekë zbatimin e këtyre VKM-ve, si edhe regjistrimin e pronave në ASHK.

Në mënyrë të detajuar paraqiten pronat të cilat janë aplikuar nga Bashkia Roskovec, për regjistrim në ASHK Fier, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2025 si vijon:

Nga dokumentacioni i kërkuar dhe vënë në dispozicion grupit të auditimit, sa u përket pasurive të cilat janë aplikuar për t'u pajisur me dokumentacionin ligjor, në Vitin 2023, nga Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, u kërkuan praktikat e aplikimit. Nga auditimi i secilës praktikë, rezulton se është aplikuar, si më poshtë vijon:

-Me shkresën nr.241 Prot datë 16.01.2023 me lëndë "Mbi kalimin në pronësi të Bashkisë Roskovec të pasurisë nr.406/1-A zk 3196 Roskovec, Bashkia Roskovec.

-Me shkresën nr.374 Prot datë 20.01.2023 me lëndë "Mbi kalimin në pronësi të Bashkisë Roskovec të pasurisë nr.213 zk 3805 fshati Vlosh , Nj.A. Kurjan, Bashkia Roskovec

-Me shkresën nr.241/1 Prot datë 17.01.2023 me lëndë "Mbi kalimin në pronësi të Bashkisë Roskovec të pasurisë nr.406/1-A zk 3196 Roskovec, Bashkia Roskovec

-Me shkresën nr.762 Prot datë 07.02.2023 me lëndë "Kthim përgjigje për vazhdimin e regjistrimit të pasurisë nr.213 truall zk 3805 fshati Vlosh, Nj.A. Kurjan, Bashkia Roskovec.

-Me shkresën nr.1529/1 Prot datë 20.03.2023 me lëndë "Plotësim dokumentacioni për kalimin në pronësi të Bashkisë Roskovec të pasurisë nr.406/1-A zk 3196 Roskovec, Bashkia Roskovec

-Me shkresën nr.2054 Prot datë 28.03.2023 me lëndë "Plotësim dokumentacioni për kalimin në pronësi të Bashkisë Roskovec të pasurisë nr.406/1-A zk 3196 Roskovec, Bashkia Roskovec

-Me shkresën nr.3061/1 Prot datë 10.07.2023 me lëndë "Dërgim informacioni në lidhje pasurisë nr.213 dhe objektet që ndodhen në këtë pasuri, zk 3805 fshati Vlosh, Nj.A. Kurjan, Bashkia Roskovec.

-Me shkresën nr.667 Prot datë 02.02.2023 me lëndë "Mbi procedurën e regjistrimit të apartamenteve të "Objektit 3Kt Social për Strehim " zk 3196 Roskovec, Bashkia Roskovec.

-Me shkresën nr.7739 Prot datë 30.09.2024 me lëndë " Dërgim dokumentacioni për regjistrimin e pasurive nr.5,190,191 zk 2326 "Kënetë' fshati Kuman, Bashkia Roskovec.

-Me shkresën nr.3208 Prot datë 02.05.2024 me lëndë "Kthim përgjigje për vazhdimin e procedurës për regjistrimin e pronës "Shkollë 9-vjecare fshati Suk-1, Nj.A. Strum, Bashkia Roskovec.

-Me shkresën nr.3209 Prot datë 02.05.2024 me lëndë " Dërgim dokumentacioni për regjistrimin e pasurisë nr.56/1 "Fushe Sporti " fshati Suk-1,Nj.A.Strum, Bashkia Roskovec.

-Me shkresën nr.5385 Prot datë 11.07.2024 me lëndë "Plotësim dokumentacioni për vazhdimësinë e regjistrimin e pronës "Shkollë 9-vjecarë ,Suk-1", Nj.A. Strum, Bashkia Roskovec.

-Aplikim AV0 nga sistemi e albania me nr.18925 datë 29.09.2024 "Për procedurën e regjistrimit të pronës "Fushë Sporti –Suk1 " zk 3538 , Nj.A. Strum, Bashkia Roskovec.

-Me shkresën nr.3365/1 Prot datë 21.05.2024 me lëndë "Dërgim informacioni në lidhje objektet që ndodhen në pasurin 213/1,zk 3805 fshati Vlosh , Nj.A. Kurjan, Bashkia Roskovec.

-Me shkresën nr.5626 Prot datë 19.07.2024 me lëndë "Dërgim dokumentacioni për regjistrimin e pasurive 213/1-ND1,ND2,ND3 ,zk 3805 fshati Vlosh , Nj.A. Kurjan, Bashkia Roskovec.

-Aplikim AV0 nga sistemi e albania me nr.14771 datë 24.07.2024 për procedurën e regjistrimit të pronës "Objektit 3Kt Social për Strehim ", Bashkia Roskovec.

-Aplikim AV0 nga sistemi e albania me nr.17108 datë 27.08.2024 "Për procedurën e regjistrimit të pronës "Fushë Sporti –Suk1 " zk 3538 , Nj.A. Strum, Bashkia Roskovec.

-Me shkresën nr.1692 Prot datë 08.02.2025 me lëndë " Dërgim dokumentacioni për regjistrimin e pasurisë nr.2/610 "Sheshe " Roskovec, Bashkia Roskovec.

-Me shkresën nr.4055 Prot datë 31.05.2025 me lëndë " Kërkesë për bashkëpunim në zbatim të vkm 269 datë 09.05.2025 " dhe për regjistrim të pasurive të shpronësuar më këtë VKM, Roskovec, Bashkia Roskovec.

-Nga analiza e praktikave fizike dhe materiali i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Administrimit të Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, grupi i auditimit ka konstatuar se:
Për sa trajtuar më sipër, nga Bashkia Roskovec, nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjitha pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve, të sipërpërmendura. Veprime këto në kundërshtim me *Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" Kreu IV neni 37 pika 1, 2. gërma a, b, Ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015,* "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu (VI) "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme" dhe *Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26-30.*

Me VKM nr. 398 datë 15.03.2020 Për disa ndryshime në vendimin Nr. 433, Datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për Transferimin në Pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe Kullotave Publike sipas Listave të Inventarit dhe Aktualisht në Administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish-Komunave/Bashkive"
Bashkia Roskovec ka në administrim këto sipërfaqe;
- *Sipërfaqe totale:* 208.21 ha.
- *Pyje:* 208.21 ha.
- *Kullota:* 0 ha.

Detyrimet nga qiratë e sipërfaqeve pyjore/tokave bujqësore
Bashkia Roskovec deri në 31.12.2025 ka disa sipërfaqe bujqësore, pyjore të dhëna me qira personave fizikë, juridikë apo individëve. Referuar dokumentacionit shkresor dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Roskovec, Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, informacionin mbi treguesit kadastral të përditësuar, për ndryshimet në nivel vendor të fondit pyjor e kullotave. Sipërfaqet pyjore dhe kullosore në Bashkinë Roskovec, për Vitin 2025 janë paraqitur në (Tabelën si më sipër).
Konstatohet se: Ndonëse rezulton nga informaconi i vënë në dispozicion nga - Bashkia Roskovec se kanë një sipërfaqe të pyjeve prej 208.21 ha**,** nuk kanë plane mbarështimi, çka do të thotë se nuk kanë edhe të ardhura nga ekonomia pyjore, duke i konsideruar një aset të rëndësishëm. Bashkia Roskovec, rezulton se për Vitin 2024-2025, nuk ka asnjë të ardhur për sipërfaqen pyjore.

Asetet e dhëna me qira
Dhënia e aseteve të bashkisë me qira realizohet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:
- *Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Nenet 826-840;*
- *Ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore;*
- *VKM me nr. 54, datë 5.2.2014, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", e ndryshuar;*
- *VKM me nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM-në me nr. 1064, datë 22.12.2010, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".*

Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve
Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, në total janë aktive **4** kontrata. Nga informacioni i kërkuar dhe vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezulton se për Vitin 2024-2025, nuk ka kontrata të reja të lidhura, për dhënien me qira të aseteve, që administrohen nga Bashkia Roskovec, konkretisht analizuar si vijon:

Kontrata për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Roskovec nuk ka lidhur kontrata të reja për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve. Për Vitin 2023 kanë qenë aktive **4** kontrata. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, për këto kontrata për Vitin 2023, ka vetëm 1 (një) debitor nga kontratat e qirasë**.** Analiza e detajuar mbi personat të cilët kanë nënshkruar kontratë qiraje për ndërtesat/objektet me Bashkinë Roskovec, si dhe likuidimet e detyrimeve për këto kontrata paraqiten në tabelën e pasqyruar si më poshtë.

Kontratat për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve.

Në lidhje me kontratat e dhënieve me qira të aseteve në pronësi të Bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative, Drejtoria e të Ardhurave Vendore ju informojmë si më poshtë:

Për periudhën e audituar, në total janë të nënshkruara 10 kontrata për dhënien me qira të tokës të cilat administrohen nga Bashkia Roskovec.

Personat dhe subjektet të cilët kanë lidhur kontratë me Bashkinë Roskovec janë:

Nr.	Emër Mbiemër	Data e lidhjes së kontratës	Sipërfaqa në ha	Detyrimi deri më 31.12.2024	Detyrimi nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025	Totali Progresiv
1	B.C	09.09.2021	1 ha	0	0	0
2	S.I	05.10.2010	1.14 ha	0	**28 500**	**28 500**
3	L.G	23.05.2012	0.438 ha	0	0	0
4	B.S	02.01.2012	0.5615 ha	0	0	0
5	A.S	02.09.2010	0.1725 ha	0	0	0
6	M.S	30.08.2010	2.5 ha	0	0	0
7	L.S	23.03.2012	20 ha	0	0	0
8	B.L	10.08.2023	1.3153 ha	**0**	**0**	**0**
9	B.L	10.08.2023	0.9142 ha	**0**	**0**	**0**
10	A. L. SH.P.K	04.03.2022	3 ha	**0**	**21 000**	**21 000**
	Total		31.8915	**0**	**49 500**	**49 500**

Për periudhën e auditimit, në total janë nënshkruar 8 kontrata për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve të cilat administrohen nga Bashkia Roskovec. Personat të cilët kanë lidhur kontratë me Bashkinë Roskovec janë:

Nr.	Subjekti	Nipti	Afati	Viti i lidhjes së kontratës	Sipërfaqe në m^2	Vlera në vit	Vlera e likuiduar	Detyrimet e pa likuiduara
1	A.B	familje	1 vjecare	31.10.2024	60 m^2	88 800	88 800	-
2	Zyra Arsimore		1 vjecare	11.03.2025	122m^2	366 000	366 000	-
3	F.K	familje	30 vjet	19.11.2020	70m^2	89 592	89 592	7 466
4	S.L	familje	30 vjet	23.03.2021	84m^2	89 640	29 880	59 760
5	G.H	familje	30 vjet	24.03.2021	78m^2	83 184	83 184	-
6	M.B	familje	30 vjet	08.03.2021	65m^2	83 184	69 320	13 864
7	T.L	familje	30 vjet	23.03.2021	84m^2	83 184	36 252	46 932
8	A.C	familje	30 vjet	31.01.2024	78m^2	83 184	957 280	-

Burimi: *Bashkia Roskovec, përpunoi grupi i auditimit*

Nga auditimi i dokumentacionit shkresor dhe statistikor (tabelave) rezultoi se: Janë lidhur kontrata qiraje me 8 subjekte, për afate të ndryshme kohore, nga të cilat, 4 subjekte (familje) kanë paguar detyrimin kontraktor, ndërsa 4 subjekte (familje), *nuk kanë paguar detyrimin, i cili deri në 31.12.2025, është në vlerën prej 128.022 Lekë (e cila përfshin debinë për vitet 2025, për qiranë vjetore* vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Roskovec.

Sa më sipër konstatuar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike (Drejtorinë e Çështjeve Ligjore) në Bashkinë Roskovec, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për të arkëtuar vlerën prej *128.022* Lekë.

8. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

1. Planet e masave të ndërmarra nga Institucioni i Bashkisë Roskovec për zbatimin e rekomandimeve.

2. Dokumentacion plotësues dhe justifikues për zbatimin e rekomandimeve.
3. Kthim përgjigje mbi pyetësorin për zbatimin e rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

1. Verifikimi i respektimit të afateve ligjore për njoftimin e KLSh-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe mbi verifikimin e raportimi në KLSh-së, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSh-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Në zbatim të nenit 15, gërma "j", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, Institucioni i Bashkisë Roskovec ka kthyer përgjigje në KLSh me shkresën nr. 343/24 prot., datë 24.10.2024, duke respektuar edhe njëkohësisht edhe afatin 20 ditor.
Raporti përfundimtar ka ardhur ne institucion ne date 14.10.2025 me nr. Prot. 8640. Pasi u njohëm me të, është bere plani i veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të adresuara nga Klsh për vitin 2025, protokolluar me nr. 8640/2 prot, datë 03.11.2025 dhe miratuar me vendim të titullarit protokolluar me nr. 8640/1 prot, datë 03.11.2025.
Ky vendim është nisur në institucionin e KLSH-së me shkresën nr. 8640/3 prot, datë 10.11.2025.
***Zbatimi*:** Ky detyrim ligjor është **zbatuar**.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSh, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Institucioni i Bashkisë Roskovec janë në proces për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke afatin 6 mujor. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, pika 2, ku përcaktohet që:

"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna".

***Zbatimi*:** Lidhur me këtë detyrim ligjor nuk mund të shprehemi, referuar shkresës përcjellëse me nr. 316/10 prot., datë 11.09.2023 e dërgimit të të Raportit Përfundimtar të Auditimit si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situates, nuk mund të shprehemi pasi është brenda afatit 6 – mujor.

III. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në institucionin e Bashkisë Roskovec administruar në KLSh me nr. 343/24 prot., datë 24.10.2024 datë 07.10.2024, dhe protokolluar në Bashkinë Roskovec me nr. 8640/3 prot, datë 10.11.2025, janë rekomanduar gjithsej:

- **20** Masa Organizative;
- **1** Masa Disiplinore;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Sipas shkresës së administruar në institucionin e Bashkisë Roskovec me nr. 8640/2 prot, datë 03.11.2025, statusi i provueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	**20**	**20**	**0**
Masa disiplinore	**1**	**0**	**1**
Totali	**21**	**20**	**1**

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

2. Zbatimi i rekomandimeve ***"Për përmirësimin e legjislacionit në fuqi".*** Në auditimin e zhvilluar nga KLSh-ja në zbatim të Programit të Auditimit nr. 563/2 prot., datë 31.05.2024, i ndryshuar, në subjektin *"Bashkia Roskovec"* për veprimtarinë nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2023, me objekt *"Auditim Financiar dhe Përputhshmërie"*, ku është konkluduar me Raportin Përfundimtar të Auditimit dërguar pranë institucionit të Bashkisë Roskovec me shkresën nr. 563/10 prot., datë 07.10.2024, **nuk janë dhënë rekomandime** të kategorisë *"Për përmirësimin e legjislacionit në fuqi"*.

3. Zbatimi i rekomandimeve ***"Për masa me karakter organizative".*** Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar **20 masa organizative** të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuara **10** masa janë zbatuar plotësisht, **2** masa janë zbatuar pjesërisht, **3** masë është në proces zbatimi dhe **5** masa nuk është zbatuar.

MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandim: Menaxhimi i lartë i Bashkisë Roskovec të miratojë dhe të zbatojë një procedurë të standardizuar për menaxhimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit, duke krijuar një regjistër të centralizuar, përcaktuar përgjegjësitë për raportimin e progresit, vendosur afate të qarta për zbatim dhe zhvilluar indikatorë të matshëm për vlerësimin e efektivitetit. Ky mekanizëm të integrohet në analizat vjetore të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, me qëllim forcimin e llogaridhënies, përmirësimin e vazhdueshëm dhe rritjen e transparencës në menaxhimin e burimeve publike në nivel vendor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment mbi zbatimin e rekomandimit: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi i mësipërm rezulton në proces.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 rezulton në **proces zbatimi.**

2.1. Rekomandim: Bashkia Roskovec, në cilësinë e njësisë publike përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm *(NjAB)*, duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për përmirësimin e strukturës, kapaciteteve dhe metodologjisë së veprimtarisë së NjAB-së konkretisht:

- Të sigurohet certifikimi, rekrutimi i audituesve të NjAB dhe trajnimi, zhvillimi i vazhdueshëm profesional, në përputhje me kërkesat ligjore.
- Të standardizohet dokumentacioni i auditimit, përmes auditimeve të planifikuara krijimit të dosjeve të përhershme dhe strukturimit profesional të angazhimeve, duke përfshirë matrica risku, objektiva të qarta dhe klasifikim të performancës.
- Të zbatohet një program i brendshëm për sigurimin e cilësisë, si dhe të vendoset një mekanizëm i qartë për ndjekjen e rekomandimeve, me klasifikim sipas riskut, afateve dhe përgjegjësive institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Është në proces certifikimi një prej audituesve, Z.F. të NjAB. Është siguruar zhvillimi i vazhdueshëm profesional, në përputhje me kërkesat ligjore.

Konkretisht:

Përgjegjësi i Sektorit të auditimit kanë ndjekur trajnimin e vazhdueshëm profesional për vitin 2025. Po kështu, ka qënë pjesëmarrës në trajnimin e zhvilluar në Korcë me tematikë,

Trajnim Rajonal për AB dhe Koordinatorët për "M.F.K. në NJ.V.V." ofruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Projekti "Financat Lokale", SECO,

Trajnim per Vleresim, Kontrolli e Auditi data 28 maj ora 10:00-12:00 ASPA.
Trajnim data 3-5 Qershor 2025 PEMPAL, Auditi in Practice and central Harmonization Unit Challenges Working Groups Meeting
Trajnim per Menaxhimi Riskut data 29 prill ora 10:00-14:30 ASPA
F.G Trajnim per Vleresim, Kontrolli e Auditi
H.S Trajnim per Vleresim, Kontrolli e Auditi dhe Trajnim Rajonal për AB dhe Koordinatorët për "M.F.K. në NJ.V.V." ofruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Projekti "Financat Lokale", SECO
Është standardizuar dokumentacioni i auditimit, përmes auditimeve të planifikuara krijimit të dosjeve të përhershme dhe strukturimit profesional të angazhimeve, duke përfshirë matrica risku, objektiva të qarta dhe klasifikim të performancës.
Është zbatuar një program i brendshëm për sigurimin e cilësisë, si dhe është vendosur një mekanizëm i qartë për ndjekjen e rekomandimeve, me klasifikim sipas riskut, afateve dhe përgjegjësive institucionale. Eshte bërë dhe programi i sigurimit të Cilësisë,date 07.01.2026 nr.29 prot. Për sa i përket,Planit Vjetor i angazhimeve të auditimit për vitin 2025. Në Planin vjetor ishin planifikuar të realizoheshin 9 angazhime auditimi të cilat janë realizuar në masën 100 %.
Koment mbi zbatimin e rekomandimit: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi i mësipërm është zbatuar.
Zbatimi: Rekomandimi 2.1 rezulton i **zbatuar.**
3.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Roskovec, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.
Koment mbi zbatimin e rekomandimit: Planifikimi i shpenzimeve per vitin 2025 nga te ardhurat e veta së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike ka qene 1,106,807 mije leke kundrejt realizimit 907,957 mije leke . Shpenzimet e kryera nga te ardhurat e veta te bashkise së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike jane realizuar ne masen 82 % per vitin 2025 kundrejt realizimit prej 75.8 % per vitin 2024.
Zbatimi: Rekomandimi 3.1 rezulton i **zbatuar.**

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec dhe Drejtoria e Ekonomike të marrin masa për hartimin e grafikut të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura në vite duke pasur prioritet datat e krijimit të tyre dhe afateve të përcaktuar në kontratë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.
Koment mbi zbatimin e rekomandimit: Per vitin 2025 totali i detyrimeve te prapambetura 51,255,649 leke me 31.12.2025, jane likujduar gjate vitit 121,045,489 leke dhe shtesa gjate vitit jane 73,813,718 leke.
Zbatimi: Rekomandimi 4.1 rezulton i **zbatuar.**

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga

detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 296,803,268 lekë dhe realizimi në vlerën 280,954,803 lekë ose në masën 94% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 15,848,465 lekë.

Zbatimi: Rekomandimi 5.1 rezulton **proces zbatimi.**

6.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec në bashkëpunim me Njësitë Shpenzuese Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Mjedisit dhe Ndërmarrja e Pyjeve, Ujitjes e Kullimit dhe Mirëmbajtje Rrugë e Varreza të marrë masa që, në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryejë sistemimin e vlerës totale prej 877,188 lekë, që i përket aktiveve të asgjësuara në procesin e inventarizimit të vitit 2024, duke i pakësuar nga gjendja e inventarit kontabël.

Deri më datë 30.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment mbi zbatimin e rekomandimit: Janë marr në konsiderat dhe janë sistemuar në pasqyrat financiare të vitit 2025

6.2. Rekomandimi: Nga komisionet e inventarizimit të aktiveve të Qendrës Ekonomike Arsimore pas përfundimit të procesit të inventarizimit të paraqitet para Nëpunësit Autorizues raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment mbi zbatimin e rekomandimit: Janë marr në konsiderat dhe janë sistemuar në pasqyrat financiare të vitit 2025.

Zbatimi: Rekomandimi 6.1 rezulton i **zbatuar.**

7.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike të marrë masa për mbylljen e procesit të inventarizimit për aktivet afatgjata materiale, duke kryer edhe verifikimin në terren të këtyre aseteve.

Deri më datë 30.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment mbi zbatimin e rekomandimit: Nuk eshte kryer procesi i inventarizimit per aktivet afatgjata materiale.

Zbatimi: Rekomandimi 4.1 rezulton i **pazbatuar.**

8.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike të kryhen veprimet përkatëse sistemuese për vlerën 27,794,945 lekë që i përket vlerës së shtuar në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, duke e pakësuar këtë vlerë dhe ri klasifikuar në llogaritë e investimeve përkatëse sipas llojit për një paraqitje të plotë e të saktë të aktiveve afatgjata materiale, si dhe aplikimin e normës së amortizimit.

Deri më datë 30.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment mbi zbatimin e rekomandimit: Janë marr në konsiderat dhe janë sistemuar nëpasqyrat financiare të vitit 2025.

Zbatimi: Rekomandimi 8.1 rezulton i **zbatuar.**

9.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryej kontabilizimin dhe përllogaritjen e saktë të vlerës që i përket pyjeve dhe kullotave të transferuara me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, me qëllim dhënien e informacionit kontabël.

Deri më datë 30.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Nuk është kryer kontabilizimi dhe përllogaritja e saktë e vlerës që i përket pyjeve dhe kullotave të transferuara me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016 ne bilancin e vitit 2025.

Zbatimi: Rekomandimi 9.1 rezulton i **pazbatuar.**

10.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike të marrë masa për pajisjen me certifikatë të kontrollit teknik për mjetet të cilat nuk e disponojnë këtë dokument, duke zbatuar njëkohësisht edhe detyrimet ligjore përkatëse.

Deri më datë 31.12.2025

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Nuk janë pajisur me certifikatë kontrolli teknik mjetet.

Zbatimi: Rekomandimi 10.1 rezulton i **pazbatuar.**

11.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masat për të klasifikuar veçmas llogarinë 218/6 *"Pajisjet kompjuterike"* brenda llogarisë 218 *"Inventar ekonomik"* në regjistrin e aseteve të njësive dhe në pasqyrat financiare, konform kërkesave të nomenklaturës së llogarive, duke aplikuar amortizimin sipas normës përkatëse për çdo aktiv.

Deri më datë 30.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Në pasqyrat financiare nuk ka nënllogari 218/6 prandaj në pasqyrat financiare të bashkisë e kemi lënë në llogarinë 218 ndërsa në tabelat exel të cilat punojmë celje, shtesa, pakësime i kemi ndarë me nënllogari më vete.

Zbatimi: Rekomandimi 11.1 rezulton i **zbatuar.**

12.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të kryejë analizë të detajuar të dokumentacionit financiar e ligjor të të dhënave për llogaritë e aktiveve afatgjata të Klasës 20, *(210, 212, 213, 214, 215 dhe 218)* për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më datë 30.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Informacioni ka ardhur i tillë nga ish komunat përmbledhës jo i detajuar dhe jo i dokumentuar.

Zbatimi: Rekomandimi 12.1 rezulton i **pazbatuar.**

13.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike të merren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

Deri më datë 30.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment mbi zbatimin e rekomandimit: Janë marr në konsiderat dhe janë sistemuar në pasqyrat financiare të vitit 2025.

Zbatimi: Rekomandimi 13.1 rezulton i **zbatuar.**

14.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për të hartuar procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier, për vlerën kontabël 611,726,615 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment mbi zbatimin e rekomandimit: Janë marr në konsiderat dhe janë sistemuar në pasqyrat financiare të vitit 2025.

Zbatimi: Rekomandimi 14.1 rezulton i **zbatuar.**

15.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për sistemin e vlerës 1,000,000 lekë nga llogaria 230 *"Për aktive afatgjata jo materiale",* e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar, të projektit për të cilin ka përfunduar procedura dhe likuiduar, duke e kontabilizuar në llogarinë 202 *"Studime dhe kërkime"*.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment mbi zbatimin e rekomandimit: Janë marr në konsiderat dhe janë sistemuar në pasqyrat financiare të vitit 2025.

Zbatimi: Rekomandimi 15.1 rezulton i **zbatuar.**

Deri më datë 30.06.2026

16.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec të marrë masa të aplikoj për pajisje me certifikatë pronësie pranë DV ASHK Fier për pasuri që kanë prioritet në investime dhe në ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Pas pajisjes me certifikatë pronësie nga ASHK-ja këto pasuri të regjistrohen në regjistrin e aktiveve afatgjata të bashkisë me vlerën e tyre kontabël, si dhe të kontabilizohen në pasqyrat financiare në llogaritë përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment mbi zbatimin e rekomandimit: Gjatë vitit 2024-2025 janë bërë aplikime për pajisje me certifikatë pronësie pranë DV ASHK Fier për pasuri që kanë prioritet në investime dhe në ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Nuk ka asnjë përgjigje nga ana e institucioneve.

Zbatimi: Rekomandimi 16.1 rezulton i **pazbatuar.**

17.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Deri më datë 30.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment mbi zbatimin e rekomandimit: Gjatë vitit 2025 janë bërë clirimi i fondeve në vlerën 12,727,000 lekë.

Zbatimi: Rekomandimi 17.1 rezulton i **zbatuar pjesërisht.**

18.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryej kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar"* me qëllim dhënien e informacionit kontabël.

Deri më datë 30.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.
Koment mbi zbatimin e rekomandimit: Janë marr në konsiderat dhe janë sistemuar në pasqyrat financiare të vitit 2025.

Zbatimi: Rekomandimi 18.1 rezulton i **zbatuar pjesërisht.**

19.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale të merren masa për pajisjen e punonjësve që punojnë në pozicionin e punës elektricist, me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, për të parandaluar çdo ngjarje në dëm të shëndetit dhe jetës së tyre.

Menjëherë

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.
Koment mbi zbatimin e rekomandimit: Nuk janë pajisur me dëshmi kualifikimi.

Zbatimi: Rekomandimi 19.1 rezulton i **pazbatuar.**

20.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe atyre në proces zbatimi si më poshtë:
Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Masa të lëna në auditimin e mëparshëm sipas shkresës nr.1035 prot., datë 07.02.2025.

A. MASA ORGANIZATIVE
7.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec, Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim/licencë.

Deri më datë 31.12.2024

Eshte derguar shkresa per bashkepunim Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial por pezullim aktivitetit nuk ka pasur.

14.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore të verifikojë dhe saktësojë pronat në administrim të saj sipas Vendime të Këshillit të Ministrave dhe të bashkëpunojë me institucionin e ASHK për të regjistruar dhe pajisur me certifikatë regjistrimi të gjitha asetet që ka në përdorim.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI
1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,124,502 lekë pa TVsh** nga OE "S." Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1743 prot., datë 17.03.2022, me objekt: "Rikonstruksioni i shkollës mesme "Didin Bishani Kurjan", Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,084,900lekë pa Tvsh** nga OE "L. K." Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën (marrëveshje kuadër) nr. 1837 prot., date 23.03.2023 me, me objekt: "Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e Bashkisë Roskovec", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masat për arkëtimin e vlerave debitorë nga subjektet:
"A. L." Sh.p.k në vlerën 21,000 lekë; S.L. në vlerën 89,640 lekë; T.L. në vlerën 83,184 lekë, M.B në vlerë 20,796 lekë si dhe të ndiqet me përpikmëri zbatimi i kushteve të kontratave të qirasë.

Menjëherë dhe në vijimësi

- A.L. ka arkëtuar me 23.04.2025 shumen 31,500 leke nga e cila 21,000 leke detyrimi dhe 10,500 leke kamat vonesa
- S.L. ka arkëtuar me date 25.11.2024 shumen prej 89,640 leke
- M.B. me date 18.11.2024 ka arkëtuar shumen prej 41,580 ne te cilen përfshihet shuma e pa arkëtuar me pare prej 20,796 leke
- T.L. është ndalur nga paga e znj.L.L shumen prej 36,652 leke. Ngelet pa u arkëtuar shuma prej 46,932 leke

G. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1-5. Rekomandim: AK në hartimin e DT, të shmangë vendosjen e kritereve që nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, nuk janë të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme. Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Roskovec dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të kualifikimit të OE që nuk plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në DT, duke analizuar arsyet e s kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

Menjëherë

Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të ri kërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatimi: Rekomandimi 20.1 rezulton i **zbatuar pjesërisht.**

B. MASA DISIPLINORE

B. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", neni 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja *"c"*, Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 *"Për nëpunësin civil"* i ndryshuar nenin 58 *"Llojet e masave disiplinore"* dhe VKM-në nr. 115, datë 05.3.2014, *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil"*, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Roskovec, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancës dhe llojin e shkeljeve të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a. "Vërejtje", për punonjësin e mëposhtëm:

1. Z. S.Ç. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare, për shkeljet:

- Në pasqyrat financiare të Aparatit të Bashkisë Roskovec janë kryer pakësime në vlerën 1,497,169 lekë që i përkasin llogarisë 218 *"Inventar ekonomik"*, ndërkohë që referuar procesverbalit të asgjësimit, janë asgjësuar aktive që i përkasin llogarisë 327 *"Inventar i imët"* në vlerën 2,943 lekë, 218 *"Inventar ekonomik"* në vlerën 1,559,929 lekë dhe 214 *"Instalime teknike, makineri e pajisje vegla pune"* në vlerën 56,400 lekë, me një diferencë në vlerën 119,160 lekë;
- Për mos realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale që i përkasin llogarive 210 *"Toka, troje, terrene"* dhe 211 *"Pyje, kullota, plantacione";*
- Në Pasqyrën nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* u konstatua se, nuk është kryer sakt sistemimi i projekteve për të cilat ka përfunduar investimi duke ju shtuar investimit në llogaritë përkatëse 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* dhe 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*, por pakësimi është regjistruar në shtesën e vitit për vlerën historike prej 27,794,945 lekë;
- Për mbivlerësimin e llogarisë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* në vlerën 656,885,090 lekë;
- Për kontabilizimin në gjendjen e llogarisë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* të vlerës 611,726,615 lekë që i përket inventarëve të transferuar që prej vitit 2014 deri në vitin 2018 në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Roskovec por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Roskovec;
- Për kontabilizimin e vlerës 1,000,000 lekë në gjendjen e llogarisë 230 *"Për aktive afatgjata jo materiale"* që i përket projektit me emërtimin *"Hartim projektesh për rruge dhe rrjete"* i përfunduar dhe i marrë në dorëzim nga Bashkia Roskovec dhe për pasojë duhej të kontabilizohej në llogarinë 202 *"Studime dhe kërkime"*.
- Për nënvlerësimin e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar"* në vlerën 107,546,388 lekë.

Lidhur me Rekomandimin nr. B.1 "Masa Disiplinore", me anë të së cilës rekomandoni fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore "Vërejtje" për punonjësin z.S.Ç. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, ky rekomandim nuk është pranuar, pasi ky punonjës ka dhënë dorëheqjen nga pozicioni i Drejtorit Ekonomik përpara datës së njohjes me Raportin Përfundimtar, rrjedhimisht nuk është më as Nëpunës Zbatues i Bashkisë Roskovec, për këtë arsye ky rekomandim nuk përfshihet në Planin e Veprimit të Bashkisë Roskovec nr. 8640/2 prot. datë 03.11.2025, "Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit" miratuar me Vendimin e Titullarit protokolluar me nr. 8640/1 prot. datë 03.11.2025. Ky informacion është nisur në isntitucionin e KLSH-së me shkresën nr. 8640/3 prot, datë 10.11.2025.

Zbatimi: Rekomandimi rezulton i **zbatuar.**

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë Roskovec për vitin 2025, u konstatuar se:
-Nuk është hartuar plani i veprimit për menaxhimin financiar për monitorimin dhe arritjen e objektivave. Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm, si dhe nuk rezultoi asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, i cili nuk ka kryer detyrat për vendosjen e rregullave të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Mungon

një rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive. Bashkia Roskovec nuk ka hartuar një strategji risku, nuk është hartuar regjistri i riskut, nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe nuk është ngritur grupi i punës së riskut. Mungojnë planet e veprimit për menaxhimin e riskut dhe nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos mundur të përcaktojë nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.
-Titullari i Bashkisë Roskovec nuk ka miratuar gjurmën e auditimit. Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT e programe të ndryshme në sektorë të ndryshëm, si dhe hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) për ruajtjen e tij.
-Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", Kreu II, neni 8/a, Kreu III, nenet 16, 21/2; me Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pikat 3.2.1,4,5.2.7, me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108 datë 17.11.2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pikat 3.2 dhe 3.3, Kapitulli V, Anekset.
1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për përmirësimin dhe funksionimin efektiv të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK), në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, duke siguruar zbatimin, dokumentimin dhe monitorimin e elementeve të tij kryesore, përfshirë menaxhimin e riskut, kontrollin e brendshëm, raportimin e performancës dhe ndjekjen e masave të përcaktuara.

Brenda 6 muajve

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Auditit të Brendshëm rezultoi se në dosjet e audituara mungojnë: projekt drafti i programit te auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit me të gjitha elementët e tij; Raportet në përmbajtjen e tyre kanë rubrika dhe përshkrime jo korrekte, të paqarta, nuk përcaktohet kampioni i testimit, trajtimi çështjeve nuk është bërë konkret, i plotë dhe i detajuar, duke mos mbështetur dhënien e ndonjë opinioni apo vlerësimi përfundimtar; Në formulimin e gjetjeve ka mangësi, pasi nuk është përshkruar qartë gjetja e evidentuar, shkaqet dhe efektet që ka sjellë ajo, duke mos u adresuar qartë hallkën që nuk ka funksionuar dhe mosveprimet konkrete, nuk ka të përcaktuar kohën kur ka ndodhur, nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i detajuar dhe në disa raste nuk është përcaktuar niveli i riskut (i lartë, i mesëm dhe i ulët); Rekomandimet nuk janë të mirë përcaktuara, i referohen bazës ligjore duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve, të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem, nuk është përcaktuar afati i zbatimit të tyre. Në auditimet e kryera në fakt nuk janë realizuar në formë të thelluar dhe të plotë sistemet objekt auditimi, ku shfaqen problematika me nivel të lartë risku si në sistemin e planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit, në sistemin e prokurimeve, në sistemin e shërbimeve publike, në sistemin e të ardhurave etj. Mungojnë auditimet në sistemin e administrimit dhe menaxhimit e aseteve etj. Këto veprime janë në kundërshtim me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar, Kapitulli III, pika 3.5; Kapitulli IV pika 4.1.1, pikës 4.1.11 dhe 4.1.12.
2.1.Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa për realizimin e plotë të procesit të auditimit në të gjitha fazat e tij, duke siguruar planifikimin, kryerjen e procedurave dhe testeve të përshtatshme të auditimit, dokumentimin e evidencave, analizimin dhe vlerësimin e rezultateve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura gjendje në fund të vitit 2025 u konstatua se nuk është bërë planifikimi i fondeve për financim dhe nuk është hartuar plani i shlyerjes së tyre. Referuar shkresës nr. 1693 prot., datë 27.02.2026 "*Raport vjetor i vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare për periudhën janar-dhjetor 2025, Bashkia Roskovec*" dërguar në MF detyrimi i mbetur në fund të vitit ushtrimor është në shumën prej 137,658,800 lekë. Pra, kemi një diferencë në raportim në MF në shumën prej 58,528,006 lekë, që i përket detyrimeve për investime të raportuara gabimisht si të palikujduara, ndërkohë që janë të likuiduara dhe të sistemuara në kontabilitet me hartimin e pasqyrave. Gjithashtu u konstatua se përllogaritja e vështirësisë financiare nuk është bërë e saktë, pasi dhe stoku i detyrimeve të prapambetura dhe fondet buxhetore të realizuara në fakt të marra në konsideratë për përcaktimin e peshës specifike të detyrimeve nuk është e saktë, për këtë arsye dhe masa e vështirësisë financiare ndryshon nga 18.45% në 9%, fakt që tregon se Bashkia Roskovec konsiderohet në situate normale të gjendjes financiare dhe jo në vështirësi financiare, pasi nuk e kalon pragun prej 15% të gjendjes me probleme financiare. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, nenet 5/c, 40/h, me Udhëzimin e MFE nr. 09, datë 20.07.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të e buxhetit*" i ndryshuar, pikat 48/i, 58,106,130, me Udhëzimin e MF nr. 22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore*" shtojca 4 germa (c), me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 27.12.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", pikat 82-91, me Udhëzimin e MFE nr. 35, datë 29.12.2023 *"Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore"* pika 33.

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike, të marrë masa për inventarizimin, rakordimin dhe raportimin e saktë të detyrimeve të prapambetura, si dhe për hartimin dhe zbatimin e planit për shlyerjen e tyre, mbi bazën e burimeve reale buxhetore, duke siguruar përputhshmërinë e të dhënave financiare dhe përmirësimin e kontrolleve të brendshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së flukseve monetare rezultoi se shumat në llogaritë sintetike dhe analitike nuk janë të sakta, pasi janë keq klasifikuar, pavarësisht se llogaria "Teprica e likuiditeteve" si në çelje dhe në fund të vitit ushtrimor 2025 është sipas akt akordimit me thesarin, konkretisht:

a. Tek rubrika I "Veprimtaritë e shfrytëzimit".

-Seksioni 1 "Akordim fonde buxhetore për shpenzime korente" paraqitet në shumën 206,217,351 lekë, kur duhet të ishte 203,827,000 lekë sipas aktrakordimit me thesarin. Po kështu kjo shumë nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 7201 "Grant korent i brendshëm nga buxheti për NJQP (vendore)" në pasqyrën e performancës që paraqitet në shumën 197,729,674 lekë.

-Seksioni 2 "Arkëtime e të hyra (Cash), gjatë vitit ushtrimor" paraqitet në shumën 0 lekë, ndërkohë sipas shumës së llogarive analitike sipas pasqyrës së performancës duhet të ishte 295,227,277 lekë.

-Gjendja e llogarisë analitike "Të hyra nga tatimet" paraqitet në shumën 0 lekë, ndërkohë që kjo llogari analoge në pasqyrën e performancës paraqitet në shumën 226,543,534 lekë dhe sipas akt rakordimit me thesarin.

-Gjendja e llogarisë analitike "Të tjera të arkëtuara" paraqitet në shumën 892,452,329 lekë, kur sipas llogarisë analoge 7204 "Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale" në pasqyrën e performancës është në shumën 49,843,533 lekë.

-Seksioni 3 “Pagesa për detyrime e shpenzime korente” paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë sipas llogarive analitike duhet të ishte 463,929,055 lekë. Pagesat për detyrime për shpenzime korente të vitit ushtrimor dhe të viteve të kaluara paraqiten në shumën 452,823,480 lekë, ndërsa sipas akt akordimit me thesarin janë në shumën 452,143,211 lekë, me një deviacion prej 680,269 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kap. 3.5 i ndryshuar, Kreu III, pika 24.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa që në hartimin e pasqyrës së flukseve të mjeteve monetare të pasqyrave financiare të paraqesë qartë e saktë gjendjet dhe analizat e llogarive “Akordim fonde buxhetore për shpenzime korente”, “Arkëtime e të hyra (Cash) gjatë vitit ushtrimor” dhe “Pagesa për detyrime e shpenzime korente”, duke i rakorduar me Degën e Thesarit Fier dhe me pasqyrat e tjera që lidhen me to.

Deri më datë 31.12.2027

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performancës u konstatuan pasaktësi në paraqitjen dhe rakordimin e llogarive, konkretisht:

- Gjendja e llogarisë 7201 *“Grant korent i brendshëm nga buxheti për NJQP (vendore*)” paraqitet në shumën 197,729,674 lekë, kur duhet të ishte 203,827,000 lekë sipas aktrakordimit me thesarin.

-Në të ardhurat e vitit ushtrimor 2025 është përfshirë gjendja e llogarisë 787 *“Tërheqje nga seksioni i investimeve”* në shumën 75,604,004 lekë, që përfaqëson të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës, dhe nuk mund të jenë pjesë e rezultatit të vitit ushtrimor.

- Gjendja e llogarisë 600 *‘Paga, shpërblime e të tjera personeli”* për vitin 2025 paraqitet në shumën 184,246,609 lekë, ndërsa nga përllogaritja rezulton në shumën 183,263,978 lekë, duke u mbivlerësuar me 982,631 lekë. Gjendja e llogarisë 601 *“Kontribute për sigurime”* për vitin 2025 paraqitet në shumën 30,123,300 lekë, ndërsa nga përllogaritja rezulton në shumën 30,638,615 lekë, duke u nënvlerësuar me 515,315 lekë.

-Seksioni *“Shpenzime të tjera”* në mbyllje të vitit ushtrimor paraqitet në shumën 131,744,356 lekë, e cila sipas informacionit të dhënë përbëhet nga shuma prej 127,077,504 lekë investime nga të ardhurat + grant viti 2024 dhe detyrime të prapambetura nga të ardhurat për investime në fund të vitit 2025 në shumën 4,666,852 lekë, shumë kjo e fundit që nuk korrespondon me detyrimet për investime nga të ardhurat në fund të vitit 2025, që në fakt janë në shumën 41,984,399 lekë, pra me një diferencë prej 37,317,547 lekë. Duhet theksuar se në seksionin *“Shpenzime të tjera”* janë kryer veprime gabuara, pasi në këtë seksion evidentohen veprimet e korrigjimit të rezultatit dhe llogaritë duhet të rakordojnë me llogaritë analoge në pasqyrën e flukseve monetare etj. Pasaktësia e gjendjes së këtyre llogarive deformon rezultatin e veprimtarisë së vitit ushtrimor 2025, rrjedhimisht pozicionin financiar të subjektit në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, duke mos dhënë siguri edhe mbi tepricat e transaksioneve mbi të cilat është përgatitur pasqyra e flukseve apo pasqyra e pozicionit financiar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar Aneksi 1, pika 4, faqe 48-51.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa që në hartimin e pasqyrave financiare të sigurojë që të bëhet kontabilizimi i saktë i veprimeve me fondet dhe i transaksioneve financiare në llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve në pasqyrën e performancës, duke i rakorduar me Thesarin dhe me pasqyrat e tjera që lidhen me to.

Brenda datës 31.03.2027

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i analizave të aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale të paraqitura në formatin 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ”, rezultoi

se në gjendjet e llogarive (kosto historike) janë përfshirë vlera të grup aktivesh të pa analizuara si: në llogarinë 210 *"Toka, troje, terrene"* në vlerën 112,776,000 lekë është përfshirë vlera 112,776,000 lekë; 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* në vlerën 1,222,086,786 lekë është përfshirë vlera 256,815,051 lekë; 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* në vlerën 3,267,932,358 lekë është përfshirë vlera 1,007,052,733 lekë; 214 *"Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune"* në vlerën 12,061,321 lekë është përfshirë vlera 4,211,717 lekë; 215 *"Mjete transporti"* në vlerën 26,376,014 lekë është përfshirë vlera 17,259,600 lekë dhe 218 *"Inventar ekonomik"* në vlerën 90,005,380 lekë është përfshirë vlera 42,987,060 lekë. Këto vlera janë të trashëguara nga bilanci i ish-komunave Roskovec të pa analizuara dhe që ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, kapitulli III, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 Pika 2. Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël).
6.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për kryerjen e një analizë të detajuar të dokumentacionit financiar e ligjor të të dhënave për llogaritë e aktiveve afatgjata të klasës 2 *(210, 212, 213, 214, 215 dhe 218),* me qëllim evidentimin dhe verifikimin e aktiveve të hyra ndër vite, saktësimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare dhe, në rast pasaktësish, kryerjen e sistemimeve të nevojshme në kontabilitet dhe në inventarin fizik.

Deri më datë 31.12.2026

7. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e prokurimit rezultoi se, në 4 procedura prokurimi të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Roskovec, me objekt realizimin e investimeve publike, kontratat janë lidhur pa u pajisur më parë me lejen përkatëse të ndërtimit/infrastrukturës. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 39, pika 3, të Ligjit nr. 107/2014, "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, i cili parashikon se punimet e ndërtimit nuk mund të fillojnë pa lejen përkatëse. Gjithashtu, në të njëjtat 4 procedura u konstatua se, përveç mungesës së lejes së ndërtimit, Autoriteti Kontraktor nuk ka kryer oponencën teknike të projekteve, megjithëse objektet e prokurimit përbëjnë ndërtime publike ose ndërtime me akses publik. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 6, pika 1, të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, si dhe me pikën 4 të VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 "*Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit*". Moszbatimi i plotë i kuadrit ligjor nga strukturat përgjegjëse të Autoritetit Kontraktor, si dhe mungesa e verifikimit të plotësimit të të gjitha kërkesave ligjore, lidhja e kontratave dhe vijimi i procedurave të prokurimit pa disponuar lejen e ndërtimit dhe pa kryer oponencën teknike cenon ligjshmërinë e procesit të investimit publik, rrit riskun për zbatimin e projekteve me mangësi teknike, si dhe mund të sjellë pasoja financiare, administrative dhe ligjore dhe teknike përpara inicimit dhe lidhjes së kontratave të prokurimit. Konkretisht për procedurat me objekt: 1. "*Rrugë parcele në fshatrat e NJA Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan*" me vlerë kontrate 16,293,750 lekë pa TVSh e cila është fituar nga OE "R.C." SHPK. 2."*Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Strum*" me vlerë kontrate 41, 383,400 lekë pa TVSh, e cila është fituar nga OE "C.M." 3. "*Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kuman*" me vlerë kontrate 24 600 000 lekë pa T.V.SH e cila është fituar nga OE "N. N." SHPK.. *4. "Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kurjan*" me vlerë kontrate 15,089,704 lekë pa TVSh e cila është fituar nga OE "E. C." Company.

7.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa që për investimet publike të sigurohen paraprakisht lejet përkatëse të ndërtimit/infrastrukturës dhe kryerja e oponencës teknike, si dhe të vendosë kontrolle të brendshme për verifikimin e dokumentacionit ligjor e teknik para zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 13 procedurave të prokurimit, me fond limit në vlerën 530,415,543 lekë pa TVSH, të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Roskovec gjatë periudhës 2024–2025, rezultoi se në 7 (shtatë) procedura janë hartuar kritere kualifikimi të ekzagjeruar, kufizuese dhe jo në përpjesëtim me natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e objektit të kontratës, kritere të cilat fillojnë me kërkesat e audituesit energjetik në rastet kur nuk është në përpjesëtim me volumin e kontratës apo inxhinier që nuk argumentohet nevoja e tyre. Konkretisht, janë vendosur kërkesa që tejkalojnë nevojat reale të realizimit të kontratës, pa argumentim të mjaftueshëm teknik apo ligjor, duke mos respektuar parimin e proporcionalitetit dhe të lidhjes së drejtpërdrejtë të kritereve me objektin e prokurimit. Këto mangësi kanë ardhur si pasojë e moszbatimit të plotë të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi nga strukturat përgjegjëse për përgatitjen e dokumenteve të tenderit, si dhe e mungesës së një argumentimi të dokumentuar mbi domosdoshmërinë e kritereve të vendosura si pasojë efekti që kanë krijuar kufizim të panevojshëm të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë dhe, për rrjedhojë, risk për reduktimin e konkurrencës në procedurën e prokurimit. Konkretisht për procedurat e prokurimit me objekt: 1.“*Rikonstruksion i rrugës "Kozma Prifti*", fshati Marinëz, (905 + 265 ml , b= 4 m+0.5 bankin) me vlerë kontrate 41,383,400 lekë pa TVSh procedurë e cila është fituar nga OE “R. E.” . 2. “*Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit*” me vlerë kontrate 125,436,315 lekë pa TVSh, procedurë e cila është fituar nga BOE “C.M & K.K” . 3. “*Kompleksi i terreneve sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën 5 Dëshmorët*”, *Suk 1*” me vlerë kontrate 41,539,346 lekë pa TVSh, procedurë e cila është fituar nga OE “Z. K.” Sh.p.k. 4. “*Mbrojtje nga lumi Seman në krahun e majtë, Zona Suk, Bashkia Roskovec*” me vlerë kontrate 29,153,415 lekë pa TVSh, procedurë e cila është fituar nga OE “B”. 4. *“Ndërtim i parkut te ri të qytetit”* me vlerë kontrate 18,661,795 lekë pa TVSH, procedurë e cila është fituar nga OE “N.” SHPK *5.* “*Ndërtim i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të*” me vlerë kontrate 24,766,467 lekë pa TVSh, procedurë e cila është fituar nga OE “B.”. 6. “*Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregtare”: Faza 1.* 7. *“Punime për bazamentin e fushës së futbollit*” me vlerë kontrate 13,808,849 lekë pa TVSh, procedurë e cila është fituar nga OE “A. C.” ShPK. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.05.2021 “*Për prokurimin publik*”, VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” neni 39 pika 4 dhe 78, pika 2.

8.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Roskovec (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur, duke përdorur vetëm ato kritere të cilat janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe duke i dokumentuar ato në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Menjëherë në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga 13 procedurat e prokurimit të audituara dhe zhvilluara nga AK Bashkia Roskovec, me fond limit 530,415,543 lekë rezultoi se, në 10 raste me vlerë kontrate 393,477,516 lekë pa TVSH (KVO-ja) anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave kanë kualifikuar dhe shpallur fitues OE në kushtet kur këta të fundit nuk kanë përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Konkretisht për procedurat e prokurimit me objekt: *“Rikonstruksion i rrugës "Kozma Prifti*", fshati Marinëz, (905 + 265 ml,

b= 4 m+0.5 bankin), 41,383,400 lekë pa TVSh procedurë e cila është fituar nga OE "R.U." "*Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit*", "*Kompleksi i terreneve sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën 5 Dëshmorët*", Suk 1", me vlerë kontrate 125,436,315 lekë pa TVSh, procedurë e cila është fituar nga BOE "C.M. & K.K." . Proceduara me objekt "*Rrugë parcele në fshatrat e NJA Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan*", me vlerë kontrate 16,293,750 lekë pa TVSh e cila është fituar nga OE "R.C" SHPK "*Ndërtim i parkut te ri të qytetit*", me vlerë kontrate 18,661,795 lekë pa TVSH, procedurë e cila është fituar nga O*E "*N." SHPK ."*Ndërtim i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të*", me vlerë kontrate 24,766,467 lekë pa TVSh, procedurë e cila është fituar nga OE B. "*Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kuman*", me vlerë kontrate 24,600,000 lekë pa T.V.SH e cila është fituar nga OE "N. N." SHPK. *"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në qytetin Roskovec"* me vlerë kontrate 19,863,000 lekë pa TVSh e cila është fituar nga "E. C." .*"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kurjan*", me vlerë kontrate 15,089,704 lekë pa TVSh e cila është fituar nga OE "E. C.". *"Blerje dhe instalimi i 3 pemëve "Smarflower" dhe ndërtim stacioni komercial të EV për makinat elektrike",* me vlerë kontrate 10,651,490 lekë pa TVSh e cila është fituar nga OE "A". "*Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregtare" Faza 1,"Punime për bazamentin e fushës së futbollit*" me vlerë kontrate 13,808,849 lekë pa TVSh, procedurë e cila është fituar nga OE "A. C." ShPK. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", neni 92 "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2. Nga analiza e rasteve të mësipërme rezulton se mangësitë kanë ardhur si pasojë e mosverifikimit dhe mosvlerësimit të plotë nga KVO-të të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë, në raport me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në kushtet kur përmbushja e këtyre kërkesave duhej të verifikohej dhe vlerësohej nga KVO-ja përpara marrjes së vendimit për kualifikimin e ofertave, përgjegjësia për këto mangësi lidhet me mënyrën e ushtrimit të detyrës nga anëtarët e KVO-ve përgjegjëse për procedurat përkatëse.
9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive për rastet e konstatuara, si dhe të sigurojë që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) të kryejë verifikimin e plotë dhe të dokumentuar të përmbushjes së kritereve të kualifikimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DST.

Menjëherë në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua një praktikë në të cilën shqyrtimi i kërkesës për leje ndërtimi është në tejkalim të afateve të përcaktuara në bazë të legjislacionit në fuqi. Përkatësisht në lejen me objekt: "*Stallë për mbarështimin e lopëve*", për të cilën është marrë Vendimi nr.01, datë 27/02/2025, me zhvillues z. O.M. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me nenit 44, pika 2, të ligjit 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*"; neni 20 dhe 21 i VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.
10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Roskovec të marrë masa që ta realizojë shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi brenda afateve të përcaktuara, duke kontrolluar në mënyrë konstante secilën fazë të aplikimit në sistemin e-leje, për të shmangur tejkalimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit/zhvillimit u konstatuan 4 praktika: 1. "*Magazinë Bujqësore 1kat*", për të cilën është marrë Vendimi Nr. 08, datë 08.08.2024, me zhvillues z. A.K. dhe subjekt ndërtues shoqëria "V.K" ShPK; 2. "*Stallë për mbarështimin e lopëve*", për të cilën është marrë Vendimi Nr. 01, datë 27.02.2025, me zhvillues z. O.M.; 3.

"*Shtesë anësore 1 kat në objektin ekzistues magazinë shërbimi*", për të cilën është marrë Vendimi Nr. 03, datë 04.09.2025, me zhvillues z. D.H. dhe subjekt ndërtues shoqëria "Kërpi" ShPK; 4. "*Godinë 1 kat banimi*", për të cilën është marrë Vendimi Nr. 07, datë 11.07.2024, me zhvillues z. A.T., në të cilat procedurat e shqyrtimit dhe miratimit nuk kanë garantuar plotësinë, saktësinë dhe përputhshmërinë e dokumentacionit teknik, pronësor dhe ligjor me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Konkretisht, u konstatuan: mosrespektim i kushteve dhe treguesve të zhvillimit të përcaktuar në PPV dhe lejen e zhvillimit, përfshirë planvendosjen, distancat, lartësinë, intensitetin, koeficientin e shfrytëzimit, tipologjinë dhe destinacionin e ndërtimit; dokumentacion pronësor të papërditësuar, marrëveshje të munguara ndërmjet pronarëve dhe zhvilluesve dhe mungesë të miratimeve/konformiteteve përkatëse; dokumentacion teknik të paplotë ose me pasaktësi, i cili nuk është ngarkuar në mënyrë të plotë në sistemin e-Leje; si dhe mungesë të mendimeve dhe/ose konformiteteve nga ASHK-ja dhe autoritetet e tjera publike që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve. Gjithashtu, në disa raste, dokumentacioni i pronësisë dhe hartat treguese paraqesin paqartësi, pasaktësi ose mbivendosje me pasuri kufizuese, pa u verifikuar statusi i tyre. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me Ligjin Nr.107/2014, datë 31.07.2014, "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar; me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar; me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.4, datë 10.06.2020; me VKM-në 283, datë 1.4.2015, "*Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore*", të ndryshuar; me pikën 4, të nënit 17, të ligjit 111/2018, për "Kadastrën", datë 7.2.2019.

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Roskovec të marrë masa që lejet e ndërtimit/zhvillimit të miratohen vetëm pas verifikimit të plotë të dokumentacionit teknik, pronësor dhe ligjor, përputhshmërisë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe lejen e zhvillimit, si dhe marrjes së mendimeve dhe konformiteteve të nevojshme nga autoritetet përkatëse, duke siguruar që i gjithë dokumentacioni të jetë i plotë, i saktë dhe i ngarkuar në sistemin e-Leje.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i certifikatave të përdorimit u konstatua një praktikë me objekt "*Ndërtim objekti 6 kate*", për të cilën është marrë vendimi nr. 03, datë 31.12.2025, me zhvillues Enti Kombëtar i Banesave dhe subjekti zbatues "*S.*" ShPK, në të cilën shqyrtimi i kërkesës është në tejkalim të afateve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e-Leje nuk është i plotë, pasi evidentohen mangësi në paraqitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për shqyrtimin e kërkesës për certifikatë përdorimi, në pasqyrimin e projektit "as build", në realizimin e objektit në përputhje me lejen e ndërtimit, si dhe me kryerjen e të gjitha verifikimeve të nevojshme përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, nëse ka pasur ndryshime/ devijime në zbatimin e punimeve të ndërtimit. Gjithashtu, nga strukturat e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nuk rezultoi të ishin zhvilluar monitorime dhe kontrolle gjatë fazës së zbatimit të punimeve, me qëllim evidentimin në kohë të çdo devijimi nga leja e ndërtimit. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me nenin 42 dhe nenin 51, të ligjit 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar; me nenin 27, nenin 27/1, nenin 27/2, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar; me nenin 10, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, "*Për inspektimin e ndërtimit*".

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Roskovec, të marrë masa që të realizojë shqyrtimin e kërkesave për certifikatë përdorimi brenda afateve të përcaktuara, duke kontrolluar në mënyrë konstante secilën fazë të aplikimit

në sistemin e-Leje, që të shmang tejkalimin e tyre. Gjithashtu, të marrë masa që përpara miratimit të certifikatës së përdorimit të shqyrtojë dhe verifikojë në sistemin e-Leje të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, vërtetësinë/saktësinë e tij, si dhe të kryej verifikimet në terren në bashkëpunim me strukturat e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, me qëllim dhënien e konformitetit për aktkontrollet e detyrueshme (*përfundimi i karabinasë, i fasadave dhe sistemimit të jashtëm*), që realizimi i objektit të jetë në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës së IMTV u konstatua mangësi në plotësimin me personelin të nevojshëm, sipas strukturës së miratuar me Vendim nr. 02, datë 05.01.2024, nr. 76 prot të Këshillit të Bashkisë Roskovec. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arsimin dhe kualifikimet e nevojshëm profesional rezultoi se në IMTV Bashkia Roskovec, nuk kishte të punësuar personel sipas kritereve arsimore të përcaktuara në nenin 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar.

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec, të marrë masa për forcimin e kapaciteteve të strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, të kualifikuar kryesisht të profilit inxhinieri, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së inspektimeve për ndërtimet pa leje dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të lejeve të ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Roskovec administruar në KLSH me nr. 343/24 prot., datë 24.10.2024, dhe protokolluar në Bashkinë Roskovec me nr. 8640/3 prot, datë 10.11.2024, janë lënë për zbatim **21** masa të kategorisë organizative të cilat janë pranuar plotësisht. Nga këto **11** masa janë zbatuar plotësisht, **2** masa janë zbatuar pjesërisht, **3** masa janë në proces zbatimi dhe **5** masa janë pazbatuar.

14.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit"*, për përmirësimin e gjendjes, rikërkojmë marrjen e masave nga Bashkia Roskovec, për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

Menjëherë dhe në vijimësi

MASA ORGANIZATIVE

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec në bashkëpunim me Njësitë Shpenzuese Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Mjedisit dhe Ndërmarrja e Pyjeve, Ujitjes e Kullimit dhe Mirëmbajtje Rrugë e Varreza të marrë masa që, në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryejë sistemimin e vlerës

totale prej 877,188 lekë, që i përket aktiveve të asgjësuara në procesin e inventarizimit të vitit 2024, duke i pakësuar nga gjendja e inventarit kontabël.

Deri më datë 30.06.2026

6.2. Rekomandimi: Nga komisionet e inventarizimit të aktiveve të Qendrës Ekonomike Arsimore pas përfundimit të procesit të inventarizimit të paraqitet para Nëpunësit Autorizues raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike të marrë masa për mbylljen e procesit të inventarizimit për aktivet afatgjata materiale, duke kryer edhe verifikimin në terren të këtyre aseteve.

Deri më datë 30.12.2026

9.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryej kontabilizimin dhe përllogaritjen e saktë të vlerës që i përket pyjeve dhe kullotave të transferuara me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, me qëllim dhënien e informacionit kontabël.

Deri më datë 30.12.2026

10.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike të marrë masa për pajisjen me certifikatë të kontrollit teknik për mjetet të cilat nuk e disponojnë këtë dokument, duke zbatuar njëkohësisht edhe detyrimet ligjore përkatëse.

12.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të kryejë analizë të detajuar të dokumentacionit financiar e ligjor të të dhënave për llogaritë e aktiveve afatgjata të Klasës 20, *(210, 212, 213, 214, 215 dhe 218)* për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më datë 30.12.2026

16.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec të marrë masa të aplikoj për pajisje me certifikatë pronësie pranë DV ASHK Fier për pasuri që kanë prioritet në investime dhe në ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Pas pajisjes me certifikatë pronësie nga ASHK-ja këto pasuri të regjistrohen në regjistrin e aktiveve afatgjata të bashkisë me vlerën e tyre kontabël, si dhe të kontabilizohen në pasqyrat financiare në llogaritë përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Deri më datë 30.12.2026

18.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryej kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar"* me qëllim dhënien e informacionit kontabël.

Deri më datë 30.12.2026

19.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale të merren masa për pajisjen e punonjësve që punojnë në pozicionin e punës elektricist, me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, për të parandaluar çdo ngjarje në dëm të shëndetit dhe jetës së tyre.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15, germat b) dhe c) "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*" dhe mbështetur në nenet 98-102 të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*", pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, nga ana e **Titullarit të Bashkisë Roskovec**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësish, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **34,632,223 lekë pa TVSh** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi i kontratës me nr. 7688 prot., datë 27.09.2024 *"Ndërtimi i parkut të ri të qytetit, Bashkia Roskovec"*, me Kontraktorit OE "N" Shpk dhe me vlerë të kontratës 22,394,155 lekë pa TVSh, u konstatuan mangësi në lidhje me raportimin e volumeve dhe pagesave të specifikimeve teknike në zërat e gërmimeve, transportin dhe shtresës gome 1.2 + primer. Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Roskovec në vlerën **828,480 lekë pa Tvsh.** Në observacionet e paraqitura ndaj projektraportit, subjekti ka kundërshtuar me dokumentacion shtesë, shtresën e gomës dhe shtresën e tartarit, ku pavarësisht se pretendohet se janë realizuar sipas specifikimeve teknike, grupi i auditimit vlerëson se duhet një analizë në terren për saktësimin përfundimtar të këtij konstatimi në përputhje me specifikimet teknike të fushës së sportit. Mbikëqyrësi i punimeve Ing. B.H., ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve, nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec, të marrë masa të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, ku të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të cilat rezultuan të padokumentuara në dosjen e punimeve. Në rast të vërtetimit të mos realizimit të zërave të punimeve, nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës **828,480 lekë pa TVSH** nga shoqëria "N." Shpk për punime të pa kryera në volumet e situacionuara.

Brenda datës 31.12.2026

2. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi i kontratës me nr. 6510 prot., datë 19.08.2024 me objekt "*Kompleksi i Terreneve Sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën "5 Dëshmorët", Suk 1"*, me Kontraktorit OE "Z. K." Shpk dhe me vlerë të kontratës 39,711,166 lekë pa TVSh, u konstatuan mangësi në lidhje me raportimin e volumeve dhe pagesave të specifikimeve teknike në zërin e shërbimit/pune "*Mirëmbajtje e punimeve për 2 vite 2 %*", mureve me tulla dhe tavan me rrjete teli. Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Roskovec në vlerën **978,300 lekë pa Tvsh.** Mbikëqyrësi i punimeve Ing. B.H, ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk kanë zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim, Kontroll dhe Zhvillimit Territorit të Bashkisë Roskovec, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **978,300 lekë pa TVSh**, nga kontraktori OE "Z.K." Shpk, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

Brenda datës 31.12.2026

3. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi i kontratës me nr. 6894 prot., datë 02.09.2024 me objekt *"Mbrojtje nga lumi Seman në krahun e majtë zona Suk Bashkia Roskovec"*, me Kontraktorit BOE "B." & "L." Shpk dhe me vlerë të kontratës 34,984,098 lekë pa TVSh, u konstatuan mangësi në lidhje mes kontratës së punimeve, dokumenteve të tenderit, formularin e ofertës dhe situacionin përfundimtar të paraqitur nga operatori ekonomik. Nga auditimi u konstatua se janë ndryshuar çmimet e zërave të punimeve në mënyrë të paargumentuar në kundërshtim me kontratën nr. 6894 prot., datë 02.09.2024 dhe ligjin nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar nenet 1, 2 neni 2 pika d). Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 11 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Referuar dokumenteve të dokumenteve të tenderit dhe nenit 9 të KVK "Lloji i kontratës" është përcaktuar se kontrata është me çmim njësie bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në preventivin njësi, ku sipas DT citohet "*Preventiv për njësi*" *do të thotë volumet e punës të dhëna në projekt shoqëruar me çmimet për njësi <u>të pandryshuara</u> që janë pjesë e Ofertës në një kontratë me punime ne matje*. Në total rezultuan diferenca të çmimeve të situacionuara, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Roskovec në vlerën **1,284,890 lekë pa Tvsh.** Mbikëqyrësi i punimeve Ing. M.A, ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk kanë zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.

<u>3.1. Rekomandimi:</u> Drejtoria e Financës së Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim, Kontroll dhe Zhvillimit Territorit të Bashkisë Roskovec, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **1,284,890 lekë pa TVSh**, nga kontraktori BOE "B." & "L." Shpk, për ndryshime të çmimeve në kundërshtim me kontratën e punimeve.

Brenda datës 31.12.2026

4. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi i kontratës me nr. 9542 prot., datë 12.12.2024 *"Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kujanit"*, me Kontraktorit BOE "K .K." Shpk & "C .M." Shpk dhe me vlerë të kontratës 149,584,878 lekë me TVSh, u konstatuan mangësi në lidhje me afatin e zbatimit të kontratës. Afati i zbatimit të punimeve është 6 muaj nga fillimi i punimeve. Njoftimi i fillimit të punimeve është data 18.12.2024, ku punimet duhet të përfundonim më 18.06.2025. Me Amendimin e kontratës nr. 1, nr. 4915/1 prot., datë 17.06.2025, palët ranë dakord të ndryshojnë afatin e ekzekutimit të punimeve deri më datë 17.12.2025.

Nga auditimi i dokumentacionit të venë në dispozicion, u konstatua se sipërmarrësi i punimeve *<u>ka dështuar në përfundimin e punimeve</u>* dhe nuk ka arritur të përfundojë objektin më datë 17.12.2025, ku nga Bashkia janë realizuar të gjitha njoftimet e nevojshme për përfundimin e punimeve dhe kushteve të kontratës në rastet e mos përfundimeve. Referuar faturave të punëve me volume, nga Drejtoria e financës së Bashkisë Roskovec janë realizuar 4 situacione progresive, ku vlera e ngelur e pazbatuar në kohë (*<u>korresponduese)</u>* është 47,788,717 lekë me

TVSh > 25 % e vlerës së kontratës. Referuar datës që duhej të përfundonin punimet 17.12.2025, rezultoi se kontraktori nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale dhe ato që rrjedhim nga Ligji nr. 7850 datë 29.07.1994 "*Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, duke vonuar punimet më shumë se 6 muaj vonesë (*llogaritur deri më 1 Qershor 2026*) plot 165 ditë vonesë. Në total rezultoi se 165 ditë x 47,788,717 lekë x 4/1000 ditë = **31,540,553 lekë**, e cila konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe Bashkisë Roskovec, për shkak të vonesave në përfundimin e punimeve.
Grupi i auditimit, në vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur gjatë kohës së auditimit në terren dhe observacion, konstatoi se dokumentet e paraqitura nga subjekti pas përfundimit të verifikimeve në terren përmbajnë elemente shtesë lidhur me rrethanat që kanë ndikuar në ecurinë dhe përfundimin e punimeve, përfshirë përmbytjet, kushtet atmosferike, furnizimin me energji elektrike dhe përfundimin e punimeve më datë 10.07.2026. Për shkak se një pjesë e këtij dokumentacioni është krijuar ose është vënë në dispozicion pas përfundimit të verifikimeve në terren të grupit të auditimit, si dhe duke qenë se dokumentacioni i paraqitur kërkon verifikim të mëtejshëm të lidhjes shkakësore ndërmjet rrethanave të pretenduara dhe ditëve konkrete të vonesës, grupi i auditimit mban në konsideratë vlerën prej 31,540,553 lekë si vlerë e dëmit ekonomik nga dokumentacioni i vënë në dispozicion gjatë auditimit në terren. Megjithatë, nga dokumentacioni i administruar dhe nga vetë procesi i zbatimit të kontratës rezulton se punimet nuk kanë përfunduar brenda afatit kontraktual dhe se ekziston nevoja për përcaktimin e saktë të periudhës së vonesës që i atribuohet sipërmarrësit, duke veçuar periudhat e shkaktuara nga rrethana objektive të dokumentuara dhe të justifikuara sipas kushteve të kontratës. Për sa më sipër, grupi i auditimit mban si konstatim faktin e vonesës në realizimin e kontratës dhe nevojën për aplikimin e penaliteteve kontraktuale sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së auditimit në terren.
4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe Drejtorinë e Planifikim, Kontroll dhe Zhvillimit Territorit të Bashkisë Roskovec, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **31,540,553 lekë** nga kontraktori "K.K." Shpk & "C.M." Shpk, e llogaritur sipas dokumentacioneve të vëna në dispozicion grupit të auditimit, për mos përfundimin të afatit të punimeve.

Brenda datës 31.12.2026

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "*Rrugë parcele në fshatrat e NJA Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan, Bashkia Roskovec për vitin 2024*", me fond limit 24,314,627 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 16,293,750 lekë pa TVSH procedurë e cila është fituar nga OE "R. M. C" ShPK, u konstatua se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik "R.M.C." ShPK, megjithëse oferta e paraqitur prej tij nuk ishte në përputhje me dokumentet e tenderit. Nga verifikimi i Shtojcës 2 "Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit" rezultoi se për Njësinë Administrative Strum operatori ekonomik kishte përfshirë dy herë sasitë dhe vlerat përkatëse, ndërkohë që në preventivin e hartuar nga Autoriteti Kontraktor këto zëra ishin kërkuar vetëm një herë. Si rezultat i këtij dublimi, oferta rezulton me një vlerë prej rreth 843,000 lekë më të lartë krahasuar me vlerën që do të rezultonte nga zbatimi korrekt i preventivit të Autoritetit Kontraktor. Nga të dhënat e vëna në dispozicion rezultoi se kjo vlerë nuk është reflektuar në likuidimin e kontratës pra nuk është paguar . Veprimet e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave kanë cënuar

parimin e përdorimit me ekonomicitet dhe efektivitet të fondeve publike, pasi oferta fituese nuk është verifikuar në përputhje me dokumentet e tenderit dhe nuk është siguruar që vlerësimi është kryer mbi baza të sakta dhe të krahasueshme. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 2 "*parimet e prokurimit publik*"; neni 76 (shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave); neni 92 (shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 82.

1.1.Rekomadimi: Titullari e Autoritetit Kontraktor, të marrë masa për garantimin e një procesi të plotë dhe të dokumentuar të vlerësimit të ofertave nga KVO, në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionit në fuqi, si dhe për nxjerrjen e përgjegjësive për rastet e mospërputhjeve të konstatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë Roskovec për shitje me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tij u konstatua se, për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 11 subjekte nga të cilat 2 subjekte janë të pajisura me autorizim me afat me 5 vjet për lejim ushtrim aktiviteti dhe kanë kryer pagesë për vlerën e plotë prej 1,000,000 lekë dhe 9 subjekte që nuk janë pajisur me autorizime, duke sjellë të ardhura të munguara në shumën 9,000,000 lekë për buxhetin e Bashkisë Roskovec. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 *"Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre",* i ndryshuar, ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, nenet 4,15 dhe 20/2" dhe me VKM nr. 970, datë 02.12.2015, *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj"*, kreu II, pika 3, pika 15.1 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore për pajisjen me autorizim të 9 subjekteve ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe gazit, duke vijuar dhe me arkëtimin e tarifave përkatëse.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Roskovec, rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë për taksat dhe tarifat vendore, ku në fund të vitit 2024 vlera debitorëve është 214,966,854 lekë, shtesat gjatë vitit 2025 janë në shumën 67,127,100 lekë, ndërsa arkëtimet në shumën 51,680,406 lekë. Në fund të vitit 2025 debitorët janë në shumën progresive prej 230,413,548 lekë, e cila përbëhet nga:

-Detyrimet debitore nga biznesit i madh dhe i vogël në shumën 26,749,971 lekë.

-Detyrimet debitore nga familjarët në shumën 203,663,577 lekë. Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga taksapaguesit debitorë ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Roskovec në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, nenet 6 dhe 9/pika 1.3. Drejtoria e Taksave Vendore në Bashkinë Roskovec për vjeljen e detyrimeve është mjaftuar me nxjerrjen e njoftim-vlerësimeve për detyrimin dhe një numri të kufizuar të masave shtrënguese dhe nuk janë aplikuar të gjitha masat administrative dhe ligjore, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 *"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Kreu XI *"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara",* nenet 89, 90, 91 dhe 93 dhe me VKB nr. 71, datë 25.11.2024 *"Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025"*.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjekë të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitore në shumën 230,413,548 lekë nga subjektet e biznesit dhe taksapaguesit familjarë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua një praktikë në të cilën taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e saktë sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi. Përllogaritja e gabuar ka ndodhur pasi vlera e taksës nuk është llogaritur sipas vlerës së çmimit të shitjes së njësive të shërbimit për metër katror, por sipas vlerës së preventit. Gjithashtu, nga verifikimi i projektit teknik u konstatuan diferenca të sipërfaqeve të ndërtimit.
Përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: **1.**"*Shtesë anësore 1 kat në objektin ekzistues magazinë shërbimi*", për të cilën është marrë vendimi Nr. 03, datë 04.09.2025, me zhvillues z. D.H. dhe subjekt ndërtues shoqëria "K." ShPK, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë **2,852,434 lekë,** që përbën dëm ndaj buxhetit të njësisë vendore. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me Nenin 46 të Ligjit 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar ; me Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për *"Sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar; me Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.101, datë 30.11.2023, "*Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2024 të Bashkisë Roskovec*", pika 1.3; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.71, datë 25.11.2024, "*Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025 të Bashkisë Roskovec*", pika 1.3.
4.1. Rekomandim: Bashkia Roskovec të marrë masa për arkëtimin e vlerës **2,852,434 lekë**, që përbën të ardhura të munguara për bashkinë, si pasojë e përllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shte*tit"; shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 të Ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*"; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civi*l"; nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "*Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë*", kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i **rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Roskovec** të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH–së, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si vijon:

E.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.
a. Në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore është **"Vërejtje"** përkatësisht:
1. znj. S.P., me pozicion përgjegjëse në Sektorin e Lejeve të Ndërtimit të Bashkisë Roskovec, për parregullsitë e konstatuara në 3 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe në 1 rast të miratimit të certifikatës së përdorimit, përkatësisht në lejet me objekt:
-"*Magazinë Buqësore 1-kat*", për të cilën është marrë Vendimi nr. 08, datë 08.08.2024;
-"*Stallë për mbarështimin e lopëve*", për të cilën është marrë Vendimi nr.01, datë 27/02/2025;
-*"Shtesë anësore 1 kat në objektin ekzistues magazinë shërbimi"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 03, datë 04.09.2025;
-*"Ndërtim objekti 6 kate"*, për të cilën është marrë Vendimi nr.03, datë 31.12.2025.

2. znj. O.G., me pozicion drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore të Bashkisë Roskovec, për pasaktësitë e konstatuara në 2 raste në llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, përkatësisht në lejet e miratuara me objekt:
- "*Shtesë anësore 1 kat në objektin ekzistues magazinë shërbimi*", për të cilën është marrë vendimi nr. 03, datë 04.09.2025;
- *"Godinë 1 kat banimi"*, për të cilën është marrë Vendimi nr.07, datë 11.07.2024.
në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik në mënyrë të përsëritur, për 11 raste për procedurat me objekt "*Rrugë parcele në fshatrat e NJA Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan*", "*Ndërtim i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të*", *"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në qytetin Roskovec", "Blerje dhe instalimi i 3 pemëve "Smarfloëer"dhe ndërtim stacioni komercial të EV për makinat elektrike"*, *"Rikonstruksion i rrugës "Kozma Prifti*", fshati Marinëz, (905 + 265 ml , b= 4 m+0.5 bankin), "*Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit*", "*Kompleksi i terreneve sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën 5 Dëshmorët*", Suk 1", *Mbrojtje nga lumi Seman në krahun e majtë, Zona Suk, Bashkia Roskovec*".
"*Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kuman*", *"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në qytetin Roskovec", "Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kurjan*", "*Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit*".
3. **z. M.L.,** në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik në mënyrë të përsëritur, në 4 raste për procedurat me objekt: *"Rikonstruksion i rrugës "Kozma Prifti*", fshati Marinëz, (905 + 265 ml , b= 4 m+0.5 bankin), "*Kompleksi i terreneve sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën 5 Dëshmorët*", Suk 1", "*Ndërtim i parkut te ri të qytetit*", "*Ndërtim i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të*", "*Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregtare": Faza 1 "Punime për bazamentin e fushës së futbollit*".
4. **z. A.D.**, në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik në mënyrë të përsëritur; në 2 raste për procedurat me objekt *"Rikonstruksion i rrugës "Kozma Prifti*", fshati Marinëz, (905 + 265 ml , b= 4 m+0.5 bankin, *"Blerje dhe instalimi i 3 pemëve "Smarfloëer"dhe ndërtim stacioni komercial të EV për makinat elektrike"*.
5. z. M.G., në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik në mënyrë të përsëritur; për 11 raste për procedurat me objekt :"Rrugë parcele në fshatrat e NJA Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan", "*Ndërtim i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të*", *"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në qytetin Roskovec", "Blerje dhe instalimi i 3 pemëve "Smarfloëer"dhe ndërtim stacioni komercial të EV për makinat elektrike"*, "*Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit*", 1", *Mbrojtje nga lumi Seman në krahun e majtë, Zona Suk, Bashkia Roskovec*", "*Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit*". "*Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kuman*", *"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në qytetin Roskovec", "Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kurjan*", "Rrugë parcele në fshatrat e NJA Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan"
6. znj. D.H., në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik në mënyrë të përsëritur, për 5 raste për procedurat me objekt: "Rrugë parcele në fshatrat e NJA Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan", "*Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit*", "Rrugë parcele në fshatrat e NJA Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan", "*Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kuman*", *"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në qytetin Roskovec"*

7. **z. D.S.**, në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik në mënyrë të përsëritur, për 10 raste për procedurat me objekt: "*Rrugë parcele në fshatrat e NJA Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan"*, "*Ndërtim i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të*", *"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në qytetin Roskovec",* "*Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit*", "*Kompleksi i terreneve sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën 5 Dëshmorët*", Suk 1", *Mbrojtje nga lumi Seman në krahun e majtë, Zona Suk, Bashkia Roskovec*", "*Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregtare": Faza 1 "Punime për bazamentin e fushës së futbollit*" "*Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kuman*", *"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në qytetin Roskovec", "Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kurjan*", "*Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit*".

8. z. M.P., në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik në mënyrë të përsëritur në 3 raste për procedurat me objekt: "*Kompleksi i terreneve sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën 5 Dëshmorët*", Suk 1" "*Ndërtim i parkut të ri të qytetit*", "*Ndërtim i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të*".

E.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre.

a. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte **"Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një periudhë deri në 2 vjet"** deri në **"Largim nga shërbimi civil"** përkatësisht:

1. Znj. E.H., me pozicion drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për parregullsitë e konstatuara në **4 raste** të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe në **1 rast** në miratimin e certifikatës së përdorimit, përkatësisht në lejet me objekt:

-"*Magazinë Bujqësore 1-kat*", për të cilën është marrë Vendimi nr. 08, datë 08.08.2024;
-"*Stallë për mbarështimin e lopëve*", për të cilën është marrë Vendimi nr.01, datë 27/02/2025;
-*"Shtesë anësore 1 kat në objektin ekzistues magazinë shërbimi"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 03, datë 04.09.2025;
-*"Godinë 1 kat banimi",* për të cilën është marrë Vendimi nr.07, datë 11.07.2024;
-*"Ndërtim objekti 6 kate"*, për të cilën është marrë Vendimi nr.03, datë 31.12.2025.

Në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik në mënyrë të përsëritur, për 10 raste për procedurat me objekt: "Rrugë parcele në fshatrat e NJA Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan", "*Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit*", "Rrugë parcele në fshatrat e NJA Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan", "*Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kuman*", *"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në qytetin Roskovec",* "*Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregtare": Faza 1 "Punime për bazamentin e fushës së futbollit*", *"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kurjan*", "*Ndërtim i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të*", "*Ndërtim i parkut te ri të qytetit*".

2. Znj. R.B., me pozicion specialiste për mbrojtjen mjedisit, për parregullsitë e konstatuara në **3 raste** të miratimit të lejeve të ndërtimit me objekt:

-"*Magazinë Bujqësore 1-kat*", për të cilën është marrë Vendimi nr. 08, datë 08.08.2024;
-"*Stallë për mbarështimin e lopëve*", për të cilën është marrë Vendimi nr.01, datë 27/02/2025;
-*"Godinë 1 kat banimi",* për të cilën është marrë Vendimi nr.07, datë 11.07.2024.

3. Znj. E.H., me pozicion përgjegjëse në Sektorin e Lejeve të Ndërtimi, për parregullsitë e konstatuara në **2 raste** të miratimit të lejeve të ndërtimit me objekt:

-"*Magazinë Bujqësore 1-kat*", për të cilën është marrë Vendimi nr. 08, datë 08.08.2024;
-*"Godinë 1 kat banimi",* për të cilën është marrë Vendimi nr.07, datë 11.07.2024.

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, pas përfundimeve të afateve ankimore, Bashkia Roskovec, *të ndërmarrë veprimet si më poshtë*:
a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013, *"Për Nëpunësin Civil"* i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013, *"Për Nëpunësin Civil"* i ndryshuar.

G. MASA ADMINISTRATIVE

G.1 INSPEKTORATIT TË MBROJTJES SË TERRITORIT, BASHKIA ROSKOVEC

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12, kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, kreu II, Pika 3, të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*" i ndryshuar (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014, datë 01.04.2013 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", **i rekomandojë**, Titullarit të Bashkisë Roskovec, t'i kërkojë **Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Roskovec,** sipas kontratave respektive, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të nxjerrë vendime për marrjen e masave dhe sanksioneve administrative për:
1. Subjekti OE **"S." Shpk**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën nr. 9542 prot., datë 12.12.2024 *"Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kujanit",* me Kontraktorit BOE "K. K." Shpk &
"C .M." Shpk dhe me vlerë të kontratës 149,584,878 lekë me TVSh, për vonesa të zbatimit të punimeve në vlerën **31,540,553 lekë.**

2. Subjekti BOE **"A." & "L-I" ShPK**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën nr. 7688 prot., datë 27.09.2024 *"Ndërtimi i parkut të ri të qytetit, Bashkia Roskovec",* me Kontraktorit OE "N." Shpk dhe me vlerë të kontratës 22,394,155 lekë pa TVSh për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën **828,480 lekë pa TVSh**.
- Në kontratën nr. 6510 prot., datë 19.08.2024 me objekt "*Kompleksi i Terreneve Sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën "5 Dëshmorët", Suk 1",* me Kontraktorit OE "Z.K" Shpk dhe me vlerë të kontratës 39,711,166 lekë pa TVSh për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën **978,300 lekë pa TVSh**.

3. Subjekti OE **"M. P." ShPK**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën nr. 6894 prot., datë 02.09.2024 me objekt *"Mbrojtje nga lumi Seman në krahun e majtë zona Suk Bashkia Roskovec"*, me Kontraktorit BOE "B." & "L." Shpk dhe me vlerë të kontratës 34,984,098 lekë pa TVSh, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën **1,284,890 lekë pa TVSh.**

4. Për shoqërinë **"R. C." ShPK,** në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve, i cili ka filluar punimet e zbatimit të kontratës "*Rrugë parcele në fshatrat e NJA Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan*", pa pasur leje ndërtimi në kundërshtim me nenin 39, të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*" i ndryshuar, sipas të cilit leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim.

5. Për shoqërinë **"C .M." ShPK,** në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve, i cili ka filluar punimet e zbatimit të kontratës "*Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Strum*", pa pasur leje ndërtimi në kundërshtim me nenin 39, të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*" i ndryshuar, sipas të cilit leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim.

6. Për shoqërinë **"OE "N." ShPK,** në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve, i cili ka filluar punimet e zbatimit të kontratës "*Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kuman*", pa pasur leje ndërtimi në kundërshtim me nenin 39, të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*" i ndryshuar, sipas të cilit leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim.

7. Për shoqërinë **"E. C." ShPK,** në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve, i cili ka filluar punimet e zbatimit të kontratës *"Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kurjan*", pa pasur leje ndërtimi në kundërshtim me nenin 39, të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*" i ndryshuar, sipas të cilit leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim.

F.2 AGJENCICË SË PROKURIMIT PUBLIK

Mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, "Për Organizim in dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; nenin 23 pika "e" dhe neni 132 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar **i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik**, që referuar shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimit të zhvilluara në **Bashkinë Roskovec** të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit *(pika 5 e Raportit Përfundimtar të Auditimit faqe 45-142)* të marrë masa disiplinore e administrative për anëtarët e Njësisë së Prokurimit, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, sipas përcaktimeve të Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar neni 129, "Procedura e hetimit administrativ" pika 1, germa "a", për procedurat e prokurimit me objekt si më poshtë:

1. Procedura e prokurimit me objekt: "*Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit*", me fond limit 153,009,860 lekë pa TVSH, ku fitues është shpallur operatori ekonomik **"**C. M." & "K.K." ShPK, me vlerë kontrate 125,436,315 lekë pa TVSH.
2. Procedura e prokurimit me objekt: "*Rrugë parcele në fshatrat e NJA Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan*", me fond limit 24,314,627 lekë pa TVSH, ku fitues është shpallur operatori ekonomik "R. M. C." ShPK, me vlerë kontrate 16,293,750 lekë pa TVSH.
3. Procedura e prokurimit me objekt: "*Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në qytetin Roskovec*", me fond limit 30,864,728 lekë pa TVSH, ku fitues është shpallur operatori ekonomik "E. C." ShPK, me vlerë kontrate 19,863,000 lekë pa TVSH.

4. Procedura e prokurimit me objekt: "*Rikonstruksion i rrugës 'Kozma Prifti", fshati Marinëz (905 + 265 ml, b = 4 m + 0.5 bankinë)*", me fond limit 59,111,172 lekë pa TVSH, ku fitues është shpallur operatori ekonomik "R.U." ShPK, me vlerë kontrate 41,383,400 lekë pa TVSH.
5. **Procedura e prokurimit me objekt:** "*Kompleksi i terreneve sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën '5 Dëshmorët', Suk 1*", me fond limit 41,539,346 lekë pa TVSH, ku fitues është shpallur operatori ekonomik "Z. K." ShPK, me vlerë kontrate 33,092,638 lekë pa TVSH.
6. **Procedura e prokurimit me objekt:** "*Mbrojtje nga lumi Seman në krahun e majtë, Zona Suk, Bashkia Roskovec*", me fond limit 41,520,230 lekë pa TVSH, ku fitues është shpallur operatori ekonomik "B." ShPK, me vlerë kontrate 29,153,415 lekë pa TVSH.
7. **Procedura e prokurimit me objekt:** "*Ndërtim i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të*", Suk 1, me fond limit 36,731,666 lekë pa TVSH, ku fitues është shpallur operatori ekonomik "B." ShPK, me vlerë kontrate 24,766,467 lekë pa TVSH.
8. **Procedura e prokurimit me objekt:** "*Blerje dhe instalimi i 3 pemëve 'Smarfloëer' dhe ndërtim stacioni komercial të EV për makinat elektrike*", me fond limit 11,250,000 lekë pa TVSH, ku fitues është shpallur operatori ekonomik "A." ShPK, me vlerë kontrate 10,651,490 lekë pa TVSH.
9. **Procedura e prokurimit me objekt:** "*Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregtare", Faza "Punime për bazamentin e fushës së futbollit*", me fond limit 20,708,484 lekë pa TVSH, ku fitues është shpallur operatori ekonomik "A.C." ShPK, me vlerë kontrate 13,808,849 lekë pa TVSH.
10. Procedura e prokurimit me objekt: "*Ndërtim i parkut të ri të qytetit*", me fond limit 18,661,795lekë pa TVSH, ku fitues është shpallur operatori ekonomik "N.," ShPK, me vlerë kontrate 18,661,795 lekë pa TVSH.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike.